XHEVAT MEHA

SYNI DHE MENDJA E QYTETARIT PËRBALLË SHËRBIMEVE TË MSHEFTA SERBE

Fishta
SHPIA BOTUESE
Prishtinë
2016

Recensent:

FADIL KAJTAZI

NEXHMEDIN SPAHIU

Lektor:

HALIL XANI

XHEVAT MEHA

SYNI DHE MENDJA E QYTETARIT PËRBALLË SHËRBIMEVE TË MSHEFTA SERBE

Jishta
SHPIA BOTUESE
PRISHTINË, 2016

Përmbajtja

FJALË HYRËSE 9
PARATHËNIE 17

KAPITULLI I PARË

NEVOJA DHE ARSYESHMËRIA PËR NDRIÇIMIN E VEPRIMTARISË SË SHËRBIMEVE TË MSHEFTA TË SERBISË NË KOSOVË 23
DALJA NË PUBLIK E INFORMACIONEVE RRETH VEPRIMTARISË SË SHMS-VE NË KOSOVË 27
SHMS-TË DHE NDËRTIMI I SHTETIT TË KOSOVËS 32
PROGRAMET E NJËPASNJËSHME TË SERBISË PËR KOSOVËN .. 34
A ËSHTË KOSOVA NË FAZËN E NEOKOLONIALIZMIT NGA SERBIA? 36
SYNI DHE MENDJA E QYTETARIT PËRBALLË VEPRIMTARISË SË SHMS-ve 37
NDRIÇIMET E DERITANISHME TË VEPRIMTARISË SË SHMS-ve NË KOSOVË 39
NEVOJA PËR DEKONSPIRIM TË VEPRIMEVE DHE PROGRAMEVE TË SHMS-VE 43
MOTIVET DHE SYNIMET E AUTORIT 47

KAPITULLI I DYTË

VEÇORITË DHE ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË VEPRIMTARISË SË SHMS-ve 53
NDËRTIMI I SISTEMEVE DEGRADUESE TË VLERAVE SHOQËRORE NJERËZORE 55
NDËRHYRJA NË PËRZGJEDHJEN E BARTËSVE TË VLERAVE SHOQËRORE NJERËZORE 60
KRYERJA E DETYRAVE TË SHMS-VE NË KOSOVË 62
SI MUND TË SHIHET DHE TË NJIHET SPIUNI ME BETIM SI I DYSHUAR 64
KULTURA E MOSZBATIMIT TË LIGJIT 70
LIDHJA DHE KONTROLLI I "MBITOKËS" NGA "NËNTOKA" 74
E MAJTA DHE E DJATHTA NË KOSOVË DHE SHMS-të 76
PËRDORIMI NGA SHMS-të I SITËS NË VEPRIMTARINË E PARTIVE POLITIKE 81
VLERAT E LUFTËS SË UÇK-SË DHE SHMS-të 87

VEPRIMET E SHMS-VE NË VEPRIMTARINË BIZNESORE..... 97
FUQIZIMI I HAJNISË MASIVE Thënia e gjyshit të autorit, Milazim Qerim Mehaj: "Ai që vjedh shpinë e vet, shpi nuk mun me ba"..... 99
FUQIZIMI I RRENËS DHE MASHTRIMIT NË KURRIZ TË SINQERITETIT DHE KORREKTËSISË Thënia e gjyshit tim: "rrena, hajnia dhe kurvnia shkojnë bashkë"..... 102
FUQIZIMI I TRADHTISË NË KURRIZ TË BESNIKËRISË..... 103
FUQIZIMI I PAPËRGJEGJËSISË NË KURRIZ TË PËRGJEGJËSISË104
FUQIZIMI I IMPROVIZIMIT PROFESIONAL NË KURRIZ TË PROFESIONALIZMIT..... 106
KRIJIMI DHE FUQIZIMI I KONFLIKTEVE DHE NGATËRRESAVE NDËRNJERËZORE SI METODË E VJETËR "PËRÇAJ E SUNDO" . 110
KRIJIMI I FRONTEVE "NE DHE ATA"..... 113
FUQIZIMI I LIDHJES SË INTERESAVE PERSONALE ME SHKELJE LIGJORE DHE KRIMINALITET..... 115
INFILTRIMI DHE FILTRIMI I INDIVIDËVE NË NDËRTIMIN E INSTITUCIONEVE DHE JETËN INSTITUCIONALE..... 118
INSTALIMI I "RANKOVIQIZMIT" NË PERIUDHËN E PASLUFTËS SË FUNDIT Thënie: "Historia që nuk mësohet, përsëritet"..... 121
NIVELI I BESIMIT DHE I BESNIKËRISË NDAJ SERBISË SI THEMEL PËR NIVEL TË HIERARKISË..... 123
KRIJIMI I SHTRESËS SË "TË PUSHTETSHMËVE" SI SHTRESË E "TË PAPREKSHMËVE"..... 126
MAKINERIA E SHTYPJES DHE LARTËSIMIT TË VLERAVE SHOQËRORE NJERËZORE 130
VEPRIMTARIA E SHIKU-UT DHE SIA-së SI FILIALA TË SHMS-ve, NË KOSOVË 134
PSE INDIVIDËT BËHEN SPIUNË ZYRTARË ME BETIM A BASHKËPUNËTORË TË SHMS-VE..... 139
FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË SHMS-ve..... 141
SI DUHET TRAJTUAR SPIUNËT ZYRTARË ME BETIM DHE BASHKËPUNËTORËT E SHMS-ve 144

KAPITULLI I TRETË

RASTET DHE BARTËSIT KONKRETË TË VEPRIMEVE TË DYSHUARA TË SHMS-ve..... 151
PARAQITJA E DËSHMIVE TË VEPRIMEVE KONKRETE DHE BARTËSVE KONKRETË SI BAZË PËR NGRITJEN E DYSHIMEVE TË BAZUARA Një ndodhi e treguar:..... 153
PSE AUTORI U BË CAK I GODITJEVE NGA SHMS-të?..... 155
VEPRIMET E SHMS-VE KUNDËR MEHAJVE..... 159

FJALË HYRËSE

Libri "Syni dhe mendja e qytetarit përballë shërbimeve të mshefta serbe" , libri i parë që në mënyrë metodike ia ka dalur ta demaskojë veprimtarinë e shërbimeve të fshehta serbe

Vështrim i përgjithshëm

Qëkur njeriu ka filluar të merret me aktivitete politike, zënë fill edhe "instrumentet" përmes të cilave sendërtohen, arrihen dhe mbrohen qëllimet e artikuluara nga politika. Dhe "instrumenti" më kompleks i arritjeve të këtyre qëllimeve është përdorimi i dhunës së organizuar fizike me anë të armëve që ne e njohim si luftë, dhe kushtimisht, ajo duhet të jetë ndër zanatet më të vjetra të njeriut. Krahas zhvillimeve të përgjithshme shoqërore, u zhvilluan edhe mënyrat dhe metodat për zhvillimin e luftës, por prirja për të ushtruar dhunë deri në ekstrem për arritjen e qëllimeve, mbeti brenda natyrës së saj, dhe kjo e bën luftën të jetë si nga veprimtaritë më të vështira dhe më të rrezikshme shoqërore.

Fitorja mbi armikun, është qëllim i ndërmarrjeve ushtarake, por të njëjtin synim ka edhe armiku i cili ia mësyn me të gjitha kapacitetet që ka në dispozicion. Kjo gjendje përpos se shkakton shpenzime të mëdha, krijon edhe rrezik, pasi në një ndeshje për jetë a vdekje, fitorja dhe humbja rrinë bashkë.

Gjatë historisë së njerëzimit, ka shumë shembuj kur politikan dhe gjeneralë aventurierë, nuk kanë vlerësuar rrezikun që në vetvete ka lufta dhe janë hedhur në të pa menduar shumë, ndërkohë që pasojat kanë qenë fatale. Si shkak i zhdukjes së shumë popujve dhe shteteve të antikitetit dhe mesjetës që njeh historia, është edhe mosvlerësimi i rrezikut që ka në vetvete lufta, si fenomen shoqërorë. Ne si shqiptarë, si pasardhës të popullit të lashtë ilir, duhet ta marrim në konsideratë më shumë se çdokush këtë fakt, nga se

historia jonë e vështirë, më se dy mijë vjeçare, u determinua nga një gabim fatal, dhe do të thosha edhe aventurier, i hyrjes në luftë me superfuqinë botërore të kohës, Perandorinë Romake.

Mbi bazë të vlerësimeve për rreziqet që shkaktohen nga lufta, gjatë historisë, shquhen politikanë dhe gjeneralë të urtë, të cilët përpunuan metoda për një formë tjetër të luftimit duke bërë që të nënshtronin ármiqtë pa përdorimin e armëve. Ata kanë vërejtur se shikuar nga prizmi kushtueshmëri-dobi (cost-benefit), kjo formë e luftimit po pati sukses, ka kosto shumë të vogël e përfitim të madh, dhe po ashtu, edhe nëse dështon, humbjet janë shumë më të vogla në krahasim me ato që do të shkaktoheshin nga ndërmarrja e aksioneve ushtarake.

Në literature, kjo formë, njihet me emërtimin si "Lufta speciale" dhe boshti i mbështetjes së saj, është operacioni i fshehtë. Ndonëse emërtimi për të është i ri dhe përkon me shekullin e kaluar, ajo historikisht evidentohet të jetë aplikuar që në agun e lindjes së qytetërimit botëror, diku rreth 4600 vite më parë, në qytetet-shtete sumere. Arkeologët kanë deshifruar një pllakë argjile të shkruar nga një autor anonim sumer, i cili përshkruan aktivitetet subversive të ndërmarra nga Ermekari, mbreti i Erahut, qytet në jug të Mesopotamisë, i cili ja arrin që përmes operacioneve të fshehta ta nënshtrojë qytetin shtet të Aratës.

Ndërkohë, që metodat për zhvillimin e luftës speciale të shkruara në literaturë, për herë të parë hasim në librin "Arti i luftës", të shkruar nga kinezi Sun Xu, në mes të shekullit III dhe IV p.e.r.. Ndonëse libri "Arti i luftës" është një doktrinë mbi mënyrën e zhvillimit të luftës, një pjesë e konsideruar e tij, u kushtohet aksioneve të fshehta, apo më mirë të themi, sipas Sun Xusë, aksioni i fshehtë është pjesë e pandashme, e në të shumtën e rasteve, duhet paraprirë aksioneve ushtarake. Për të rrumbullakuar konstatimet e kinezit gjenial, mund të themi se ai porosit udhëheqësit shtetërorë dhe ushtarakë që ta shmangin luftën, atë ta zhvillojnë vetëm për nevoja ekstreme dhe përparësi t'i jepet aksionit të fshehtë. Në një nga versetet e librit të tij, ai porositë: "T'i mbërrish njëqind fitore, në njëqind beteja, nuk është kulmi i zotësisë, por ta mundësh armikun pa asnjë betejë, është kulmi i zotësisë... Kush e njeh mirë artin e luftës, ai di të mposhtë ushtrinë armike pa betejë. Pushton qytetet armike pa i rrethuar dhe përmbysur një shtet pa operacione të gjata"

Termi "duke shkaktuar dhe menaxhuar kriza" është termi modern i përkufizimit i të gjitha mënyrave të deritanishme të zhvillimit të aksioneve të fshehta, që nga antikiteti e deri më sot. Edhe pse gjatë shekujve ato janë

rafinuar e përpunuar, thelbi i tyre mbetet po ai për të cilën edhe filluan të organizohen këto aksione.

Vështrim mbi librin

Pas disfatës ushtarake që pësoj Serbia, në përpjekje për ta mbajtur nën sundim Kosovën, ajo, për shkak të konstelacionit të forcave, për momentin, ka hequr dorë nga aksioni ushtarak, por në mënyrë intensive dhe sistematike është duke bërë agresion përmes aksioneve të fshehta. Libri "Syni dhe mendja e qytetarit përballë shërbimeve të mshefta serbe" i autorit Xhevat Meha, është i vonë dhe i rrallë në krahasim me fillimin e aksioneve të fshehta serbe në drejtim të popullit tonë. Por është ndër të paktët dhe të parët, që në mënyrë metodike ia ka dalur ta demaskojë këtë veprimtari.

Shteti serb, përmes shërbimeve të veta, agresionin në drejtim të shqiptarëve e fillon që në vitin 1844, ku në elaboratin famëkeq "Naçertanije", krijohen shabllonet e veprimtarisë së fshehtë në drejtim të popujve joserb të Ballkanit, me theks të veçantë kundër shqiptarëve, e të cilat që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, kanë ruajtur kontinuitetin e veprimit. Autori Meha, pa iu referuar literaturës dhe pa i hyrë historisë, por në mënyrë analitike, konstaton vështirësitë e konsolidimit shoqëror të popullit shqiptar, në hapësirat ballkanike, ku me theks spikatë lindjen e vështirë të shtetit të Kosovës si dhe funksionalizimin e tij. Ai ia ka dalur që të analizojë dhe të piketojë veprimtarinë subversive të shërbimeve të fshehta serbe si faktorin kryesor i cili ngadalëson funksionalizimin dhe herë-herë e çon drejt rrënimit të shtetit të Kosovës.

Ndonëse autori në këtë fushë vjen nga një profesion tjetër, ia del që natyrshëm të shtjellojë dhe të vë në pah aksionet e fshehta të shërbimeve serbe, të cilat përmes agjenturës masive, ia kanë arritur të ndikojnë që jeta jonë shoqërore të futet në rrjedha të gabuara në fushat politike, ekonomike, ushtarake, kulturore, shkencore, fetare etj". E veçanta e kundrimit të autorit Meha në këtë punim është fakti se ai ka shfrytëzuar përvojën e vet prej kontabilisti dhe të revizionit financiar, për të identifikuar shabllonet e vjetra, por efektive, të veprimeve të fshehta në drejtim të shqiptarëve, e të cilat përfshin:

1. Kamuflimin e veprimtarisë së fshehtë deri në masën që ajo të duket gjë e rëndomtë, duke e reduktuar në nivelin e një fatkeqësie elementare

   Veprimtaria e shërbimeve të fshehta është e kamufluar dhe sikur mos të ishte e tillë, ajo do të identifikohet lehtë dhe efektet e saj nuk do të

kishin pasoja. Që në fillim, autori e kapë këtë shabllon të veprimtarisë së shërbimeve serbe, duke dhënë shembuj nga praktika e përditshmërisë, mbi krijimin e efekteve negative shoqërore, të cilat, neve na duken sporadike dhe të natyrshme, pasi lënë përshtypjen se janë të krijuara nga inercia e përditshmërisë, e që në fakt prodhojnë efekte të këqija për shtetin tonë. Simbolikisht, autori këtë shabllon e quan "errësirë" e që praktikisht nënkupton "fshejen" e kësaj veprimtarie, duke luajtur në mes të asaj që është e ligjshme dhe e kundërligjshme, e që konsiston në zhvillimet e operacioneve të "intensitetit të ulët", me qëllim të përgatitjes së fazës së hapjes së një "konflikti jokonvencional" , i cili do të përqëndrohet në taktikat jo të dhunshme, por edhe jo të ligjshme, që kryesisht kanë të bëjnë me nxitje për të mos zbatuar ligjet e Kosovës. Në terren, taktika e realizmit konsiston në: përkrahjen e grupeve të caktuara që kundërshtojnë realitetin politik; nxitjen dhe përkrahjen e aksioneve terroriste; propaganda gri; propaganda e zezë; mbështetjen e personaliteteve të caktuara me ndikim në fushën e mediave, kulturore, fetare e sportive; ndihmën e organizatave që kanë ndikim në jetën publike; mbështetjen e bizneseve të papastra, nxitjen e korrupsionit, mbështetjen e krimit të organizuar, etj. Të gjitha këto, do të jenë trajtim i thuktë në këtë libër, ku autori në mënyrën e vet origjinale e shkoqit gjenezën dhe efektet masive të kësaj veprimtarie, duke e dhënë porosinë, por edhe zgjidhje njëkohësisht, e që sipas tij është "ndriçimi i kësaj veprimtarie është eliminimi i errësirës"

2. Sulmin masiv mbi popullatën ose grupet që e masivizojnë efektin

Sulmi masiv ndaj popullatës ose grupeve që e masivizojnë efektin, si një nga shabllonet përmes të cilave krijohen efektet e pritura, është pjesa që më së shumti zë vend në këtë libër. Pikënisja e trajtesës së veprimit të shërbimeve të fshehta serbe, përmes këtij shablloni, për autorin është një debat, në një nga televizionet tona, i transmetuar në fund të janarit të vitit 2014, ku nga të ftuarit në emision, bëhet publike e dhëna se "Serbia në Kosovë ka 700 spiunë". Në fakt, kjo e dhënë ishte bërë publike në mediat ballkanike një vit më parë, pasi që në një debat të zhvilluar në Bruksel, e që temë kishte shërbimet sekrete të vendeve ish komuniste. Zoran Petroviq, pjesëmarrës në këtë debat, si përfaqësues i OJQ-së "Kupi-Kapinik", publikon shifrën për masivitetin e agjenturës serbe në Ballkan, e cila përfshin kontingjentin prej 2.200 spiunëve, ku më së shumti kishte në Kosovë, 700 sish. Si duket kjo e dhënë e ka shqetësuar së tepërmi autorin, i cili merr për sipër që në mundësitë e veta ta "ndriçojë terrenin" ku veprojnë ata. Autori nuk merr përsipër veprime operative për të dokumentuar aktivitetin agjenturor të spiunëve të shtetit

serb në Kosovë. Ai merr mostra nga përditshmëria kosovare, dhe së pari, në mënyrë analitike fakton mundësitë e regjimeve serbe për të rekrutuar kapacitete të tilla të spiunëve. Dhe së dyti, konstaton se ky masivitet është kualitativ, dhe ky kualitet mundëson rritje sipas progresionit gjeometrik. Kohë pas kohe, jo për retorikë, por i ndikuar nga eksplorimi analitik, i cili autorin e çon deri në shqetësim, e përsërit frazën "700 spiunë sa 70 batalione ushtarake, me nga 700 ushtarë". Kjo rritje sipas progresionit gjeometrik, për autorin krijon premisa që shërbimet serbe të ndërmarrin sulmin masiv mbi popullatën, ose mbi grupet që masivizojnë efektet në dobi të tyre. Më në brendësi të librit, do të gjeni të zbërthyer lëmshin e kësaj rritjeje të kategorizuar në tri kategori, sipas mënyrës së autorit, të cilat janë: spiunët me betim, që janë 700; bashkëpunëtorët që janë në dijeni; dhe bashkëpunëtorët që nuk janë në dijeni. Sipas përllogaritjeve, me një mbështetje solide të shtetit serb, kontigjenti i kategorisë "me betim" ka kapacitete të prodhojë masën prej rreth 50.000 personave të dy kategorive tjera, të cilat sipas autorit "janë arsenal i Serbisë në Kosovë, janë fuqia e Serbisë në Kosovë".

3. Veprimtaria e fshehtë, të orientohet në fushat që kanë ndikim psikologjik te popullata, në mënyrë që me kalimin e kohës, ose të shkaktojnë gjendjen e depresionit dhe paperspektivës, ose të krijojë efekte që i konvenojnë agresorit, në këtë rast Serbisë

Shablloni tjetër i veprimit ku veprimtaria e fshehtë orientohet në fushat që kanë ndikim psikologjik te popullata, në mënyrë që me kalimin e kohës, ose të shkaktojnë gjendjen e depresionit dhe paperspektivës, ose të krijojë efekte që i konvenojnë Serbisë, autori Meha e trajton si produkt të veprimtarisë në kuadër të dy shablloneve të para çka në realitet duhet të jetë edhe synim i veprimtarisë së fshehtë të shërbimeve serbe. Kjo sipas autorit është e orientuar në "ndërtimin e sistemit degradues të vlerave shoqërore". I tërë kapitulli i dytë i këtij libri merret me zbërthimin e këtij sistemi i cili është ndërtuar me kujdes dhe ka përfshirje masive që nga individi, familja e deri në institucionet më të larta. Autori pasi konstaton mungesën e kujdesit institucional për popullin tonë gjatë gjithë historisë, e me theks të veçantë, periudhën e sundimit serb nga viti 1912, e konsideron familjen e konsoliduar si institucion të vetëm të atdhetarizmit dhe mbijetesës. Këtë konstatim autori e bën pa e lexuar vlerësimin për familjen shqiptare që e bën Vojisllav Sheshel më 14.10.1995 , në intervistën e gjatë në gazetën "Velika Serbija" , në cilësinë e zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Serbisë. Sipas Sheshelit, familja shqiptare është e fortë dhe për të thyer rezistencën shqiptare, duhet të dobësohet ajo, ku me këtë rast, ai

përmend një mori veprimesh, por theksin e vë në veprimet që mundësojnë degjenerimin e saj, e ku si masë praktike fillestare përmend "lejimin për hapjen e mediave të cilat shfaqin programe dekadente". Sulmi sistematik i shërbimeve të fshehta serbe mbi individët dhe familjet shqiptare i cili bartet shkallë-shkallë, në të gjitha institucionet sipas autorit Meha, realizohet duke i ndërtuar sistemet e antivlerave ku spikatë ngritja në sistem dhe të bërit fenomen të rrenës, hajnisë, tradhtisë dhe kurvënisë. Përmes këtyre sistemeve, gjithnjë sipas autorit, është futur nën kontroll dhe është bërë funksionimi jonormal i shumë segmenteve që e determinojnë jetën shoqërore në Kosovë, ku është arritur që të vihet dorë në ekonomi, në gjyqësi, në parti politike, në vlerat e luftës, në arsim dhe kulturë, shkencë etj.

4. Dhe së fundmi, ndikimi në krijimin e masave të mëdha njerëzish që përhapin idenë se pushteti i agresorit (në këtë rast i Serbisë) është më i mirë

Shablloni, ndikimi në krijimin e masave të mëdha njerëzish, që përhapin idenë se pushteti i agresorit është më i mirë (në këtë rast i Serbisë), është i trajtuar pothuajse në gjithë librin. Ndonëse ai askund në mënyrë eksplicite nuk përmend frazën "me mirë ka qenë në kohën e Serbisë", çdo temë e trajtuar, fillon, apo diku në brendësi, ose në fund, e pret barazimin, që qëllim i veprimtarisë së shërbimeve të fshehta serbe të jetë rezultati: defetizmi, rënia për tokë e moralit të popullsisë dhe kërkimi i alternativave tjera jokonvencionale. Autori duke trajtuar këtë shabllon të veprimtarisë së shërbimeve serbe, na përkujton në vazhdimësi për rreziqet në të cilat dërgon rruga e trasuar nga veprimtaria e shërbimeve të "fshehta" serbe e që fundin e ka në frazën "Kosova shtet jofunksional" të cilën çdo ditë politika dhe diplomacia serbe e përsërisin.

Përfundime

Tema të cilën autori Meha e trajton në këtë libër është e ndjeshme dhe zgjon kureshtje, pasi që pjesa më e madhe e familjeve kosovare, në një apo formë tjetër, janë prekur nga veprimtaria e shërbimeve të fshehta serbe në këto njëqind vitet e fundit. Aq më tepër, kur këto veprime kanë lënduar rëndë shumë familje. Dhe lexuesi i intriguar nga titulli, do të nxitojë ta marrë librin dhe do të presë që brendësia e librit të jetë e mbushur me emra dhe me data, të cilat do ta "ndriçonin veprimtarinë e errët" të personave që kanë qenë në afërsi të tyre, të shokëve të tyre, prindërve apo gjyshërve, e të cilët rrugës i kanë tradhtuar. Një kategori tjetër, posa të marrë vesh për botimin e këtij libri, gjithashtu e intriguar nga titulli, deri sa ta përfundojë së lexuari librin deri në fund, do të ndihet në siklet; në radhë të parë nga frika se diku do të dalë emri i tij/saj, apo i të afërmëve të tij/saj, dhe së dyti, do të bashkëjetojë me librin, pasi gjatë gjithë kohës do të gjej vetën si pjesë e komplotit kundër popullit të vet. Nga ky prizëm, autori as kategorisë së parë nuk i plotëson kërshërinë e as kategorinë e dytë nuk e sikletosë shumë. Në këtë pikë ai ka ka dalur të jetë mbi vetën; stili i të shkruarit dhe mesazhi është universal, është ndërgjegjje dhe thirrje për të gjithë, si për ata që e vërejnë këtë veprimtari e nuk e "ndriçojnë" ashtu edhe për ata që verbërisht janë zhytur brenda saj. Dhe thirrja e autorit për amnisti, e ndarë në periudha kohore, për të gjithë ata që janë zhytur në këtë veprimtari, është apel publik për ta, që për paraardhësit e tyre dhe për vetën të sigurojnë një vend në purgator, kurse pasardhësit t'i shmangin nga rruga e ferrit. Përndryshe shqiptarët dhe Kosova do ta jetojnë jetën edhe nëse kjo vështirësohet nga veglat e shërbimeve të fshehta serbe.

Natyrisht se do të ketë edhe të atillë që temën e shtjelluar nga autori Meha, do ta cilësojnë boshe ose paranojë, dhe kjo është e drejtë dhe çështje e perceptimit të tyre. Por këtë qasje e cenon materia që na ofrohet në këtë libër. Më lart thamë që materja nuk shtjellohet nga niveli operativ por nga ai analitik, që në gjuhën profesionale i bie shfrytëzim i burimeve të hapura. Zakonisht pikënisja e gjurmimit të veprimtarisë së shërbimeve të huaja në një vend, bazën e ka nga burimet e hapura. Kështu, nga ky nivel i kundrimit, autori na servon shembuj dhe situata konkrete të stilit "duke shkaktuar dhe menaxhuar kriza", e të cilat atij ia konfirmojnë brengën. Ato që nga fillimi e deri në fund të librit janë të bollshme, prandaj ia vlen të lexohen me kujdes.

Fadil Kajtazi

PARATHËNIE

Ky libër do të jetë libri i parë i botuar nga Xhevat Meha. Shprehja angleze "never say never", (kurrë mos thuaj kurrë) u vërtetua edhe me këtë rast. Drejtimi ishte që të ndërtojë zhvillim profesional dhe ta ushtrojë profesionin e revizorit të avarur financiar. Ushtrimi i këtij profesioni më tepër ngërthen angazhim dhe kyerje të punëve të profesionit me klientë dhe më pak në botimin e librave, dhe gjithsesi botimet e librave do të duhej të ishin nga fusha profesionale. Botimi i ndonjë libri nga fusha e këtij libri me temë jashtë profesionit bazë, kurrë nuk është menduar, deri në krijimin e rrethanave jetësore që u bënë shtytëse për t'u angazhuar në këtë punë.

Veprimet goditëse të Shërbimeve të Mshefta Serbe[1] (SHMS) ndaj autorit patën si efekt atë që plotësisht të largohet nga ushtrimi i profesionit për të cilin kishte të fituara të gjitha kualifikimet dhe përvojat e punës. Koha e lirë e krijuar nga mosangazhimi professional, u shfrytëzua në përgatitjen për botim të këtij libri.

Përmbajtja e këtij libri nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me profesionin e autorit. Njohuritë e nevojshme për shtjellimin e çështjeve të paraqitura nuk kanë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me njohuritë profesionale të cilat autori i ka fituar përmes shkollimit dhe përvojave të punës profesionale. Të gjitha

---

[1] Shprehja "Shërbime të Mëshefta Serbe" është përdorur në vend të shprehjës "Shërbimet Informative të Sërbisë" si kuptim i përgjithshëm që përfshinë të gjitha institucionet, strukturat, organet dhe organizatat të ndërtuara dhe të kontrolluara nga shteti i Serbisë që kanë punuar dhe që punojnë mësheftas. Këtu përfshihen spiunët e infiltruar si bashkëpunëtor ("saradnik" në gjuhën serbe), zyrtarët, zyratë dhe qendrat për analizë, institutet dhe institucionet shkencore dhe profesionale, si dhe institucionet tjera shtetërore.

Fjala "mësheftë" është përdorur përgjatë gjithë tekstit në vend të fjalës "fshehtë". Ky përdorim është bërë pasiqë përmbajtja e publikimit ka të bëj pothuajse ekskluzivisht me Kosovën, ku fjala "mësheftë" e përçon në mënyrë më burimore kuptimin e veprimtarisë së trajtuar në këtë publikim. Bazë e njëjtë është përdorur edhe për fjalët "syni", burrëni", "uri", "llaskuc", "rrejtë".

njohuritë e paraqitura në këtë libër janë njohuri të nxjerra nga vetë jeta. Dituritë dhe njohuritë në lidhje me veprimet dhe veprimtarinë e SHMS-ve janë fituar nga përvojat jetësore të periudhës deri në fillim të viteve '90 kur emigron në Londër dhe nga përvojat jetësore pas kthimit nga Londra, në vitin 2001, me theks të veçantë të përvojave jetësore të 5-6 viteve të fundit.

Përjetimet dhe përvojat e drejtpërdrejta janë dëshmi e bazuar për të paraqitur veprime konkrete të spiunëve dhe të bashkëpunëtorëve të SHMS-ve. Dyshimi për rastet konkrete të paraqitura në këtë publikim, por edhe për veprimet konkrete të paraqitura në publikim, është i bazuar në dëshmi të cilat ka qenë e mundur të grumbullohen dhe kjo jo të gjitha dëshmitë e mundshme, por që janë të mjaftueshme si bazë për paraqitje të dyshimit.

Të gjitha rastet dhe veprimet e paraqitura në këtë publikim, janë në nivel të dyshimit edhe kur paraqitjet në mënyrë të veçantë shprehin se janë në nivel të dyshimit dhe edhe në rastet kur paraqitja nuk shpreh këtë në mënyrë të veçantë.

Përveç rasteve konkrete, janë paraqitur edhe vështrimet, pikëpamjet dhe konceptet personale mbi nevojën dhe rëndësinë e ndriçimit të veprimtarisë së SHMS-ve, në ndërtimin dhe funksionimin e shtetit të pavarur të Kosovës.Autori të gjitha paraqitjet në këtë publikim i bën në cilësinë e qytetarit të zakonshëm, qytetarit që përveç se është qenie organike (të hajë bukë), është edhe qenie njerëzore që ka sy për të parë dhe mendje për të menduar.

Ky libër u shkrua në periudhën nga fundi i muajit shkurt deri në muajin maj të vitit 2014, si përpilim i brumit dhe u rishikua me përmirësime dhe plotësime në muajt shtator – nëntor 2014, kur mori formën përfundimtare. Disa pjesë dhe disa korrigjime, por jo edhe shumë, janë kryer gjatë vitit 2015. Puna në përgatitjen e këtij libri u diskutua me disa shokë intelektualë me përvojë, të cilët i falënderoj për ndihmën dhe kontributin e dhënë në përgatitjen e këtij libri.

Autori nxjerr gjykime në lidhje me veprimtarinë e SHMS-ve, në fakt gjykime nxirren gjatë gjithë këtij publikimi në lidhje me veprimtarinë e tyre në Kosovë. Të gjitha gjykimet që nxirren gjatë gjithë publikimit, janë gjykime të një qytetari të zakonshëm, pa asnjë njohuri profesionale të fushës së veprimtarisë së shërbimeve të mshefta dhe pa as edhe pretendimin më të vogël të shprehjes së njohjes profesionale të fushës së veprimtarisë së këtyre shërbimeve. Gjykimet janë nxjerrë në bazë të njohurive të fituara nga përjetimet dhe përvojat personale gjatë gjithë jetës.

Në shkrimin e këtij libri, autori nuk u konsultua as edhe me një botim, ose dokument të vetëm me burim tjetër nga autori i këtij shkrimi si burim. Nuk ka as edhe një referim të vetëm tek ndonjë libër i shkruar. Publikimi është ndërtuar mbi nxjerrjet nga vet jeta, nga rastet dhe ndodhitë e përjetuara, si dhe nga përvojat dhe njohuritë e përfituara nga vetë jeta. Të vetmet referime janë referimet nga jeta. Gjithashtu, nuk ka citime nga ndonjë libër i shkruar. Të vetmet citime janë thëniet e individëve, të cilat janë dëgjuar nga veshët dhe të cilat janë mbajtur mend nga autori.

Përmbajtja e librit u përgatit dhe u shkrua me përdorimin dhe zbatimin e metodave shkencore. Metoda bazë shkencore e përdorur është zbatimi i metodës së analizës së sistemeve informative. Skema më e thjeshtë e sistemeve informative të përpunimit të t'dhënave ka tre pjesë: HYRJA – PËRPUNIMI – DALJA (DATA INPUT – DATA PROCESSING – DATA OUTPUT). Sipas kësaj metode, në rastet kur përpunimi i të dhënave është i mbyllur dhe nuk ka qasje, kuptimi se çka përpunohet brenda nxirret duke analizuar hyrjet dhe daljet e të dhënave. Kur proceset janë të njohura, kuptimi mbi përpunimin nxirret në bazë të analizës së veçorive përbërëse të elementeve të HYRJEVE dhe të elementeve të DALJEVE. Rezultatet e kësaj metode janë vërtetuar shkencërisht.



Në përmbajtjen e librit në raste të caktuara përdoren sisteme dhe modele të ndryshme për të pasqyruar temat e shtjelluara në mënyrë më të plotë dhe më të kuptueshme. Ndërtimi i sistemeve të paraqitura në përmbajtje, është kryer duke u nisur nga fakti se veprimet e njëjta të përsëritura janë veprime sistematike dhe në këtë mënyrë është nxjerrë përfundimi se është fjala për sistem.

Kur të kuptohet se është fjala për sistem, atëherë mbetet që vetëm të përcaktohet modeli i sistemit. Modeli i sistemit ndërtohet në bazë të veçorive të elementeve që e përbëjnë sistemin e caktuar dhe të lidhjeve logjike të veçorive të elementeve të sistemeve. Konfiguracioni i modelit të sistemit

është në fakt konfiguracioni i veçorive të elementeve të sistemit dhe të lidhjeve logjike të tyre.

Po ashtu, modelet e paraqitura në përmbajtje janë ndërtuar në bazë të pozicioneve, pozicionimeve dhe konfigurimeve të elementeve si pjesë të caktuara dhe lidhjeve logjike të elementeve që përmbajnë pozicionet, pozicionimet dhe konfigurimet e këtyre pjesëve, që si tërësi e tyre në fakt është fjala për model.

KAPITULLI I PARË

NEVOJA DHE ARSYESHMËRIA PËR NDRIÇIMIN E VEPRIMTARISË SË SHËRBIMEVE TË MSHEFTA TË SERBISË NË KOSOVË

Thënie: **"Ti flenë po armiku nuk flenë"**

Veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë, sikurse edhe veprimtaritë e tjera të ngjajshme, sigurisht se është e msheftë. Kur një veprimtari është e msheftë, siç është veprimtaria e SHMS-ve, ndriçimi i kësaj veprimtarie është eliminim i errësirës përreth kësaj veprimtarie si terren i cili krijon kushte në të cilin është e mundur të zhvillohet kjo veprimtari. Kur një veprimtari është e msheftë dhe e dëmshme, ndriçimi i kësaj veprimtarie është eliminim i errësirës që paraqet eliminim të kushteve për zhvillim të veprimtarisë dhe në këtë mënyrë shmangie e mundësisë për bërjen e dëmit.

Pas përfundimit të luftës së fundit, Kosova filloi të ndërtojë institucionet e veta shtetërore ashtu siç edhe ishte e pritshme. Mirëpo, rishtas nga koha e bërjes së këtij publikimi, në njërin nga televizionet e Kosovës, dy ish- zyrtarë të shërbimeve informative patën një paraqitje shumë të rëndësishme për këtë fushë. Njëri nga këta ish-zyrtarë, ishte nga strukturat e Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme dhe tjetri nga strukturat paralele shtetërore të Republikës së Kosovës, të formuara në vitet '90. Njëri nga këta ish-zyrtarë ndriçoi se sipas një burimi të Këshillit të Europës, Serbia pas lufte, në Kosovë ka 720 spiunë, ku 720 spiunë janë të barabartë me 70 batalione lufte me nga 700 ushtarë.

Gjithashtu, nga këta dy ish-zyrtarë të shërbimeve informative u tha se këta bashkëpunëtorë janë të shtrirë në institucionet e Kosovës, përfshi Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, mjetet e informimit, etj. Nuk po është vështirë të nxirret mendimi së këto batalione punojnë për pengimin e ndërtimit të institucioneve të Kosovës. Gjithashtu, nuk po është e vështirë të nxirret mendimi se, ndriçimi i kësaj veprimtarie është eliminim i pengesave në ndërtimin e institucioneve të Kosovës. Populli i Kosovës, njëjtë sikur edhe popujt tjerë, ndërton institucionet e veta për të patur një jetë më të mirë për individët si pjesëtarë të shoqërisë. Pengimi i ndërtimit të institucioneve është pengim i ndërtimit të një jete më të mirë për pjesëtarët e shoqërisë së Kosovës.

Kosova, pas përpjekjeve të pandërprera gjatë gjithë okupimit serb, dhe pas përballjes luftarake gjithëpopullore dhe ndërhyrjes së fuqive të mëdha, fitoi

pavarësinë ushtarake dhe administrative nga shteti i Sërbisë. Qytetarët e zakonshëm, këtë pavarësi e kuptojnë si një pavarësi të plotë nga shteti serb. Në fakt, realiteti nuk është kështu. Se pavarësia nga shteti serb tani për tani është pavarësi ushtarake dhe administrative, por jo edhe pavarësi e plotë, kuptohet nga individë që janë njohës të varësisë dhe pavarësisë, që janë njohës të okupimit dhe të lirisë.

Serbia vazhdon të ushtrojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi punën e institucioneve të Kosovës. Ky kontroll i drejtpërdrejtë i Serbisë, ushtrohet nëpërmes shërbimeve të mshefta të cilat veprimet e strukturave të tyre i shtrijnë deri në kreun e institucioneve të Kosovës. Se në çfarë niveli dhe masiviteti është e shtrirë veprimtaria e msheftë serbe, dëshmohet nga deklarata e kolonelit Momir Stojanoviq, i cili në cilësinë e Shefit të Shërbimit Informativ të Ushtrisë Serbe, në janar të vitit 2004, gazetës beogradase NIN i deklaron :"në vitin që shkoi kemi arritur të instalojmë agjenturën tonë në kreun e lëvizjes seperatiste".

Ngjarjet që pasuan në Kosovë në vitin 2004 vërtetuan këtë prezencë. Kjo prezencë u konfirmua edhe tani me deklaratën e dhënë për Radiotelevizionin e Sërbisë me datë 17 mars 2015 nga Milivoje Mihajlloviq, drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Mediat i Qeverisë së Sërbisë. Ky drejtor deklaron: "Në këtë moment shteti i Sërbisë e ka ndikimin më të fuqishëm në Kosovë që nga viti 1999 deri më sot, gjë që mund të shihet edhe përmes dialogut të Brukselit".

Duhet theksuar gjithashtu se përveç ushtrimit të kontrollit të drejpërdrejtë shteti serb ushtron edhe kontroll jo të drejpërdrejtë mbi punën e institucioneve të Kosovës. Kontrolli jo i drejtpërdrejtë mbi punën e institucioneve të Kosovës ushtrohet përmes ndikimit të shtetit serb në sjelljet dhe veprimet e shteteve tjera ndaj Kosovës, si dhe ndikimit të shtetit serb në sjelljet dhe veprimet e organizatave dhe institucioneve regjionale dhe botërore ndaj Kosovës.

Qytetarët e zakonshëm, ose populli, nëse përdorim një gjuhë më populliste, kupton aq sa institucionet e Kosovës i bëjnë të ditur popullit. Kur institucionet dështojnë, janë bijtë dhe bijat e popullit që i bëjnë të ditur popullit. Në lidhje me pavarësinë e Kosovës dhe faktit se Kosova ende nuk është plotësisht e pavarur nga shteti serb, institucionet e Kosovës kanë dështuar, por edhe bijtë dhe bijat e popullit kanë punuar shumë pak për t'i bërë të ditur popullit se pavarësia e tanishme nuk është pavarësi e plotë.

Në fakt për të marrë pavarësinë e plotë, ka edhe bukur shumë punë. Edhe kur të arrihet pavarësia e plotë, duhet që vazhdimisht të punohet që Kosova të

mos të futet përseri në varësi të shtetit serb. Dikë mund ta befasojë, ose dikush mund të mos e besojë të dhënën, se janë shumë 720 spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve, dhe atë që bëjnë sa 70 batalione ushtarake me nga 700 ushtarë, për të vepruar në Kosovën e pasluftës. Dikë mund ta befasojë, ose dikush mund të mos besojë se në Kosovë ka veprimtari të SHMS-ve.

Dikë mund ta befasojë, ose dikush mund të mos besojë se spiunët zyrtarë me betim të SHMS-ve, së bashku me batalionet e tyre mund jenë pjesë e Qeverisë së Kosovës, pjesë e Kuvendit të Kosovës, pjesë e institucioneve tjera të Kosovës, pjesë e mjeteve të informimit, etj. Për shumëkë është pak e besueshme se jo vetëm që të jenë pjesë e institucioneve të Kosovës, por edhe janë në krye të tyre dhe atë të institucioneve më të larta, dhe të kenë kontroll të plotë të institucioneve të Kosovës dhe në këtë mënyrë të gjithë Kosovës. Mendoj se këto nuk janë befasi, dhe se janë të besueshme, për faktin se Kosova ende nuk ka të ndërtuara institucione të cilat do të mund të pamundësonin veprimtarinë e SHMS-ve. Në mungesë të veprimit të institucioneve, si çdoherë, janë bijtë dhe bijat e popullit që veprojnë në mbrojtje të interesave të popullit.

Njëri nga ish-zyrtarët e shërbimeve informative në paraqitjen në televizion theksoi se bashkëpunëtori i shërbimit të msheftë është syni dhe veshi për shërbimin. Mendohet se në mungesë të institucioneve të Kosovës, qytetari i zakonshëm duhet të jetë syni dhe mendja përballë veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë. Fatkeqësisht pas përfundimit të luftës, përgjithësisht ka mbizotëruar mendimi se me tërheqjen e administratës dhe forcave të sigurisë së Serbisë nuk ka më Serbi në Kosovë, gjë që fatkeqësisht ka vërtetuar thënien: "ti flenë por armiku nuk flenë".

Shtrohet pyetja: Si mund qytetari i zakonshëm të jetë syni dhe mendja përballë veprimtarisë së SHMS-ve?

Kjo veprimtari në fund godet qytetarin e zakonshëm. Sado e msheftë të jetë veprimtaria, qytetari i zakonshëm sheh dhe ndjen goditjen që i bëhet nga to. Në këtë mënyrë qytetari i zakonshëm mund të jetë syni dhe mendja përballë veprimtarisë së SHMS-ve. Krejt çka kërkohet është që qytetari i zakonshëm të kuptojë dhe të njohë se cilat janë goditjet që i vijnë nga SHMS-të. Goditjet e SHMS-ve burojnë nga synimet e Serbisë ndaj Kosovës të përmbajtura në politikat dhe programet e Serbisë për Kosovën. Ndriçimi i politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën i mundëson qytetarit të zakonshëm që të njohë dhe dallojë goditjet që i vijnë nga SHMS-të.

Pas daljeve në publik të informacioneve shumë të rëndësishme për veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë, bie në sy një mosreagim ose reagim tepër i ulët nga zyrtarët e tanishëm të institucioneve të Kosovës. Ky nivel i ulët i reagimit është dëshmi e shkallës së lartë të veprimit dhe të funksionit efikas të SHMS-ve në Kosovë, janë duke e kryer punën siç duhet! Efikasiteti i punës së këtyre shërbimeve në Kosovë, dëshmohet me arritjen e shkallës kaq të lartë të relativizimit të efekteve dhe pasojave të veprimeve të SHMS-ve në Kosovë.

Shkalla e ulët e reagimit dëshmon për nevojën që bijtë dhe bijat e popullit të punojnë më shumë për të bërë të ditur formën dhe mënyrën e veprimeve të SHMS-ve, për të bërë të ditur efektet dhe pasojat e veprimeve të tyre në Kosovë. Fakti i shkallës së ulët të reagimit në përgjithësi dhe sidomos në veçanti nga krerët e institucioneve të Kosovës, është dëshmi se vetë krerët e institucioneve tona janë të përfshirë në këto veprimtari.

Autori, meqë është i vetëdijshëm për nevojën e të bërit sa më shumë të ditur veprimet dhe veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë, në këtë publikim paraqet vështrimet dhe pikëpamjet e veta në lidhje me veprimet e SHMS-ve në Kosovë. Vëmendja më e madhe shtrihet në veprimet dhe veprimtarinë e pasluftës së fundit, kjo për dy arsye: 1) përjetimet dhe përvojat e drejtpërdrejta kanë qenë më të shumëta, dhe 2) debati dhe diskutimet pas daljes në publik të disa informacioneve rreth veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë është kufizuar pothuajse terësisht në, kush kë, dhe si, e ka dërguar dhe persekutuar në burg. Kjo e dyta veçanërisht është me peshë për faktin se veprimtaria e SHMS-ve shtrihet në të gjitha fushat e frymimit të qytetarëve dhe të institucioneve të Kosovës, dhe jo vetëm në burgosjet dhe persekutimet.

Konsiderohet se në lidhje me punën dhe veprimtarinë e SHMS-ve është e nevojshme të angazhohen kundër kësaj veprimtarie shkencëtarët, profesionistët dhe specialistët përkatës të të gjtha fushave të frymimit të qytetarëve dhe frymimit të institucioneve të Kosovës. Në veçanti, është e domosdoshme që individët që janë veprimtar ë politikë, jo lakmitarët që janë pjesë e partive politike për krijim të mirëqenies për vete dhe familjarët, maksimalisht të angazhohen që në partitë politike ku veprojnë të pamundësojnë veprimtarinë e SHMS-ve.

Të paraqiturat në këtë publikim nuk kanë pretendime më tepër sesa të jenë një material i përdorshëm nga institucionet e Kosovës, në realizimin e punëve dhe përgjegjësive që kanë, dhe, të jenë një material i përdorshëm për specialistët e fushave tjera për përpunime të mëtutjeshme profesionale e shkencore.

DALJA NË PUBLIK E INFORMACIONEVE RRETH VEPRIMTARISË SË SHMS-VE NË KOSOVË

Paraqitja publike e dy ish-zyrtarëve të shërbimeve informative krijoi zhvillime shumë interesante tek qytetarët dhe tek institucionet e Kosovës. Shumë u zunë në befasi nga informacionet e bëra publike. Disa u besuan informacioneve të shpalosura, kurse disa nuk u besuan informacioneve të shpalosura, meqë ishin të shpalosura nga ish-zyrtarë të shërbimeve informative. Shumica, nga informacionet e shpalosura kthyen mendjen prapa dhe kujtuan ditët e kaluara të diferencimeve, përjashtimeve nga puna, burgosjeve dhe përsekutimet nga më brutalet që mund të bëheshin në Kosovë.

Është sidomos interesant reagimi nga zyrtarët e institucioneve. Është shumë me interes që të analizohen veprimet e zyrtarëve të institucioneve për dy arsye:

1) Zyrtarët e institucioneve është e pritshme që të kenë përgjegjësinë dhe interesin për ngritje të debatit, dhe

2) Informacionet e dala në publik shpalosnin, se disa nga këta spiunët zyrtarë me betim, janë pjesë e Qeverisë së Kosovës dhe e Kuvendit të Kosovës.

Sipas njohësve të fushës së veprimtarive të mshefta, spiunët që janë zyrtarisht të stërvitur si spiunë, përgatiten në të gjitha aspektet e veprimtarisë së msheftë. Po ashtu sipas njohësve të veprimtarive të mshefta, numri prej rreth 700 spiunëve në Kosovë është maksimumi i nevojshëm për Serbinë, nuk nevojitën më shumë (me gjasë konsiderohet se vetëm pështillen). Në mesin e detyrave, këta spiunë duhet që të krijojnë rreth njerëzish afër vetës, që në rastin e Kosovës këta 720 spiunë zyrtarë me betim[2] së bashku me rrethin e njerëzve të tyre bëjnë sa 70 batalione ushtarake me nga 700 ushtarë.

Individët që janë të afërt me spiunët me betim, bashkëpunojnë me këta spiunë në kryerjën e detyrave të marra, dhe në këtë mënyrë shndërrohen në bashkëpunëtorë. Shumica e këtyre bashkëpunëtorëve nuk janë në dijeni se punojnë për shërbime të mshefta, kurse një pjesë janë në dijeni, mirëpo

[2] Gjatë tekstit të librit, janë përdorur shprehjet "spiun zyrtar me betim", "bashkëpunëtor me dijeni", "bashkëpunëtor pa dijeni" dhe "zyrtar i SHMS-ve". Këto shprehje janë përdorur për të paraqitur individët që në një ose mënyrë tjeter kryejnë punë për SHMS-të. Këto shprehje nuk janë emërtime zyrtare nga SHMS-të por janë konceptime të autorit.

lakmojnë lëverditë që marrin nga bashkëpunimi, "m'bjen ma mirë që t'jam afër tyre, me punu me ta" mendojnë ata.

Në bazë të asaj që autori ka nxjerrë nga vështrimi i veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, janë tri kategori të individëve që punojnë për SHMS-të:

1) Spiunët me betim

Këta janë individët që kanë dhënë betimin se deri në vdekje do të punojnë për shtetin e Serbisë. Këta janë zyrtarisht spiunë të Serbisë. Kur këta spiunë japin betimin, betohen se do t'i shërbejnë me përkushtim interesave të shtetit të Serbisë.

2) Bashkëpunëtorët që janë në dijeni

Këta individë janë në dijeni se veprimet e tyre janë pjesë e veprimtarisë së SHMS-ve dhe se me vetëdije i kryejnë këto veprime. Kjo kategori ka bindje dhe vërtet ka besim në shtetin e Serbisë. Ky besim vërtetohet në vijimësi me demonstrim të besnikërisë së plotë ndaj shtetit të Serbisë. Me demonstrimin në vijimësi ata janë bashkëpunëtorë të SHMS-ve, dhe atë bashkëpunëtorë të besueshëm. Bashkëpunëtorët me dijeni, shprehur me numra, në bazë të gjykimit të autorit, janë diku mes 5 – 10 individë që kanë vullnet të jenë zyrtarisht një nga spiunët e stërvitur me betim. Nëse numri gjithsej i spiunëve me betim është 720, atëherë numri gjithsej i bashkëpunëtorëve me dijeni duhet të jetë mes 3,500 – 7,000 individë. Autori nxjerr gjykim se numri gjithsej i bashkëpunëtorëve të SHMS-ve në Kosovë, duhet të jetë rreth 5,000. Këta 5,000 bashkëpunëtorë, me dijeni janë pothuaj statikë, janë pothuaj të njëjtë.

3) Bashkëpunëtorët që nuk janë në dijeni

Këta individë nuk janë në dijeni se veprimet e tyre janë pjesë e veprimtarisë së SHMS-ve dhe se nuk i kryejnë këto veprime me vetëdije. Kjo kategori nuk beson në shtetin e Serbisë dhe as që janë në dijeni se veprimet e tyre janë pjesë e programeve të Serbisë për Kosovë, janë zbatim i programeve të Serbisë për Kosovën. Këta individë nuk kanë besim as në shtetin e Kosovës, janë karakter i ligë, lakmojnë shumë dhe besojnë vetëm në interesin e ngushtë të tyre. Përmes veprimeve të demonstrimit të lakmisë, këta individë shndërrohen në bashkëpunëtorë të SHMS-ve. Veprimet e tyre lakmuese në fakt janë veprime bashkëpunuese, për faktin se kryejnë zbatimin e programeve të SHMS-ve, dhe në këtë mënyrë këta individë janë bashkëpunëtorë të SHMS-ve.

Bashkëpunëtorët pa dijeni, që në bazë të gjykimeve të autorit janë gjithsej 45,000, janë pjesa tjetër nga numri prej gjthsej 50.000 individësh, Këta 45,000 individë nuk janë statikë, rekrutohen dhe ndyshojnë varësisht nga gjykimet e SHMS-ve për kontributin individual si dhe nevojës për ta. Zakonisht, si bashkëpunëtorë pa dijeni rekrutohen individë të rinjë (jo për nga mosha) lakmitarë si motor i ri për të shtyer përpara kryerjën e detyrave, kur këta motorë humbin fuqinë zëvendësohen me individë të rinjë, si energji e re, si gjak i ri, si motor i ri.

Fakti se Serbia në Kosovë ka 720 spiunë zyrtarë me betim, ku 720 spiunë me betim janë të barabartë me 70 batalione lufte me nga 700 ushtarë, do të thotë se janë rreth 50,000 ushtarë të Serbisë që punojnë msheftas në Kosovë. Informatorët (bashkëpunëtorë ose saradnik, në gjuhën serbe) janë spiunë të betuar, të stërvitur dhe të përgatitur mirë për kryerjen e detyrave të ngarkuara. Këta spiunë kanë për detyrë të krijojnë rreth me njerëz afër tyre, që kur merret i gjithë rrethi i këtyre njerëzve të tyre bëjnë sa 50,000 ushtarë. Po kuptohet se këta 50,000 ushtarë janë të gatshëm që të kryejnë cilëndo dhe të gjitha detyrat që SHMS-të e shohin të nevojshme për t'u kryer. Këta 50.000 ushtarë janë arsenali i Serbisë në Kosovë, janë fuqia e Serbisë në Kosovë.

Marrë në përgjithësi, reagimi qytetar ndaj informacioneve të bëra publike mbi veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë ishte shumë indiferent. Përderisa tek qytetarët u shpreh një shkallë e lartë e iritimit ndaj faktit të ekzistimit të personave që edhe pas gjithë atyre vuajtjeve dhe persekutimeve para luftës dhe gjatë luftës së fundit të ketë individë të tillë, nuk u vërejt ndonjë reagim tjetër i madh.

Nuk u vërejt dhe nuk u vlerësua pesha e informacionit se edhe tani, 15 vite pas tërheqjes së administratës dhe forcave të sigurisë së Serbisë, në Kosovë veprojnë 720 spiunë zyrtarë me betim, me kode të veçanta, dhe se secili nga këta ka 70 batalione të bashkëpunëtorëve përreth vetës, dhe se këta spiunë zyrtarë me betim, gjenden në Qeverinë e Kosovës dhe në Kuvendin e Kosovës.

Përderisa qytetarët shprehën nivel të shqetësimeve rreth informacioneve të shpalosura, zyrtarët e institucioneve të Kosovës ishin pothuajse plotësisht të pandjeshëm. Me përjashtim të disa deputetëve të Kuvendit të Kosovës, numri i të cilëve nuk tejkalon numrin e gishtave të një dore, nuk pati ndonjë reagim tjetër. Reagimi mungoi nga zyrtarët e Qeverisë dhe nga vetë kreu i Qeverisë.

Gjithashtu mungoi edhe reagimi nga krerët e të gjitha partive politike të Kosovës.

Meqë në tekstin e këtij publikimi, edhe në paragrafët e mësipërm dhe në pragrafët në vijim, përgjatë gjithë publikimit, ka referime tek informacionet e shpalosura nga dy ish-zyrtarë të shërbimeve informative, është e nevojshme të sqarohet baza dhe arsyeshmëria e përdorimit të këtyre informacioneve si dhe referimet tek këto informacione. Informacionet e shpalosura nga këta ish zyrtarë të shërbimeve informative merren si të qena, për arsye se secili individ në Kosovë ka përgjegjësi ligjore për fjalën publike. Nga dita e bërjes publike, nuk ka patur asnjë veprim dhe nuk është inicuar ndonjë procedurë që do të vënte në dyshim vërtetësinë e informacioneve të bëra publike.

Sido që të jetë, përmasat e peshës së informacioneve të bëra publike janë shumë shqetësuese, janë tepër shqetësuese, janë tepër tepër shqetsuese. Përmasat e peshës së informacioneve të bëra publike do të duhej të ishin terësisht shqetësuese edhe për qytetarët e zakonshëm të Kosovës, do të duhej të ishin terësisht shqetësuese për të gjithë zyrtarët e institucioneve të Kosovës, dhe veçanërisht për krerët e të gjitha institucioneve të Kosovës, me theks të veçantë në krerët e të gjitha partive politike.

Përmasat e peshës së informacioneve të bëra publike do të duhej të ishin shqetësuese për profesionistët e të gjitha fushave siç janë gazetarët, gjyqtarët, prokurorët, juristët, kontabilistët, revizorët financiarë, ekspertët financiarë, ekspertët e fushave tjera dhe përgjithësisht profesionistët e të gjitha fushave.

Përmasat e peshës së informacioneve të bëra publike do të duhej të ishin edhe më shqetësuese edhe për shkencëtarët e të gjitha fushave.

Gjendja e krijuar nga bërja publike e informacioneve rreth SHMS-ve në Kosovë ka shumë dimensione dhe ka disa rrafshe për t'u shoshitur. Gjykimet e qytetarëve të zakonshëm në këtë gjendje janë plotësisht normale dhe të kuptueshme.

Qytetari i zakonshëm, duhet që në rend të parë të ketë preokupimet ditore të punës dhe jetës që ka. Qytetari i zakonshëm e di se tani janë institucionet e Kosovës të cilat kanë fituar të drejtat dhe kanë marrë përgjegjësitë përmes marrjes së votës për t'i trajtuar dhe për t'u gjetur zgjidhje problemeve të tilla. Qytetari i zakonshëm në kushte normale nuk pritet që të kryejë punët të cilat janë përgjegjësi e institucioneve.

Qytetari i zakonshëm ka shprehur pikërisht atë që edhe i takon, ka shfaqur shqetësim për përmasat e peshës së informacioneve të bëra publike, dhe ka shprehur iritim ndaj faktit të përmasave kaq të mëdha të veprimtarisë së SHMS-së në Kosovë. Pjesa tjetër e punës u takon institucioneve. Populli kupton dhe nxjerr gjykime aq sa institucionet i bëjnë të ditur popullit. Në mungesë të punës së institucioneve, janë bijtë dhe bijat e popullit që kryejnë punën, i bëjnë të ditur popullit atë që populli duhet të dijë.

Institucionet e Kosovës, së paku deri në kohën e bërjes publike të këtij publikimi, nuk kanë qenë në nivel të përgjegjësive dhe kanë dështuar të marrin veprime që janë të nevojshme për gjendjet e tilla. Rreth punës së institucioneve të Kosovës në lidhje me veprimtarinë e SHMS-ve pas lufte, do të ketë trajtime edhe në vijim të këtij publikimi. Përgjithësisht, puna e institucioneve sidomos pas bërjës publike të informacioneve, përveç se është brengosëse, është dëshmi e shtrirjes dhe përmasave të veprimtarisë së SHMS-ve në institucionet e Kosovës.

SHMS-TË DHE NDËRTIMI I SHTETIT TË KOSOVËS

Thënia e shkodranes: **"Me kanë kollaj me ba shpi, Kola jem i kish ba tri"**

Përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, sigurisht se krijoi kushte të përshtatshme për ndërtimin e shtetit të Kosovës. Shteti i Kosovës është i ndërtuar aq sa institucionet e Kosovës janë të ndërtuara. Shteti i Kosovës është funksional aq sa funksionale janë institucionet e Kosovës. Ndërtimi i shtetit të Kosovës përngjanë në ndërtimin e një shtëpie, jo në kuptim të ndërtimit të objektit të shtëpisë, por në kuptim të ndërtimit të një familjeje, që në fakt janë një grumbull njerëzish, të cilët jetojnë, punojnë dhe zhvillohen së bashku. Të jetuarit së bashku, nënkupton që pjesëtarët e familjes domosdoshmërisht ndajnë edhe të mirat e të jetuarit së bashku, por ndajnë edhe të këqijat e të jetuarit së bashku.

Qytetarët e Kosovës të cilët vendosin të jetojnë në Kosovë, janë të detyruar të jetojnë në Bashkësinë e qytetarëve të Kosovës, të ndajnë të mirën dhe të keqën e të jetuarit së bashku. Bashkësia nuk mund të mbahet si bashkësi pa patur rregulla të brendshme, rregulla të cilat jo se janë sa për të thënë se bashkësia ka rregulla, por se këto rregulla zbatohen në plotëni. Në bazë të rregullave të brendshme, bashkësia kryen ndërtimin e organizimit të Bashkësisë. Në bazë të rregullave të brendshme, Bashkësia ndërton institucionet e brendshme të Bashkësisë. Në bazë të rregullave të brendshme, Bashkësia siguron funksionalitetin dhe efikasitetin e institucioneve të Bashkësisë, dhe në këtë mënyrë siguron funksionalitetin dhe efikasitetin e Bashkësisë si terësi. Në rastin e Bashkësisë së qytetarëve të Kosovës, kuptohet se këto rregulla në fakt janë ligjet e Kosovës.

Qytetarët e Kosovës pas përfundimit të luftës, me ndihmën e miqve ndërkombtarë, filluan dhe janë duke ndërtuar institucionet e Kosovës, dhe përmes ndërtimit të tyre edhe ndërtimin e shtetit të Kosovës. Deri më tani janë shkruar dhe miratuar shumë ligje të cilat bëjnë një kornizë të mirë për ndërtimin e institucioneve të Kosovës. Përderisa kemi pothuajse mjaftushëm miratim të ligjeve, zbatimi i ligjeve ende është shumë larg nga niveli i zbatimit të ligjeve që Kosova ka nevojë. Sigurisht, niveli shumë i ulët i zbatimit të ligjeve në Kosovë përcakton edhe nivelin shumë të ulët të funksionalitetit dhe efikasitetit të institucioneve të Kosovës, dhe në këtë mënyrë edhe nivelin e funksionalitetit dhe efikasitetit të Kosovës si terësi.

Shtrohet pyetja: Si ndërtohen institucionet e Kosovës kur në Kosovë ka spiunë zyrtarë me betim, që punojnë për shërbime informative të huaja

armiqësore ndaj Kosovës? Po kur shtrirja e veprimtarisë së SHMS-ve është e përmasave që u bënë publike?

Sigurisht është e ditur se detyra e spiunëve zyrtarë me betim të SHMS-se në rend të parë është që të mos lejojë ndërtimin e institucioneve. Kur këtë nuk mund të arrijnë falë ndihmës së miqve ndërkombtarë, atëherë detyra e këtyre spiunëve mbetet që të pengojnë funksionimin e tyre. Nëse u jepet mundësia, këta spiunë zyrtarë me betim, i futin institucionet e Kosovës në funksion të realizimit të politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën. Këto detyra të këtyre spiunëve nuk vëhen në dyshim, çështja është se si këta spiunë i arrijnë caqet e tyre.

Arritja e caqeve të spiunëve mundësohet nga vetë shkalla e madhësisë dhe shtrirjes së tyre. Kur këta spiunë gjënden në krye të institucioneve të Kosovës, përmbushja e caqeve të tyre është e sigurt, nuk ka dyshime. Meqë nuk ka dyshime të pranisë së spiunëve zyrtarë me betim të SHMS-ve, atëherë mbetet vetëm që të mendohet për formën dhe përmbajtjen e veprimit të tyre, çka dhe si veprojnë.

Realiteti po tregon se Kosova ka vështirësi në funksionimin dhe efikasitetin e institucioneve të Kosovës. Kjo po dëshmohet radhazi nga të gjitha raportet e institucioneve të pavarura ndërkombëtare për shumë vite rresht. Fakti i vështirësive në funksionimin dhe efikasitetin e institucioneve të Kosovës është dëshmi e pranisë së veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë. Fakti i funksionalitetit kaq të ulët dhe efikasitetit kaq të dobët të institucioneve të Kosovës, dhe fakti i shtrirjes kaq të madhe të spiunëve me betim dhe bashkëpunëtorëve, vetvetiu jep dëshmi se shkalla e shtrirjes së veprimtarisë arrinë edhe nivelet më të larta të institucioneve të Kosovës.

Shtrohet pyetja: çka të bëhet kur në Kosovë veprojnë spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve të cilët janë të pranishëm në krye të institucioneve të Kosovës?

Fillimisht, fuqia e shërbimeve të mshefta qëndron në vetë të qenit shërbim i msheftë. Bërja publike e veprimtarisë së spiunëve zyrtarë me betim zvogëlon fuqinë e SHMS-ve. Shkalla e bërjes publike e veprimtarisë së SHMS-ve është proporcionalisht e barabartë me shkallën e dobësimit të fuqisë së tyre në Kosovë.

Nëse dekonspirimi i individëve që janë spinë zyrtarë është i vështirë, për faktin se këta spiunë janë të msheftë, dhe, se Serbia nuk ka interes t'i bëjë të ditur, atëherë mund të bëhet dekonspirimi i politikave, dhe sidomos

dekonspirimi i veprimeve të këtyre spiunëve me betim dhe bashkëpunëtorëve, meqë këto veprime janë publike. Ky publikim bën përpjekje që të jap një kontribut në identifikimin dhe njohjen e politikave dhe veprimeve të mundshme të SHMS-ve në Kosovë.

PROGRAMET E NJËPASNJËSHME TË SERBISË PËR KOSOVËN

Për qytetarin e zakonshëm, është e njohur se Serbia në vazhdimësi ka patur në zbatim programe të veçanta rreth dhe në lidhje me Kosovën. Shtrohet pyetja, po pas lufte a ka patur dhe a ka në zbatim programe të veçanta për Kosovën?

Përgjigjja e logjikshme do të ishte: ka patur dhe ka në zbatim programe të veçanta për Kosovën. Në këtë rast mbetet vetëm që të mendohet dhe të dihet më tepër për këto programe. Më e lehta do të ishte sikur të kishim kopjet e këtyre programve, t'i lexonim ngadalë dhe në qetësi, dhe të kuptonim se çka përmbajnë këto programe, çka janë synimet e këtyre programeve, si zbatohen këto programe, çfarë janë dhe cilat janë mënyrat e veprimit dhe veprimet konkrete në realizimin e këtyre programeve?

Nëse bëhet një vështrim nga larg i programeve deri më tani të njohura të Serbisë, mund të shihen disa veçori dhe sigurisht se këto veçori nuk janë të vetmet:

- Serbia nuk ka patur vetëm një program për Kosovën. Serbia ka patur në vazhdimësi shumë programe për Kosovën.

- Programet e Serbisë për Kosovën që janë bërë të njohura për qytetarin e zakonshëm, janë shumëdimenzionale, përfshijnë shumë fusha, d.m.th. janë shumëdisiplinare, dhe në këtë mënyrë janë komplekse.

- Fakti se Serbia ka patur shumë programe për Kosovën të cilat janë bërë të njohura për qytetarin e zakonshëm nënkupton, se Serbia ka patur edhe programe tjera për Kosovën të cilat nuk janë bërë të njohura për qytetarin e zakonshëm.

- Fakti se ka patur programe të cilat nuk janë bërë të ditura për qytetarin e rëndomtë, më tutje nënkupton se Serbia ka patur edhe programe të cilat

janë përgatitur si alternativa rezervë, për t'u përdorur, varësisht nga skenarët dhe situatat e krijuara.

- Fakti se Serbia ka patur shumë programe dhe se ka patur programe alternative, nënkupton se në përgatitjen e tyre janë angazhuar ekspertët dhe specialistët e institucioneve shtetërore.

- Fakti se këto programe janë përgatitur nga institucionet shtetërore, nënkupton se ekspertët dhe specialistët e angazhuar, kanë qenë të profilit më të lartë profesional dhe shkencor, financimi nuk ka qenë problem.

- Fakti se në përgatitjen e këtyre programeve janë angazhuar ekspertët dhe specialistët e profileve më të larta, dëshmon se këto programe në themel janë të fuqishme.

- Fakti se këto progame janë të fuqishme, përballja dhe kundërvenia këtyre programeve gjithashtu kërkon fuqi, kërkon angazhimin e ekspertëve dhe specialistëve të profileve të larta.

Derisa Serbia në Kosovë kishte të instaluar administrimin e drejpërdrejtë, forcat e sigurisë, dhe gjithashtu shërbimet e mshefta, zbatimi i programeve për Kosovën ka qenë i lehtë falë mundësisë së angazhimit të gjithë këtyre strukturave për zbatimin e këtyre programeve.

Po pas tëreheqjes së administratës dhe forcave të sigurisë?

Mundësia për zbatimin e programeve për Kosovën mbetën strukturat e shërbimeve të mshefta, dhe kjo nuk do të duhej të vihej në dyshim.

Çka të bëhet në këtë gjendje?

Më e mira do të ishte, sikur institucionet e Kosovës të ishin funksionale dhe efikase. Mjerisht, tani për tani, nuk kemi një gjendje të tillë. Mbetet që populli të nxjerr bijat dhe bijtë e vet për të krijuar kushte për mbrojtje nga veprimtaria e SHMS-ve, derisa të ngritet dhe fuqizohet funksionaliteti dhe efikasiteti i institucioneve të Kosovës.

A ËSHTË KOSOVA NË FAZËN E NEOKOLONIALIZMIT NGA SERBIA?

Se Kosova gjatë periudhës së okupimit serb ka qenë në një pozitë të kolonializimit më brutal të mundshëm, besohet se nuk ka dyshime.

Shtrohet pyetja: po pas tërheqjes së adminstritatës dhe forcave të sigurisë së Serbisë, në çfarë gjendje është Kosova?

Të gjithë ne që kemi kryer pak shkollë në kohën e socializmit, ku numri i të diplomuarëve arrinë në qindra mijëra, kemi mësuar se pas kolonializimit pason faza e neokolonializimit. Po ashtu, kemi mësuar se neokolonializmi është vazhdim i kontrollit, veçse me metoda tjera, që janë më të padukshme. Të habit fakti se, të paktën publikisht, askush nuk ka paraqitur ndonjë mendim se a mos Kosova tani është në fazën e neokolonializmit nga Serbia.

Mbizotëron një mendim i përgjithshëm se Kosova me tërheqjen e forcave të sigurisë dhe të administratës së Serbisë, ka fituar një shkëputje të plotë nga Serbia, d.m.th. nga kolonializmi brutal ka kaluar në pavarësi absolute, dhe se nuk ka më Beograd në Prishtinë. Habit fakti se ku mbeti mësimi i kohës së socializmit që nuk arriti të na mësojë, të paktën të bëhet e ditur publikisht, që të mendohet se a mos edhe Kosova po kalon proceseve që kanë kaluar edhe vendet dhe popujt tjerë të botës.

Mendohet se Kosova pas tërheqjes së administratës dhe forcave të sigurisë së Sërbisë, ka kaluar në fazën e neokolonializmit nga Serbia në formën që e ka përshkruar mësimi në socializëm. Për të fituar pavarësinë e plotë, Kosova duhet që të shkëputet nga neokolonializmi dhe të përfundojë edhe këtë lloj neokolonializimi që tani Kosova ka nga Serbia.

Shtrohet pyetja: si e realizon Serbia neokolonializimin e Kosovës pa administratë dhe pa forca të sigurisë?

Mendoj se neokolonializimi i Kosovës nga Serbia sigurohet nga veprimet dhe veprimtaria e spiunëve zyrtarë me betim të SHMS-ve në Kosovë si dhe të bashkëpunëtorëve me dijeni dhe pa dijeni.

Gjatë kohës së diskutimeve për ndryshimet kushtetuese të fundviteve 80-ta autori ishte ende student dhe mban në kujtesë një tubim të klasës punëtore të Elektroekonomisë së Kosovës. Në këtë takim nga Beogradi kishte ardhur Sllobodan Millosheviqi për të folur lidhur me ndryshimet kushtetuese për Serbinë unike. Tubimi ishte në transmetim të drejtpërdrejt ë të Radio

Prishtinës. Përfaqësuesit e klasës së punëtorëve mbajtën fjalim dhe njëri pas tjetrit mbronin Kosovën nga humbja e autonomisë. Pastaj e merr fjalën Sllobodan Millosheviqi i cili thotë: "Çka po doni more ju shqiptarët, edhe po që se unë dua ta lëshoj Kosovën, kam aq shumë njerëz që nuk e duan ndarjen e Kosovës nga Serbia, sa nuk më lejojnë. Kam aq shumë njerëz në Kosovë sa ta mbaj Kosovën edhe një mijë vjet". Pas këtyre fjalëve, në radio dëgjohet zhurma nga shumë zëra kundërshtues dhe transmetimi ndërpritet.

Shtrohet pyetja: Sa njerëz vërtet kanë qenë në atë kohë që nuk e kanë dashur ndarjen e Kosovës nga Serbia dhe ku janë ata sot, çfarë bëjnë?

Se Kosova është nën neokolonializmin e Serbisë ka shumë fakte. Përveç importit të lartë të mallrave nga Serbia që është diçka publike, neokolonializimi shihet përmes jofunksionalitetit dhe joefikasitetit të institucioneve të Kosovës. Importi i lartë nga Serbia në vetvete nuk është edhe problemi më i madh, një import i tillë i lartë në kushtet e pavarësisë së plotë nuk ka asgjë të keqe, sepse në ekonominë e tregut tregtimi është i lirë. Institucionet funksionale dhe efikase të Kosovë do të pamundësonin gjendjen neokolonialiste të Kosovës.

Serbia në Kosovë po e realizon neokolonializmin dhe po e mundëson jofunksionalitetin dhe joefikasitetin e institucioneve të Kosovës përmes veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve. Përmes punës së spiunëve zyrtarë me betim dhe të bashkëpunëtorëve të tyre, Serbia po e bën të mundshme neokolonializimin e Kosovës. Garantuese për funksionimin dhe mirëmbajtjen e funksionimit të neokolonializmit të Kosovës nga Serbia është armata prej 720 spiunëve zyrtarë me betim dhe 50.000 bashkëpunëtorëve, ushtarë të gatshëm për veprim.

SYNI DHE MENDJA E QYTETARIT PËRBALLË VEPRIMTARISË SË SHMS-ve

Thënie: **"Njeriu sheh me men e jo me sy"**

Siç u përshkrua më lart, institucionet e Kosovës kanë vështirësi në funksionalitetin dhe efikasitetin e tyre. Në një gjendje të tillë, është e nevojshme që individët që kanë dije dhe njohuri rreth veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, të jenë aktivë dhe të bëjnë publike për qytetarin e zakonshëm sëcilën dije dhe njohuri dhe sëcilin informacion që kanë në lidhje me veprimtarinë e shërbimeve informative të huaja armiqësore në Kosovë.

Me bërjen publike të njohurive dhe informacioneve rreth veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, qytetari i zakonshëm do të njohë dhe kuptojë veprimet konkrete, dhe në këtë mënyrë do të mund të përballej me veprimtarinë e msheftë që kryejnë ato.

Në daljen publike të dy ish-zyrtarëve të shërbimeve informative, në mes të shumë informacioneve, u shpalos se për shërbimet e mshefta, bashkëpunëtori është syni dhe veshi i shërbimit. Po kundërvënia ndaj kësaj veprimtarie?

Sigurisht se institucionet përkatëse të një Kosove funksionale dhe efikase do të bënin kundërvënien e duhur të shërbimeve të huaja armiqësore. Edhe po që se kemi institucione të Kosovës shumë funksionale dhe efikase, qytetari i zakonshëm do të ishte shtylla mbështetëse e këtyre institucioneve. Në kushtet kur funksionaliteti dhe efikasiteti i institucioneve të Kosovës është i dobët, bëhet e domosdoshme që qytetari i zakonshëm të jetë shtylla e përballjes me veprimtarinë e SHMS-ve. Mbetet vetëm që të dihet se si, dhe në çfarë mënyre qytetari i zakonshëm mund të bëhet shtylla e përballjes me veprimtarinë e shërbimeve të huaja armiqësore.

Qytetari i zakonshëm është shtylla e përballjes me veprimtarinë e SHMS-ve, atëherë kur qytetari i zakonshëm është syni dhe mendja e tij(saj) përballë kësaj veprimtarie. Qytetari i zakonshëm është i pranishëm në çdo pjesë të Kosovës, është i pranishëm në çdo institucion të Kosovës, është i pranishëm në çdo pore të jetës në Kosovë. Meqë kjo veprimtari në Kosovë nuk është miqësore, përkundrazi është armiqësore, sigurisht se qytetari i zakonshëm është shumë i interesuar që të jetë syni dhe mendja përballë kësaj veprimtarie në Kosovë, kjo nga fakti se ka interes në mbrojtjen nga veprimtaritë armiqësore. Mbetet që vetëm të dihet se si dhe në çfarë mënyre qytetari i zakonshëm mund të bëhet shtylla e përballjes me veprimtarinë e SHMS-ve.

Veprimet e SHMS-ve në Kosovë, në shikim të parë duket se janë të fsheta, por në fakt këto veprime janë publike, janë publike por nuk shihen po që se qytetari i zakonshëm nuk ka sy për t'i parë dhe mendje për t'i kuptuar. Duket paradoksale që dikush të ketë interes që të shohë dhe kuptojë diçka, të ketë sy që shohin dhe mendje që mendon, dhe prapë mos t'i shohë dhe mos t'i kuptojë veprimet që ka interes t'i shohë dhe t'i kuptojë. Ky paradoks zgjidhet nga fakti se veprimet e këtyre lloj shërbimesh janë të mshefta, këto shërbime janë profesionale dhe të specializuara, janë të menduara dhe të kryera ashtu që i ke para syve dhe nuk i sheh, të prekin jetën dhe nuk i kupton. Përndryshe nuk do të quheshin veprime të mshefta. Jo rastësisht shërbimet e mshefta quhen shërbime inteligjente.

Për të qenë qytetari i zakonshëm syni dhe mendja përballë veprimeve të SHMS-ve, duhet që qytetarit t'i ndihmohet për t'i parë këto veprime, duhet që qytetarit t'i ndihmohet për t'i kuptuar këto veprime. Me qytetarin duhet të punohet për t'i mundësuar të pamurit dhe të kuptuarit e këtyre veprimeve. Ndihma më e madhe që mund t'i bëhet qytetarit të zakonshëm është që ai të jetë i informuar rreth veprimtarisë. Ndriçimi i informatave mundëson që qytetari i zakonshëm t'i shohë dhe t'i njohë, t'i kuptojë mirë veprimet dhe veprimtarinë, dhe në këtë mënyrë t'u dalë në ballë dhe t'i kundërvihet kësaj veprimtarie.

Në kushte normale, do të ishin institucionet e Kosovës që do të duhej të mundësonin që qytetari i zakonshëm të jetë syni dhe mendja përballë veprimeve të SHMS-ve. Në mungesë të punës së institucioneve të Kosovës, mbetet që bijtë dhe bijat e popullit të punojnë me qytetarin e zakonshëm, dhe ta përgatisin qytetarin e zakonshëm që të jetë syni dhe mendja përballë veprimtarisë. Poashtu, në këtë fazë të zhvillimit të Kosovës, është e nevojshme që të gjithë ata që kanë ndonjë njohuri mbi veprimet dhe veprimtarinë e SHMS-së në Kosovë t'i bëjnë ato njohuri publike dhe të njohura për qytetarin e zakonshëm.

Në këtë fazë të zhvillimit të Kosovës, është e nevojshme që të gjithë gazetarët dhe të gjitha mjetet e informimit të shtojnë hapësirat dhe përpjekjet për t'i ofruar qytetarit të zakonshëm sa më shumë informacione të kësaj fushe. Gjithashtu, në këtë fazë të zhvillimit të Kosovës është e nevojshme që të gjitha institucionet e Kosovës, institucionet shtetërore, institucionet e pavarura, institucionet profesionale dhe institucionet shkencore të angazhohen maksimalisht dhe të shtojnë përpjekjet për t'i ofruar qytetarit të zakonshëm sa më shumë informacione dhe njohuri të kësaj fushe. Përmes këtij publikimi po bëjmë përpjekje që të kryejmë detyrimin tonë qytetar.

NDRIÇIMET E DERITANISHME TË VEPRIMTARISË SË SHMS-ve NË KOSOVË

Në opinionin e Kosovës, çështja e veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë nuk është vërejtur si një çështje e cila ka ngritur debat deri me daljen në publik të dy ish-zyrtarëve të shërbimeve informative. Bile po të bisedoje për këtë veprimtari në mënyrë private në rreth shokësh a miqsh, qytetarë të zakonshëm, tepër të pakët ishin ata që do të merrnin veprimtarinë e SHMS-ve si diçka për t'u shqetësuar. Të flasësh me dikë në lidhje me këtë veprimtari në Kosovë ka qenë dhe fatkeqësisht vazhdon të mbetet sikur të

flasësh me murin. Për më tepër, tek një shumicë përmbajtësore, po që se hapëshe ose hap bisedë në lidhje me veprimtarinë e SHMS-ve të merrnin për të keq, të merrnin si dikush që fantazon gjëra të paqena. Për më tepër, po që se shpreheshe ndonjë dyshim për ndonjë veprim konkret ose të ndonjë personi si bartës i veprimtarisë së SHMS-ve, të merrnin si person subjektiv, si një person që ka gjëra personale me ndonjë individ të apostrofuar si i dyshuar, e të ngjajshme.

Në ditët e para pas daljes në publik të dy ish-zyrtarëve të shërbimeve informative, shumica e qytetarëve të zakonshëm shprehën një shqetësim të theksuar për veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë. Po ashtu, shumica e qytetarëve të zakonshëm shprehen iritim nga personat që punojnë për interesa të Serbisë pas gjithë asaj historie të keqe dhe shumë trishtuese të okupimit.

Është interesante për t'u theksuar se shumica e qytetarëve të zakonshëm shfaqën mllef ndaj veprimeve persekutuese të aparatit shtetëror të Serbisë në të kaluarën, por që ky mllef kufizohej në pjesën e veprimeve persekutuese që ishin publike, të strukturave publike siç ishin veprimet e UDB-së, SDB-së, RDB-së dhe SUP-it. Veprimet dhe veprimtaria e shërbimeve të mshefta shtrihet përtej strukturave publike siç janë UDB, SDB, RDB dhe SUP dhe se kjo pjesë e kësaj veprimtarie nuk ishte fare pjesë e debatit dhe në këtë mënyrë nuk ishte as shqetësuese, nuk ishte as irituese, dhe në këtë mënyrë as që demonstrohej ndonjë mëllef.

Ngritja e shqetësimeve, iritimeve dhe e mllefit ndaj strukturave publike të aparatit shtetëror të Serbisë është e kuptueshme për qytetarin e zakonshëm. Edhe mosshprehja e mllefit nga qytetari i zakonshëm ndaj pjesës jo publike të veprimtarisë së SHMS-ve është e kutpueshme, kjo për faktin e mungesës së informacioneve. Veprimet dhe veprimtaria e tillë edhe gjatë kohës së pranisë së strukturave publike shtetërore të Serbisë në Kosovë nuk ka qenë e ndriçuar asnjëherë deri tani.

Në mungesë të informacioneve dhe në mungesë të njohurive, qytetari i zakonshëm nuk kishte si të shprehte shqetësim, nuk kishte si të shprehte iritim dhe nuk kishte si të shprehte mllef. Veprimet dhe veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë vazhdon të mos ndriçohet as pas luftës, deri në ditët e sotme.

Përderisa në mesin e qytetarëve të zakonshëm u shprehën shqetësime dhe u ngritën diskutime e debate, së paku për pjesën publike të aparatit shtetëror të Serbisë, këto shqetësime dhe debate shumë shpejt ranë në qetësi, nuk u

zgjatën më shumë se pak javë, dhe u harrua çdo gjë mëpastaj, u fut në dhe çdo gjë. Nga ana tjetër, institucionet e Kosovës rreth ndriçimit të veprimtarisë së SHMS-ve u kufizuan me shprehjen e kërkesave nga një numër shumë i vogël i deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratim të Ligjit të lustrimit, si dhe kërkesave të përgjithësuara për ndriçimin e emrave të personave konkretë që janë spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve dhe që janë pjesë e Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës.

Gjatë periudhës së pasdaljes në publik të informacioneve të cekura më lart, në publik dolën edhe disa rrëfime personale nga e kaluara rreth veprimeve konkrete dhe emrave konkretë të përfshirë në strukturat e aparatiti shtetëror, por që kryesisht kishin të bënin me pjesën e strukturave publike si UDB, SDB, RDB, SUP, etj. Po ashtu, në publik dolën edhe disa lista të ish-bashkëpunëtorëve të "UDB-së" lista të cilat nuk ishin zyrtare dhe nuk ishin të vërtetuara. Gjatë periudhës së këtij debati, në publik dolën edhe reagime dhe paraqitje të individëve të ndryshëm, disa nga të cilët shprehnin dyshime në shpalosjen e informacioneve nga ish-zyrtarë të shërbimeve informative me gjykimin se këto bëhen nga vetë Serbia për të futur përçarje, huti, pasiguri etj. në ndërtimin e institucioneve të Kosovës. Shtrohet pyetja: çfarë interesi ka Serbia të bëjë shpalosjen e veprimtarisë së vet?

Është interesante se edhe në debatet e qytetarëve të zakonshëm, dhe edhe në debatet e pak deputetëve të Kuvendit të Kosovës të kyçur në debat, veçori ishte se shqetësimet dhe diskutimet kryesisht lidheshin me veprimet e individëve, thënë thjeshtë" kush kë e ka dërguar në burg", "kush kë e ka rrahur", "kush kë e ka diferencuar", e të ngjajshme. Po ashtu, nga debatuesit, nuk mund të bëhej ndonjë dallim në mes të veprimeve dhe veprimtarisë së shërbimeve të mshefta dhe veprimeve të strukturave publike shtetërore.

Niveli i debatit siç u paraqit në paragrafët më lart dhe kufizimi i debatit në çështjet e veprimeve të strukturave shtetërore publike është i kuptushëm për qytetarin e zakonshëm. Ky nivel i debatit dhe kufizim i debatit tek zyrtarët e institucioneve të Kosovës nuk është i kuptueshëm dhe nuk mund të arsyetohet, kjo nga fakti se do të duhej të kishin nivel më të lartë të shqetësimeve, nivel më të lartë të njohurive dhe nivel më të lartë të përgjegjësive rreth veprimtarisë së SHMS-ve, në këtë fazë të ndërtimit të institucioneve të Kosovës. Zyrtarët e institucioneve të Kosovës kanë marrë përgjegjësitë për ndërtimin e institucioneve të Kosovës, dhe për këtë arsye kanë përgjegjësi edhe për ndalimin e veprimtarisë së shërbimeve informative të huaja armiqësore në Kosovë.

Në fakt, për ndërtimin e institucioneve të Kosovës pas përfundimit të luftës, ka pak interes në ndriçimin e veprimeve të ish- strukturave shtetërore publike të Serbisë që ekzistonin në Kosovë dhe Jugosllavi. Interes jetik është ndriçimi i veprimeve dhe i veprimtarisë së SHMS-ve në periudhën e pasluftës së fundit. Nga përfundimi i luftës, aq pak është punuar në ndriçimin e veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve, sa që lirisht mund të thuhet se nuk është bërë asgjë. Kjo sidomos vlen për periudhën e pas bërjes publike të përmasave të kësaj veprimtarie në Kosovë. Nuk ka rastisur që në publik të dalë diçka nga institucionet e Kosovës siç janë Agjensioni Kosovar i Inteligjencës, Policia e Kosovës, partitë politike, institutet shkencore dhe profesionale, e të ngjajshme në lidhje me veprimtarinë e shërbimeve informative të huaja armiqësore në Kosovë.

Ndriçimi i veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë pas përfundimit të luftës së fundit, në këtë fazë të ndërtimit të institucioneve të Kosovës, mund të bëhet vetëm nga individët të cilët në një ose mënyrë tjetër kanë patur rast që të përfitojnë informacione, të kenë përjetuar goditje personale nga SHMS-të, ose që kanë përvoja tjera të ndryshme që u kanë mundësuar të përfitojnë njohuri rreth kësaj veprimtarie. Individë të ndryshëm që kanë njohuri dhe informacione, qoftë si pjesëtar të institucioneve të Kosovës qoftë si qytetar të zakonshëm, është e nevojshme që t'i ndriçojnë dhe t'i bëjnë publike këto njohuri dhe informacione.

Puna e SHMS-ve ngjan me punën e urit, punon nën dhe, ku nuk ka dritë. Po që se uri del në dritë, nuk di nga të shkojë, nuk di çka të bëjë, bile edhe ngordh. Për t'i ç'orientuar dhe ngordhur veprimet dhe veprimtarinë e tillë, duhet që këto veprime dhe veprimtari të ndriçohen, duhet që t'u hiqet errësira, duhet që t'i marrë drita.

Veprimet dhe veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë mund të ndriçohen aq sa dihet për këtë veprimtari, aq sa është e njohur kjo veprimtari. Nuk mund të ndriçohet diçka që nuk njihet, diçka që nuk dihet për të. Për veprimtarinë e paraluftës së fundit dihet diçka, realisht dihet shumë pak, së paku nga ana e publikut të gjerë. Për veprimtarinë e SHMS-ve pas lufte dihet edhe më pak, në fakt nga publiku i gjerë nuk dihet asgjë, nga fakti se publiku i gjerë është përfshi nga mendimi se pas luftës nuk ka spiunë me betim dhe veprimtari të SHMS-ve në Kosovë, janë tërhequr spiunët e SHMS-ve së bashku me administratën dhe forcat e sigurisë. Me bërjen publike të disa informacioneve rreth kësaj veprimtarie, realiteti doli krejt tjetër, se jo që ka veprimtari, por se përmasat e kësaj veprimtarie janë shqetësuese. Mendimi nga publiku i gjerë se pas luftës nuk ka spiunë dhe veprimtari të SHMS-ve, ka krijuar mjedis

tepër të përshtatshëm për zgjërim të veprimtarisë, deri tek përmasat e pranisë shqetësuese.

NEVOJA PËR DEKONSPIRIM TË VEPRIMEVE DHE PROGRAMEVE TË SHMS-VE

Në paragrafët paraprakë u shtjellua se ndriçimi i veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë për periudhën e paraluftës së fundit është bërë shumë pak, kurse për periudhën e pasluftës nuk është bërë asgjë, me përjashtim të informacioneve të bëra publike nga dy ish-zyrtarët e shërbimeve informative kohëve të fundit. Po ashtu, u shtjellua se kjo veprimtari mund dhe duhet të ndriçohet nga individë që kanë informacione dhe njohuri rreth kësaj veprimtarie. Nevoja për dekonspirim është e padyshimtë, mbetet që të dihet se si dhe çka mund dhe duhet të dekonspirohet.

Dihet se veprimet dhe veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë janë të mshefta, mirëpo, po në të njëjtën kohë veprimet e tyre janë publike, vetëm se nuk shihen dhe nuk kuptohen nga publiku. Kjo është edhe fuqia e tyre, kryerja e veprimeve në publik dhe mos hetimi nga publiku. Jorastësisht shërbimet e mshefta quhen shërbime inteligjente. Atëherë çka mund të shihet dhe çka mund të kuptohet nga publiku i gjerë, çka mund të shihet dhe çka mund të kuptohet nga qytetari i zakonshëm?

Po që se fillohet të mendohet se pas luftës në Kosovë ka spiunë zyrtarë me betim dhe se ka veprimtari të SHMS-ve, atëherë edhe sheh veprime konkrete të tyre dhe se qartë sheh veprimtarinë konkrete. Sa më shumë të mendosh dhe të shikosh për veprime dhe veprimtari të SHMS-ve, aq më shumë sheh dhe kupton veprimet dhe këtë veprimtari Kosovë.

Qytetari i zakonshëm e di se Serbia vazhdimisht ka patur politika dhe programe të veçanta për Kosovën. Këto politika dhe programe kanë patur synime dhe kanë patur zbatim, varësisht nga rrethanat që kanë ekzistuar. Synimi parësor i përgjithshëm i politikave dhe programeve të Serbisë, nga okupimi dhe deri në luftën e fundit, kanë qenë që tokën e Kosovës ta bëjnë tokë Serbe. Synimet e veçanta të politikave dhe programeve të veçanta i janë nënshtruar këtij synimi të përgjithshëm.

Sigurisht se edhe pas lufte, synimi i përgjithshëm i Serbisë mbetet i njëjtë. Lufta e fundit ka krijuar realitetin që synimet e veçanta që i nënshtrohen

synimit të përgjithshëm do të duhej të ishin pamundësimi i pavarësisë së Kosovës. Ky synim do të mund të arrihej përmes pamundësimit të formimit të institucioneve të Kosovës. Po që se formimi i institucioneve nuk mund të pamundësohet, atëherë do të mbetej që si synim që këto institucione të jenë jofunksionale, të jenë joefikase, me një fjalë të jenë sa më të dobëta. Sigurisht, të gjitha këto synime të mundshme arrihen përmes zbatimit të politikave dhe programeve të mundshme të veçanta' për Kosovën dhe se realizimi i tyre arrihet përmes zbatimit të veprimeve nga SHMS-të.

Po që se synim i Serbisë është jofunksionaliteti dhe joefikasiteti i institucioneve të Kosovës, realiteti në Kosovë po tregon se institucionet e Kosovës përgjithësisht janë jofunksionale dhe joefikase. Kjo po dëshmohet edhe me të gjitha raportet e institucioneve ndërkombtare që konsiderohen si të pavaruara. Po ashtu, tani është bërë publike prania dhe shtrirja shqetësuese e veprimtarisë. Një lidhje logjike u gjet: prania deri në nivele shqetësuese e spiunëve të SHMS-ve, me veprimtari konkrete - jofunksionaliteti dhe joefikasiteti i institucioneve të Kosovës. Përmes gjetjes së kësaj lidhje logjike, u krye edhe një dekonspirim i një politike të Serbisë ndaj Kosovës, u dekonspirua zbatimi konkret dhe fatkeqësisht u vërtetua arritja e synimit të politikës së Serbisë për Kosovën.

Arritja e synimeve të politikave të Serbisë, bëhet vetëm përmes zbatimit të programeve konkrete. Me dekonspirimin e politikës, u bë edhe dekonspirimi se Serbia paska program ose programe konkrete për Kosovë. Të gjitha programet e Serbisë për Kosovën janë zbatuar nga SHMS-të. Njëjtë duhet të jetë edhe pas luftës së fundit.

Në qoftë se mendohet rreth synimeve të politikave të Serbisë për Kosovë, do të gjenden edhe lidhje tjera në mes të politikave të Serbisë ndaj Kosovës dhe realitetit në Kosovë. Të gjitha politikat e Serbisë ndaj Kosovës, për t'u realizuar, duhet të kenë programe konkrete. Programet e Serbisë për Kosovën, në kushtet e pasluftës mund të realizohen vetëm përmes spiunëve zyrtarë me betim, të SHMS-ve, në Kosovë.

Shtrohen pyetjet: cilat janë politikat tjera të Serbisë? A ka politikë dhe në këtë mënyrë program të veçantë për secilin institucion të veçantë?

Sigursht se ka, përndryshe nuk do të arrihej synimi parësor i përgjithshëm i jofunksionalitetit dhe joefikasitetit të institucioneve të Kosovës.

Pyetja në vazhdim do të ishte: si realizohen programet e veçanta për secilin institucion?

Përgjigjja është se realizohen përmes spiunëve konkretë, me veprime konkrete të tyre, në secilin institucion të Kosovës.

Pyetja: po si të shihen dhe të dihen këto veprime konkrete? Si të dihet se një veprim konkret kryhet me qëllim të realizimit të një programi konkret të Serbisë ndaj Kosovës?

Përgjigjja është se, po që se dihen synimet dhe politikat e Serbisë ndaj Kosovës për një institucion konkret, atëherë është lehtë të kuptohet se çfarë do të ishte programi konkret për realizimin e atij synimi dhe politika mbi institucionin konkret dhe cilat veprime konkrete do të mund të bënin të mundur arritjen e synimit dhe politikës konkrete mbi një institucion konkret.

Me qënë se siç u përshkrua paraprakisht, programet e Serbisë zbatohen me qëllim të ndërtimit të realitetit të Kosovës, në përputhje me synimet dhe politikat e Serbisë për Kosovën, atëherë veprimet konkrete të SHMS-ve, në realizimin e programeve janë publike, realiteti është publik, veçse edhe pse veprimet janë publike nuk shihen nga publiku. I ke para syve por nuk i sheh!

Shtrohet pyetja si të vërehet, si të dihet një veprim që qenka publik por që nuk po u vërejka nga publiku, nga qytetari i zakonshëm?

Përgjigjja është: së pari duhet të mendosh se mund të ketë veprimtari të SHMS-ve në Kosovë, pastaj duhet të dihen synimet dhe politikat e Serbisë për secilin institucion konkret, pastaj në bazë të synimeve dhe politikave të Serbisë mund të kuptohet se çfarë do të duhej të ishte programi konkret për atë institucion dhe në bazë të përmbajtjes së programit, mund të kuptohen se cilat janë veprimet konkrete që kryhen dhe çojnë kah përmbushja e synimit dhe politikës konkrete.

Meqë veprimet kryhen me qëllim të ndërtimit të një realiteti, këto veprime janë publike meqë realiteti vetëm kështu ndërtohet, me realitet dhe në këtë mënyrë mund të vërehen. Duhet që të identifikohet lidhja logjike në mes të një synimi dhe politike konkrete dhe të një veprimi konkret që kryhet në funksion të realizimit të atij synimi dhe politike konkrete.

Me qëllim të njohjes së synimeve dhe politikave konkrete të Serbisë ndaj institucioneve konkrete të Kosovës, në këtë publikim bëhet ftesë që të gjithë individët që kanë informacione dhe njohuri rreth synimeve, politikave dhe veprimeve konkrete të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, t'i bëjnë publike. Me bërjen publike, qytetari i zakonshëm do të njohë, do të shohë dhe do të kuptojë veprimet konkrete të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve. Kur

qytetari i zakonshëm i sheh dhe i kupton veprimet konkrete të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve edhe do të reagojë në atë mënyrë që të parandalojë këto veprime.

Në lidhje me veprimet dhe veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë, janë shumë me interes që të jenë plotësisht të kuptueshme rendësia e ndriçimit të veprimeve dhe rëndësia e çasjes në ndriçimin e veprimeve të SHMS-ve, në Kosovë. Qasja e drejtë siguron rezultate të prekshme. Konsiderojmë se qasjet e paraqitura në këtë libër si: njohja e synimeve dhe politikave të Serbisë për Kosovën, njohja e veprimeve konkrete të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve dhe bërja publike e të gjitha njohurive në lidhje me synimet, politikat, programet dhe veprimet e SHMS-ve jep rezultate të prekshme.

Me ndriçimin e veprimeve konkrete dhe të veprimtarisë së SHMS-ve si terësi, në të njëjtën kohë bëhet edhe dekonspirimi i veprimeve dhe veprimtarisë. Dekonsipirimi i veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, në të njëjtën kohë bën dekonspirimin e politikave dhe programeve të Serbisë ndaj Kosovës. Përmes dekonspirimit arrihet njohja e veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve nga qytetari i zakonshëm, dhe në këtë mënyrë bëhet pamundësimi i veprimeve ose së paku pamundësimi i efekteve të veprimeve dhe veprimtarisë, dhe në këtë mënyrë bëhet pamundësimi i arritjes së synimeve të politikave të Serbisë ndaj Kosovës, si dhe pamundësimi i pengimit të institucioneve të Kosovës për të qenë funksionale dhe efikase.

Dekonspirimi i veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve ka edhe dimensione tjera, siç është zhvendosja e tanishme e vëmendjes së qytetarit të zakonshëm në drejtimin e duhur. Me fillimin, dhe sidomos me fuqizimin e dekonspirimit të politikave dhe programve të Serbisë ndaj Kosovës, vëmendja dhe përqëndrimi i qytetarit të zakonshëm, zhvendoset nga angazhimi për dekonspirim të individëve si bartë dhe atë kryesisht të periudhës së paraluftës së fundit, në angazhimin e dekonspirimit të veprimeve dhe veprimtarisë së SHMS-ve, për periudhën e pasluftës së fundit si për individët si bartës, ashtu edhe të veprimtarisë si tërësi.

Meqë u bë e qartë se veprimtaria e SHMS-ve është pengesë e funksionalitetit dhe efikasitetit të institucioneve të Kosovës, dekonspirimi i veprimeve dhe veprimtarisë së tillë në periudhën e pasluftës heq pengesat në rritjen e funksionalitetit dhe të efikasitetit të institucioneve për të krijuar mundësinë e zhvillimit më të shpejtë të Kosovës.

MOTIVET DHE SYNIMET E AUTORIT

Nuk është diçka e lehtë dhe e thjeshtë ndërmarrja e përpjekjeve për ndriçimin e veprimtarisë së shërbimeve të mshefta të një vendi, siç është Serbia, një superfuqi e deritanishme rajonale, në një mjedis që e ka patur të okupuar për 100 vjet, në një mjedis që është i dëshmuar për ushtrimin e një brutaliteti dhe persekutimi shumë të lartë, përmasat e të cilit poqëse bëhen rangime, sigurisht se do të prijë në nivele ndërkombëtare. Konsiderohet e arsyeshme që të dihet diçka se kush është autori i publikimit, cilat janë motivet dhe cilat janë synimet. Gjithsesi kjo është pjesa jo e këndshme, për faktin se duhet të shkruhet për vetvetën.

E kaluara është e përshkruar shkurtimisht në vijim. Është i lindur në Prekaz të Poshtëm të Skenderajt. Ka kryer fakultetin ekonomik, në vitin 1989. Ka punuar profesor i shkollës së mesme në Skenderaj, nga viti shkollor 1990/1991 deri në mars të vitit 1992. Pastaj emigron nga Kosova në Londër. Në Londër jeton deri në shtator të vitit 2001, për t'u kthyer në Kosovë, ku jeton edhe tani.

Gjatë qëndrimit në Londër, ka përcjellur studimet profesionale dhe është kualifikuar si "Kontabilist i Çërtifikuar i Mbretërisë së Bashkuar" , në vitin 2000. Gjatë qëndrimit në Londër, ka punuar punë profesionale në fushën e revizionit financiar ku në 5 vitet e fundit ka punuar për KPMG, Zyra e Londrës, Sektori Financiar, Departamenti i Revizionit. KMPG , është një nga 4 firmat më të fuqishme në botë për revizion financiar dhe konsulencë. Pas kthimit në Kosovë, në vitin 2001, ka hapur zyrën e vet për revizion financiar dhe konsulencë, ku ka punuar deri në vitin 2010, për të kaluar me punë në PTK deri me ndarjen e Postës së Kosovës ku tani punon.

Janë disa motive dhe disa synime për një ndërmarrje të tillë, siç u përshkrua në paragrafin më lart. Këto motive dhe synime janë të përshkruara edhe në vijim. Motivet dhe synimet janë reale, kanë të bëjnë me vetë autorin. Edhe motivet dhe edhe synimet burojnë dhe janë të lidhura me përjetimet dhe me përvojen e drejtpërdrejtë të vetë autorit me veprimet e SHMS-ve. Përshkrimi i përvojave të drejtpërdrejta është paraqitur në pjesën e mëvonshme të këtij publikimi.

Motivet për ndërmarrjen e përpjekjeve për ndriçimin e veprimtarisë së SHMS-ve, në Kosovë, janë paraqitur në vijim:

- Lirimi personal nga veprimet e SHMS-ve

Në pjesët vijuese të këtij publikimi, do të paraqiten përvojat e veprimeve konkrete goditëse, të drejtpërdrejta kundër autorit të këtij publikimi. Me ndriçimin e veprimeve, pritet që veprimtaria e SHMS-ve, ose të humb fuqinë goditëse, ose të eliminohet pothuajse tërësisht. Në këtë mënyrë, autori pret që edhe vetë personalisht të ndjehet i lirë nga veprimet e SHMS-ve në Kosovë.

- Lirimi i të tjerëve nga veprimet e SHMS-ve

Sigurisht se autori nuk është i vetmi individ, objekt pre i veprimeve goditëse të SHMS-ve, në Kosovë. Objekt pre i veprimeve të tilla në Kosovë janë, në mos dhjetëra mijëra, sigurisht se janë mijëra individë, përndryshe nuk do të arriheshin synimet e politikave të Serbisë ndaj Kosovës. Me humbjen e fuqisë goditëse, ose të eliminimit pothuajse të tërësishëm të veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, autori pret që edhe shumë individë të tjerë të ndjehen të lirë nga veprimet e tyre.

- Kontributi në bërjen e qytetarit të zakonshëm syni dhe mendja, përballë SHMS-ve

Konsideroj se përballja me SHMS-të, në Kosovë, mund të bëhet me sukses vetëm kur qytetari i zakonshëm është syni dhe mendja përballë kësaj veprimtarie. Qytetari i zakonshëm ka interes që të jetë syni dhe mendja përballë SHMS-ve, në Kosovë, mirëpo duhet që t'i ndihmohet në realizimin e kësaj. Ndihma mund t'i jepet përmes ofrimit të njohurive dhe informacioneve, e cila arrihet përmes ndriçimit të veprimeve dhe veprimtarisë. Kur qytetari i zakonshëm është syni dhe mendja përballë SHMS-ve, autori ndjehet se mund të jetë i lirë nga të qenët objekt, pre i veprimeve të tyre.

- Kontributi në zhvillimin e institucioneve të Kosovës

Institucionet e Kosovës nuk po mund të jenë funksionale dhe efikase për shkak të veprimtarisë së SHMS-ve, në Kosovë. Dobësimi i fuqisë së veprimtarisë ose edhe pothuaj eliminimi i kësaj veprimtarie, sigurisht se do të mundësojë që institucionet e Kosovës të jenë funksionale dhe efikase. Kur institucionet e Kosovës janë funksionale dhe efikase në përballjen me SHMS-të, në Kosovë, autori ndjehet se mund të jetë i lirë nga të qenët objekt pre i veprimeve të tyre.

Motivet e përshkruara në paragrafët më lart, shtyjnë që të punohet dhe të bëhen përpjekje që të arrihen disa synime, të cilat janë paraqitur në vijim:

- Ngritja në nivel meritor i shqetësimeve për veprimtarinë e SHMS-ve

  Prania e veprimtarisë së SHMS-ve, në Kosovë edhe po të ishte e përmasave shumë më të vogla sesa është shpalosur, është për t'u shqetësuar. Shqetësimet e ngritura nga prania e përmasave të bëra publike nga qytetarët dhe në veçanti e zyrtarëve të institucioneve të Kosovës, është e një niveli tepër të ulët, larg asaj që në këto rrethana do të duhej të ishte. Përmes paraqitjeve në këtë publikim, synohet që shqetësimet edhe të qytetarëve të zakonshëm edhe të zyrtarëve të institucioneve të Kosovës, të ngriten në nivelin e duhur për rrethanat e pranisë së përmasave të bëra publike rishtazi.

- Fitimi i lirisë dhe rehatisë për vete dhe të tjerët nga veprimet e SHMS-ve

  Veprimtaria e SHMS-ve, në Kosovë, nuk mund të kryhet pa ndërmarrjen e veprimeve goditëse ndaj personave konkretë. Një nga këta persona konkretë, ka rastisur të jetë edhe autori, edhe pse është vetëm njëri nga mijëra a nga dhjetëra mijëra persona tjerë. Përmes të paraqiturave në këtë publikim, synohet që niveli i shqetësimeve të ngritet në nivelin që do të dobësonte, ose edhe pothuajse eliminonte veprimet goditëse, së pari kundër vetë autorit, por gjithsesi edhe kundër gjithë personave tjerë.

- Rritja e funksionalitetit dhe efikasitetit të institucioneve të Kosovës

Ndriçimi i veprimtarisë së SHMS-ve, sigurisht që ndikon në dobësimin e fuqisë së kësaj veprimtarie. Dobësimi i kësaj veprimtarie sigurisht se do të ndikojë në rritjen e funksionalitetit dhe efikasitetit të institucioneve të Kosovës. Përmes të paraqiturave në këtë publikim, synohet që niveli i ndriçimit të veprimtarisë së SHMS-ve, në Kosovë, të rritet dhe se me rritjen e nivelit të ndriçimit në proporcion të drejtë, do të rritet funksionaliteti dhe efikasiteti i institucioneve të Kosovës.

KAPITULLI I DYTË

VEÇORITË DHE ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË VEPRIMTARISË SË SHMS-ve

Në kapitullin paraprak u shtjellua se veprimtaria e SHMS-ve pengon deri në pamundësim, ndërtimin e institucioneve të Kosovës, të cilat shërbejnë si mekanizma ose instrumente për ndërtimin e jetëve më të mira për pjesëtarët e shoqërisë së Kosovës. Nevoja për eliminim ose për pamundësim të veprimtarisë së tillë, kërkon që kjo veprimtari së pari të njihet.

Njohja e veprimtarisë së SHMS-ve, në fakt është njohje e veçorive dhe elementeve të veprimtarisë së tyre. Meqë veprimtaria e SHMS-ve është veprimtari e msheftë, sigurisht edhe njohja e veçorive dhe elementeve të veprimtarisë është e ulët. Kur përpjekjet për njohje mungojnë, atëherë kjo njohje pothuajse mungon krejt.

Po a ekziston ndonjë njohuri për veprimtarinë e SHMS-ve?

Sigurisht se njohuri ka, veç se gjendet tek individët të cilët në një ose mënyrë tjetër, kanë patur përvoja të drejtpërdrejta me veprimtarinë e tillë. Rritja dhe zgjerimi i njohjes së veprimtarisë së SHMS-ve, sidomos në këtë fazë të zhvillimit të Kosovës, ku mungojnë institucione funksionale dhe efikase të kësaj fushe, mund të kryhet vetëm me ndriçimin (qitjen në dritë) të diturive të këtyre individëve rreth veçorive dhe elementeve të veprimtarisë së tillë.

Për të njohur veçoritë dhe elementet e veprimtarisë së SHMS-ve, do të ndihmonte nëse nisemi nga njohja e veçorive dhe elementeve që janë të nevojshme për ndërtimin e institucioneve të Kosovës. Veçoritë dhe elementet e nevojshme për ndërtimin e institucioneve të Kosovës kanë të bëjnë me vlerat shoqërore njerëzore që janë pozitive, që kanë të bëjnë me kapacitetet krijuese zhvillimore të njerëzve të Kosovës.

Veçoritë dhe elementet e nevojshme për ndërtimin e institucioneve të Kosovës, që janë vlera shoqërore njerëzore pozitive, që kanë të bëjnë me kapacitetet krijuese zhvillimore, janë të mishëruara në individë të veçantë. Për të arritur synimet e politikave dhe të programeve të Serbisë për Kosovën, sigurisht se SHMS-të veprimtarinë e vet e zhvillojnë me veçori dhe elemente të cilat pamundësojnë vlerat shoqërore njerëzore pozitive tek individët e veçantë dhe zhvillojnë veprimtarinë me veçori dhe elemente që zvogëlojnë ose zhdukin kapacitetet krijuese zhvillimore të njerëzve të Kosovës.

Veprimtaria e SHMS-ve nuk kryhet vetëm me disa veprime, por kryhet me shumë veprime. Veprimet e tyre nuk janë veprime të çastit, janë veprime të studiuara mirë nga institutet dhe institucionet më të fuqishme të Serbisë nga pikëpamja profesionale dhe shkencore. Meqë veprimet e SHMS-ve janë të shumta dhe të shumëllojshme, janë të organizuara, dhe që kryhen pa ndërprerë në vazhdimësi, janë pra veprime sistematike. Përmes veprimeve sistematike, SHMS-të kanë ndërtuar sisteme të veçanta në Kosovë, të cilat janë funksionale dhe shumë efektive.

Në fakt, nuk kanë të ndërtuar vetëm një sistem në Kosovë, por kanë të ndërtuara shumë sisteme. Përmes ndërtimit të shumë sistemeve, kanë ndërtuar tërësi të sistemeve që paraqet një makineri që vepron si mekanizëm i fuqishëm për arritjen e synimeve të politikave dhe programeve të Serbisë. Tërësia e sistemeve është ndërtuar, mbahet në funksion dhe mirëmbahet funksionimi i kësaj tërësie përmes veprimeve konkrete të spiunëve konkretë dhe të bashkëpunëtorëve të SHMS-ve.

NDËRTIMI I SISTEMEVE DEGRADUESE TË VLERAVE SHOQËRORE NJERËZORE

Së pari konsiderohet e nevojshme që të sqarohet se çka kuptohet me nocionin "vlera shoqërore njerëzore". Me nocionin "vlera shoqërore njerëzore" , kuptohen një a më shumë shkathtësi, cilësi ose veçori të një individi, karshi shoqërisë dhe karshi marrëdhënieve me shoqërinë. Me fjalë tjera, vlera shoqërore njerëzore janë shkathtësitë, cilësitë ose veçoritë njerëzore që një individ i posedon dhe se me këto shkathtësi, cilësi ose veçori, ndërton marrëdhënie me rrethin ku jeton, ndërton marrëdhëniet në shoqërinë ku jeton. Këto shkathtësi, cilësi ose veçori, përbëjnë kulturën e individit.

Shkathtësi, cilësi ose veçori janë: ndershmëria, besnikëria, dredhia, mençuria, improvizimi, falsifikimi, korrektësia, mbajtja e fjalës së dhënë, shkelja e fjalës së dhënë, tradhtia, etj.
Sigurisht se shkathtësitë, cilësitë ose veçoritë njerëzore të një indvidi, mund të jenë pozitive ose negative për shoqërinë, mund të jenë të dobishme ose të dëmshme për shoqërinë, mund të jenë më pak të dobishme ose më shumë të dobishme për shoqërinë, e kështu me radhë.

Gjatë gjithë periudhës së okupimit të Kosovës nga Serbia, në Kosovë është imponuar ndërtimi i shumë sistemeve degraduese të vlerave shoqërore njerëzore. Llojet e sistemeve të vlerave shoqërore njerëzore të ndërtuara në Kosovë, kanë ndryshuar dhe u janë përshtatur rrethanave të kohës, mirëpo vazhdimisht janë imponuar sisteme, që në thelb kanë qenë degraduese për shoqërinë kosovare, në thelb kanë qenë dëmtuese dhe shkatërruese për shoqërinë kosovare.

Pavarësisht modeleve të sistemeve të vlerave shoqërore njerëzore, të ndërtuara në Kosovë, synimet e Serbisë kanë qenë gjithmonë të njëjta. Përmes ndërtimit të imponuar të sistemeve të vlerave, Serbia ka synuar që Kosovën ta pengojë në zhvillimet shoqërore. Duke penguar zhvillimet shoqërore, Kosova do të mbetej më e pazhvilluar dhe sa më e pazhvilluar, më lehtë Serbia do të bëjë shndërrimin e tokës së Kosovës në tokë serbe, përmes ndërrimit të strukturës së popullësisë në favor të popullësisë serbe. Imponimi i ndërtimit të modeleve të sistemeve të vlerave shoqërore njerëzore në Kosovë, është realizuar përmes veprimeve ndërhyrëse të SHMS-ve në Kosovë.

Në lidhje me modelet e sistemeve të vlerave shoqërore njerëzore, që Serbia ka ndërtuar me imponim, vlen të përmendet modeli i ndarjes së shqiptarëve

në katundarë dhe qytetarë. Ky model është tipik model i ndërtuar artificialisht. Në përfundim të luftës së dytë botërore, në fakt kanë ekzistuar dallimet reale dhe natyrore në vlerat shoqërore njerëzore në Kosovë. Në atë kohë ka patur dallime kulturore në mes të popullatës që ka jetuar në qytete dhe popullatës që ka jetuar në fshat.

Dallimet kulturore të të jetuarit në fshat dhe e të jetuarit në qytet, kanë shkuar deri në atë nivel ku janë ndërtuar edhe sistemet përkatëse të vlerave shoqërore njerëzore. Këto sisteme të vlerave kanë qenë natyrore dhe kanë funksionuar mirë si sisteme, sepse kanë patur hierarkinë e sistemit të vlerave. Përkufizim i përgjithshëm për këto sisteme do të ishte se në qytet ka funksionuar sistemi i vlerave të esnafisë, kurse në fshat ka funksionuar sistemi i vlerave të burrnisë.

Popullata e Kosovës që ka jetuar në qytet, përveç atyre që kanë punuar në adminstratë, është marrë kryesisht me veprimtari të zejtarive të ndryshme. Familjet që kanë patur zeje, që kanë punuar mirë dhe me nder, kanë qenë të njohura si familje esnafe, kurse kryefamiljarët e tyre kanë qenë të njohur si esnafë. Kryefamiljari që ka arritur të ndërtojë një familje të ndershme dhe zeje të suksesshme, që ka patur familje sa më të rregullt dhe me sjellje shoqërore më të mira, ka qenë më esnaf sesa kryefamiljarët e familjeve që këtë nuk e kanë arritur. Sistemi i vlerave të esnafisë ka patur hierarki, jo secili që është marrë me zejtari është shquar për esnaf të vërtetë. Familjet që kanë jetuar në qytete janë veçuar për mënyrë më liberale të jetesës, kanë qenë më "allafranga" edhe në veshje edhe në marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe me të tjerët.

Popullata e Kosovës që ka jetuar në fshat, është marrë kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Familjet që kanë patur më shumë tokë sesa që kanë mundur ta punojnë vetëm me anëtarët e vet të familjes, kanë angazhuar punëtorë tjerë, që njihen si "rrogëtarë". Familjet që kanë arritur të punojnë mirë dhe me nder, kanë qenë të njohura si "shpi", "oxhak", "kullë", etj. kurse kryefamiljari ka qenë i njohur si burrë. Kryefamiljari që ka arritur të ndërtojë një familje të ndershme dhe me punë të suksesshme, që ka patur familje sa më të rregullt dhe me sjellje shoqërore më të mira, ka qenë më burrë sesa kryefamiljari i familjeve që këtë nuk e kanë arritur. Burrënia ka patur hierarki, jo secili që ka jetuar dhe punuar në fshat është shquar si burrë i vërtetë. Familjet që kanë jetuar në fshat, janë veçuar për mënyrë më konservative të jetesës, kanë qenë më "të shtrënguar" edhe në veshje edhe në marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe me të tjerët.

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, shumica absolute e popullatës ka jetuar në fshat, kurse një pakicë ka jetuar në qytetet e atëhershme. Edhe pse kanë patur dallime kulturore, këto dy sisteme të vlerave shoqërore njerëzore, kanë patur edhe veçoritë e përbashkëta siç janë: ndershmëria, korrektësia, ruajtja e fjalës së dhënë, mbajtja e pastërtisë në sjellje që njihet si "ftyrë" dhe "ruajtja e ftyrës", etj. E përbashkëta e këtyre sistemeve të vlerave ka qenë krenaria Në të dy sistemet e vlerave janë kultivuar vlera të cilat kanë mundësuar të mbajturit krenar.

Këto dy sisteme të vlerave kanë bashkëjetuar dhe se dallimet ekzistuese kanë qenë dallime të pranueshme për sistemin tjetër të vlerave, janë pranuar si dallime të natyrshme. Kanë qenë të pranueshme këto dallime për arsye se dallimet kanë qenë natyrore dhe jo dallime të krijuara artificialisht.

Dallimet kulturore në Kosovë që kanë qenë të natyrshme, Serbia përmes SHMS-ve ka arritur që t'i shkatërrojë, sepse, meqë ishin natyrale, d.m.th. prodhim i vet shoqëror i shoqërisë kosovare, si të tilla ishin rezistuese ndaj asimilimit dhe transformimeve tjera që Serbia kishte synim t'i kryente. Përmes veprimtarisë së SHMS-ve, Serbia ka arritur që dallimet natyrore t'i shndërrojë në dallime artificiale të imponuara, që kanë rezultuar në krijimin e dy shtresave krejt artificiale: shtresa e katunarëve dhe shtresa e qytetarëve. Si janë krijuar artificialisht përmes imponimit këto dy shtresa?

Me fillimin e ndërtimit të sistemit të ri administrativ të pasluftës së dytë botërore, fillon edhe ndërtimi i administratës dhe institucioneve komuniste, më vonë të quajtura socialiste. Meqë administrata dhe institucionet ishin të reja dhe se kishin të angazhuar numër të madh të punëtorëve, SHMS-të ndërhynë, përzgjodhën dhe filtruan individë nga fshati me veti të larta lakmitare dhe me karakter të dobët për t'i punësuar në administratë dhe institucionet e reja. Këta individë u fuqizuan me të mira materiale (paga të mira dhe beneficione tjera), me pozita të larta shoqërore, me autoritet dhe me të mira tjera shoqëore. Ky fuqizim i bëri këta individë që të veçohen nga të tjerët dhe përmes veprimeve të SHMS-ve, këta individë filluan të quhen qytetarë.

Meqë këta individë të përzgjedhur si të përshtatshëm nga SHMS-të arritën që të shtohen në numër dhe të fuqizohen me të mira materiale e shoqërore, ua zunë frymën dhe e lanë në errësirë shtresën e esnafëve që jetonte në qytet. Këtë zënie fryme, sigurisht e ndihmoi edhe shkatërrimi i veprimtarive zejtare, që shërbenin si djepi i Esnafisë. Në këtë mënyrë këta individë u bën "shtresa e lartë", "shtresa qytetare", etj. dhe krejt të tjerët ishin shtresa e ulët-

katundarë.

Ngritja dhe fuqizimi i "shtresës së lartë", "shtresës qytetare", përmes ndërhyrjeve të SHMS-ve, i kreu disa funksione: Së pari, pamundësoi zhvillimin natyror të shtresës së esnafëve. Pastaj, duke e ngjyrosur si katundarë, popullatën që jetonte në fshat, i shndërroi në shtresë të shkallës së dytë, në shtresë të izoluar, në shtresë të diskriminuar dhe në këtë mënyrë pamundësoi zhvillimin natyror të shtresës së burrënisë. Përveç që veproi si mekanizëm për shkatërrimin e shtresës së esnafëve dhe shtresës së burrënisë, shtresa artificialisht e krijuar si "shtresë qytetare" mundësoi që të krijohet një konflikt shtresor krejt artificial, si mekanizëm për goditje dhe shkatërrim edhe të shtresave tjera që më vonë do të duhej natyralisht të krijoheshin si shtresa e profesionistëve, shtresa e iluministëve, etj.

Procesi i ngritjes artificiale dhe mirëmbajtjes së "shtresës qytetare" u krye përmes imponimit të vlerave të caktuara, të cilat do të zbërthehen në pjesët e mëvonshme të këtij libri. Po ashtu, edhe procesi i krijimit dhe i mirëmbajtjes së këtij mekanizmi për goditje dhe shkatërrim të shtresave tjera, u krye përmes shkatërrimit të vlerave të caktuara të cilat do të zbërthehen në pjesët e mëvonshme të këtij publikimi. Vlera e vetme që idividët pjesëtarë të "shtresës qytetare" ishte se atyre trurin dhe mendjen ua diktonte barku. Sa e si mbushej barku i tyre me të mira materiale e shoqërore, ashtu u punonte edhe truri. Kjo ishte arsyeja, që në popull kjo shtresë njihej si "shtresa e zorraxhive".

Shtrohet pyetja: po pas luftës së fundit të viteve 1998-1999, a ka përpjekje të SHMS-ve për të ndërtuar model të veçantë të sistemit të vlerave shoqërore njerëzore?

Sigurisht që bëjnë përpjekje të tilla.

Atëherë, cili është modeli i sistemit të vlerave shoqërore e njerëzore që SHMS-të angazhohen të ndërtojnë në Kosovë?

Mendim i plotë në këtë çështje mund të jetë e vështirë të formohet, për faktin se pas përfundimit të luftës, rrethanat në Kosovë kanë ndryshuar shumë.

Sigurisht se përpjekjet nga SHMS-të për të ndërtuar sistem të veçantë të vlerave janë duke u bërë dhe se puna e tyre ka shkuar deri në një shkallë të caktuar. Mirëpo, mundet që modeli të mos jetë përfunduar ende, që të kuptohet me ndonjë saktësi. Elementet përbërëse të modelit të sistemit të vlerave shoqërore njerëzore, që shihet se janë në ndërtim e sipër dhe që dalin

në sipërfaqe, lidhen me hajni, me shkelje ligjore, me amoralitet, me rrenë, me mashtrim, me falsifikim, me improvizim, me shumëfytyrësi, me veprime pas shpine, me gjuatje të gurit e fshehje të dorës, me ndryshe fol e ndryshe puno, me manipulim të situatave dhe të njerëzve dhe elemente tjera të ngjajshme. Mund të shihet se shumica e këtyre elementeve lidhen me modelin e fuqisë së shtetit serb, të bërë publik nga Dobrica Qosiqi i cili deklaron: "fuqia e shtetit serb janë rrena dhe mashtrimi".

Meqë është fjala për vlera shoqërore njerëzore, konsiderohet si më e përshtatshme që të zbërthehen dhe të shtjellohen vlera të veçanta shoqërore njerëzore, veçmas, dhe një nga një. Këto vlera kanë qenë pjesë përbërëse e sistemeve të vlerave në të kaluarën dhe që shihet se janë edhe tani pjesë përbërëse e sistemeve të vlerave, që tani janë duke u ndërtuar nga shërbimet informative, të huaja armiqësore, në Kosovë, që janë duke funksionuar dhe që janë duke u mirëmbajtur në Kosovë. Zbërthimi dhe shtjellimi i këtyre elementëve bëhet përpjekje që të kryhet në vazhdim të këtij publikimi.

Lloji i sistemit të vlerave "katunar – qytetar" është vetëm një nga modelet që kanë ekzistuar dhe i cili u përzgjodh për publikim, si më i përshtatshëm dhe më gjithëpërfshirës, për një terësi të vlerave shoqërore, njerëzore, që Serbia ka imponuar në Kosovë. Sigurisht se ka edhe modele tjera si: "revolucionar – kundërrevolucionar", "vëllazërim – bashkim", "shqiptar i ndershëm – shqiptar i pandershëm".

Edhe modeli i sistemit të vlerave "katunar – qytetar", edhe modelet tjera që kanë ekzistuar në Kosovë, janë ndërtuar përmes bartësve konkretë (emrave të përveçëm) të vlerave që u kanë përkitur modeleve të sistemeve të atyre vlerave. Edhe në periudhën e pasluftës së fundit, cilindo ose cilëtdo modele të sistemeve të vlerave që SHMS-të janë duke u përpjekur t'i imponojnë Kosovës, janë kryer deri tani dhe janë duke u kryer edhe tani, me bartës konkretë, me emra të përveçëm konkretë. Sigurisht se këta emra të përveçëm konkretë, me saktësi janë të ditur vetëm nga Serbia.

Emrat konkretë kanë rëndësi të jenë të njohur sepse është e ditur se këta persona duhet t'i kenë cilësitë e kërkuara për të qenë bartës të sistemit të vlerave që SHMS-të marrin përsipër të ndërtojnë. Kur është konsideruar e nevojshme, p.sh. një individ ka patur disa, por jo të të gjitha cilësitë e kërkuara, këta individë u janë nënështruar stërvitjeve dhe përgatitjeve të mshefta speciale për zhvillimin e cilësive të munguara.

NDËRHYRJA NË PËRZGJEDHJEN E BARTËSVE TË VLERAVE SHOQËRORE NJERËZORE

Ndërtimi i cilitdo sistem të vlerave në një shoqëri, nuk është punë e thjeshtë. Në secilën fazë të ndërtimit dhe pastaj të mirëmbajtjes së një sistemi të tillë, është e nevojshme një punë sistematike e profilit të lartë profesional dhe shkencor. Në secilën fazë të ndërtimit dhe pastaj të mirëmbajtjes të cilitdo sistem të vlerave, kërkohen njohuri dhe shkathtësi të specializuara të cilat vetëm disa persona mund t'i kenë.

Në përzgjedhje, personat që kanë njohuritë dhe shkathtësitë e kërkuara, ose që i fitojnë përmes stërvitjeve dhe përgatitjeve të specializuara, për ndërtim dhe mirëmbatje të sistemit të caktuar të vlerave, mund të jenë edhe bartës të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së atij sistemi të vlerave, të tjerët jo. Këtu është edhe ndërhyrja më e madhe nga ana SHMS-ve në Kosovë, ndërhyrja në përzgjedhjen dhe filtrimin e individëve të përshtatshëm për punët e tyre. Kuptohet se pikënisja në përzgjedhjen dhe filtrimin e individëve, përveç të qenët lakmitar, është kodi gjenetik. As nuk mundet që dikush të jetë spiun i madh dhe as patriot i madh pa e patur edhe kodin gjenetik, përkundër stërvitjeve e përgatitjeve që tentohen të bëhen ose imponohen.

Ndërhyrje nga SHMS-të, në përzgjedhjen dhe filtrimin e bartësve të vlerave shoqërore, njerëzore, mund të ketë filluar edhe më heret, mirëpo në sipërfaqe dukshëm ka dalur së paku qysh pas Luftës së Dytë Botërore, në ndërtimin e modelit "katunar – qytetar" për të vazhduar me modelet tjera deri në ditët e sotme. SHMS-të si pikënisje në vlerësimin e zotësive dhe shkathtësive të kërkuara, përveç të qenët lakmitar, kanë marrë për bazë kodin gjenetik të individit se sa është i përshtatshëm për t'u marrë në konsiderim dhe se çfarë dhe deri ku mund të punohet më të.

Pastaj, individi është vlerësuar se sa është lakmitar dhe karakter i dobët. Përzgjedhja është vazhduar me vlerësimin e individit për zotësitë dhe shkathtësitë për hajni, për amoralitet, për të gënjyer, për të mashtruar, për të falsifikuar, për të improvizuar, për shumëfytyrësi, për veprime pas shpine, për gjuatje të gurit e fshehje të dorës, për të folur ndryshe e për të punuar ndryshe, për të manipuluar situatat dhe njerëzit, e të ngjajshme. Këto shkathtësi, janë cilësi edhe në këtë mënyrë janë vlerat e individit, janë vlera njerëzore, veçse janë vlera negative.

Individët që kanë patur disa shkathtësi/cilësi/vlera dhe iu kanë munguar shkathtësitë/cilësitë/vlerat tjera, janë stërvitur dhe përgatitur. Varësisht nga

shkathtësitë/cilësitë/vlerat e poseduara dhe shkathtësitë/cilësitë/vlerat e fituara përmes stërvitjes, janë shpërndarë edhe detyrat në cilësinë e bashkëpunëtorit, ose spiunit të SHMS-ve.

Bashkëpunëtorët të cilët janë treguar të suksesshëm, kanë ofruar dëshmi të kërkuara të shkathtësive/cilësive/vlerave dhe të zbatimit të detyrave, janë avancuar në spiunë zyrtarë me betim i SHMS-ve. Për të mbajtur pozitën e tillë, është dashur që vazhdimisht të dëshmohen shkathtësitë/cilësitë/vlerat dhe zbatimi i detyrave. Ata që kanë ofruar dëshmi më të mëdha të shkathtësive/cilësive/vlerave dhe të zbatimit të detyrave, janë avancuar në spiunë më të lartë. Sa më shumë shkathtësi/cilësi/vlera dhe detyra të kryera, pozita dhe fuqia, kanë qenë më të larta. Këto praktika, sigurisht që edhe sot zbatohen nga SHMS-të, është ndërtuar traditë tanimë, dhe nuk është vështirë.

Në lartësimin e pozitës së dikujt, qoftë nga pozita e bashkëpuntorit në pozitën e spiunit me betim, ose në një pozitë me të lartë të spiunit me betim, kyçe ka qenë besimi i SHMS-ve në bartësin e vlerave shoqërore, njerëzore. Për të fituar besim në bartësin e vlerave, bartësi është dashur që vazhdimisht dhe sa më shumë të dëshmojë besimin që e ka në shtetin e Serbisë dhe ndaj shtetit të Serbisë. Po ashtu, në lartësimin e pozitës së ndonjë bartësi, më të rëndësishme kanë qenë shkathtësitë/cilësitë/vlerat, sesa kryerja e detyrave.

Autori, në rrethinën ku ka jetuar deri në fillim të viteve nëntëdhjeta, ka njohur disa bartës të vlerave shoqërore, njerëzore që SHMS-të kanë imponuar në Kosovë. Ka patur individë që kanë kryer detyra të ndryshme, mirëpo më të lartë në hierarki dhe më të fuqishëm kanë qenë ata që kanë qenë më të pamoralshëm sesa ata që kanë kryer më shumë detyra ose që kanë kryer detyra të mëdha. Ata që kanë kryer kurvëni me serbe dhe që iu kanë mundësuar serbëve të kryejnë kurvëni me shqiptare, ose në familjen e tyre, ose në rrethinën e tyre, kanë qenë të fuqishëm, nuk ka patur kush që ka mund të matet me ta. Këto praktika sigurisht, që edhe sot zbatohen në Kosovë nga SHMS-të, është ndërtuar traditë tanimë dhe nuk është vështirë.

Është me rëndësi të theksohet se deri në fillim të viteve nëntëdhjeta ka qenë konkurrencë dhe një garë bukur e fortë për të arritur pozitën e bashkëpunëtorit, pozitën e spiunit ose të ndonjë pozite më të lartë të spiunit. Jo çdokush që ka dëshiruar me qenë bashkëpunëtor a spiun i SHMS-ve edhe ka mundur të bëhet bashkëpunëtor ose spiun. Kanë ekzistuar rregulla dhe kanë funksionuar kritere për përzgjedhje dhe avancim, siç kanë funksionuar rregulla dhe kritere edhe për degradim ose pushim nga pozita. Këto praktika sigurisht që edhe sot zbatohen në Kosovë nga SHMS-të, është ndërtuar një traditë.

Shtrohet pyetja: si kanë arritur në të kaluarën dhe njëjtë edhe tani, që SHMS-të t'i njohin individët, shkathtësitë/cilësitë/vlerat e tyre, përshtatshmërinë e tyre për kryerjen e detyrave? Si kanë arritur të bëjnë kombinimet në mes të individëve, cilësive të individëve dhe detyrave që u përshtatën secilit indvid?

Këto kombinime kanë qenë të "suksesshme", kjo është dëshmuar me suksesin e detyrave të kryera. Këto kombinime kaq të suksesshme kanë mundur të bëhen vetëm përmes një armate (shumë batalioneve) të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve, të cilët kanë grumbulluar të dhënat e duhura. Këto të dhëna janë dërguar në qendrat e SHMS-ve për analizim dhe vendimmarrje. Vendimet e marra pastaj janë zbatuar me përpikëri nga armata e spiunëve dhe bashëpunëtorëve. Qendrat e analizimit dhe vendimmarrjes duhet të kenë qenë të pajisura me një armatë të specialistëve, profesionistëve, shkencëtarëve, etj. përndryshe nuk do të kishin patur sukses.

KRYERJA E DETYRAVE TË SHMS-VE NË KOSOVË

Në imponimin e ndërtimit të sistemeve të vlerave që i kanë imponuar SHMS-të, në Kosovë, në periudhën e paraluftës së fundit, por njëjtë edhe më pastaj, sigurisht se ka patur shumë punë dhe shumë detyra. Shumica e këtyre punëve kanë qenë dhe janë publike dhe janë kryer e kryhen përmes institucioneve publike të Kosovës. Në këtë mënyrë edhe bartës më të shumtë në numër, kanë qenë dhe janë të punësuarit e institucioneve të Kosovës, pa ditur se janë duke kryer punë të cilat shkojnë në drejtim të ndërtimit të një sistemi të vlerave që ka qenë ose është i imponuar për Kosovën. Duke qenë sistem i imponuar i vlerave, në këtë mënyrë ka qenë dhe është i imponuar edhe për vetë ata të punësuar dhe për familjet e tyre.

Edhe pse të shumtë në numër, nuk ka mjaftuar që vetëm përmes këtyre që nuk kanë patur ide se çka po bëjnë, të ndërtohet i gjithë sistemi. Ka qenë dhe është e nevojshme që të angazhohen edhe bashkëpunëtorët me dijeni dhe spiunët e drejtpërdrejtë.

Bashkëpunëtorët dhe spiunët e SHMS-ve, kanë qenë dhe janë shtylla kryesore, kanë qenë dhe janë boshti rreth të cilit është ndërtuar sistemi, ka funksionuar sistemi dhe është mirëmbajtur sistemi. Këta janë vendosur dhe vendosen në pozitat kyçe të institucioneve. Këta shumicën e punës dhe angazhimeve i kanë kryer dhe i kryejnë si detyra të rëndomta, dhe vetëm disa nga punët që kanë kryer kanë qenë dhe janë edhe detyra të SHMS-ve.

Ka patur edhe individë që kanë qenë dhe janë në pozita kyçe të institucioneve të Kosovës, kanë kryer dhe kryejnë detyra të SHMS-ve, mirëpo kanë menduar dhe mendojnë se punët e kryera janë punë të rregullta publike. Shumë prej këtyre individëve kanë kryer edhe veprime joligjore në rastet e kërkuara nga spiunët a bashkëpunëtorët e SHMS-ve, duke menduar se këto janë praktika të zakonshme. Në fakt, kur kryhen moszbatime të ligjit, në raste të shumta, kjo edhe bëhet si praktikë normale. Një fjalë popullore thotë: "i meçmi (dhelpnak) rrnon n'shpinë t'budallës", d.m.th. të mençëm, dhelpnak, ka aq sa ka budallë dhe vetëm kur ka budallë, ka edhe të mençëm dhelpnak.

Këta pozitarë, siç u përshkrua më lart, që kanë qenë dhe janë në krye të cilitdo institucion të Kosovës dhe kanë kryer dhe kryejnë detyra të SHMS-ve pa e ditur, sikur veç pak të mendonin dhe të mendojnë se çfarë janë duke bërë, kah çon kryerja e punëve të caktuara, do të shihnin dhe do të shohin se diçka nuk është në rregull, do të shihnin dhe do të shohin se shkojnë në dëm të shoqërisë së Kosovës. Po të shihnin dhe po të shohin se diçka shkon në dëm të shoqërisë së Kosovës, kurdo që do të kishin dhe të kenë mundësi dhe çkado që të kishin patur dhe të kenë mundësi, do të bënin dhe do të bëjnë ndonjë veprim që do të zvogëlonte dëmin ose mundësisht edhe të eliminonte dëmin.

Ata/ato që kanë qenë ose që tani janë zyrtarë të institucioneve të Kosovës dhe që kanë kryer dhe kryejnë detyra të SHMS-ve dhe nuk e kanë ditur ose nuk e dijnë dhe se vetëm pak po të mendonin, do të kishin patur ose do të kenë pak dije se çka punojnë, ndyshe nuk din njeriu çfarë epiteti t'u jep, përveç se budallë në shpinë të të cilëve ka jetuar i mençmi dhelpnak (ndonjë spiun ose bashkëpunëtor i SHMS-ve). Kjo sidomos vlen për ata/ato që kanë një nivel të përgatitjes shkollore, që fatkeqësisht vërtetojnë thënien e plakut: "Sa i patëm budallt pa shkollë mirë i kishim pas pasë punët, pej se i bam budallt me shkollë, marum".

Ka patur dhe ka edhe pozitarë që i kanë kuptuar dhe kuptojnë se janë detyra të SHMS-ve, ose plotësisht, ose bile kanë patur, ose kanë pak të kuptuar se janë detyra të SHMS-ve, kanë bërë dhe bëjnë përpjekje për shmangie, kuptohet brendpërbrenda mundësive që kanë patur dhe që kanë. Këta individë, i kanë kryer dhe i kryejnë detyrat e SHMS-ve, që gjithsesi është dashur ose duhet t'i kryejnë, mirëpo kanë evituar ose evitojnë diçka, kanë shpëtuar ose shpëtojnë diçka dhe në këtë mënyrë kanë zvogëluar ose zvogëlojnë, po edhe kanë eliminuar ose eliminojnë dëmin në shoqërinë e Kosovës, kuptohet për aq sa ka qenë e mundur. Të tjerët që e kanë ditur ose e dijnë se punë të caktuara janë edhe detyra të SHMS-ve, ose se kanë dyshuar

dhe dyshojnë se janë detyra të SHMS-ve dhe i kanë kryer ose i kryejnë ato punë pa hezitim, ose kanë qenë dhe janë bashkëpunëtorë me dijeni, ose kanë qenë dhe janë spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve.

Çështja rreth kryerjes së detyrave të SHMS-ve pas luftës së fundit është interesante për faktin se pothuajse askush nuk ka menduar se pas tërheqjes së administratës dhe forcave të sigurisë së Serbisë, në Kosovë do të mbeten bashkëpunëtorët dhe me këtë edhe veprimtaria e SHMS-ve. Fakti se pothuajse askush nuk ka menduar për veprimtarinë e SHMS-ve, ka krijuar rrethana shumë të volitshme për to që të shtrijnë dhe fuqizojnë veprimtarinë e tyre. Kjo dëshmohet me daljen në publik të informacioneve të përmasave të pranisë së SHMS-ve në Kosovë. Këto përmasa të pranisë së veprimtarisë dhe gjendja që hiç nuk mendohet nga pothuaj të gjithë se ka veprimtari të tillë në Kosovë, bën që masivisht të kryhen detyra të tyre pa u ditur fare.

Në kontekst të kryerjes së detyrave të SHMS-ve në Kosovë, duhet gjithashtu të theksohet se disa detyra janë kryer përmes shantazhit. Individë të ndryshëm që ka rastisë të kryejnë ndonjë delikt, SHMS-të kanë shfrytëzuar këtë delikt që ta përdor si shantazh për kryerjen e ndonjë detyre për ta. Po ashtu, ka patur edhe raste kur SHMS-të kanë kurdisur ngjarje për të kryer delikte, të cilat pastaj i kanë shfrytëzuar për të krijuar bashkëpunëtorë dhe për të kryer detyra të ndryshme.

Ka raste dhe histori nga më të ndryshmet, mirëpo përgjithësisht rastet kur dikush ka kryer ndonjë detyrë ose është bërë bashkëpunëtor për shkak të shantazhit, kur i është dhënë mundësia për t'u larguar nga këto veprime edhe është larguar. Mirëpo, ka patur edhe raste kur dikush ka filluar veprimtarinë për shkak të shantazhit, por më vonë i ka pëlqyer, "ju ka shishmue" siç thotë populli dhe ka vazhduar me vetëdëshirë, kjo për të vërtetuar thënien: "duke ngrënë gjellë, të shtohet oreksi për gjellën".

SI MUND TË SHIHET DHE TË NJIHET SPIUNI ME BETIM SI I DYSHUAR

E gjithë veprimtaria e SHMS-ve, si një veprimtari e msheftë, kryhet përmes bartësve konkretë, të cilët kryejnë veprime konkrete. Sigurisht se qytetari i zakonshëm ka shumë interes që të shohë dhe të njohë bartësin konkret, si të dyshuar të veprimtarisë së SHMS-ve, si dhe gjithashtu të njohë veprimin konkret si veprim i dyshuar i SHMS-ve. Kuptohet se derisa nuk janë të

vërtetuara nga institucionet e Kosovës, të gjithë bartësit dhe të gjitha veprimet e SHMS-ve, janë të dyshuara dhe jo të vërtetuara.

Spiunët e betuar, janë të stërvitur mirë për të kryer me sukses të gjitha detyrat që u jepen nga qendra. Kuptohet se stërvitja bëhet për t'i aftësuar që të kenë shkathtësitë e duhura ashtu që edhe t'i kryejnë detyrat si të plota dhe të jenë të mshefta veprimet si dhe vetë bartësi. Nga pozicioni i autorit, është vështirë të bëhet dallimi në mes të bartësit të veprimit që është spiun i stërvitur dhe bartësit të veprimit që është bashkëpunëtor me dijeni, për faktin se bashkëpunëtorët me dijeni, mund të kenë patur ndonjë stërvitje në të kaluarën dhe se nuk kanë arritur të marrin statusin e spiunit të betuar, ose edhe mund t'i kenë zhvilluar shkathtësitë nga praktika. Për nevoja të analizës në këtë libër, si ilustrim do të merret për shtjellim spiuni i stërvitur me betim.

Paraqitur thjeshtë, spiuni i stërvitur, mundësisht kryen të gjitha detyrat përmes rrjetit njerëzve që ka krijuar përreth vetës dhe jo drejtpërdrejt vetë. Kjo është mënyra më efikase e veprimtarisë së SHMS-ve. Vetëm kur është e domosdoshme, spiuni i stërvitur kryen veprim drejtpërdrejt. Individët që formojnë rrjetin e njerëzve përreth spiunit janë bashkëpunëtorët e tij, dhe kësisoji, janë bashkëpunëtorë me dijeni e pa dijeni. E dëshirueshme dhe e dobishme për SHMS-të është që jo vetëm spiunët e betuar, por as bashkëpunëtorët me dijeni të mos kryejnë drejtpërdrejt veprime, të kryhen përmes bashkëpunëtorëve pa dijeni.

Krijimi i disa hallkave të rrjetit të njerëzve, krijon mundësi më të mira për të fshehur veprimin. Vetëm institucionet e specializuara ose individët e specializuar do të mund fillimisht të kuptojnë dhe pastaj të dokumentojnë gjithë rrjetin dhe të gjitha hallkat e individëve dhe veprimeve.

Mënyra e kryerjes së veprimeve, siç është përshkruar në paragrafin sipër, sigurisht që e bën të vështirë dukjen e veprimeve të SHMS-ve edhe pse këto veprime në fund janë publike për faktin se janë veprime konkrete, janë veprime në shesh. Po si të shihet dhe të njihet se një veprim është veprim i SHMS-ve?

Së pari duhet të dihen se cilat janë synimet dhe politikat e Serbisë për Kosovën. E dobishme do të ishte të dihen edhe programet konkrete të Serbisë për realizimin e synimeve dhe politikave, mirëpo Serbia nuk i bën këto publike. Kur synimet dhe politikat e Serbisë për Kosovë janë të njohura, atëherë secili veprim, qoftë i një individi, qoftë i një institucioni të Kosovës, qoftë i të gjitha institucioneve të Kosovës, dihet se janë në funksion të arritjes së synimeve politike të Serbisë, për Kosovën. Të gjitha veprimet

mund të shihen dhe të njihen, vetëm se duhet menduar mirë dhe analizuar me kujdes.

Kuptohet se të gjitha veprimet e SHMS-ve, sado të mshefta, mund të shihen, të njihen, bile edhe të dokumentohen, veç se parakusht për këtë, është njohja e synimeve dhe politikave të Serbisë për Kosovën, si dhe një njohje nga praktikat e zbatuara në kryerjen e këtyre veprimeve. Synimet dhe politikat e Serbisë për Kosovën, gjërësisht janë të ditura nga qytetari i zakonshëm, kurse pjesa e praktikave të zbatuara është më pak e njohur. Për t'i mundësuar qytetarit të zakonshëm që të njohë praktikat e zbatuara, duhet që të gjithë individët që kanë çfarëdo njohurie në lidhje me praktikat e zbatuara, t'i qesin në shesh, t'i bëjnë të njohura për të tjerët. Mbajtja nën dhe e këtyre njohurive, është mohim i njohjes nga qytetari i zakonshëm, dhe në këtë mënyrë kontribut për veprimtarinë e SHMS-ve.

Shtrohet pyetja: çka të bëhet kur individi ka njohuri të synimeve dhe politikave të Serbisë për Kosovën, mirëpo nuk ka njohuri rreth praktikave të zbatuara?

Në këto raste, është e mjaftueshme që individi të mendojë se në Kosovë ka veprimtari të msheftë të SHMS-ve. Mendimi se ka veprimtari të msheftë e shtynë individin të mendojë dhe të bëjë pyetje: po si kryhet kjo veprimtari?

Pastaj kjo e shtynë individin të mendojë rreth veprimeve konkrete dhe të shikojë përreth, për veprime të mundshme. Posa të mendojë për ndonjë veprim konkret, do të shikojë përreth dhe do të shohë ndonjë veprim konkret, kuptohet si i dyshuar. Lidhja logjike e efekteve të një veprimi konkret, ose të grupveprimeve konkrete, me arritjen e synimeve dhe politikave të Serbisë për Kosovën, është kuptimi dhe njohja e veprimtarisë së msheftë të SHMS-ve. Sa më shumë të mendohet rreth veprimeve, a grupveprimeve konkrete si të dyshimta, sa më shumë të shikohet përreth, për veprime a grupveprime konkrete, si të dyshimta, si dhe sa më shumë lidhje logjike të gjenden në mes të veprimeve a grupveprimeve konkrete, me arritjen e synimeve të Serbisë për Kosovën, aq më shumë rritet dhe zgjerohet kuptimi dhe njohja e veprimtarisë së SHMS-ve.

E gjitha çka u përshkrua në paragrafin sipër, mund të përmblidhet edhe me thënien e popullit: "Mos e vet se t'kallxon vet", dhe me thënien tjetër: "n'dash me dit dikë se kush asht, kqyrja punt". Edhe populli ynë ka ardhë deri tek gjetja e së vërtetës. Në fakt, përshkrimet e paraqitura në paragrafin sipër, janë proces i njohjes me bazë shkencore sipas teorisë së zhvillimit të

sistemeve informative. Kjo teori shkencore është shtjelluar në paragrafët e mësipërm dhe është paraqitur edhe në mënyrë skematike si më poshtë:



Kur qytetari i zakonshëm njeh veprimin, a grupveprimin, si të dyshimtë, se është i SHMS-ve, mund të njohë edhe inidividin ose individët si të dyshimtë, se janë bartës të veprimtarisë së msheftë të SHMS-ve. Vështirësia qëndron në dallimin se a është individi spiun i stërvitur me betim, a është bashkëpunëtor me dijeni, ose se është bashkëpunëtor pa dijeni.

Spiuni me betim, ka dallim nga bashkëpunëtori me dijeni, mirëpo dallimi zakonisht nuk është i madh. Dallimi më i madh është në mes të këtyre dhe bashkëpunëtorëve pa dijeni. Qytetari i zakonshëm që nuk ka njohuri në lidhje me praktikat e zbatuara në veprimet e SHMS-ve, e ka të vështirë të dallojë se cili është spiun i betuar, cili është bashkëpunëtor me dijeni dhe cili është bashkëpunëtor pa dijeni. Këtu qëndron nevoja dhe arsyet për t'i ofruar qytetarit të zakonshëm informacione dhe njohuri sa më të shumta, në lidhje me praktikat e zbatuara nga SHMS-të, në veprimtarinë e tyre të msheftë.

Në përpjekje për të ofruar informacione dhe njohuri tek qytetari i zakonshëm, në lidhje me praktikat e zbatuara nga SHMS-të, do të paraqesim si shembuj ilustrativë disa nga kësilloj praktikash në paragrafët në vijim. Praktikat e paraqitura këtu janë nxjerrë në bazë të përvojave dhe njohurive që kemi pasur nga jeta dhe ballafaqimi me këtë veprimtari të msheftë. Paraqitja e praktikave bëhet përmes përshkrimit në shembuj ilustrative, si përmbledhje e disa veprimeve përfaqësuese, për nevoja të shtjellimit të temës. Përshkrimet e shembujve ilustrativë nuk lidhen dhe nuk apostrofojnë ndonjë individ konkret, ose ndonjë veprim konkret, që realisht ka ndodhur, përshkrimet kanë të bëjnë me zbërthimin e çështjes së shtjelluar në formën që i mundëson lexuesit përfitim më të mirë të kuptimit, në lidhje me praktikat e zbatuara në veprimtarinë e msheftë.

Nëse merret për ilustrim një institucion shtetëror, që në bazë të ligjit është i pavarur, dhe në të njëjtën kohë ky institucion ka rëndësi të veçantë të madhe

për funksionimin e shumë sistemeve tjera funksionale në Kosovë, atëherë supozojmë se është Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Supozojmë se SHMS-të vlerësojnë se një spiun i stërvitur me betim, duhet gjithsesi të jetë i pozicionuar brenda BQK-së. Në kushtet që ka Kosova, me shkallë të ulët të zbatimit të ligjit dhe shkallë të lartë të kontrollit politik mbi institucionet e pavarura, nuk ka nevojë që spiuni të pozicionohet në nivelet më të larta të udhëheqjes, mjafton niveli i mesëm.

Supozojmë se nivelet e larta të udhëheqjes së BQK-së janë nën kontroll, përmes kontrollit që SHMS-të kanë në kreun e partisë politike fituese e zgjedhjeve. Veprimet e vendimmarrjes së niveleve të larta në këtë institucion SHMS, i kryen përmes lidhjeve të krerëve të këtij institucioni me krerët politikë (lidhjet formale dhe më tepër lidhjet joformale). Krejt çka qytetari i zakonshëm mund të shohë dhe kuptojë, janë ndejat si kontakte fizike, kryesisht në kafe-restorantet e krerëve të këtij institucioni, me njerëzit e krerëve politikë, ose edhe me vetë krerët politikë. Të gjitha të tjerat mund të kuptohen vetëm nga institucionet e specializuara përmes perpunimit operativ.

Po spiuni i stërvitur çfarë bën brenda BQK-së? Detyrat e këtij spiuni janë kryesisht mbledhja e informacioneve mbi zbatueshmërinë e kontrollit të SHMS-ve ndaj këtij institucioni si dhe ndërtimi dhe mirëmbajtja në funksion e sistemeve të vlerave, siç janë paraqitur në këtë libër e që kanë të bëjnë me degradimin e vlerave shoqërore, njerëzore, të dobishme për shoqërinë dhe fuqizimin e vlerave shoqërore, njerëzore, të dëmshme për shoqërinë. Këto ndërhyrje në sistemin e vlerave brenda këtij institucioni, ky spiuni i kryen përmes bashkëpunëtorëve të SHMS-ve pa dijeni, që përbëjnë shumicën absolute të individëve bashkëpunëtorë dhe të ndonjë bashkëpunëtori me dijeni.

Spiuni vetë nuk e kryen as edhe veprimin e vetëm, ose rrallë ndodh të kryej ndonjë veprim. Krejt çka qytetari i zakonshëm mund të shohë dhe kuptojë, janë shoqërorizimet si kontakte fizike, të këtij spiunit me individët, bartës të veprimeve (me dijeni e pa dijeni), të gjitha të tjerat mund të kuptohen vetëm nga institucionet e specializuara. Veprimet e bashkëpunëtorëve me dijeni e pa dijeni janë veprime ndërhyrëse të SHMS-ve, në vlerat shoqërore, njerëzore, shkeljet ligjore, improvizimet profesionale e të ngjajshme.

Nëse marrrim si shembull ilustrativ njërën nga dy partitë më të mëdha politike, bazuar në mjedisin Kosovar, siç është paraqitur në këtë libër, supozojmë se spiuni i stërvitur është funksionar i lartë i partisë politike, ose është anëtar i Kryesisë që dikton politikat dhe vendimmarrjet partiake, efekti

është i njëjtë. Detyrat e marra nga SHMS-të, ky spiuni i zbaton me kryerjen e veprimeve në dy drejtime:

1) Diktimi i politikave partiake në drejtimin e kërkuar nga SHMS-të

Veprimet e kryera në drejtim të diktimit të politikave partiake, sipas kërkesave të SHMS-ve, është vështirë të shihen dhe të kuptohen nga qytetari i zakonshëm, nga fakti se maskohen dhe mbështillen mirë. Veprimi i diktimit të politikave partiake mund të shihet dhe kuptohet vetëm nga idividi brenda Kryesisë së partisë me njohje shumë të mirë të proceseve dhe praktikave politike. Këto veprime me lehtë shihen dhe kuptohen edhe nga faktori ndërkombtar, për faktin se këta kanë njohje të mirë të proceseve dhe praktikave politike dhe se janë të interesuar për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

2) Sitja, filtrimi dhe infiltrimi i individëve si brenda partisë ashtu edhe nëpër institucionet tjera të Kosovës sipas kërkesave të SHMS-ve

Veprimet në drejtim të sitjes, filtrimit dhe infiltrimit të individëve, më lehtë mund të shihen dhe kuptohen nga qytetari i zakonshëm, për faktin se individët janë edhe bartës të vlerave shoqërore, njerëzore. Të gjitha sitjet, filtrimet dhe infiltrimet e individëve kryhen në dy drejtime: i)individët bartës të vlerave njerëzore, shoqërore, të dobishme për Kosovën, siten dhe filtrohen në drejtim të degradimit dhe shkatërrimit, dhe ii)individët bartës të vlerave njerëzore shoqërore të dëmshme për Kosovën siten, filtrohen dhe infiltrohen në drejtim të fuqizimit të tyre.

Me përjashtim të veprimeve të paraqitura në paragrafët nën 1) dhe 2) sipër, veprimet tjera të spiunit të stërvitur janë vështirë të shihen dhe të kuptohen nga qytetari i zakonshëm. Të gjitha veprimet tjera mund të kuptohen vetëm nga institucionet e specializuara.

Siç mund të shihet në paragrafët sipër, disa nga veprimet e spiunit të stërvitur mund të shihen dhe kuptohen më lehtë nga qytetari i zakonshëm dhe disa veprime është më vështirë të shihen dhe të kuptohen. Megjithatë, niveli i të kuptuarit nga një individ, si qytetar i zakonshëm, varet nga niveli i informimit dhe niveli i njohurive paraprake në lidhje me veprimtarinë e SHMS-ve.

Veprimet e spiunit, ose spiunëve të stërvitur, në disa institucione të Kosovës, mund të shihen dhe të kuptohen vetëm nga profesionistët e fushës dhe jo nga improvizuesit profesionalë të fushës (improvizuesit profesionalë janë

përshkruar tek pjesa FUQIZIMI I IMPROVIZIMIT PROFESIONAL NË KURRIZ TË PROFESIONALIZMIT).Veprimet e spiunit, ose spiunëve të stërvitur, në Kuvendin e Kosovës, gjatë miratimit të ligjeve, në prokuroritë e Kosovës, në gjyqësitë e Kosovës, në Policinë Hetuese të Kosovës, mund, të shihen dhe kuptohen vetëm nga profesionistët specialist të fushës (jo nga improvizuesit). Njëjtë është edhe tek veprimtaritë tjera profesionale, si të gazetarisë, avokatisë, kontabilitet-revizionit; mjekësisë, veprimtaritë profesionale inxhinierike, të kulturës dhe artit etj. Njëjtë është tek veprimtaritë edukative, arsimore, shkencore dhe akademike.

KULTURA E MOSZBATIMIT TË LIGJIT

Qytetarët e Kosovës, nuk janë të lindur me përfundimin e luftës së fundit dhe .të jenë rritur pas kësaj lufte, nuk janë qytetarë se nuk kanë parë se çka është ligji dhe se nuk janë qytetarë që nuk kanë jetuar me zbatimin e ligjit. Përjashto të rinjtë që janë rritur pas lufte, gjithë popullata tjetër është po ajo që ka jetuar në kohën e socializmit, ku ka patur ligje të cilat janë zbatuar. Nuk është e arsyeshme që këtu të hapet debati se sa kanë qenë të drejta ligjet, mirëpo ato ligje janë zbatuar pothuajse në plotni.

Përjashtim në zbatimin e ligjit kanë bërë rastet që kanë qenë të lidhura me zbatimin e politikave të Serbisë për Kosovën, kuptohet politikave të mshefta (jo zyrtare), të cilat janë zbatuar nga SHMS-të. Këto raste të moszbatimit të ligjit, edhe pse janë kryer nga SHMS-të, kanë qenë aq të gjëra sa kanë qenë sekret publik që në këto raste ligji edhe nuk zbatohet. Këto raste në popull kanë qenë të njohura si raste për motive politike.

Besoj se të gjithëve u ka rënë në sy niveli i zbatimit të ligjeve në Kosovë, pas luftës së fundit, qasja në zbatimin e ligjit, sjellja karshi ligjshmërisë etj. Se moszbatimi i ligjit është në shkallë tepër të lartë, kjo dëshmohet me të gjitha raportet ndërkombëtare, për shumë vite rresht. Niveli i lartë i moszbatimit të ligjit, qasja ndaj ligjit dhe përgjithësisht sjellja karshi ligjit, demonstron një kulturë të moszbatimit të ligjit. Shtrohen pyetjet: pse ndodh kjo, pse qytetarët nuk zbatojnë ligjet e shtetit të vet, çka bëjnë politikanët (nëse ka të tillë!) për këtë kulturë të moszbatimit të ligjit, po qytetarët e zakonshëm çka bëjnë karshi kësaj kulture?

E pakta që mund të nxierret si përfundim në lidhje me kulturën e moszbatimit të ligjit pas lufte në Kosovë është, se kjo praktikë është diçka e pazakontë, diçka jonormale (shprehur me një fjalë popullore "si me t'ba dikush sehire").

Prodhim i kujt është kjo kulturë?

Domosdo se, kultura e moszbatimit të ligjit është prodhim i veprimtarisë së SHMS-ve. SHMS-të kanë demonstruar në të kaluarën se kanë imponuar ndërtimin e sistemeve të vlerave shoqërore, njerëzore. Kur sistemi funksionon për një kohë, shndërrohet në kulturë, mënyrë e veprimit, përditshmëri e qasjes dhe sjelljes në rastin konkret ndaj ligjit.

Kultura e moszbatimit të ligjit është ndërtuar pas veprimeve sistematike, d.m.th. pas funksionimit të sistemit të moszbatimit të ligjit për një periudhë të caktuar.

Po si arritën që SHMS-të të ndërtojnë sistemin e moszbatimit të ligjit?

Ky sistem është ndërtuar, siç janë ndërtuar edhe sistemet tjera. Zbatimi dhe moszbatimi i ligjit si sistem, ndërtohet përmes ndërtimit të sistemit të vlerave. Zbatimi i ligjit nga një individ kërkon që ai individ të posedojë cilësi (vlera) të caktuara, që lidhen me zbatimin e ligjit, njëjtë edhe tek moszbatimi i ligjit nga një individ, kërkohet që ai individ të posedojë cilësi të caktuara që lidhen me moszbatimin e ligjit.

Kur është fjala tek shkathtësitë/cilësitë e individit për moszbatimin e ligjit, kërkohet që individi t'i ketë ato shkathtësi/cilësi, të cilat i mundësojnë këtij individi që të kryej shkeljen e ligjit, vetëm në raste të caktuara (rastet e përcaktuara nga SHMS-të) dhe të vazhdojë punën e zakonshme pa u vërejtur për këto shkelje të ligjit. Pikërisht këtu ndërhyjnë SHMS-të, që të përzgjedhin dhe filtrojnë individët e përshtatshëm si bartës të shkathtësive/vlerave të nevojshme për moszbatim të ligjit. Kur individi ka disa shkathësi/cilësi/vlera, por jo të gjitha shkahtësitë/cilësitë/vlerat e duhura, bëhet stërvitja dhe përgatitja e specializuar. Bartësit e vlerave kryejnë veprimet e nevojshme për ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të vlerave, në rastin konkret funksionimin e sistemit të vlerave të moszbatimit të ligjit.

Shtrohen pyetjet si në vijim:

- Si arrijnë të përzgjedhin dhe të filtrojnë individët, bartës të vlerave për moszbatim të ligjit, p.sh. që një individ të punojë si prokuror i Shtetit të Kosovës dhe i cili do të kryej detyrat e SHMS-ve (shkelja e procedurave dhe detyrimeve ligjore) në raste të caktuara kur i kërkohet dhe që ky prokuror dhe shkeljet që kryen, të mos dihen, si i njohin dhe identifikojnë këta individë si të përshtatshëm?

SHMS-të nuk veprojnë nga dje ose nga sot, janë në veprim që mbi 100 vjet. Këto shërbime nuk janë struktura të vogla, por janë një armatë me shumë batalione. Gjatë gjithë veprimtarisë, batalionet e SHMS-ve mbledhin informata dhe dërgojnë në qendër, ku analizohen dhe merren vendime nga specialistë të profileve më të larta profesionale e shkencore.

- Si arrijnë SHMS-të që të kryejnë shkeljet ligjore, t'i fshehin shkeljet e kryera ligjore dhe t'i fshehin e mbrojnë individët që kanë kryer shkelje ligjore dhe në shumë raste këta individë t'i promovojë si më të mirët?

  Shtrirja e pranisë së SHMS-ve, nuk është vetëm p.sh. në prokurori ose gjyqësi, shtrirja e pranisë është në të gjitha hallkat e institucioneve të Kosovës dhe në të gjitha nivelet e institucioneve të Kosovës, përndryshe nuk do të mund të kishte sukses në ndërtimin e një sistemi të plotë funksional, që në rastin konkret është rasti i sistemit të moszbatimit të ligjit. Shtrirja e pranisë së gjerë me 70 batalione, iu mundësojnë që pa problem t'i kryejnë shkeljet ligjore dhe t'i fshehin ato, t'i mbulojnë, dhe edhe t'i promovojnë individët që kryejnë shkelje ligjore.

- Si ndërtohet një sistem i kompletuar i moszbatimit të ligjit (sistemi funksional)? Pastaj, përveç ndërtimit, si mirëmbahet sistemi që është funksional, pa problem, në të gjitha hallkat dhe në të gjitha nivelet e institucioneve të Kosovës?

  Mendojmë se, të gjitha këto, mundësohen nga kohëzgjatja e veprimtarisë për më tepër se 100 vjet dhe shtrirja e pranisë me 720 spiunë me betim, në të gjitha institucionet dhe nivelet e institucioneve të Kosovës. Këta spiunë thithin informacionet e nevojshme, i dërgojnë në qendër për analizim dhe vendimmarrje dhe po këta spiunë zbatojnë vendimet e marra nga qendra. Po ashtu, SHMS-të kanë të angazhuar specialistët e profileve më të larta profesionale dhe shkencore. Specialistët më të lartë profesionalë dhe shkencorë, analizojnë të dhënat e marra nga 720 spiunët duke shfrytëzuar njohuritë specialistike të fushave përkatëse dhe në bazë të përfundimeve të nxjerra, marrin vendime të cilat zbatohen nga këta 720 spiunë, që bëjnë sa 70 batalione ushtarake që veprojnë në terren.

Kur një sistem është i ndërtuar mirë, funksionon pa probleme për një kohë, atëherë mënyra e funksionimit të këtij sistemi bën të mundur zgjërimin e funksionimit të sistemit, bën të mundur që mënyra e funksionimit të sistemit

të shndërrohet në diçka të pranueshme, diçka të zakonshme, diçka normale në sjelljet e përditshme të individëve të punësuar në institucionet e Kosovës. Duke u shndërruar në përditshmërinë e veprimit dhe sjelljes, kjo mënyrë e veprimit dhe sjelljes shndërrohet në kulturë pune e të punësuarve në institucionet e Kosovës.

Shikuar nga aspekti i efektit të cilësive (vlerave) dhe i sistemeve, funksionimi i sistemit të moszbatimit të ligjit pamundëson funksionimin e sistemit të zbatimit të ligjit. Kultura e moszbatimit të ligjit përjashton kulturën e zbatimit të ligjit. Sistemi dhe kultura e moszbatimit të ligjit dhe sistemi dhe kultura e zbatimit të ligjit, funksionojnë njëjtë si sistemet operative tek sistemet kompjutoristike. Kur një sistem kompjutoristik ka të vendosur p.sh. sistemin operativ Windows, nuk mund të instalohen dhe të funksionojnë programet që funksionojnë p.sh. në sistemin operativ Oracle, dhe anasjelltas. Kur institucionet e Kosovës kanë të instaluar sistemin operativ të moszbatimit të ligjit, nuk mund të funksionojnë programet (cilësitë/vlerat) e zbatimit të ligjit dhe anasjelltas, sikur institucionet e Kosovës të kenë të instaluar sistemin e zbatimit të ligjit, nuk do të mund të funksionojnë programet (cilësitë/vlerat) e moszbatimit të ligjit.

Sistemi i moszbatimit të ligjit në Kosovë, është ndërtuar nga SHMS-të, si një makineri që vepron paralelisht në dy drejtime:

1) Mundëson ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha vlerave dhe sistemeve tjera që SHMS-të kanë për detyrë t'i ndërtojnë në Kosovë, dhe

2) Bluan dhe shkatërron të gjitha vlerat dhe sistemet që janë të nevojshme të ndërtohen, të funksionojnë dhe të mirëmbahen në Kosovë, për të siguruar ndërtimin dhe zhvillimin e Kosovës.

Këto veprime dydrejtimëshe, mund të shihen më lehtë nga një shembull i thjeshtë: një bartës i vlerave të nevojshme për zhvillimin e Kosovës konkurron në një tender ku po të zbatohej ligji, ky bartës do të duhej të fitonte tenderin. Veprimet e SHMS-ve, bëjnë që të shkelen procedurat e tenderit dhe ky bartës nuk e fiton tenderin. Ky bartës paraqet ankesat e nevojshme tek institucionet përkatëse, mirëpo si rezultat i veprimeve të SHMS-ve, merr përgjigje negative. Ky bartësi vazhdon tutje me ngritje të padisë në gjykatë, por edhe në gjykatë SHMS-të ndërmarrin veprimet e nevojshme që rezultojnë me përgjigje negative edhe nga gjykatat e të gjitha niveleve. Ky bartës kishte përvoja të ngjajshme edhe në të kaluarën, kështuqë humbja e këtij tenderi shkakton bankrotimin dhe shuarjen e

veprimtarisë biznesore. Tenderi i humbur nga ky bartës fitohet nga një bartës i vlerave të cilat SHMS i fuqizon në Kosovë.

Siç shihet në paragrafët më lart, kjo makineri veproi në dy drejtime:

1) mundësoi ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e vlerave dhe sistemeve që SHMS-të kanë për detyrë t'i ndërtojnë në Kosovë, dhe

2) bluajti dhe shkatërroi vlerat dhe sistemet që janë të nevojshme të ndërtohen, të funksionojnë dhe të mirëmbahen në Kosovë, për të siguruar zhvillimin e Kosovës.

LIDHJA DHE KONTROLLI I "MBITOKËS" NGA "NËNTOKA"

Qytetari i zakonshëm mund të vërejë se diçka nuk shkon në rregull me vendimmarrjen e institucioneve publike dhe shtetërore të Kosovës. Lehtë mund të shihet se në pothuaj të gjitha rastet, vendimet, disi merren nga "dikush" dhe vetëm bëhen të njohura në publik si të gatshme për të tjerët. Nuk ka pjesëmarrje në vendimmarrje nga të gjithë akterët, bëhet anashkallimi i akterëve tjerë, në forma të ndryshme. Kjo shihet qartë se vendimet realisht merren jashtë institucioneve të Kosovës, në baza joformale dhe vetëm disi formalizohen dhe legjitimohen nga institucionet legjitime të Kosovës. Kjo formë e vendimmarrjes, thjeshtë mund të kuptohet si model ku "nëntoka" merr vendimet dhe "mbitoka" formalizon dhe në këtë mënyrë legjitimon vendimet. Kjo mënyrë e marrjes së vendimeve dhe e formalizimit dhe legalizimit të vendimeve të marra në fakt, është kontrolli i mbitokës nga nëntoka.

Edhe pse shihet se vendimmarrjet e institucioneve të Kosovës rëndom, merren nga një grup i ngushtë, në baza joformale dhe pastaj formalizohen në institucionet e Kosovës, qytetarët e zakonshëm këtë e arsyetojnë me atë se jemi shtet i ri; demokracia ende nuk funksionon dhe se në këtë mënyrë sikur e marrin si të pranushme, këtë mënyrë të vendimmarrjes e marrin si normale. Ky gjykim i qytetarëve të zakonshëm është i kuptueshëm për arsye të mungesës së informacioneve dhe përgjithësisht mungesës së njohurive të këtyre fushave.

Nuk është e pritshme që qytetari i zakonshëm të ketë njohuritë e plota se si është i organizuar dhe si funksionon një institucion. Janë institucionet e

Kosovës, janë zyrtarët e institucioneve të Kosovës, ata që duhet t'i kenë njohuritë e nevojshme për punën e institucioneve dhe t'i shohin dhe njohin mënyrat e vendimmarrjes. Në mungesë të funksionimit dhe efikasitetit të institucioneve të Kosovës, nuk mbetet tjetër veçse bijtë dhe bijat e popullit të dalin në skenë dhe t'iu mundësojnë qytetarëve të zakonshëm të kuptojnë punën e institucioneve të Kosovës, të kuptojnë mënyrën e funksionimit dhe të vendimmarrjes në institucionet e Kosovës.

Shtrohen pyetjet si në vijim:

- A është rastësi një mënyrë e tillë e vendimmarrjes?

  Sipas një thënieje, në politikë nuk ka rastësi, ka kalkulim. Në politikat e Serbisë ndaj Kosovës, nuk ka rastësi hiç se hiç. Mendojmë se kjo mënyrë e vendimmarrjes është prodhim i veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë. Meqë mënyra e vendimmarjes nga një individ, ose grup i vogël individësh në baza joformale dhe formalizimi pastaj, në institucionet ligjore është shndërruar në diçka të zakonshme, kjo dëshmon se mënyra e tillë e marrjes së vendimeve është në fakt sistem funksional i marrjes së vendimeve.

- Po si arrijnë që SHMS-të të ndërtojnë një sistem të tillë funksional të vendimmarrjes?

  Sistemi i marrjes së vendimeve nga nëntoka dhe pastaj formalizimi dhe legalizimi i vendimeve në institucionet e Kosovës, është ndërtuar duke përdorur mënyrat e njëjta siç i ka përdorur në ndërtimin e sistemeve tjera të trajtuara në pjesët tjera të librit. Edhe ky sistem është i ndërtuar në bazë të sistemit të cilësive (vlerave) përmes bartësve të vlerave të përshtatshme për këtë sistem të vlerave.

- Për çka i duhet SHMS-së, sistemi i marrjes së vendimeve nga "nëntoka" dhe pastaj formalizimi dhe legalizimi i këtyre vendimeve?

  Nëpërmes funksionimit të këtij sistemi, mundësojnë funksionimin e sistemeve tjera, ndërtimi i të cilave është imponuar. Meqë SHMS-të kryejnë veprime të mshefta, atëherë "nëntoka" është hapësira e plleshme për të ushtruar veprimtaritë e mshefta. Meqë veprojnë msheftë, atëherë "nëntoka" përveç që është më e përshtatshme, është gjithashtu edhe më e lehtë për t'u kontrolluar.

"Nëntoka" që kontrollohet nga SHMS-të, përbëhet nga të gjitha veprimtaritë e mshefta dhe joligjore me të cilat merren SHMS-të, duke filluar nga krimet e organizuara të të gjitha llojeve, trafikimet, pastrimi i parave, deri te spiunët zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorët e tyre. Në anën tjetër "mbitoka", përbëhet nga të gjitha institucionet dhe format tjera organizative në Kosovë, që janë legale, që janë të regjistruara në bazë të ligjit dhe që veprojnë në bazë të ligjit. Kuptohet, se institucionet dhe format tjera organizative legale do të duhej të zbatonin ligjin dhe po të zbatohej, do të pamundësonte lidhjen dhe kontrollin e "nëntokës" në "mbitokën".

E MAJTA DHE E DJATHTA NË KOSOVË DHE SHMS-të

Në lidhje me përcaktimin ideologjik ose profilizimin politik, siç e quajnë vetë ato, paraqitjet në publik nga shumica e partive politike është interesante. Në shikim të parë, të duket se është një garë se kush më parë e kush më shumë është parti politike e djathtë. Për të bërë këtë të dukshme, krerët partiakë, japin shumë paraqitje publike, bile betohen edhe me letra (me dokumente partiake). Mendojmë se të gjitha paraqitjet publike të partive politike, se sa janë, dhe si janë parti të djathta, nuk janë më tepër sesa ofendim i inteligjencës së qytetarit të zakonshëm.

Të gjitha paraqitjet publike, se janë parti të djathta, nuk janë gjë tjetër vetëm se japin dëshmi të origjinës së bindjeve dhe të koncepteve të tyre politike komuniste, të konceptit themelor politik të komunistëve që ka qenë mashtrim i publikut (ndryshe fol e ndryshe puno). Fatkeqësisht ky koncept ka edhe sot shtrirje masive të zbatimit.

Nuk është e pritshme edhe për një kohë që të ketë parti politke të djathtë të mirëfilltë edhe po të donte dikush që vërtet të ndërtonte një parti politike të tillë. Ndërtimi i ndonjë partie politike të djathtë të mirëfilltë, nuk është i mundshëm të kryhet edhe për një kohë, për arsye se vlerat shoqërore, njerëzore, të djathta janë shkatërruar tepër shumë, për një kohë shumë të gjatë.

Vlerat e djathta tek shqiptarët e Kosovës kanë qenë të mishëruara në vlerat e esnafisë dhe në vlerat e burrënisë. Që të dy këto sisteme të vlerave kanë qenë natyrore dhe kanë patur bazën e tyre ideologjike të djathtë. Kjo bazë ideologjike, i ka bërë këto vlera që posaçërisht të jenë cak i sulmeve shkatërruese nga ideologjia komuniste. Meqë baza ideologjike e djathtë, ka qenë natyrore dhe ka qenë dominuese tek shqiptarët, ka bërë që të jetë cak i

veçantë për sulm shkatërrues nga Serbia, kuptohet përmes SHMS-ve.

Vlerat e djatha të esnafisë u shkatërruan shumë herët në periudhën e pasluftës, dhe mbetën vetëm si të thuash disa fije të holla të këtyre vlerave. Këto fije të holla të vlerave të djathta, kryesisht u kufizuan në disa cilësi të karakterit dhe personalitetit, që ishin kultivuar në disa familje që jetonin në qytete, pavarësisht brutalitetit të realitetit komunist dhe hegjemonisë serbe. Brutaliteti i komunistëve dhe i hegjemonisë serbe ndaj vlerave të esnafisë, u krye përmes ngritjes dhe fuqizimit së shtresës së qytetarëve që bartte vlerat e majta të socializmit, shtresës së qytetarëve siç u trajtua në paragrafët paraprakë. Kjo shtresë ua zuri frymën vlerave të esnafisë dhe i mbyti ato vlera, për të mbijetuar shumë pak nga këto vlera.

Vlerat e djathta të burrënisë, mbijetuan pak më shumë, deri në përfundim të luftës së fundit, pak më shumë se vlerat e esnafisë, kryesisht në disa familje që jetonin në fshatra. Vlerat e djathta të burrënisë, në disa familje, u mbajtën kryesisht falë pronësisë mbi toka që kishin këto familje dhe falë emigrimit të anëtarëve të këtyre familjeve. Vlerat e djathta tek këto familje mbijetuan për faktin se regjimi i kaluar izoloi popullatën që jetonte në fshatra për të pamundësuar zhvillimin e tyre, në këtë mënyrë për të shkatërruar vlerat e burrënisë. Meqë ishin të izoluara edhe u lanë anash nga vëmendja e plotë ndaj zhvillimeve brenda kësaj popullate. Nën këto kushte të izolimit dhe të kufizimit të mundësisë për zhvillim, mbijetuan disa familje me rendin shtëpiak të burrënisë dhe me këtë mbijetuan edhe vlerat e burrënisë.

Vlen të theksohet se gjatë fundit të viteve '80, kur filloi të zbatohet programi i ekonomisë së tregut të Ante Markoviqit, filluan të zhvillohen edhe vlerat e djathta. Fatkeqësisht, për shkak të ndërhyrjeve të regjimit të Sllobodan Millosheviqit, rregullat e ekonomisë së tregut u pezulluan dhe u zëvendësuan me rregulla të një regjimi klasik shfrytëzues, të një okupimi brutal deri në barbarizëm. Nën këto kushte, nuk u bë e mundur që të zhvillohen vlerat e djathta. Pati disa veprimtari të ndërmarrësisë, që ishin kryesisht tregtare, por që ishin plotësisht të nënshtruara kërkesave të pushtetit. Nën këso kushtesh nuk ka patur ekonomi të tregut dhe në këtë mënyrë, nuk ka patur shanse për zhvillim të vlerave të djathta.

Gjatë gjithë periudhës, nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e deri tek përfundimi i luftës së fundit, janë zhvilluar vetëm vlerat e majta, por që kanë qenë vlera të majta socialiste. Gjatë periudhës së komunizmit, nuk kemi patur ndonjë zhvillim të vlerave të mirëfillta, bile as zhvillim të vlerave të mirëfillta të majta, për faktin e mungesës së eknomisë së tregut.

Në Kosovën e pasluftës së fundit, fatkeqësisht ende nuk kemi zhvillim të vlerave të mirëfillta, as vlera të majta dhe as vlera të djathta. Vlerat e mirëfillta të djathta dhe vlera të mirëfillta të majta, mund të zhvillohen vetëm në ekonominë e tregut.

Dikush mund të mendojë se pas luftës së fundit, në Kosovë kemi funksionim të ekonomisë së tregut. Fatkeqësisht, kemi shumë pak ekonomi të tregut, kjo për faktin e shkallës së ulët të zbatimit të ligjit. Moszbatimi i ligjit dhe forcat e ekonomisë së tregut veprojnë ashtu që njëra e përjashton tjetrën. Moszbatimi i ligjit ka përjashtuar veprimin e forcave të tregut.

Moszbatimi i ligjit del si prodhim i veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë. Nëpërmes të fuqizimit të moszbatimit të ligjit. SHMS-të po arrijnë të ndalojnë edhe zhvillimin e ekonomisë së tregut dhe me këtë edhe zhvillimin e vlerave të mirëfillta të majta dhe edhe të vlerave të mirëfillta të djathta.

Në kontekst të zhvillimit në Kosovë, të vlerave të majta dhe të vlerave të djathta, nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e deri në përfundimin e luftës së fundit, është e nevojshme që të shtjellohet edhe veprimtaria kombëtare dhe patriotike e individëve dhe grupeve ilegale.

Në vitet e hershme të pasluftës së Dytë Botërore, ka patur veprimtari kombëtare dhe patriotike të zhvilluar kryesisht nga individë dhe grupe me vlera të djathta, kurse në dekadat e fundit të paraluftës së fundit ka patur veprimtari kombëtare dhe patriotike të zhvilluar nga individë dhe grupe kryesisht me vlera të majta. Kjo ka ndodhur për arsye se individët dhe grupet me vlera të majta janë mbështetur dhe ndihmuar nga shteti amë, Shqipëria, kurse individët dhe grupet me vlera të djathta, jo që nuk janë mbështetur nga Shqipëria, por janë përndjekur edhe më egërsisht sesa nga vetë Serbia. Këto rrethana kanë ndikuar që vlerat e djathta të mos kenë ndonjë fuqi.

Veprimtaria e individëve dhe grupeve me vlera të majta, ka qenë shumë aktive deri në përfundim të luftës së fundit. Mirëpo, në dekadat e fundit, për shkak të infiltrimit në këto veprimtari dhe në këto grupe të bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, kjo veprimtari nuk ka mundur të demonstrojë rezultatet e pritshme.

Fillimi i viteve '90, në Kosovë solli rrethana të reja. Veprimtaria kombëtare dhe patriotike u zgjerua dhe përfshiu edhe vlerat e djathta. Pothuajse për herë të parë nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, u krijua një front i përbashkët i vlerave të djathta dhe vlerave të majta, përballë regjimit okupues të Serbisë. Ky bashkëpunim i vlerave të majta dhe vlerave të djathta

edhe pse me disa vështirësi, mundësoi që të hapet fronti i luftës së drejtpërdrejtë me pushtetin e Serbisë.

Lufta e UÇK-së u bë e mundur vetëm kur individët dhe grupet me vlera të majta u mbështetën nga fijet e mbetura të individëve dhe familjeve me vlera të djathta. Spiunët zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve, gjatë periudhës së paraluftës dhe gjatë periudhës së luftës së fundit, kanë qenë të infiltruar fuqishëm edhe brenda forcave të majta dhe forcave të djathta të kohës, mirëpo nuk kanë arritur që të ndalin përparimin e çështjes kombëtare, falë fuqisë së krijuar nga të qenët në një front edhe të vlerave të majta edhe të vlerave të djathta. Veprimtaria e individëve dhe grupeve me vlera të majta, e cila ishte aktive në vazhdimësi për disa dekada, shijoi rezultatet e pritshme vetëm kur u mbështet dhe u ndihmua edhe nga fijet e mbetura të individëve dhe familjeve me vlera të djathta.

Për të patur Kosova një zhvillim të fuqishëm shoqëror dhe ekonomik, është e nevojshme që të zhvillohen edhe vlerat e majta të ekonomisë së tregut dhe edhe vlerat e djathta të ekonomisë së tregut. Këto vlera brenda një kombi, në kushtet e ekonomisë së tregut, nuk janë armiqësore, por bashkëjetojnë.

Në Kosovë deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, kanë bashkëjetuar dy sisteme të vlerave që kanë përfaqësuar dy filozofi dhe koncepte jetësore, të cilat kanë qenë shumë të ndryshme, por nuk kanë patur pozicione armiqësore ndaj njëra-tjetrës. Filozofia dhe koncepti jetësor i esnafisë, nuk ka rastisur të ketë patur ndonjë konflikt armiqësor me filozofinë dhe konceptin jetësor të burrënisë, dhe anasjelltas. Njëra filozofi dhe koncept jetësor nuk e ka pranuar si të vetën filozofinë dhe konceptin tjetër jetësor, mirëpo kjo nuk ka shkaktuar konflikte armiqësore.

Ka patur edhe raste të martesave në mes të këtyre dy shtresave. Një rast konkret mund të përmendet rasti i kushëririt të autorit të këtij publikimi, Selman Mehaj, që ka qenë pjesëtar tipik i shtresës së burrënisë, është martuar me Ferdane Bexhetin, një pjesëtare tipike e shtresës së esnafisë dhe të dy familjet kanë patur marrëdhëniet më të mira të mundshme ndërmjet veti. Çifti ka jetuar dhe ende jeton në një harmoni dhe mirëkuptim të admirueshëm ideal.

Kur vendi ka patur rreziqe, shtresa e esnafisë dhe shtresa e burrënisë, kanë bashkëpunuar dhe kanë dalur së bashku në mbrojtje të vendit. Kjo u dëshmua edhe në luftën e fundit të UÇK-së, ku në luftë u gjetën së bashku pjesëtarët e të dy këtyre shtresave përkrah individëve dhe grupeve të majta socialiste.

Në rrethanat e deritanishme të pasluftës së fundit në Kosovë, paraqitjet publike të krerëve të disa partive politike, se janë parti politike të djathta nuk është e bazuar në realitet. Në fakt, këta krerë me këto paraqitje publike janë duke dëshmuar shkathtësitë e mashtrimit, shkathtësitë e uzurpimit, shkathtësitë e përvetësimit. etj. dhe, në këtë mënyrë janë duke kryer shkatërrimin e vlerave të djathta në Kosovë. Nga dy grupimet më të mëdha politike në Kosovë, dhe që paraqiten si parti të djathta, njëri nga krerët është betuar në besnikërinë ndaj komunistit Enver Hoxha, dhe tjetri është betuar në besnikërinë ndaj komunistit tjetër Josip Broz Tito dhe që të dy tani betohen se bartin vlerat e djathta. bile betohen edhe me letra dhe dokumente të partisë.

Shkatërrimi i vlerave të djathta. ka qenë gjatë gjithë kohës, cak i veçantë i veprimtarisë së SHMS-ve për faktin se me vlerat e majta socialiste ka patur diçka të përbashkët nga praktika socialiste. Afërsia ideologjike e majtë socialiste, ka krijuar lehtësi për ndërtimin e krijesave artificiale të paraqitura në paragrafët paraprakë si dhe ka krijuar lehtësi për luftimin dhe shkatërrimin e zhvillimeve të natyrshme të shoqërisë, siç është paraqitur në paragrafët paraprakë.

Me veprime mashtruese se janë parti të djathta, kur në fakt vetë krerët janë vlera tipike të majta. këta krerë partiakë janë duke kryer punën e SHMS-ve. SHMS-të në vazhdimësi kanë ndërhyrë në procese të ndryshme për të ndryshuar rrjedhën dhe zhvillimin nga një rrjedhë dhe zhvillim natyror, kah rrjedha dhe zhvillimi i imponuar. kuptohet në drejtim të përmbushjes së caqeve të politikave të Serbisë ndaj Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. e cila përcakton ekonominë e tregut si themel i ndërtimit të shoqërisë Kosovare. do të duhej që në Kosovë të kemi parti politike të majta. të mirëfillta dhe parti politike të djathta të mirëfillta. Me ndërhyrjen e krerëve të partive politike si bartës tipik të vlerave të majta për gjoja zhvillimin e vlerave të djathta, në fakt bllokojnë mundësinë e zhvillimit të vlerave të djathta dhe me këtë kryejnë shkatërrimin e vlerave të djathta. Këto veprime të këtyre krerëve të këtyre partive politike janë tipike veprime të SHMS-ve në Kosovë.

Është e rëndësishme që të bëhet e ditur se vlerat e djathta kanë për bazë pronën dhe pasurinë private, mirëpo nuk do të thotë se çdo pasuri dhe çdo pronë private është vlerë e djathtë. Prona dhe pasuria e krijuar me hajni, me krime dhe me vepra tjera kundërligjore, nuk është vlerë e djathtë, është vlerë e hajnisë, është vlerë e krimit, dhe është vlerë e moszbatimit të ligjit. Prona

dhe pasuria e krijuar me ndihmën dhe mbështetjen e veprimtarisë së SHMS-ve, nuk është vlerë e djathtë, është vlerë e SHMS-ve.

A mund të pohohet se është dëgjuar ndonjëherë titull ose status "Hajn Aga". Sigurisht se jo, për faktin se nuk ekzistojnë hajna "Agë". Hajni është hajn dhe ka vetëm epitetin e hajnit. Në asnjë shoqëri, hajni nuk ka status me vlerë shoqërore.

Personi që krijon prona dhe pasuri me hajni dhe krime tjera, sa do i fuqishëm që të bëhet, nuk është i djathë, është kriminel. Personi që krijon prona dhe pasuri përmes SHMS-ve, nuk është i djathtë, është spiun dhe meqë spiunimi dhe bashkëpunimi me SHMS-të është vepër e ndyer kriminale, këta individë janë kriminelë të ndytë. Vetëm prona dhe pasuria individuale e krijuar me zbatim në plotni të ligjeve të Kosovës, është vlerë e djathtë e Kosovës.

Vlerat e hajnisë dhe krimeve tjera dhe vlerat e SHMS-ve, në fakt dëmtojnë dhe shkatërrojnë vlerat e djathta. Këta krerë të partive politike që betohen në vlerat e djathta, deri më tani nuk kanë dhënë ndonjë dëshmi të luftimit të vlerave të hajnisë, të luftimit të vlerave të krimeve tjera dhe të luftimit të vlerave të SHMS-ve. Një luftim i tillë do të mbronte vlerat e djathta dhe do të krijonte kushte më të mira për zhvillimin e vlerave të djathta. Fakti i mosluftimit nga këta krerë partiakë të vlerave të krimit dhe të vlerave të SHMS-ve, është dëshmi se këta krerë po kryejnë punët e SHMS-ve.

PËRDORIMI NGA SHMS-të I SITËS NË VEPRIMTARINË E PARTIVE POLITIKE

Partitë politike që tani veprojnë në Kosovë dhe që tani janë parlamentare, me përjashtim të njërës, janë krijuar pas luftës së fundit. Në vazhdim, shtjellimi përqëndrohet rreth partisë politike të themeluar para luftës së fundit për faktin se zhvilllimet brenda kësaj partie, janë më përpara sesa zhvillimet në partitë tjera të cilat janë krijuar më vonë pas lufte. Nga aspekti i veprimtarisë së SHMS-ve, zhvillimet dhe proceset që kanë ndodhur dhe që janë duke ndodhur në këtë parti, janë të njëjta me zhvillimet dhe proceset që kanë ndodhur dhe që janë duke ndodhur ose do të ndodhin edhe në partitë tjera, veçse më vonë. Përshkrimi i zhvillimeve dhe procesve në këtë parti, vlen edhe për partitë tjera politike.

Nëse SHMS-të kanë prani të gjerë në Kosovë me 720 spiunë, shtrohen pyetjet:

- A ka spiunë zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve brenda partive ekzistuese politike në Kosovë?

  Shtrirja e gjërë e veprimtarisë së tyre, sigurisht se përfshin edhe brendinë e partive politike. Nisur nga fakti se i gjithë organizimi shtetëror dhe institucional i Kosovës ndërtohet nga partitë politike, prania e spiunëve me betim dhe bashkëpunëtorëve brendpërbrenda partive politike, do të duhej të ishte më e madhja dhe më e fuqishmja.

  Prania e SHMS-ve brenda partive politike, dëshmohet edhe me ngjarje të.tilla si ato me prijësin historik të partisë politike, të themeluar para lufte. Është bërë e njohur edhe për qytetarin e zakonshëm se prijësi historik ka patur pengesa dhe bllokada nga individë brenda partisë së vet, si ndërprejra e telefonit, ndërprerja e financimit etj. dhe se nuk ka ndërmarrë masa, edhepse prijësi historik ka patur mbështetje plebishitare në popull.

  Në kontekst të kësaj, shtrohen pyetjet: kah dhe si janë bërë këta individë aq të fuqishëm sa që prijësi historik që ka gëzuar përkrahje plebishitare të mos ballafaqohet me ta?

  Përgjigje rrjedhëse është se këta individë kanë qenë spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë të SHMS-ve dhe fuqinë e kanë marrë nga SHMS-të, dhe se prijësi historik nuk ka dashur që të konfrontohet me ta. Po pas vdekjes së prijësit historik, ku janë sot ata individë, dhe çfarë bëjnë?

  Sigurisht se këta individë vazhdojnë të kryejnë detyrat e SHMS-ve në këtë subjekt politik, si në "bashqe të babës" pa patur kush t'u dalë përballë.

- Nëse ka patur spiunë zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve brenda partive politike, çfarë kanë punuar? Nëse tani ka spiunë zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorë brenda partive politike, ku janë dhe çfarë punojnë tani?

  Sigurisht, që spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve kanë kryer dhe vazhdojnë të kryejnë detyrat e marra nga SHMS-të.

- Çfarë janë punët që kryejnë spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve brenda partive politike?

  Parimisht, spiunët dhe bashkëpunëtorët kryejnë detyrat sipas programeve të SHMS-ve, në arritjen e synimeve të politikave të Serbisë për Kosovën. Nga fakti se partitë politike janë bartës të ndërtimit të të gjitha institucioneve të Kosovës, detyrat e spiunëve zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorëve brenda partive politike, janë më të specializuarat dhe më të përgatiturat nga të gjitha detyrat e SHMS-ve, për faktin se përmes spiunëve dhe bashkëpunëtorëve brendpërbrenda partive politike ndërtohen dhe kontrollohen të gjitha ndërhyrjet dhe të gjitha sistemet e vlerave dhe sistemeve tjera funksionale.

  Meqë veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë, në pjesën më të madhe ka të bëjë me ndërhyrjen në vlerat shoqërore njerëzore, edhe veprimet e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve brenda partive politike duhet të jenë në pjesën më të madhe ndërhyrje në vlerat shoqërore, njerëzore, me qëllim të ndërtimit të sistemeve të vlerave që i përcaktojnë SHMS-të.

Nëse shikohen me kujdes zhvillimet dhe proceset e partisë politike të formuar në fund të viteve '80, çdo lëvizje brendapërbrenda partisë, çdo zhvillim dhe çdo proces që ka patur të bëjë me kuadrot partiake, është shoqëruar me veçori afërsisht të njëjta. Në secilën lëvizje, në secilin zhvillim dhe në secilin proces që ka patur lëvizje të aktivistëve partiakë, individët që kanë qenë më të sinqertë, më parimorë dhe më të devotshëm për interesat e Kosovës, ose kanë përfunduar në pozita më të ulëta brenda partisë, ose kanë përfunduar jashtë strukturave të partisë! Në secilën lëvizje, në secilin zhvillim dhe në secilin proces që ka patur lëvizje të aktivistëve partiakë, individët që kanë qenë më hileqarë, që kanë qenë më joparimorë, që në të kaluarën, vetë individët ose familjarët e afërt të tyre, kanë dëshmuar besim dhe besnikëri ndaj regjimit të kaluar, janë avancuar në pozita më të larta partiake.

Proceset e paraqitur sipër janë kryer njëjtë sikur sita, sa herë që lëvizë, diçka lëshon poshtë e diçka mban brenda në sitë. Zhvillime dhe procese të ngjajshme janë zhvilluar dhe zhvillohen edhe pas lufte në vazhdimësi, pothuajse edhe tek të gjitha partitë tjera politike ekzistuese në Kosovë.

Me fillimin e ndërtimit të institucioneve dhe mbajtjes së zgjedhjeve të lira, puna më e madhe e SHMS-ve në sitjen e individëve brenda partive politike është kryer në ndërtimin e listave zgjedhore dhe në sigurimin se individët

nga lista e SHMS-ve arrijnë të marrin statusin e delegatit të Kuvendit të Kosovës. Ndërtimi i listave të kandidatëve sipas kërkesave të SHMS-ve kryhet lehtë nën kushtet e kontrollit të fuqishëm nga krerët partiakë dhe të pranisë së kontrollit të SHMS-ve mbi krerët partiakë. Edhe sigurimi se kandidatët e kërkuar nga SHMS-të sigurojnë votat e nevojshme për t'u bërë delegat nuk është i vështirë nën kushtet e trafikimit të votave brenda listës të nivelit siç është raportuar nga mediet.

Rezultatet e zhvillimeve dhe proceseve të përshkruara në paragrafët paraprakë, mund të shihen tek pothuaj të gjitha partitë ekzistuese politike. Së paku, tek të gjitha partitë më të mëdha ekzistuese në Kosovë edhe nga qytetari i zakonshëm mund të shihet se strutkurat e tyre partiake, janë të mbizotëruara nga individë, që vetë, ose familjarët e afërt të tyre, kanë dëshmuar besim dhe besnikëri ndaj regjimit të Serbisë. Jo vetëm strukturat partiake, por edhe shumica e institucioneve të Kosovës, janë të drejtuara nga individë, që ose vetë ose familjarët e afërm të tyre, kanë dëshmuar besim dhe besnikëri ndaj regjimit të Sërbisë.

Shtrohet pyetja: a janë rastësi vendosjet e individëve me profile të përshkruara më lart, në drejtimin e shumicës së institucioneve të Kosovës?

Sigurisht se në politikë kurrgjë nuk ka rastësi, bile në politikat e Serbisë ndaj Kosovës jo se jo. Këto vendosje të këtij profili të individëve, kanë mundur të kryhen vetëm përmes përdorimit të sitave nga spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve brenda partisë politike që ka emëruar këta individë dhe atë në nivelet më të larta të partisë. Nëpërmes vëndosjes së këtij lloj profili të individëve në udhëheqjen dhe drejtimin e institucioneve të Kosovës, sigurohen bartësit e vlerave, të përshtatshëm për ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha sistemeve, siç janë: sistemi i moszbatimit të ligjit, sistemi i kontrollit dhe drejtimit të mbitokës nga nëntoka, sistemi i hajnisë masive, sistemi i amoralitetit-kurvënisë.

Se SHMS-të kanë të instaluar spiunët zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorët e vet brenda strukturave të partive politike, përfshi krerët e partive politike, po, është e kutpueshme. Se këta spiunë dhe bashkëpunëtorë kanë përdorur dhe po përdorin sita të caktuara në emërimet, përzgjedhjet dhe punësimet partiake, si brenda partive politike ashtu edhe nëpër institucionet e Kosovës edhe kjo është e kutpueshme, veçse si i thjeshtë po duket ky proces.

Sitja e individëve nga SHMS-të, brenda partive politike dhe përmes kësaj edhe nëpër institucione tjera, nuk është kryer vetëm për individët se kush ku duhet të pozicionohet në nivele më të larta të drejtimit dhe të udhëheqjes në

parti politike dhe në institucionet e Kosovës. Sitja e individëve është kryer edhe për individët se kush sa duhet të shkelet poshtë, kush sa duhet të degradohet, kush sa duhet të shkatërrohet, me një fjalë, kush sa duhet të neutralizohet si brenda partisë politike ashtu edhe brenda institucioneve të Kosovës dhe përgjithësisht shoqërisë kosovare.

Sitja nga SHMS-të, nëpër të gjitha institucionet e Kosovës, është kryer edhe për individët, kush dhe sa duhet të shkojë lart, por edhe për individët se kush dhe sa duhet të shkojë poshtë. Kriteri i parë që zbatohet për të vendosur për një individ, se a duhet të ngritet lart ose a duhet të shkelet poshtë, është lakmia, ose siç e quan populli, llaskucia. Nëse individi është llaskuc, duhet të ngritet lart dhe nëse nuk është llaskuc, duhet të shkilet poshtë.

Llaskuci e ka motorin e fuqishëm, llaskucinë, që e shtynë për t'i kryer të gjitha punët që i duhen SHMS-ve, nuk lë gjë pa bërë, nuk lë gjë pa shkelur.

Pas klasifikimit, se a duhet një individ të shkojë lart, ose a duhet të shkelet poshtë, SHMS-të përdorin kritere tjera shtesë për të përcaktuar se sa individi duhet të shkojë lart dhe se sa individi duhet të shkelet poshtë.

Përdorimi i sitave tek individët, është një proces shumë kompleks, shumë i specializuar dhe shumë profesional e shkencor. Përdorimi i kësaj site është veprim shumë i specializuar dhe është veprim shumë inteligjent, siç është e shtjelluar më lart dhe do të shtjellohet në vijim:

- Pse është i tillë?

  Këto sita janë të përdorura edhe për individët brendpërbrenda partive politike, por edhe në të gjitha institucionet e Kosovës, përfshi nivelin komunal.

- Sa institucione të Kosovës janë në nivelin qendror dhe në nivelin komunal?

  Janë qindra institucione.

- Sa të punësuar në nivele të larta drejtuese kanë të gjitha këto institucione?

  Kanë të punësuar mijëra veta.

- Cilat janë profilet personale, profilet profesionale, profilet e karakterit të këtyre të punësuarve?

  Janë profile të të gjitha llojeve të mundshme të profileve që ekzistojnë në popullin e Kosovës.

- Cilat janë njohuritë që janë të nevojshme për të kryer sitjen e cila lëshon individët me cilësitë/vlerat që kërkohen për secilin individ me karakter, personalitet dhe nivel profesional të ndryshëm?

  Janë të nevojshme njohuritë e nivelit më të lartë profesional dhe më të lartë shkencor.

- A mundet kryetari ose të gjithë krerët së bashku të një partie politike të kryejnë sitjen e tillë të individëve për gjithë Kosovën dhe për të gjitha institucionet e Kosovës?

  Sigurisht se nuk munden. Nuk kanë njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për një sitje të tillë, këtë e dëshmojnë të gjithë prijësit e partive politike në paraqitjet e tyre publike. Edhe po të kishin njohuri dhe ekspertizë të përafërt, fizikisht nuk kanë mundësi të kryejnë sitjen, siç është paraqitur në këtë publikim, nuk do të kenë kohë edhe nëse nuk flejnë 24 orë.

- A i kanë njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme krerët e strukturave të organizuara si SHIK-u, të kryejnë sitjen, siç është paraqitur në këtë publikim?
  Asnjëri nga krerët e SHIK-ut, si individ edhe nëse i marrim të gjithë së bashku, nuk kanë njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për kryerjen e një sitjeje të tillë për gjithë Kosovën dhe për të gjitha institucionet e Kosovës. Edhe po të kishin njohuri dhe ekspertizë të përafërt, fizikisht nuk kanë mundësi të kryejnë sitjen, siç është paraqitur në këtë publikim.

Nga pyetjet dhe përgjigjet e paraqitura në paragrafët paraprakë, nxirret përfundimi se veprimi i sitjes së individëve siç është përshkruar në këtë publikim, në të gjitha institucionet, në gjithë Kosovën, duke filluar nga partitë politike, nuk mund të kryhet nga një individ ose disa individë si një grup i veçantë, përfshi SHIK-un si organizatë me pretendime të veprimtarisë së msheftë, si dhe organizatat tjera të njohura për publikun me pretendime të ngjajshme me ato të SHIK-ut.

Sitja e individëve me profile nga më të ndryshmet, të karaktereve, të personaliteteve dhe profileve të niveleve profesionale, mund të kryhet vetëm nga SHMS-të. Krejt çka kanë mundur të kryejnë dhe çka mund të kryejnë individët dhe grupet e individëve, qoftë krerë të partive politike, qoftë krerë të SHIK-ut, qoftë krerë të strukturave tjera të mshefta, është që të koordinojnë mbledhjen e të dhënave për individë në gjithë Kosovën, përmes 50.000 ushtarëve spiunë dhe bashkëpunëtorë në Kosovë, si dhe të koordinojnë zbatimin e vendimeve të marra nga qendra e SHMS-ve përmes këtyre batalioneve të ushtarëve nëpër të gjitha institucionet e Kosovës, përfshi në rend të parë partitë politike.

Mënyra se si janë situr dhe si po siten individët në gjithë Kosovën dhe në të gjitha institucionet e Kosovës, të forcon bindjen se krerë të partive politike dhe të disa nga institucionet kryesore të Kosovës, kanë vija të rregullta komunikimi me SHMS-të, kanë në dorë listat e individëve, se kë e sa duhet ngritur lart dhe kë e sa duhet shkelur poshtë, ose neutralizuar fare.

Spiunët zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve brenda partive politike, kanë kryer veprimet e nevojshme për të siguruar arritjen e plotë të synimeve e të politikave dhe programeve të Serbisë ndaj Kosovës. Sigurimi në arritjen e plotë të synimeve të politikave dhe të programeve të Serbisë për Kosovën, është arritur përmes përdorimit të sitës në përzgjedhjen e individëve për punë dhe për udhëheqje me intitucionet e Kosovës, përfshi partitë politike në rend të parë.

Këto veprime të SHMS-ve të sitjes së individëve të përshtatshëm për ndërtimin e institucioneve të Kosovës, janë kryer nga individë brenda partive politike, përfshi vetë krerët e këtyre partive politike, përndryshe nuk do të kishte rezultate kaq të fuqishme. Nga përfundimi i luftës së fundit e deri tani, nuk kemi pa dhe nuk kemi dëgjuar diku, ose nga dikush, as edhe veprimin e vetëm më të vogël të ndonjë prijësi të ndonjë partie politike, të kundëvënies së zbatimit të sitjeve të individëve, të zbatuara nga spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve.

VLERAT E LUFTËS SË UÇK-SË DHE SHMS-të

Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe vlerat e luftës së saj, janë pasuria më e madhe kombëtare e historisë sonë më të re. Angazhimi, përpjekjet, vuajtjet dhe sakrificat e bëra nga populli shqiptar, për fitimin e lirisë së Kosovës, nuk janë ndalur kurrë dhe të gjitha këto kulmuan me një organizim ushtarak, që hyri në luftë dhe solli lirinë e Kosovës. Kuptohet se "trimi i mirë me shokë

shumë", gjithsesi jep rezultatet e veta. Edhe lirinë e Kosovës, lufta e UÇK-së e solli bashkë me miqtë ndërkombëtarë. Vlerat e UÇK-së dhe të luftës së UÇK-së si vlerat më të larta kombëtare të historisë sonë më të re, duhet ruajtur sikur sytë e ballit.

Për t'i ruajtur vlerat e luftës së UÇK-së, bile edhe për t'i mbrojtur këto vlera, duhet të dihet se nga kush mund të sulmohen dhe si mund të sulmohen. Në pyetjen se kush është më i interesuari për zhvlerësim deri në shkatërrim të këtyre vlerave, përgjigjja gjithsesi do të duhej të ishte se Serbia është më e interesuara.

Hulumtimi rreth arsyeve se pse Serbia ka këtë interesim, nuk shton ndonjë vlerë, sepse dihet sheshazi. Vlerë e madhe do të ishte po që se hulumtohen dhe dihen mënyrat se si Serbia sulmon këto vlera deri në shkatërrim.Si pjesëtar i shoqërisë së Kosovës, edhe autori është i interesuar që t'i ruajë dhe t'i mbrojë vlerat e UÇK-së dhe të luftës së saj dhe në këtë publikim përpiqet të jep kontributin personal për këtë mbrojtje. Përpjekjet për kontribut bëhen nga këndvështrimi dhe vrojtimi i qytetarit të zakonshëm.

Jemi dëshmitarë se qysh prej përfundimit të luftës së UÇK-së, janë vërejtur tendenca dhe veprime për zhvlerësimin e UÇK-së dhe luftës së saj. Këto veprime dhe tendenca herë-herë kanë qenë hapur e herë-herë janë fshehur e maskuar shumë mirë. Lufta dhe "lufta" si dhe mbrojtja dhe "mbrojtja" , kanë qenë të mbuluara dhe të mbështjellura, por gjithsesi të fuqishme.

Se lufta është përzier dhe mbështjellë me "luftën" dhe mbrojtja është përzier dhe mbështjellë me "mbrojtjen", është bërë e kuptueshme edhe për qytetarin e zakonshëm se diçka nuk është në rregull, edhe pse këto përzierje dhe mbështjellje janë menduar mirë dhe janë zbatuar mirë. Përpjekje duhet të bëhet që të jetë e pastër, se çka në të vërtetë është sulm kundër vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, si dhe çka është në të vërtetë mbrojtje e vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj.

Fillimisht, me përfundimin e luftës, u krijuan dy blloqe të grupeve politike: blloku i grupeve politike të luftës dhe blloku i grupeve politike të paqes. Kjo ndarje është artificiale dhe jonatyrore. Kjo ndarje është artificiale për arsye se nuk ka patur asnjë grup politik që ka qenë grup politik vetëm për luftë dhe nuk ka patur asnjë grup politik që ka qenë grup politik vetëm për paqe. Grupet politike të dy këtyre blloqeve edhe para luftës po edhe gjatë luftës, janë përpjekur për lirinë e Kosovës.

Para luftës dhe gjatë luftës, ka patur grupe politike që kanë bërë përpjekje. që liria e Kosovës të arrihet pa luftë, mirëpo kanë qenë të bindur se kjo liri nuk mund të arrihet pa luftë dhe ka patur grupe politike që kanë bërë përpjekje që liria e Kosovës të arrihet me luftë dhe kanë qenë të bindur se kjo liri mund të arrihet vetëm me luftë, ose së paku me një ballafaqim minimal luftarak.

Dallimet në mes të këtyre grupeve politike kanë qenë dallime të drejtimeve të tyre politike, dallime që janë krejt normale. Këto dallime kanë qenë krejt natyrore, kurrë nuk mendojnë të gjithë njëjtë. Po si u bë atëherë që këto dallime natyrore të shndërrohen në dallime artificiale, deri në krijim të një lloj konflikti. Konflikti i ndërtuar mbi dallimet artificiale sigurisht se është konflikt artificial.

Sigurisht së është në interes të të gjithë neve, të mos kemi asnjëlloj konflikti brenda shoqërisë sonë edhe po të jetë konflikt natyror e lëre më, po që se është konflikt krejt artificial. Në përpjekje për kontribut në tejkalim të këtij lloj konflikti artificial, shtrohen disa pyetje:

- A është e interesuar Serbia që përmes SHMS-ve të zhvlerësojë vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj?

  Sigurisht se po.

- A ka krijuar në të kaluarën Serbia përmes SHMS-ve dallime artificiale, me qëllim të arritjes së synimeve të veta?

  Siç u shtjellua në paragrafët paraprakë , përmes SHMS-ve, janë krijuar dallime artificiale në të kaluarën.
- A kanë përdorur dhe a përdorin SHMS-të lakminë dhe lakmitarët si mjet për rekrutimin e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre?

  Siç u shtjellua në paragrafët paraprakë, çdoherë pikënisja e tyre në rekrutimin e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre është lakmia.

- A kanë kryer SHMS-të veprime konkrete fillimisht për krijimin e këtij dallimi artificial, dhe pastaj edhe të këtij lloji konflikti artificial?

  Sigurisht se po. Kjo rrjedh nga të gjitha përgjigjet në paragrafët paraprakë .

- Si dhe çka konkretisht kanë vepruar SHMS-të?

Përgjigjja në këtë pyetje ka nevojë për një shtjellim më të zgjëruar, gjë që është paraqitur në paragrafët në vijim.

Fillimisht, nëse pohohet se SHMS-të kanë kryer veprime konkrete për zhvlerësimin deri në shkatërrim të vlerave të UÇK-së dhe të luftës së saj, është e nevojshme që të bëhet e kuptueshme se si kanë arritur deri tek mundësia për të kryer veprime të tilla.

Pa infiltrim të spiunëve zyrtarë me betim dhe të bashkëpunëtorëve të SHMS-ve me dijeni dhe pa dijeni, brenda grupeve të mshefta dhe grupeve publike politike, për lirinë e Kosovës, nuk do të ishte e mundur që SHMS-të të kryejnë veprime të tilla. Disa informata në lidhje me infiltrimin brenda grupeve të mshefta politike kanë dalë në publik, mirëpo nuk janë të vërtetuara nga institucionet e Kosovës.

Pohimi se SHMS-të kanë kryer veprime brenda strukturave të UÇK-së, për zhvlerësimin deri në shkatërrim të vlerave të UÇK-së dhe të luftës së saj rrjedh nga besueshmëria se ka patur infiltrime. Besueshmëria se ka patur infiltrime të spiunëve zyrtarë me betim dhe të bashkëpunëtorëve brenda grupeve të mshefta, arrihet nga paraqitjet në paragrafët më poshtë.

Në emisionin e një televizioni të Kosovës, u shpalos e dhëna që ishte e pavërtetuar, por që thotë: "5 nga 7 anëtarët e Kryesisë së LPK-së, kanë qenë spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve". Sigurisht se kjo informatë nuk është e mundur për rrethanat ekzistuese që të jetë e vërtetuar nga institucionet e Kosovës, mirëpo besueshmëria e kësaj të dhëne mund të vërtetohet me dëshmi.

Tani, se a kanë qenë saktësisht 5 nga 7 anëtarët e Kryesisë së LPK-së spiunë me betim, nuk është shumë me rëndësi. E rëndësishme është të dihet se a ka patur prani të SHMS-ve brenda Kryesisë së LPK-së, dhe nëse po, çfarë kanë qenë përmasat e pranisë. Prania e mjaftueshme për të patur nën kontroll veprimet e Kryesisë së LPK-së, nënkupton se është prani e mjaftushme për të patur nën kontroll të gjitha zhvillimet që kanë qenë nën kontroll të Kryesisë së LPK-së. Se SHMS-të kanë patur prani të mjaftueshme brenda Kryesisë së LPK-së, për të mbajtur nën kontroll të gjitha zhvillimet e kontrolluara nga organizata e LPK-së, është e besueshme për faktet e paraqitura në vijim:

1) Në një emision tjetër, të po të njëjtit televizion të Kosovës, u shpalos, se sipas një burimi të Këshillit të Evropës, SHMS-të gjatë kohës së luftës, kanë patur brenda strukturave të UÇK-së 140 spiunë të stërvitur, zyrtarë me betim. Në lidhje me këta 140 spiunë, nuk u shpalos se si dhe në çfarë

nivelesh kanë qenë të shpërndarë, mirëpo logjikisht nxirret përfundimi se kanë përfshi edhe vetë krerët udhëheqës të luftës. Koka është me rëndësi për SHMS-të dhe jo bishti. Nga koka kryhen punët dhe jo nga bishti.

Dëshmitë në paragrafët në vijim vërtetojnë se prania e SHMS-ve ka qenë mu në kokën e strukturave të UÇK-së, dhe nëse koka e UÇK-së ka qenë Kryesia e LPK-së, prania e SHMS-ve, ka qenë mu në Kryesinë e LPK-së.

2) Është dëshmuar se SHMS-të, kanë rehatuar mirë me pasuri dhe pozita publike të gjithë spiunët zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorët e tyre, sidomos bashkëpunëtorët me dijeni. Nga anëtarët e Kryesisë së LPK-së, shumica (kush më shumë e kush më pak) janë rehatuar mirë me pasuri dhe pozita publike, kurse pakica janë përjashtuar plotësisht nga rehatimi, as nuk kanë krijuar pasuri dhe as nuk mbajnë pozita publike, janë hedhur sikur lecka.

3) Dëshmi tjetër për vërtetimin e besueshmërisë, është se të gjitha grupet e mshefta politike, që nuk kanë qenë nën kontrollin e plotë të SHMS-ve, janë luftuar egërsisht dhe janë shkatërruar me format nga më të ndryshme, siç janë burgosjet, persekutimet e deri tek eliminimet fizike përmes vrasjes. Kjo Kryesi e LPK-së, si grup i msheftë politik, nuk është shkatërruar, janë menjanuar dhe lënë jashtë çdo kyçje në ndërtimin e institucionve të Kosovës, anëtarët që nuk kanë qenë spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë të SHMS-ve dhe janë shpërblyer me pasuri dhe pozita shoqërore të gjithë të tjerët, kush më shumë e kush më pak. Menjanimet nuk janë kryer para luftës së fundit por mëpastaj, nuk ka patur nevojë nga fakti se organizata ka qenë plotësisht nën kontroll.

4) Dëshmi tjetër për vërtetimin e besueshmërisë se SHMS-të, kanë patur prani brenda Kryesisë së LPK-së, mjaftueshëm për të patur nën kontroll këtë organizatë, janë të gjitha zhvillimet e pasluftës, që kanë qenë të drejtuara dhe të kontrolluara nga individët, anëtarë të Kryesisë së LPK-së. Individët që kanë qenë anëtarë të Kryesisë së LPK-së dhe që nuk janë përjashtuar plotësisht nga rehatimi me të mira materiale e mirëqenie, sot kudo mbajnë poste të larta publike, janë drejtuesit kryesorë të shtetit dhe të institucioneve të shtetit.

Si drejtues të shtetit dhe të institucioneve të shtetit, kanë ndërtuar dhe mirëmbajnë në funksion të gjitha sistemet në Kosovë, që sigurojnë zbatimin e politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovë. Këta

individë, së bashku me individët tjerë nga grupet tjera politike të mshefta e publike që kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë spiunë me betim a bashkëpunëtorë të SHMS-ve, tani janë duke mirëmbajtur në funksion sistemin e neokolonializmit, sistemin e moszbatimit të ligjit dhe të gjitha sistemet tjera të ndërtuara nga SHMS-të, siç janë paraqitur në këtë libër.

Përveç dëshmive të paraqitura sipër në paragrafët 1 – 4, bësimi se SHMS-të kanë patur prani të mjaftueshme brenda Kryesisë së LPK-së, për të mbajtur në kontroll çdo veprim dhe veprimtarinë e tyre politike si tërësi, përforcohet edhe me njohuritë që autori ka fituar nga një shok i tij, i cili para disa viteve kishte punuar për një kohë për Këshillin e Evropës, Zyra e Kosovës. Gjatë punës këtu, ky individ mëson nga një i punësuar i Këshillit të Evropës, i cili vetë deklarohet si pjesëtar i shërbimeve të mshefta, të njërit nga shtetet mike perëndimore, se kur gjoja vritet Komandanti Çeçen, pas kryerjes së aktit terrorist të vrasjes së mbi 400 civilëve të pafajshëm në Moskë, Këshilli i Evropës kërkon që të shihet trupi i tij. Autoritetet ruse nuk pranojnë të tregojnë trupin e tij. Pas kësaj, kuptohet se 5 nga komandantët kryesorë çeçenë, nuk dihet se ku janë dhe ku jetojnë.

Përveç që pohimi, se ka patur infiltrime të SHMS-ve në radhët e UÇK-së, përfshi vetë kreun e UÇK-së, po del i bazuar, ky pohim po është edhe i qëndrushëm. Atëherë, po është e kuptueshme se këta të infiltruar, kanë kryer detyrat që kanë marrë nga SHMS-të, detyra që kanë patur të bëjnë me zhvlerësimin deri në shkatërrim, të vlerave të UÇK-së dhe të luftës së saj.

Gjithashtu, meqë pohimi rreth infiltrimit është i qëndrueshëm, nuk është gabim të përfundohet se të gjitha veprimet që janë kryer gjatë luftës dhe pasluftës dhe që kanë qenë dëmtuese për vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj, kanë buruar nga SHMS-të dhe se janë kryer përmes spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.
Nëse merret si e qëndrueshme e dhëna se gjatë luftës, SHMS-të kanë patur 140 spiunë zyrtarë me betim, brenda UÇK-së, këta kanë patur edhe numër të madh të bashkëpunëtorëve të tyre, ku gjithsesi shumica prej këtyre nuk kanë ditur as kanë patur ide se janë bashkëpunëtorë të SHMS-ve. Sikurse spiunët zyrtarë me betim, edhe bashkëpunëtorët kanë qenë të shpërndarë nëpër gjithë strukturën e UÇK-së, përfshi kreun udhëheqës të UÇK-së. Pjesëmarrja e SHMS-ve brendpërbrenda UÇK-së, me një nivel të tillë, si dhe dëshmia se SHMS-të rekrutojnë lakmitarë në radhët e veta, e bën të kuptueshme që programet e SHMS-ve për UÇK-në, të kenë patur mundësinë që të zbatohen pa ndonjë vështirësi.

Siç u shtjellua në paragrafët paraprakë, Serbia ka patur të gjitha mjetet dhe mundësitë që të realizojë programet e veta kundër vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj. Për të mundësuar mbrojtjen e vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, është e vlefshme që të kuptohet sa më shumë se çka mund të përmbajnë programet e Serbisë për UÇK-në, dhe si i realizon Serbia këto programe.

Programet e Serbisë për UÇK-në, është e pritshme të përmbajnë të gjitha llojet e veprimeve të mundshme që do të zhvlerësonin vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj deri në shkatërrim. Niveli më i lartë i dëmtimit të vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, do të ishte sikur UÇK të kuptohej si një grup njerëzish kriminalë, me një fjalë si një grup kriminal që nuk lë gjë pa bërë. Lexuesi mund të shohë një lidhje në mes të synimit të programeve të Serbisë për UÇK-në dhe burgosjes së disa ish- krerëve të UÇK-së.

Lidhja e synimeve të Serbisë rreth UÇK-së dhe burgosjes së ish-krerëve të UÇK-së, është dëshmi e angazhimeve të Serbisë përmes SHMS-ve në kryerje të veprimeve konkrete për implikim të këtyre krerëve të UÇK-së.

Shtrohet pyetja, pse pikërisht krerët e UÇK-së janë gjendur si të akuzuar?

Për ta shpallur UÇK-në si grup kriminal, është dashur që krerët gjithsesi të jenë të përfshirë në vepra kriminale dhe jo vetëm nivelet tjera, nuk do të arrihej qëllimi.

Shtrohet pyetja tjetër, po si u bë që mu krerët të jenë të përfshirë në veprime kriminale?

Pikënisja e SHMS-ve, në përzgjedhjen e individëve për spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë të tyre (qoftë edhe të bashkëpunëtorëve pa dijeni), është lakmia. Këta krerë që janë përfshirë në veprime kriminale, së paku kanë plotësuar këtë kriter, përndryshe nuk do të përzgjidheshin për të kryer këto veprime.

Krerë të UÇK-së dhe gjithashtu spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë të SHMS-ve?!

Po, gjithsesi. Sigurisht se shumica e këtyre krerëve të UÇK-së, nuk kanë qenë bashkëpunëtorë të SHMS-ve, që e kanë patur dijeni se janë bashkëpunëtorë . Fakti se kanë kryer vepra kriminale që kanë qenë pjesë e programeve të Serbisë për UÇK-në, i ka shndërruar këta veprues në së paku bashkëpunëtorë pa dijeni të SHMS-ve, i kanë kryer argatin SHMS-ve. Një thënie popullore thotë: "me qëllim pa qëllim, synin ma qorrove".

Veprimet e SHMS-ve kundër vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, kanë vazhduar pas luftës, përmes gjendjes së krijuar nga ndarja e grupeve politike në dy blloqe, siç u shtjellua në paragrafët paraprakë. Kjo ndarje, e fuqizuar me veprime propaganduese të fuqishme, krijoi militantë dhe gjendje me tensione shumë të larta. Gjendja e tensionuar është gjendje e përkyer për veprime të pamenduara nga të dy blloqet. Kur veprimet kryhen me logjikën militante, është gjendje e përkyer për veprime joracionale, që shumëherë janë veprime krejt budallaqe.

Veprime militanteske ka patur nga grupet politike të të dy blloqeve politke njëjtë. Me fjalë tjera, veprime budallaqe, njëjtë ka patur nga grupet politike të të dy blloqeve. Secili veprim joracional rreth vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, sigurisht se ka qenë dëmtuese për vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj.

Meqë të gjitha shenjat janë se SHMS-të kanë patur në radhët e veta spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë në nivel të krerëve të dy grupeve politike, prijëse të blloqeve edhe ndarja në blloqe edhe tensionimi edhe veprimet joracionale, janë inicuar dhe janë kontrolluar përmes këtyre spiunëve dhe bashkëpunëtorëve.

Militantizmi zakonisht ndërtohet nga krerët politikë, për të krijuar masë njerëzore, që me mundin, me sakrificën dhe nganjëherë edhe me gjakun e tyre, t'i realizojnë synimet e veta politike.

Me fjalë të thjeshta, krerët politikë i shfrytëzojnë veprimet e militantëve në dobi të tyre, për arritjën e synimeve të tyre. Nëse merret si i qëndrueshëm pohimi se SHMS-të kanë infiltruar spiunë dhe bashkëpunëtorë në vetë kreun e grupeve politike prijëse të të dy blloqeve, atëherë, mundi, sakrifica dhe nganjëherë edhe gjaku i militantëve është shfrytëzuar në dobi të SHMS-ve, në realizimin e programeve të tyre për UÇK-në.

Përzierja dhe mbështjellja e veprimeve militanteske nga të dy blloqet, e luftës dhe "luftës" si dhe e mbrojtjes dhe "mbrojtjes ", ka ushqyer edhe më tepër militantizmin, e ka trashë atë, dhe me këtë ka siguruar fuqizimin në këto pozita të krerëve të këtyre grupeve politike dhe me këtë ka siguruar mbajtjen e mëtejme të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, në kreun e këtyre grupeve politike, dhe me të gjitha këto, ka siguruar realizimin e synimeve të programeve të Serbisë për UÇK-në.

Dallimet natyrore në mes të dy drejtimeve politike, siç u shtjellua më sipër, me ndërhyrjen e SHMS-ve, u shndërruan në dallime artificiale, përmes

përzierjes dhe mbështjelljes së sulmuesve dhe "sulmuesve" në njërën anë dhe mbrojtësve dhe "mbrojtësve" në anën tjetër. Njohja dhe kuptimi i drejtë i sulmuesve dhe mbrojtësve, por edhe i "sulmuesve" dhe "mbrojtësve" është mbrojtje e vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, është mbrojtje e vlerave kombëtare, është mbrojtje e pasurisë kombëtare.

Sulmues të vërtetë kundër vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj janë SHMS-të, përmes veprimeve të tyre dhe mbrojtës i vërtetë i këtyre vlerave është populli, përmes institucioneve të veta (kuptohet kur institucionet mungojnë ose nuk funksionojnë, janë bijtë/bijat e popullit që dalin mbrojtës). Tek mbrojtja e vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj nga populli, fatkeqësisht pak është punuar deri tani, kjo në mungesë të mbrojtjes institucionale.

Fillimisht, SHMS-të për të siguruar dhe realizuar mirë përzierjen dhe mbështjelljen, krijuan ndarjen në blloqe, siç u shtjellua në paragrafët paraprakë, ku këto blloqe ishin artificiale, për arsyet në vijim:

Nuk ka patur dhe nuk ka grup politik e lëre më bllok politik, që sulmon vlerat e kombit të vet, pasuritë e popullit të vet. Ka patur dhe ka individë që sulmojnë këto vlera dhe këto pasuri dhe se këta kanë qenë spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve, brenda këtyre grupeve politike. Po ashtu, ende nuk ka patur dhe nuk ka grup politik, që ka qenë mbrojtës i mirëfilltë i vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj. Mbrojtja e vlerave të luftës nga blloku "mbrojtës" në të vërtetë është përdorur për dy qëllime:

i) fuqizimi i individëve të përzgjedhur brenda këtij blloku përmes përvetësimit të vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj dhe
ii) mashtrimi i shoqërisë për kinse mbrojtje të vlerave, mashtrim i cili tashmë ka dalur sheshazi.

Vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj, nuk mund të mbrohen nga vetëm një grup politik, ose nga vetëm disa grupe politike, ose edhe vetëm nga një bllok politik. Vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj, mund të mbrohen vetëm nga populli, përmes institucioneve të veta, mbrojtje kjo që ka munguar deri tani. Në fakt, në këto grupe politike ka patur më tepër individë që vetëm kanë proklamuar mbrojtjen e vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, ku me kësi lloj veprimesh kanë mbrojtur pozitat e veta si krerë udhëheqës.

Po që se merret si i qëndrueshëm pohimi, se në kreun e këtyre grupeve politike që kanë proklamuar mbrojtje të vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, ka patur spiunë a bashkëpunëtorë të SHMS-ve, në të vërtetë kjo lloj mbrojtjeje ka qenë mbrojtje e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre në

kreun e këtyre grupeve politike. Me këtë, në të vërtetë, në këtë mënyrë, këta kanë qenë "mbrojtës" të vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj.

Mbrojtës të vërtetë i vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj, mund të jetë vetëm populli përmes institucioneve të veta, mbrojtje e cila ka munguar deri tani. Në këtë mënyrë, nuk ka patur bllok sulmues dhe as grupe politike sulmuese, në të vërtetë ka qenë bllok "sulmues" dhe kanë qenë grupe politike "sulmuese" të vlerave të UÇK-së dhe luftës së saj. Ky bllok dhe këto grupe politike nuk kanë qenë sulmuese por kanë qenë "sulmuese", nga fakti se individët spiunë a bashkëpunëtorë të SHMS-ve, kanë qenë sulmues të vërtetë. Nuk ka patur dhe nuk ka grup politik e lëre më bllok politik, që sulmon vlerat e kombit të vet.

Për të mbrojtur vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj, është e nevojshme që të kuptohet mirë se çka në të vërtetë janë vlerat e UÇK-së dhe luftës së saj. Në bazë të të dhënave preliminare të Komisionit Qeveritar për përcaktimin e numrit të ushtarëve të UÇK-së, pritet që ky numër të jetë mbi 15.000.

Deri më tani, nga institucionet e drejtësisë, janë ngritur disa padi kundër ish-luftëtarëve të UÇK-së dhe pothuajse asnjë akuzë nuk është vërtetuar. Po që se numri i ish-luftëtarëve të UÇK-së, që u ngritet aktakuzë dhe që u vërtetohet akuza është 150, shprehur me përqindje do të ishte më pak se 1% e numrit gjithsej të ish-ushtarëve të UÇK-së. Askush nuk pret që numri i atyre që mund t'u vërtetohet akuza të jetë 150, gjithsesi ky numër pritet të jetë shumë më i vogël. Vetëm atyre që u vërtetohet akuza mund të themi se kanë kryer veprime kriminale, të gjithë ish-luftëtarët tjerë kanë qenë të pastër.Qysh tani, lirisht mund të themi se mbi 99% e ish-luftëtarëve të UÇK-së, janë të pastër si loti dhe se kanë bërë luftë të drejtë çlirimtare për lirinë e Kosovës.

Pyetje e thjeshtë, a janë vlera të UÇK-së dhe luftës së saj mbi 99% e pjesëtarëve, a janë më pak se 1% e pjesëtarëve?

Sigurisht se më pak se 1% e pjesëtarëve nuk përbën vlerën e UÇK-së.

Po, të akuzuar janë edhe ish-krerë të UÇK-së?

Të gjithë ish-krerët e UÇK-së që mund t'u ngritet dhe mund t'u vërtetohet aktakuza, nuk përbëjnë shumicën e ish-kreut të UÇK-së. Shumica i ish-krerëve të UÇK-së, do të dalin të pastër si loti në veprimet e tyre luftarake, për lirinë e Kosovës. Në këtë mënyrë, kur shumica e krerëve të UÇK-së janë të pastër, vlerat e UÇK-së dhe të luftës së saj janë të pastra.

Për shumëkë është vështirë e besueshme dhe edhe më e vështirë e besueshme që një individ të ketë qenë komandant dhe kreu i UÇK-së dhe në të njëjtën kohë të ketë kryer krime.

Shtrohet pyetja: kush i caktoi individët si komandantë?

Këta individë të caktuar si komandantë të UÇK-së, në të vërtetë kanë qenë. ose do të duhej të kishin qenë, të besuarit e popullit, të besuarit e një populli shumë të vuajtur, do të duhej të kenë ruajtur besimin e popullit si sytë e ballit dhe në asnjë rrethanë të mos e keqpërdorin besimin e popullit.

Nëse në fillet e luftës, komandantët janë emëruar nga krerë të grupeve politike, ku në vetë kreun e këtyre grupeve politike ka patur spiunë me betim të SHMS-ve, atëherë është e pritshme që komandantët të jenë emëruar me preferenca të ndikuara nga spiunët me betim të SHMS-ve. Nëse spiunët me betim, në cilëndo formë, kanë patur kontrollin e këtyre grupeve politike edhe emërimi i komandantëve nga këto grupe politike ka qenë i kontrolluar nga spiunët me betim të SHMS-ve.

VEPRIMET E SHMS-VE NË VEPRIMTARINË BIZNESORE

Veprimtaria biznesore është një terren shumë tërheqës për veprimet e SHMS-ve, për shumë arsye. Kriteri themelor në përzgjedhjen e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve, është lakmia, pra personat që janë lakmitarë. Pasuria dhe prona, janë karrem i përshtatshëm për tërheqjen dhe rekrutimin e lakmitarëve, në veprimtarinë e SHMS-ve.

Veprimtaria biznesore është e përshtatshme edhe për faktin se është vendi i përshtatshëm për legalizimin e pasurive të përfituara përmes shkeljeve ligjore, siç janë hajnia e parasë publike, trafiqet e ndryshme, pastrimi i parasë, etj. Posaçërisht, SHMS-të janë të interesuara për të shtrirë veprimet e veta në veprimtarinë biznesore, për të kontrolluar dhe drejtuar zhvillimet e biznesit në atë mënyrë që të pengojë zhvillimin dhe rritjen e bizneseve të rregullta dhe të mirëfillta përmes fuqizimit të bizneseve të lidhura me veprimtari joligjore të formave të ndryshme.

Strohet pyetja, a ka prani të spiunëve zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve në veprimtarinë biznesore?

Sigurisht se ka shtrirje të veprimtarisë së tyre në veprimtarinë biznesore. Një fushë e plleshme, siç është veprimtaria biznesore, për veprime të SHMS-ve përmes të cilave mundësohet ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e funksionimit të shumë sistemeve tjera nuk ka gjasa që të jetë pa prani të veprimtarisë së SHMS-ve, bile të veprimtarisë së fuqishme. Çështja mbetet që vetëm të dihet, se si dhe çfarë veprimesh dhe veprimtarie zhvillojnë SHMS-të, brenda veprimtarisë biznesore në Kosovë.

Mjedis i përshtatshëm për SHMS-të, për të shtrirë praninë e veprimeve të veta në veprimtarinë biznesore, është krijuar nga gjendja ekonomike e Kosovës menjëherë pas luftës së fundit. Mundësia e parë dhe më e madhe për tregtim të mallrave të nevojshme për Kosovën ishte në mënyrë absolute Serbia. Ky tregtim pothuajse absolutisht me Serbinë edhe u zhvillua në vitet e para të pasluftës.

Autori, në përfundim të luftës së fundit, ka parashtruar pyetje të njëjtë tek 5-6 persona që kanë qenë të përfshirë në veprimtari biznesore paraluftës së fundit dhe ka marrë përgjigje të njëjtë nga të gjithë këta persona. Pyetja ka qenë: personat që janë marrë me veprimtari biznesore edhe para luftës dhe se me përfundimin e luftës kanë mbajtur qëndrim se tani kemi shtetin tonë dhe se tani duhet të punohet duke zbatuar ligjet e Kosovës, a janë ende duke zhvilluar veprimtari biznesore. Përgjigjja ishte se të gjithë këta individë, ose janë krejt jashtë veprimtarisë biznesore, ose janë para bankrotimit dhe daljes nga veprimtaria biznesore.

Pothuajse të gjithë personat që kanë filluar tregtimin pasluftës së fundit, kanë zhvilluar të njëjtën veprimtari edhe para luftës. Të gjithë këta persona para lufte është dashur të dëshmojnë besim dhe besnikëri në shtetin e Serbisë, përndryshe nuk kanë mundur të sjellin mallra nga Serbia. Personat që kanë besuar në shtetin e Kosovës dhe në zbatimin e ligjeve të Kosovës pas lufte, ose kanë mbijetuar me vështirësi, ose nuk kanë mundur të mbijetojnë në zhvillimin e veprimtarisë biznesore. Kjo mënyrë e të bërit biznes në Kosovë, është dëshmi e fuqisë së kontrollit të SHMS-ve mbi veprimtarinë biznesore. Individët që kanë besuar në zbatimin e ligjeve të Kosovës, kanë luhatur besimin ndaj shtetit të Serbisë dhe për këtë arsye SHMS-të kanë goditur deri në shuarje veprimtaritë e tyre biznesore.

Futja nën kontroll e veprimtarisë biznesore nga SHMS-të, menjëherë pas luftës së fundit, ka mundësuar që ky kontroll të vazhdohet deri në ditët e sotme. Kontrolli mbi veprimtarinë biznesore i kombinuar me shtrirjen e pranisë së gjerë në institucionet e Kosovës, ka mundësuar dhe vazhdon t'u mundësojë SHMS-ve ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha

sistemeve tjera të tyre, të cilat kanë marrë për detyrë t'i ndërtojnë, t'i mbajnë në funksion dhe të mirëmbajnë funksionimin e tyre. Kjo dëshmohet me mirëfunksionimin e sistemeve të imponuara të vlerave në Kosovë, me mirëfunksionimin e sistemit të moszbatimit të ligjit, me mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të mbitokës nga nëntoka, etj.

Prania e gjatë mbi 100 vjeçare dhe shtrirja e pranisë me 720 spiunë zyrtarë me betim, përfshi oponentë nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, e veprimtarisë së SHMS-ve, shkakton nevojën që t'i kushtohet vëmendje shumë e theksuar, në zhvillimin e secilës fushëveprimtarie në Kosovë. Në këtë fazë të zhvillimit ekonomik dhe të veprimtarisë biznesore, meqë është ende e brishtë, është me rëndësi t'u kushtohet vëmendje e duhur vlerave biznesore që janë duke u zhvilluar.

Nuk janë vlera të njëjta biznesore ato që kanë besim në shtetin e Kosovës dhe në zbatimin e ligjeve të Kosovës me ato vlera biznesore që nuk kanë besim në shtetin e Kosovës dhe në zbatimin e ligjeve të Kosovës. Sigurisht se kur në Kosovë, shumica absolute e bizneseve dëshmojnë besim në shtetin e Kosovës dhe në zbatimin e ligjeve të Kosovës, zhvillimi ekonomik dhe biznesor i Kosovës do të jetë shumë më i fuqishëm sesa kur kemi gjendjen e kundërt.

FUQIZIMI I HAJNISË MASIVE

Thënia e gjyshit të autorit, Milazim Qerim Mehaj: **"Ai që vjedh shpinë e vet, shpi nuk mun me ba"**

Qytetarët e zakonshëm kujtojnë kohën e para Millosheviqit, e kujtojnë edhe kohën e Millosheviqit dhe e dijnë se edhe në ato regjime ka patur hajni të parasë dhe pronës publike, ose pronës shoqërore, siç njihej atëherë. Vjedhja e parasë publike para luftës së fundit ka qenë në përmasa shumë të vogla. Hajnia e paraluftës është kryer më së shumti nga një grup i vogël i individëve, të cilët në fund kanë patur mbrojtjen e vetë shtetit nga ndjekjet dhe dënimet. Ka patur edhe individë që për nga natyra kanë patur prirje dhe shkathtësi për të vjedhur dhe kanë vjedhur. Të gjithë këta hajna, së bashku, nuk kanë qenë edhe aq të shumtë, kurse shumica absolute njerëzve nuk kanë guxuar as të mendojnë për hajni të parasë dhe pronës publike.

Hajnia e instaluar pas luftës së fundit, ka shtrirje dhe përmbajtje krejt tjetër, nga hajnia e paraluftës. E para që i bie në sy qytetarit të zakonshëm është se vjedhja e parasë publike është masive, shtrirja është shumë e gjerë dhe përfshinë nga individët, nga pastruesit deri tek drejtorët e niveleve më të larta, nga portirët e shoferët deri tek ministrat e kryeministrat. Me një fjalë, sipas të gjithë parametrave, hajnia është masive.

Në lidhje me këtë hajni masive shtrohen disa pyetje:

- Kush e krijoi këtë hajni kësisoji, a e ka krijuar Zoti këtë hajni, a është krijuar nga njerëzit?

  Sigurisht se e kanë krijuar njerëzit.

- Nëse këtë hajni masive e kanë krijuar njerëzit, kush janë këta njerëz?

  Këta njerëz, janë njerëzit tanë, pjesëtarë të shoqërisë sonë (edhe hajnat janë pjesë e shoqërisë). Fakti se në hajni janë të përfshirë edhe krerët e institucioneve, dëshmon se në hajni janë të përfshirë nga shefat më të lartë e deri poshtë, d.m.th. hajnat paskan shefa e këta shefa janë vetë krerët e institucioneve. Shefat e institucioneve janë edhe shefa hajna, sepse po të mos ishte shefi hajn, shumë pak individë nën kontrollin e shefit që nuk vjedh do të mund dhe do të guxonin të mendonin për vjedhjen.

- Nëse shefat e institucioneve të Kosovës janë edhe shefa hajna, kush i bëri këta individë shefa? A i ka votuar populli?

  Praktika dëshmon se populli i ka votuar dhe u ka dhënë besimin për të mbrojtur dhe përparuar paranë dhe pasurinë e popullit, mirëpo këta individë janë duke e përdorur keqazi besimin e popullit për vjedhjen dhe shkatërrimin e pasurisë publike, paranë dhe pasurinë e popullit.

- Po si është e mundur që jo një ose disa individë, por masivisht ata që marrin besimin e popullit për ta ruajtur dhe përparuar pasurinë e popullit, ta shkatërrojnë atë?

  Këta individë si të vetëm nuk mund të krijojnë gjendje të hajnisë masive. Për të krijuar hajni massive, duhet një organizim masiv, d.m.th. organizatë ose shumë organizata masive. Nuk mjafton që organizimet të jenë vetëm masive, organizimet duhet të jenë të ndërtuara mirë, të jenë

shumëfunksionale, të mirëmbahet funksionimi i organizimit. përndryshe vjen dështimi i funksionimit.

- Nëse për një hajni masive po u dashka organizim masiv, kush mund të kryej organizime të tilla në Kosovë?

  Mendojmë se janë SHMS-të, ato organizime, që kryejnë me sukses veprimet e nevojshme për të ndërtuar hajni masive të parasë dhe pronës publike. SHMS-të kanë traditën mbi 100 vjeçare të veprimit në Kosovë dhe kanë shtrirje të pranisë me 70 batalione, në të gjitha institucionet e Kosovës, përfshi Qeverinë e Kosovës dhe Kuvendin e Kosovës.

Ndërtimi i hajnisë masive të parasë dhe pronës publike në Kosovë, duhet domosdo të jetë detyrë e SHMS-ve, për të arritur përmbushjen e synimeve dhe politikave të Serbisë në Kosovë. Përmes hajnisë masive, SHMS-të në njërën anë arrijnë të ndërtojnë shumë sisteme dhe vlera të cilat i kanë për detyrë t'i ndërtojnë dhe në anën tjetër, të shkatërrojnë shumë sisteme dhe vlera të cilat kanë për detyrë t'i shkatërrojnë. Fakti që hajnia është masive, dëshmon se këto veprime janë sistematike, d.m.th. janë sistem funksional që kanë sistemin përkatës të vlerave të hajnisë dhe bartësit konkretë të vlerave të hajnisë.

Secili organizim shoqëror, ka mënyrën e vet të funksionimit, që në përgjithësi është një tërësi funksionale e sistemeve dhe nënsistemeve. Funksionimi shoqëror ka ngjajshmëri me funksionimin e kompjutorëve, që kanë sistemet operative dhe sistemet aplikative. Tek kompjutorët, sistemet aplikative duhet t'u përshtaten sistemeve operative, siç janë Windows, Apple, etj., ku aplikacioni që funksionon në Apple nuk funksionon në Windows dhe anasjelltas.

Njëjtë tek organizimi shoqëror, nëse është vendosur sistemi operativ i vlerave të zbatimit të ligjit, nuk mund të funksionojë sistemi aplikativ i vlerave të hajnisë, sepse në këtë sistem operativ mund të funksionojë vetëm sistemi aplikativ i vlerave të johajnisë. Këtë mënyrë të funksionimit të këtyre vlerave dhe sistemeve e shohim dhe e përjetojmë në baza ditore ngado që shikohet ose veprohet. Pothuajse secili mund të shohë dhe përjetojë këtë mënyrë të funksionimit të vlerave dhe sistemeve të hajnisë në baza ditore ngado që shikon ose kudo që vepron.

FUQIZIMI I RRENËS DHE MASHTRIMIT NË KURRIZ TË SINQERITETIT DHE KORREKTËSISË

Thënia e gjyshit tim: **"rrena, hajnia dhe kurvnia shkojnë bashkë"**

Thuhet, qysh se ekziston njeriu, ekziston edhe hajnia dhe se kjo ka lindur së bashku me njeriun. **"Rrena, hajnia dhe kurvnia shkojnë bashkë"**, edhe këtu këto vlera shoqërore, njerëzore, po paraqiten të lidhura edhe pse janë të shtjelluara ndaras. Përveç rritjes masive të amoralitetit (kurvnisë, sipas gjyshit) dhe të rritjes masive të hajnisë, në periudhën e pasluftës janë rritur dhe fuqizuar shumë edhe rrena dhe mashtrimi. Sikurse prania masive e kurvënisë dhe prania masive e hajnisë, edhe prania masive e rrenës dhe mashtrimit, në periudhën e pasluftës nuk është rastësi.

Secili e di se rrena dhe mashtrimi ekzistojnë në shoqëri dhe se janë pjesë e vlerave shoqërore, njerëzore, pjesë e vlerave negative, dëmtuese të shoqërisë. Qytetari i zakonshëm, sidomos së paku këtyre 5-6 viteve të fundit, sigurisht ka patur rastin që të njohë nga afër individë që kanë qenë rrenca dhe mashtrues dhe ka përjetuar në jetën e vet rrena dhe mashtrime.

Masiviteti deri në absolutizëm, i rrenës dhe mashtrimit, për një periudhë prej më pak se 15 vjeçare, nuk ka mundur të arrijë këto nivele pa një veprimtari të organizuar mirë nga organizata të fuqishme, siç janë SHMS-të. Vetëm këto shërbime kanë strukturat organizative, kanë specializimet e duhura për ndërtime të tilla të dëshmuara në traditën mbi 100 vjeçare. Shtrirja e pranisë me 70 batalione edhe në institucionet e Kosovës, siç janë Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, bëjnë të mundur lehtësisht ndërtime të tilla në vlerat shoqërore, njerëzore, të Kosovës, siç janë masivizimi deri në absolutizëm i rrenës dhe mashtrimit.

Rrena dhe mashtrimi kanë ekzistuar në të kaluarën dhe do të ekzistojnë edhe në të ardhmen, por, nuk kanë qenë vlera sunduese në të kaluarën dhe nuk do të jenë vlera sunduese edhe në të ardhmen. Do të jenë vlera sunduese për aq kohë sa SHMS-të, të kenë fuqinë sunduese në Kosovë. Fuqizimi i rrenës dhe mashtrimit si vlera shoqërore, njerëzore, u mundëson këtyre shërbimeve që të krijojnë rezerva të çmuara të bartësve të vlerave të nevojshëme për funksionim të sistemeve dhe mekanizmave të ndërtuara në Kosovë, siç janë përshkruar në këtë publikim. Kur individët shlyhen nga karakteri i të qenët real dhe i të qenët i sinqertë dhe shndërrohen në specialistë të rrenës dhe mashtrimit, në të njëjtën kohë ndërtohen edhe në bartës të përshtatëshëm për

të gjitha vlerat dhe sistemet që SHMS-të, kanë marrë për detyrë t'i ndërtojnë, t'i funksionalizojnë dhe t'i mirëmbajnë në Kosovë.

FUQIZIMI I TRADHTISË NË KURRIZ TË BESNIKËRISË

Vlerat e rrenës dhe mashtrimit u shtjelluan në paragrafët paraprakë. Tradhtia është vlerë e të njëjtit trung të vlerave të rrenës dhe mashtrimit, është shkalla më e lartë e rrenës dhe mashtrimit në hierarkinë e poshtërsisë. Tradhtia është kulmi i rrenës dhe mashtrimit për arsye se tradhtia kryhet kur personat merren vesh ndërveti (me shkrim a me gojë) për të kryer veprime të caktuara, në besim dhe pastaj tradhtari vepron pas shpine ndryshe, nga çka është marrë vesh.

Edhe tradhtia ka ekzistuar qysh se ekziston njeriu dhe do të ekzistojë përderisa të ekzistojë njeriu. Të parët tanë, duke njohur ekzistimin e tradhtisë, si pjesë e vlerave shoqërore, meqë kanë njohur efektet shkatërruese për shoqërinë, kanë lartësuar besën, për të zvogëluar hapësirën për tradhti, sepse njëra i zë hapësirën tjetrës, përjashton tjetrën; nuk mundet që i njëjti individ edhe të jetë tradhtar edhe të jetë besnik. Lartësimi i besës, ka mbajtur gjallë dhe i ka mundësuar popullit shqiptar që të mbijetojë si shoqëri.

Meqë besa dhe besnikëria e forcojnë shoqërinë shqiptare, tradhtia e dobëson shoqërinë shqiptare deri në shkatërrim. Në bazë të kësaj, nuk është vështirë që të shihet se kush bën përpjekje për fuqizimin e besës dhe besnikërisë dhe kush bën përpjekje për fuqizimin e tradhtisë. Tradhtia ka ekzistuar edhe para lufte, mirëpo ka qenë në nivele shumë më të ulëta.
Tradhtia para lufte ka qenë më shumë e theksuar në veprimtarinë politike të msheftë dhe në grupet e mshefta politike, kurse në fushat tjera ka qenë diçka e rrallë. Paraqitja më e madhe e tradhtive në veprimtarinë e msheftë politike, sigurisht se ka ardhë nga fuqizimi i veprimeve tradhtuese të spiunëve zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, të futur brenda grupeve të fahehta politike. Fuqia vepruese e këtyre grupeve, ka qenë besimi në mes të anëtarëve të grupit dhe sigurisht kjo ka qenë arsye për të goditur besimin përmes veprimeve tradhtuese brenda grupit.

Lehtë mund të shihet se sot shoqëria e Kosovës ka ardhur në gjendjen që "të mos i besohet askujt" është diçka e domosdoshme për të jetuar. Kjo gjendje është pasqyrimi i drejtpërdrejtë i nivelit të veprimeve tradhtuese, të kryera masivisht.

Pavarësisht masivitetit të veprimeve tradhtuese të periudhës së pasluftës së fundit, shtrohet pyetja: a është normale që në një shoqëri, të mos i besohet askujt, për shkak të masivitetit të tradhtimeve?

Nëse në një shoqëri, askush nuk i beson askujt, ajo shoqëri do të përfundojë së ekzistuari.

Pse një shoqëri nuk mund të ekzistojë pa patur edhe vlerën e besimit?

Asnjë punë nuk mund të kryhet pa ekzistimin e një shkalle të besimit të ndërsjellë mes palëve. As në shtetet që kanë shkallë shumë të lartë të zbatimit të ligjit, kontrata nuk lidhet me dikë që nuk ekziston një shkallë e besimit të ndërsjelltë. Sidomos tek punët e mëdha, as nuk mund të mendohen pa ekzistuar edhe besimi i ndërsjellë mes palëve. Rregulli që vlen në lidhje me besimin dhe tradhtinë, është se çdoherë duhet t'i besohet dikujt, mirëpo asnjëherë nuk duhet t'i besohet personit të gabuar.

Vetë efektet shkatërruese të tradhtisë në shoqërinë e Kosovës dhe duke patur parasysh praninë e vperimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, me 70 batalione, të drejtojnë të menduarit se edhe veprimet tradhtuese janë pjesë e veprimeve të bashkëpunëtorëve të SHMS-ve në Kosovë. Veprimet tradhtuese plotësojnë mozaikun e veprimeve të tërësishme të bashkëpunëtorëve të SHMS-ve.

Duke fuqizuar tradhtinë, SHMS-të arrijnë që të shkatërrojnë besimin dhe duke shkatërruar besimin, eliminojnë kushtet për kryerjen e punëve (besimin e ndërsjellë) dhe atë sidomos të punëve të mëdha në Kosovë. Eliminimi i kushteve të kryerjes së punëve përmes eliminimit të besimit dhe sidomos kushteve për punë të mëdha, siguron se Kosova nuk mund të zhvillohet dhe fuqizohet, mënyrë kjo shumë efektive që të kryhet arritja e synimeve të politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën.

FUQIZIMI I PAPËRGJEGJËSISË NË KURRIZ TË PËRGJEGJËSISË

Edhe shtazët, në veprimet e veta shprehin një lloj përgjegjësie, mirëpo shtazët, për arsye të nivelit të ulët të zhvillimit të trurit të tyre, në raste të caktuara nuk arrijnë që të ndërmarrin veprime të përgjegjshme, dhe për këtë arsye edhe pësojnë. Përgjegjësia është një veçori që e bën njeriun të dallojë nga shtazët për arsye se truri i njeriut mundëson nivel më të lartë të përgjegjësisë, për veprimet e kryera. Mendja i mundëson njeriut që të vlerësojë se cilat veprime janë të dobishme për shoqërinë dhe sa janë të dobishme për shoqërinë. Mendja, poashtu i mundëson njeriut që të vlerësojë

se cilat veprime janë të dëmshme për shoqërinë dhe sa janë të dëmshme për shoqërinë.

Truri i shtazëve nuk u mundëson atyre nivelin e të menduarit dhe të vlerësuarit që njeriu e ka. Ky nivel më i lartë i të menduarit dhe i përgjegjësisë në veprimet e kryera i ka mundësuar njeriut që të ndërtojë jetën më të mirë, përmes vlerësimit të veprimeve të dëmshme dhe veprimeve të dobishme për shoqërinë. Ky nivel më i lartë i të menduarit dhe i përgjegjësisë në veprimet e kryera i ka mundësuar njeriut që të ndërtojë jo vetëm jetën e tanishme më të mirë, por të ndërtojë edhe jetën e së ardhmes, dhe përgjithësisht të ardhmen e tij.

Njeriu nuk mundet që në një veprim të kryer, të ketë edhe veprimin e përgjegjëshëm edhe veprimin e papërgjegjëshëm. Veprimi është një, ose është veprim i përgjegjshëm, ose është veprim i papërgjegjshëm. Kur kryhet një veprim i papërgjegjshëm, eliminon mundësinë e kryerjes së veprimit të përgjegjshëm, i zë vendin, nuk ka hapësirë për veprimin e përgjegjshëm. Fuqizimi i veprimeve të papërgjegjshme, zë hapësirat dhe eliminon mundësinë e veprimeve të përgjegjshme, që në të njëjtën kohë është fuqizim i veprimeve të dëmshme për shoqërinë dhe eliminim i mundësive për veprime të dobishme për shoqërinë.

Veprime të papërgjegjshme ka patur edhe para luftës së fundit, mirëpo rritja e këtyre veprimeve deri në masivitet ka ndodhur vetëm në periudhën e pasluftës. Qytetari i zakonshëm, jo vetëm se i sheh dhe i njeh veprimet e papërgjegjshme, por edhe është i lodhur dhe i dëshpëruar nga veprimet e papërgjegjshme.

Veprimet e papërgjegjshme në Kosovë, në periudhën e pasluftës, janë shtrirë në të gjitha poret e jetës, mirëpo kjo shtrirje ka një renditje. Së pari ka filluar me zyrtarët e institucioneve të Kosovës, të krijuara menjëherë pas lufte, të jenë shumë të papërgjegjshëm. Kjo arsyetohej me atë se janë institucione të krijuara rishtaz dhe se UNMIK-u nuk ka të vendosura brendpërbrenda mekanizmat e duhur të kontrollit dhe të përgjegjësisë.

Pavarësisht se kompetencat barteshin në vazhdimësi deri në kulmimin e shpalljes së pavarësisë, në vitin 2008, dhe tërheqjes së mbikëqyrjes ndërkombëtare, veprimet e papërgjegjshme të zyrtarëve të institucioneve vetëm se rriteshin. Rritja e papërgjegjësisë në veprimet e kryera nga zyrtarët e institucioneve të Kosovës, i shndërroi institucionet e Kosovës në institucione të papërgjegjshme. Thënia popullore "rrushi e sheh rrushin e piqet" u vërtetua. Veprimet e papërgjegjshme u zgjëruan tek të gjithë, si:

veprimtaritë biznesore, veprimtaritë profesionale, etj., dhe edhe sjelljet në jetë private dhe jetën personale janë bërë përgjithësisht shumë të papërgjegjshme.

Marrë parasysh shtrirjen e pranisë së veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, të shtrirë edhe në Qeverinë e Kosovës edhe në Kuvendin e Kosovës, drejton të menduarit se edhe fuqizimi i papërgjegjësisë është pjesë'e veprimeve të spiunëve zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve. Kur vetëm një zyrtar i një institucioni nuk mbahet përgjegjës për veprimet e kryera, i gjithë institucioni humb funksionalitetin dhe efikasitetin. Kur masivisht zyrtarët e pothuaj të të gjitha institucioneve nuk mbahen përgjegjës për veprimet e kryera, atëherë institucionet masivisht janë jofunksionale dhe joefikase. Zënia e hapësirës për veprime të dobishme (veprime të përgjegjshme) nga kryerja e veprimeve të dëmshme (të papërgjegjshme), pamundëson zhvillimin dhe fuqizimin e shoqërisë Kosovare, gjë që është edhe synimi i politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën.

FUQIZIMI I IMPROVIZIMIT PROFESIONAL NË KURRIZ TË PROFESIONALIZMIT

Kalimi nga rendi shoqëror socialist, në rendin shoqëror të ekonomisë së tregut, në Kosovë, ka filluar qysh në vitet '80, me zbatimin e programit të njohur të Ante Markoviqit, në kohën e shtetit të Jugosllavisë. Mirëpo, në Kosovë ende nuk është kryer kalimi i plotë në rendin shoqëror të eknomisë së tregut. Deri në përfundim të luftës së fundit, rendi shoqëror i ekonomisë së tregut, u ndalua nga zbatimi i rendit shoqëror të kolonializmit brutal të Serbisë.

Pas përfundimit të luftës, filloi ndërtimi i rendit shoqëror të ekonomisë së tregut, por fatkeqësisht në mungesë të ndërtimit të sistemit të zbatimit të ligjit, rendi shoqëror i ekonomisë së tregut, u zëvendësua me rendin shoqëror të krimit të organizuar. Rendi shoqëror i ekonomisë së tregut do të funksionojë vetëm kur të kemi zbatim të plotë të ligjit në Kosovë. Profesioni dhe profesionalizmi mund të zhvillohen vetëm në rendin shoqëror të ekonomisë së tregut.

Profesionalizmi ka të bëjë me argumentin dhe argumentimin, ka të bëjë me realitetin, ka të bëjë me ndershmërinë, ka të bëjë me paanësinë e kështu me radhë.

Shtrohet pyetja: pse profesionalizmi mund të zhvillohet vetëm në rendin shoqëror të ekonomisë së tregut?

Elementet që u përmenden në fjalinë e parë të paragrafit sipër, mund të zhvillohen vetëm në mjedisin real, në mjedisin konkret, në mjedisin që si thotë populli "preket me dorë dhe shkelet me këmbë". Mjedisi i tillë ekziston vetëm në rendin shoqëror të ekonomisë së tregut. Kjo u dëshmua me përpjekjet për zhvillim të profesionalizmit në rendin shoqëror të socializmit, përpjekje që përfunduan me dështim dhe heqje dorë nga iluzionet e tilla të ndërtimit socialist. Mjedisi i rendit shoqëror socialist dështoi për faktin se ishte mjedis abstrakt, ishte mjedis joreal, e të ngjajshme, që në fund doli të ishte mjedis mashtrues, d.m.th. mjedis i pandershmërisë.

Edhe mjedisi i rendit shoqëror të krimit të organizuar nuk mund të zhvillojë profesionalizmin për faktin se është mjedis që fsheh realitetin, është mjedis që mashtron, d.m.th. është mjedis larg realitetit, mjedis që nuk duron faktin dhe faktimin. Në themel të mjedisit të rendit shoqëror të krimit të organizuar është pandershmëria. Përkundër mjedisit të rendit shoqëror të socializmit dhe rendit shoqëror të krimit të organizuar, mjedisi i rendit shoqëror të ekonomisë së tregut është mjedis real, mjedis konkret dhe jo mjedis abstrakt ose mjedis mashtrues, d.m.th. është mjedis që bazohet në faktin dhe kërkon faktimin. Në themel të rendit shoqëror të ekonomisë së tregut është ndershmëria. Ndershmëria është veçoria kryesore mbi të cilën ndërtohet profesionalizmi.

Se Kosova tani për tani është në rendin shoqëror të krimit të organizuar, vërtetohet nga të gjitha raportet e institucioneve ndërkombëtare që konsiderohen si institucione të pavaruara. Edhe në këtë publikim, në pjesët e shtjelluara deri këtu, janë paraqitur elementet kryesore mbi të cilat ndërtohet rendi shoqëror i krimit të organizuar.

Sistemi funksional dhe efektiv i moszbatimit të ligjit, sistemi funksional dhe efektiv i hajnisë masive, sistemi funksional dhe efektiv i kontrollit të mbitokës nga nëntoka, sistemi funksional dhe efektiv i rrenës, mashtrimit dhe tradhtisë, sistemi funksional dhe efektiv i papërgjegjshmërisë, si dhe sistemet funksionale dhe efektive të tjera të shtjelluara në këtë publikim, janë elementet dhe pjesët funksionale të rendit shoqëror të krimit të organizuar. Të gjitha sistemet funksionale që janë pjesë e rendit shoqëror të krimit të organizuar, në themel kanë pandershmërinë. Në rendin shoqëror që ka themel pandershmërinë, nuk ka hapësirë për profesionalizëm, për faktin se nuk ka hapësirë për ndershmërinë.

Shtrohet pyetja: çfarë veprimesh bëjnë që ndershmëria të mos ketë hapësirë?

Janë shumë veprime që bëjnë ndershmërinë të ketë ose të mos ketë hapësirë, mirëpo, meqë objekti i këtij publikimi nuk është shtjellimi i ndershmërisë, përqëndrimi do të jetë vetëm në disa nga veprimet që janë më veçuese për ndershmërinë:

- Rrena, mashtrimi, tradhtia

  Me qenë i ndershëm, nënkupton që të mos rrejsh asnjëherë dhe në asnjë rrethanë. Nuk mund të jesh rrenc, qoftë edhe vetëm një herë të rrejsh dhe të jesh i ndershëm. Me qenë i ndershëm nënkupton që të mos mashtrosh asnjëherë dhe në asnjë rrethanë. Nuk mund të jesh mashtrues, të mashtrosh qoftë edhe vetëm një herë dhe të jesh i ndershëm. Me qenë i ndershëm nënkupton që të mos tradhtosh asnjëherë dhe në asnjë rrethanë. Nuk mund të jesh tradhtar, qoftë edhe vetëm një herë të tradhtosh, dhe të jesh i ndershëm.

- Hajnia

  Sigurisht është e kuptueshme për secilin se edhe të vjedhësh edhe të jesh i ndershëm, nuk është e mundur!

- Shkelja e ligjit

  Ligjet e shtetit janë rregullat shtëpiake, ose rregullat familjare për shtëpinë e Kosovës, ose për familjen e Kosovës. Nuk mund të jetë i ndershëm dikush që nuk u përmbahet rregullave të familjes, ose rregullave të shtëpisë.

- Përdorimi i punës publike për interesa personale
  Në angazhimin, në secilën punë publike, roli dhe përgjegjësia janë të përshkruara edhe me ligje të cilat përgjithësisht kërkojnë që puna publike të kryhet në të mirë të qytetarit dhe në mënyrë të ndershme. Çdo trajtë e përdorimit të pozitës publike, e përdorimit të autoritetit publik, e përdorimit të ndikimit publik, etj. për interesa personale në dëm të interesit publik, është thyerje e ndershmërisë.

Veprimet, si: rrena, mashtrimi, tradhtia, hajnia, përdorimi i punës publike për interesa personale, si dhe veprimet tjera të ngjajshme të përshkruara, jo vetëm që janë fuqizuar shumë në periudhën e pasluftës së fundit, por janë

veprime me dominim masiv. Sigurisht se kësi lloj veprimesh kryhen njëjtë edhe në vetë lëmitë të cilat do të duhej të ishin profesionale.

Paradoksi: lëmi profesionale pa profesionistë! Si shpjegohet kjo?

Personat e kyçur në kryerjen e veprimeve të përshkruar në paragrafët më lart. dhe që kanë tituj profesionalë, në vend që të jenë profesionistë, në fakt janë improvizues profesionizmi. Nuk është e mundur që në një rend shoqëror të krimit të organizuar, të mbijetosh si profesionist, mund të mbijetosh vetëm duke qenë improvizues profesionizmi.

Improvizuesi i profesionizmit i ka shkathtësitë e kërkuara, që të paraqesë gjendjen që nga pamja e jashtme të duket sikur është punë profesionale, por që në brendi nuk është profesionale, sepse në brendi ka diçka që thyen së paku ndershmërinë (diçka nga veprimet e përshkruara në paragrafët më lart).

Rendi shoqëror i krimit të organizuar nuk duron ndershmërinë. Kuptohet se ka individë që do të duhej të ishin profesionistë, mirëpo janë të zhytur në veprimet që thyejnë ndershmërinë dhe thyejnë ligjin, veprime të cilat kësisoj shndërrohen në veprime kriminale dhe këta individë kësisoj shndërrohen në kriminelë.

Veprimet e nevojshmë për ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rendit shoqëror të krimit të organizuar, nuk kanë ndodhur dhe nuk janë duke ndodhur rastësisht. Këto veprime janë masive dhe janë sistematike dhe mund të kryhen vetëm nëse janë të organizuara, të kryera, dhe të mbikëqyrura nga struktura të organizuara. Këto veprime sistematike mund të kryhen vetëm si të organizuara, që për rrethanat e Kosovës mund të jenë vetëm SHMS-të.

Rendi shoqëror i krimit të organizuar funksional dhe efektiv, është pikërisht arritja e synimeve dhe politikave të Serbisë për Kosovën, për faktin se ky rend shoqëror mban Kosovën të pazhvilluar dhe të pafuqishme. Krijimi i kushteve të pamundësisë për zhvillim të profesionizmit përmes fuqizimit të rendit shoqëror të krimit të organizuar, mundëson arritjen e synimeve të politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën.

KRIJIMI DHE FUQIZIMI I KONFLIKTEVE DHE NGATËRRESAVE NDËRNJERËZORE SI METODË E VJETËR "PËRÇAJ E SUNDO"

Shumica e qytetarëve të zakonshëm, sigurisht se janë në dijeni të përdorimit nga SHMS-të, të konflikteve dhe ngatërresave ndërmjet individëve, me qëllim të arritjes së synimeve të tyre e që janë dëmtimi deri në shkatërrim i këtyre individëve dhe në këtë mënyrë edhe i shoqërisë si terësi. Kjo metodë është përdorur nga SHMS-të tepër shumë pas luftës së fundit. Lexuesi nga Kosova mund të hedh një vështrim në rrethinën e vet familjare e shoqërore dhe të vërtetojë këtë pohim.

Krijimi i konflikteve dhe prishja e marrëdhënieve ndërnjerëzore, pas luftës së fundit, zbatohet në të gjitha rastet e mundshme si: në mesin e kolegëve të punës, në mesin e anëtarëve të familjes dhe rrethit familjar, në mes të anëtarëve dhe aktivistëve të së njëjtës parti politike, në mesin e bizneseve, në mes të kolegëve profesionalë e akademikë, në mes të lagjeve dhe fshatrave, në mes të rajoneve, si Drenicë vs Llap, Drenicë vs Dukagjin, Dukagjin vs Anamoravë, etj.

Efekti më i madh i prishjes së marrëdhënieve ndërnjerëzore, siç është krijimi i konflikteve dhe ngatërresave, pas luftës së fundit është arritur në mes të grupeve politike. Fuqizimi i militantizmit brenda një grupi politik, ka krijuar kushte të përshtatshme për grumbullim dhe mobilizim të lartë të energjisë militanteske, në atë grup politik, energji e cila është përdorur pastaj për kundërvënie grupit tjetër politik. Në këtë gjendje të krijuar kësisoj, grupi politik rival gjithashtu ka fuqizur militantizmin e vet për përballje me militantizmin rival. Ky rivalitet i militantistëve është shndërruar në garë, dhe kjo garë ka fuqizuar mobilizim edhe më të lartë të militantëve. Gjendje e tillë tipike ka qenë edhe në Prishtinë pas zgjedhjeve të fundit, në vitin 2014, ku vetëm falë ndërhyrjes së forcave të KFOR-it është shmangur gjakderdhja e mundshme.

Krijimi dhe fuqizimi i konflikteve dhe ngatërresave, po dihet se bëhet për të dëmtuar individë të caktuar deri në shkatërrim. Vetëm inicimi i konflikteve dhe ngatërresave është problem, pasi të fillojë konflikti, rritja dhe fuqizimi ecën vetë, nganjëherë ndoshta me ndonjë "ndihmë" shtesë.

Puna më e mirë e SHMS-ve është kur të dy palët në konflikt janë cak i goditjeve për dëmtim. Secila palë në konflikt kurdo që godet palën tjetër, kryen një punë të vlefshme për SHMS-të. E bukura e krejt kësaj për SHMS-

të, është kur asnjëra palë në konflikt, nuk është në dijeni se po kryen punë për SHMS-të. Ka raste kur SHMS-të, në njërën anë vendosin palën që është cak për goditje dhe në anën tjetër vendosin ndonjë viktimë të rastësishme (nuk i dhimbset viktima SHMS-së). Viktima përzgjedhet dikush me prirje konfliktualiteti, që ndryshe nga të tjerët njihet si budallë, kuptohet ai nuk e njeh vetëvetën të tillë.

Në krijimin dhe fuqizimin e konflikteve dhe marrëdhënieve konfliktuoze, pas luftës së fundit, SHMS-të kanë shrytëzuar me të madhe interesat personale të individëve. Fillimi i zhvillimit të iniciativës së lirë, u shfrytëzua që të ndërhyhet dhe të devijojë ky zhvillim. Zhvillimi i iniciativës së lirë bëhet vetëm në kushtet e një konkurrence të drejtë. Ndërhyrjet e SHMS-ve në konkurrencën e drejtë, e kanë shndërruar konkurrencën në një lloj konfliktualiteti të vazhdueshëm, si një "luftë" që nuk zgjedh mjete.

Në mjedisin e shkallës së lartë të moszbatimit të ligjit që ekziston në Kosovë edhe vetvetiu krijohet konfliktualiteti. Kur kësaj i shtohen edhe favorizimet dhe shkeljet poshtë të individëve, të kryera nga veprimet e SHMS-ve, konfliktualiteti gjithsesi është shumë i fuqishëm. Sigurisht se në këto konfliktualitete fiton pala që në anën e saj ka veprimet mbështetëse të SHMS-ve dhe humb pala që është cak i veprimeve goditëse të SHMS-ve.

Në prishjen e marrëdhënieve ndërnjerëzore, peshë të theksuar kanë marrë prishja e marrëdhënieve familjare. Në marrëdhëniet familjare, më e theksuar ka qenë prishja deri në shkatërrim e martesave, por nuk kanë mbetur pa u prekur edhe marrëdhëniet në mes të vëllezërve, si dhe marrëdhëniet në mes të individëve, cak i goditjeve nga SHMS-të me rrethin e vet familjar dhe përgjithësisht farefisin.

Në prishjen e martesave, masivisht është përdorur sistemi i amoralitetit dhe kurvënisë. Amoraliteti dhe kurvënia janë fuqizuar me qëllim të prishjes deri në shkatërrin të gjithë shoqërisë Kosovare në përgjithësi, por, amoraliteti dhe kurvënia janë përdorur në mënyrë të posaçme ndaj individëve të veçantë që kanë qenë cak i goditjeve nga SHMS-të.

Futja e individëve në amoralitet dhe kurvëni, në shumë raste është bërë me mashtrime të drejtëpërdrejta të individëve të përzgjedhur nga SHMS-të, për goditje përmes spiunëve zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorëve me dijeni e pa dijeni. Këta spiunë dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve, kanë rrethuar individët, cak të sulmeve me lloj-lloj rrethanash, për një kohë, ku kanë krijuar mjedisin në të cilin individi cak i sulmit "ka rrëshqitë" në së paku një amoralitet a kurvëni. Pastaj, ky amoralitet a kurvëni është përdorur si

shantazh për amoralitete tjera, ose është përdorur si joshje për amoralitete tjera, "duke ngrënë të shtohet oreksi" është një thënie.

Model i njëjtë është zbatuar edhe në futjen e individëve në konflite personale deri në vrasje dhe në prishjen e raporteve ndërfamiljare si: në mes të vëllezërve, individit të përzgjedhur me të tjerët nga rrethi familjar e të ngjajshme. Spiunë dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve, kanë rrethuar individët, cak të këtyre sulmeve, me lloj-lloj rrethanash për një kohë, ku kanë krijuar mjedisin në të cilin individi cak i sulmit "ka rrëshqitë" dhe është bërë pjesë e valles sipas skenarit të SHMS-ve. Në këtë mënyrë janë përgatitur shumë vrasje, sepse në valle në mënyrë të njëjtë është futur edhe pala në anën tjetër.

Si rezultat i veprimtarisë së SHMS-ve, në amoralitet dhe kurvëni, sot këto dukuri janë masive dhe sidomos është vështirë të mund të gjejsh person publik, që përveç gruas ose burrit, të mos ketë edhe dashnor/dashnore dhe në shumë raste kjo të dihet edhe publikisht. Poashtu, shumë prej ish-komandantëve, ose kanë nga dy gra ose publikisht dihet se kanë dashnore dhe njëjtë është edhe me biznismenët e deri te profesorët universitarë. Secili mund të vërejë se numri i prishjes së martesave pas luftës së fundit, është shumë i lartë.

Fuqizimi i konflikteve dhe ngatërresave, përveç se dëmton palët e përfshira deri në shkatërrim, krijon edhe mjegullnajë si mjedis i përshtatshëm për kryerjen edhe të detyrave tjera të SHMS-ve. Mjegullnaja e krijuar, nuk i lë individët e zakonshëm që të shohin çështje dhe probleme të përbashkëta dhe në këtë mënyrë as problemet më madhore. Individi i rënduar me probleme personale, siç janë konfliktet dhe ngatërresat, as në mend nuk i bie dhe as që mund të shohë probleme tjera.

Niveli i konfliktualitetit në ditët e sotme shprehet me gjendjen e marrëdhënieve ndërnjerëzore që kemi. Secili dëgjon dikë duke thënë: "ka humb lezeti i bisedave". Edhe në biseda të zakonshme individët ruhen nga krijimi i konflikteve dhe në këtë mënyrë u shmangen takimeve dhe bisedave me shokët, familjarët, kolegët, etj.

Është e dhimbshme kur sheh se bashkëluftëtarët e Adem Jasharit, pas lufte në mes tyre nuk kanë marrëdhënie të mira, bashkëluftëtarët e UÇK-së që në luftë ishin bashkë në liri nuk kanë marrëdhënie të mira në mes të po të njëjtëve. Gjithashtu, marrëdhëniet familjare janë jo të mira, marrëdhëniet në mes të kolegëve ose bizneseve janë ballë-për-ballë e shumëherë fyt-më-fyt, sikur në një gjendje lufte. Po që se të gjithë të përmendurit në këtë paragraph, rishikojnë këto marrëdhënie me një nivel të lartë të racionalitetit dhe

arsyeshmërisë, sigurisht se do të shohin që këto marrëdhënie lehtë mund të jenë shumë më të mira.

KRIJIMI I FRONTEVE "NE DHE ATA"

Kryerja e veprimeve me shtrirje të gjerë, kërkon numër të madh të individëve. Për arsye të tilla, SHMS-të kanë përdorur metoda që mundësojnë mobilizim të gjerë, mobilizim që përfshinë numër të madh të individëve. Një nga metodat e përdorura për mobilizim të gjerë, ka qenë krijimi i fronteve "ne dhe ata", siç është shtjelluar në vazhdim.

Frontet "ne dhe ata" , janë krijuar në të gjitha rastet që ka patur mundësi për t'u përdorur. Themeli mbi të cilin janë krijuar këto fronte është "ngjyrimi" i palëve në front me diçka të përshtatshme dhe tërheqëse për mobilizim të individëve. Disa, por jo të vetmet, nga këso ngjyrime të përdorura janë: "i luftës", "i paqes", "pacifist", "i kuq", "LDK"," PDK", "AAK", "Vetëvendosje", "UÇK", "kundër UÇK", "thaçist", "rugovist" "titist", "enverist", "i egër", "i butë", "i drejtë", "problematik", "kokëfortë", "i pamarrur vesh", "i ligë", "ekstremist", "intelektual", "katunar", "zorraxhi", "komunist", "shpiun", "i rrezikshëm", "militant", "anarkist", si dhe ngjyrimet rajonale me një në nivel të gjerë: "drenicak", "llapjan", "dukagjinas" etj. dhe deri te ngjyrimet sipas fshatit ose lagjes përkatëse.

Kuptohet se të gjitha ngjyrimet e përdorura, kanë fshehur përmbajtjen reale të palës ndaj të cilës është përdorur ngjyrimi. Në fakt, të gjitha ngjyrimet e përdorura janë të bazuara në gjykime joracionale me qëllim të krijimit të paragjykimit. Mendimi joracional dhe paragjykues, ka mundësuar në njërën anë mobilizimin e individëve për veprim, në njërën palë të frontit dhe në anën tjetër ka ushqyer për mobilizim palën tjetër të frontit. Thënë me fjalë të tjera, ngjyrimi është njëjtë sikur tek qeni kur e ndërsen, i thua kape palën tjetër. Kur qentë janë të përgatitur përmes stërvitjes, menjëherë hedhën në sulm. Të gjitha frontet janë krijuar artificialisht, me qëllim të arritjes së synimeve dhe caqeve të politikave dhe programeve të SHMS-ve për Kosovë.

Ngjyrime të tilla janë përdorur me të madhe edhe gjatë kohës së komunizmit dhe të socializmit dhe se këto sisteme janë të ndërtuara shumë mbi themele të tilla. Fatkeqësisht, kësilloj ngjyrimesh janë përdorur dhe përdoren edhe pas luftës së fundit. Është për keqardhje gjetja e terrenit të përshtatshëm për "shitjen" e këtyre ngjyrimeve pas tërheqjes nga Kosova, të forcave të sigurisë dhe të administratës së Serbisë.

Frontet "ne dhe ata", më së shumti janë përdorur brenda partive politike si dhe brenda grupeve politke, përbrenda partisë politike. Ngjyrimet janë përdorur për fuqizimin e militantizmit politik. Kur SHMS-të kanë përdorur ngjyrimin, jo vetëm tek një, por tek të gjitha partitë politike dhe se me ketë ngjyrim jo vetëm se kanë mobilizuar militanitizmin por edhe kanë "ndërsyer" kundër palëve tjera, arritja e synimeve dhe caqeve të SHMS-të është e siguruar. Kur ideologjizimi dhe militanizmi janë fuqizuar shumë përmes ngjyrimeve, jo rrallë ka patur edhe vrasje dhe forma tjera të dhunës dhe gjakderdhjes në mes të palëve në front.

Derisa shtjellohen ngjyrimet dhe krijimet e fronteve, është me interes të bëhet e ditur se këtë lloj ushqimi po e shërbejnë edhe një pjesë e myslimanëve të njohur më herët si muxhahedinë, vehabistë etj. dhe emërime tjera të mëvonshme. Këto krijime janë të përmasave ndërkombëtare dhe kanë elemente me bazë jashtë Kosove, mirëpo është ushqim i njëjtë pa marrë parasysh se ku gatuhet. Në njërën anë të frontit janë vendosur "islamët" që gjoja janë të gjithë ata që besojnë në Zot dhe në anën tjetër janë "kafirët", të gjithë ata që nuk besojnë në Zot.

Islamizmi i shpjeguar nga grupet e paraqitura në paragrafin sipër, nuk ka lidhje me besimin islam, është ideologjizim i pastër. Si mund të jetë besim fetar ky islam që ofron shpjegime tjera nga ato të deritanishmet. Ky islam thotë se kushdo që beson në Zot (dhe pastaj shpjegojnë se cilin Zot, Zotin siç e shpjegojnë ata) është musliman, dhe të gjithë të tjerët janë kafirë. Sipas këtyre predikuesve, bëj çka të duash, kryej çfarëdo aktesh të liga, mjafton se je me Zotin që e shpjegojnë ata dhe je prapë mysliman. Në rrethinën ku ka jetuar autori, më përpara, hoxha i xhamisë ka thënë se kush kryen punë të liga si këtë, e këtë, e këtë, nuk ka vend në xhami, dhe jo rrallë ka ndodhur që hoxha i xhamisë të largojë dikë nga xhamia për këto arsye.

Shpjegime tjera të këtyre "myslimanëve" janë si:"Të gjithë muslimanët janë vëllezër"!?
Çfarë shpikje fantastiko-shkencore! Vëllezërit janë vetëm nga gjaku, nuk ka diku që të jenë vëllezër veç se besojnë njëjtë. Ne shqiptarët myslimanë, vëllezër i kemi katolikët dhe ortodoksët shqiptarë, nuk i kemi vëllezër myslimanët e pupujve tjerë.

Përveç fuqizimit të militantizmit, ngjyrimet kanë krijuar kushte të volitshme edhe në kryerjen e filtrimeve dhe infiltrimeve të individëve nëpër institucionet shtetërore, si dhe për shkeljen poshtë, të bartësve të vlerave shoqërore, njerëzore të dobishme për Kosovën.

Ngjyrimet janë përdorur kudo dhe kurdo që kanë mundur të përdoren, mirëpo këto ngjyrime kanë lehtësuar shumë punën e filtrimeve dhe infiltrimeve të individëve nëpër institucionet e shtetit. Kur vendosmëria e një individi si veti e dobishme ngjyroset dhe shitet si "kokëfortësi", që është veti e dëmshme, individi i tillë është e lehtë të largohet nga një post publik i lartë si individ i dëmshëm për institucionin. Po ashtu, kur një individ është kërkues për ndryshime pozitive dhe të dobishme për shoqërinë, ngjyroset si "ekstremist", është lehtë të degradohet dhe të largohet nga institucioni.

Për arritjen e qëllimeve të ngjajshme, janë ngjyrosur edhe vetitë tjera të dobishme me ngjyra të ndryshme si të padobishme ose të dëmshme si psh: urtësia është ngjyrosur si "i butë", parimësia, si "i drejtë", revolucionariteti, si "i rrezikshëm", mbajtësi i diciplinës, si "i egër", intelgjenti, si "intelektual" në njërën anë por edhe në anën tjetër personi me diplomë e pa dije është ngjyrosur si "intelektual", si dhe shumë ngjyrime tjera të ngjajshme që janë konsideruar të përshtatshme për rastin në të cilin është zbatuar ngjyrimi.

FUQIZIMI I LIDHJES SË INTERESAVE PERSONALE ME SHKELJE LIGJORE DHE KRIMINALITET

Veprimtaria e SHMS-ve pas luftës së fundit është fuqizuar në nivele kaq të larta deri në kontrollin e plotë të pasqyruar në formën e neokolonializmit, vetëm për faktin e mjedisit të përshtatshëm për ushtrimin e kësaj veprimtarie, e ky mjedis është niveli i ulët i zbatimit të ligjit. Fuqia e veprimtarisë së SHMS-ve është në proporcion me nivelin e zbatimit të ligjit: nivel i ulët i zbatimit të ligjit, fuqizim i lartë i veprimtarisë së SHMS-ve, dhe anasjelltas.

SHMS-të, me qëllim të arritjes së caqeve të tyre, kanë përdorur dhe përdorin shkeljet ligjore si themel mbi të cilin ndërtojnë dhe fuqizojnë funksionalizimin e plotë të sistemeve mbi këtë themel. Ndërtimi dhe funksionalizimi i sistemeve të cekura në pjesët tjera të këtij libri, është mundësuar përmes lidhjes së interesave personale me shkeljet ligjore.

Fillimisht, SHMS-të kanë mundësuar për individë të caktuar arritjen e disa fitimeve dhe dobive nga moszbatimi i ligjit. Këtu janë përzgjedhur lakmitarët, të etshmit për pasuri dhe mirëqenie personale. Pastaj, falë veprimeve tjera që kanë mundësuar shkelje të vazhdueshme ligjore në njërën anë dhe në anën tjetër sigurimin për mosdhënie përgjegjësi të këtyre individëve para ligjit, kanë lidhur interesat personale të këtyre individëve me

shkeljet ligjore dhe atë deri në kriminalitet të rëndë. Në vazhdim, SHMS-të vetëm kanë punuar që numri i këtyre individëve të rritet deri në masivitet dhe kjo është arritur në bazë të mundësisë për shkelje masive ligjore dhe mundësisë për sigurim masiv të mosdhënies përgjegjësi para ligjit.

Lidhja e interesave personale me shkeljet ligjore është fuqizuar aq shumë sa që tani kemi gjendjen ku të punësuarit në administratën publike nuk mund të kenë pozita të larta pa qenë të përfshirë në shkelje ligjore, bizneset nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me fiti pa shkelje ligjore, profesionistët nuk mund të arrijnë fuqi profesional pa u përfshirë në shkelje ligjore. Rezultat i kësaj veprimtarie janë raportet e organizatave të jashtme që japin raporte të shkallës së zbatimit të ligjit në Kosovë, të cilat për shumë vite rresht pasqyrojnë në vazhdimësi shkallë të lartë të moszbatimit të ligjit.

Masiviteti i shkeljes së ligjit dhe mosdhënia përgjegjësi para ligjit për kohë të gjatë, ka krijuar gjendjen e joshjes tek shumë persona për shkelje ligjore deri në shkallën ku tani gjerësisht besohet se nuk mund të punosh ose të prosperosh duke zbatuar ligjin, por duke kryer së paku ngapak shkelje ligjore. Kjo armatë e shkelësve të ligjit që janë duke vepruar sot, nuk janë të gjithë spiunë zyrtarë me betim ose bashkëpunëtorë me dijeni të SHMS-ve, shumica absolute, që në bazë të gjykimit të autorit janë mbi 90%, as që janë në dijeni se po kryejnë punë për SHMS-të, dhe po mirëmbajnë në funksion sistemet e ndërtuara nga SHMS-të, të cekura në pjesët tjera të librit. Shprehur me numra, nga 50.000 ushtarë të tillë të SHMS-ve, më së shumti 5. 000 janë në dijeni se kryejnë punë për SHMS-të, kurse së paku 45.000, as që janë në dijeni.

Futja e individëve në shkelje ligjore, përveç përmes joshjes, siç u paraqit në paragrafin sipër, është bërë edhe me mashtrime të drejtëpërdrejta të individëve të përzgjedhur nga SHMS-të, përmes spiunëve zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorëve me dijeni e pa dijeni. Këta spiunë dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve, kanë rrethuar individët, cak të këtyre sulmeve, me lloj-lloj rrethanash për një kohë, ku kanë krijuar mjedisin në të cilin individi cak i sulmit "ka rrëshqitë" në së paku një shkelje ligjore. Pastaj kjo shkelje ligjore, ose është përdorur si shantazh për shkelje tjera ligjore ose është përdorur si joshje për shkelje tjera ligjore, "duke ngrënë, të shtohet oreksi" është një thënie.

Shkalla e shkeljeve ligjore për individët siç është cekur në paragrafët sipër, caktohet nga SHMS-të dhe zbatohet nga spiunët dhe bashkëpunëtorët, varësisht nga gjykimi se sa i përshtatshëm dhe sa i besueshëm është individi në njërën anë, por edhe sa mund të përfitohet nga ky individ në anën tjetër.

Nëse vlerësohet përshtatshmëria si e duhur, besimi dhe përfitimi i lartë, atëherë individi futet në nivele më të larta të shkeljeve ligjore, dhe e kundërta. Me përfitime, këtu nënkuptohet mundësia që spiunët dhe bashkëpunëtorët me nivel më të lartë të mund të përfitojnë drejtpërdrejt nga ky individ dhe në këtë mënyrë edhe SHMS-të, si terësi.

Individët e futur në shkelje ligjore, përdoren nga SHMS-të edhe për krijimin e frontit "ne dhe ata", edhepse ngjyrimi nuk bëhet publik. Në njërën anë, si palë vendosin shkelësit e ligjit dhe në anën tjetër, zbatuesit e ligjit. Shkelësit e ligjit vetvetiu janë të interesuar që edhe të tjerët përreth tyre të jenë shkelës të ligjit, të jenë njëlloj, por ndonjëherë kur ka nevojë, individët tjerë nxiten ose shtyhen edhe nga SHMS-të, të janë të interesuar përmes spiunëve dhe bashkëpunëtorëve. Përderisa pala në frontin e shkelësve të ligjit në të shumtën e rasteve janë në dijeni se janë palë në front si "ne", pala tjetër e frontit të zbatuesve të ligjit si "ata" nuk janë në dijeni se janë palë në front.

Në frontin "ne dhe ata", pala e shkelësve të ligjit si "ne", janë të përgatitur dhe të drejtuar nga struktura të organizuara të nivelit të SHMS-ve dhe pala si "ata" në anën tjetër që janë zbatuesit e ligjit, nuk kanë asnjë formë të organizimit dhe të drejtimit, janë plotësisht të shkapërderdhur. Fitorja e luftës në këtë front është e sigurt për palën e shkelësve të ligjit dhepse në numër të pakët (rreth 50.000 të vlerësuar), kurse pala e zbatuesve të ligjit janë humbës të sigurt edhepse në numër janë shumëfish më shumë se pala tjetër.

Përveç krijimit të frontit "ne dhe ata" të paraqitur në paragrafët sipër, shkelësit e ligjit përdoren nga SHMS-të edhe "për të patur derën hapur" tek këta individë kurdo dhe për çfarëdo detyre që mund të kryhet nga këta individë. Dera është e hapur tek këta individë, qoftë përmes lidhjes së interesave personale me shkeljet ligjore, qoftë nga shantazhi i drejtëpërdrejtë i SHMS-ve përmes spiunëve dhe bashkëpunëtorëve, gjithsesi këta individë e kanë kokën nën gërshërë. Lidhja e fuqishme e interesave personale me shkelje ligjore, e kombinuar me forma tjera të zënies së interesave personale, ka prodhuar si rezultat instalimin e "rankoviqizmit" të paraqitur në pjesët e mëvonshme të librit, nuk guxon kush të lëvizë ("me shpurdhë" siç thotë populli).

Mosguximi i paraqitur në paragrafin sipër, vjen nga fakti se SHMS-të kanë krijuar gjendjen ku lidhja e interesave personale me shkelje ligjore dhe realizimi i interesave tjera personale edhe përmes zbatimit të ligjit është e varur dhe e kontrolluar drejtëpërdrejt nga një grup jo i madh individësh, që janë zyrtarët më të lartë të shtetit të Kosovës. Sot, vështirë e ke të gjesh dikë që mund të bësh të mendojë diçka për kundërshtim të pushtetarëve. Instalimi

i tillë i "rankoviqizmit" është i mundësuar por edhe i garantuar nga shtresa e "të pushtetshmëve" si shtresë " e të paprekshmëve" që është paraqitur në pjesët e mëvonshme të librit.

INFILTRIMI DHE FILTRIMI I INDIVIDËVE NË NDËRTIMIN E INSTITUCIONEVE DHE JETËN INSTITUCIONALE

Për qytetarin e zakonshëm të Kosovës është e dukshme dhe e ditur se disi institucionet e Kosovës udhëhiqen me njerëz që janë të dobët, kurse njerëzit e mirë, njerëzit e dijshëm, njerëzit e ngritur profesionalisht, janë jashtë institucioneve. Kjo shihet nga bisedat e rëndomta të përditëshme që shprehen edhe në formë të ankesës.

Shtrohet pyetja: a është kjo rastësi? Në Kosovën e kontrolluar fuqishëm nga SHMS-të, për më tepër se 100 vjet, çështjet si kjo nuk janë rastësi.

Kur të merret parasysh fakti se një gjendje e tillë ka qenë gjatë gjithë kohës së paraluftës së fundit dhe kur t'i shtohet kësaj edhe fakti se gjendja e tillë është fuqizuar në këto vitet e fundit të pasluftës, kuptohet se kjo gjendje është krijuar me veprime sistematike. Veprimet sistematike janë veprime të organizuara dhe jo veprime spontane. Veprime të tilla të organizuara, të kësaj natyre deri më tani, padyshim kanë kryer SHMS-të në Kosovë.

Këtu paraqitet se SHMS-të kanë punuar dhe janë duke punuar që në ndërtimin e institucioneve të Kosovës, të fusin brendpërbrenda individë, që ose ata vetë ose të afërm të familjeve të tyre, kanë dëshmuar besueshmëri dhe besnikëri ndaj shtetit të Serbisë. Është e nevojshme të bëhet e ditur për lexuesin se vlera e demonstrimit të besueshmërisë dhe besnikërisë ndaj shtetit të Serbisë, vetëvetiu nuk është e mjaftueshme nëse nuk dëshmohen dhe përtrihen vazhdimisht. Po ashtu, edhe nëse vetëm dëshmohet në vazhdimësi besueshmëria dhe besnikëria ndaj shtetit të Serbisë, vetvetiu nuk është e mjaftueshme për t'u filtruar në ndërtimin e institucioneve të Kosovës, duhen edhe shkathtësi/cilësi/vlera tjera shtesë.

Shtrohet pyetja: pse SHMS-të do të kryenin veprime që në ndërtimin e institucioneve të Kosovës të filtrohen individë edhe me vlera tjera nga vetëm dëshmimi i besueshmërisë dhe besnikërisë ndaj shtetit të Serbisë?

Përgjigjja do të ishte se vlerat e besimit në shtetin e Serbisë dhe vlerat e besnikërisë ndaj shtetit të Serbisë, vetëm një here, ose vetëm në një kohë, por

edhe në vazhdimësi, nuk janë të mjaftueshme për infiltrim në ndërtimin e institucioneve të Kosovës, të cilat do të funksiononin në drejtim të arritjes së synimeve të politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën. Kërkohen shkathtësi të veprimit konkret për zbatim të progameve.

SHMS-të, si pjesë të veprimeve dhe të veprimtarisë në Kosovë, sigurisht se kryejnë veprimet e duhura ndaj individëve që marrin pjesë dhe që ndërtojnë institucionet e Kosovës, që të sigurohen se këta individë kanë shkathtësitë/vlerat/cilësitë e tilla për t'u siguruar se institucionet e Kosovës funksionojnë në drejtim të përmbushjes së synimeve të tyre. Në kuadër të kësaj, në procesin e rekrutimit të individëve për pjesëmarrje në ndërtimin dhe posaçërisht në drejtimin dhe udhëheqjen e institucioneve të Kosovës, SHMS-të vendosin filtra me rregulla dhe kritere të caktuara për të siguruar arritjen e synimeve.

Përveç kritereve të paraqitura më lart: si besimi dhe besnikëria ndaj shtetit të Serbisë, SHMS-të vendosin edhe kritere tjera në filtrimin e individëve për pjesëmarrje në ndërtimin dhe në udhëhqjen e institucioneve të Kosovës. Disa nga kriteret tjera (që mund të mos jenë të vetmet) që SHMS-të vendosin në filtrime të tilla po i paraqesim në vijim:

- Në pozitën ku nevojitet nivel i caktuar profesional dhe nivel i caktuar i njohjes profesionale, të vendoset individi që ka nivel më të ulët profesional sesa niveli i kërkuar. Sa më larg nivelit profesional të kërkuar për pozitën e caktuar, aq më mirë për arritjen e caqeve të SHMS-ve.

- Në pozitën ku nevojitet qëndrueshmëri dhe vendosmëri në zbatimin e ligjeve të Kosovës, të vendoset individi që ka më pak qëndrueshmëri dhe më pak vendosmëri në zbatimin e ligjeve të Kosovës. Sa më larg qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë së kërkuar për zbatim të ligjeve të Kosovës për pozitën e caktuar, aq më mirë për arritjen e caqeve të SHMS-ve.

- Në pozitën ku nevojitet ndershmëri në kryerjen e punëve, të vendoset njeriu me më pak ndershmëri në kryerjen e punëve. Sa më larg nivelit të ndershmërisë së kërkuar për pozitën e caktuar, aq më mirë për arritjen e caqeve të SHMS-ve.

Kriteret e vendosura në filtrat për individët të cilët marrin pjesë në ndërtimin dhe udhëheqjen e institucioneve të Kosovës, nëse paraqiten thjeshtë, mund të

përmblidhen kësisoj: sa më i padijshëm individi, aq më mirë për SHMS-të, sa ma i keq individi aq më mirë për SHMS-të, sa më i pamoralshëm individi, aq më mirë për SHMS-të, sa më i poshtër individi, aq më mirë për SHMS-të. Kur bartësit e ndërtimit dhe të funksionimit të institucioneve të Kosovës kanë kaluar nepër filtra me kriteret e paraqitur në paragrafët paraprakë, krijohet brumi i përshtatshëm për ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen në funksion të të gjitha sistemeve të vlerave të shtjelluara në këtë publikim.

Përshkrimet rreth filtrimit të individëve për marrje pjesë në ndërtimin dhe udhëheqjen e institucioneve të Kosovës, në paragrafët paraprakë, është bërë i thjeshtë me qëllim të kuptimit më të lehtë. Mirëpo, procesi i filtrimit është kompleks dhe tepër mirë i përgatitur dhe zbatuar nga SHMS-të. Filtrimi i individëve siç e kemi përshkruar, ka ndodhur vazhdimisht gjatë gjithë kohës së paraluftës së fundit, për të vazhduar pandërprerë deri tani dhe do të vazhdojë derisa SHMS-të, të kenë mundësi të veprimit të tillë.

Ilustrim i mirë i proceseve të filtrimit të indvidëve do të bëhej, po që se merret për bazë e dhëna e shpalosur në emisionin e një televizioni të Kosovës, që thotë: "5 nga 7 anëtarët e Kryesisë së LPK-së kanë qenë spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve". Sigurisht se kjo informatë nuk është e vërtetuar nga institucionet e Kosovës, por, nuk është me rëndësi numri se a kanë qenë 5 nga 7, me rëndësi është se a ka patur të infiltruar dhe atë mjaftueshëm për të patur nën kontroll këtë organizatë dhe përmes kësaj edhe zhvillimet e kontrolluara nga kjo organizatë. Edhe pse nuk është e vërtetuar, besueshmëria e të dhënës së paraqitur më lart, mund të vërtetohet me dëshmi siç është paraqitur në paragrafët paraprakë.

Ka qenë LPK-ja, që ka përcaktuar se cilët individë duhet të jenë Komandantë të UÇK-së. Pastaj, nga njerëzit e LPK-së janë krijuar parti politike të njohura si të dala nga lufta.

Mirëpo, çka ndodhi?

Këto parti politike të dala nga lufta, punuan ashtu që Kosova të ndërtojë institucione jofunksionale dhe joefikase dhe pothuajse të paralizuara nga moszbatimi i ligjit dhe nga krimi i organizuar. Këto parti politike, të dala nga lufta, pastaj edhe mbrojtën vlerat e luftës ashtu që 15 vjet pas përfundimit të luftës, nuk ka ligj në zbatim të vlerave të luftës, ashtu që dhjetëra, në mos qindra ish ushtarë të UÇK-së të bëjnë vetëvrasje, ashtu që qindra në mos mijëra ish ushtarë të UÇK-së të jetojnë në skamje, ashtu që mijëra ish ushtarë të UÇK-së të jenë të papunë.

Puna e tillë siç u paraqit sipër nuk ka të bëjë me punën e dikujt që punon për interesa të popullit, ka të bëjë me arritjen e realizimit të programeve të SHMS-ve për Kosovë. Realizimi i programeve të SHMS-ve, në këtë nivel, nuk mund të kryhet pa patur spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë të SHMS-ve, të infiltruar në kreun e këtyre partive politike.

Po që se kthehemi prapa, qysh në përzgjedhjen e individëve për komandantë të UÇK-së, nuk janë emëruar individët që kanë qenë më meritor për të qenë komandantë, por janë eliminuar se nuk kanë qenë lakmitarë. Këta komandantë të përzgjedhur në bazë të kriterit të lakmisë dhe jo të meritës për të qenë bartës i besimit të popullit në luftë, pas lufte dëshmuan arrogancë, moszbatim të ligjit e probleme tjera për shoqërinë.

Sigurisht, po që se do të ishin emëruar komandantë, individët tjerë që kanë merituar të jenë komandantë, ndryshe do të vepronin pas lufte. E themi këtë nga fakti se në rrethinën ku autori ka jetuar, ka njohur personalisht individët që do të duhej të ishin komandantë të UÇK-së, si dhe individët që realisht janë emëruar komandantë të UÇK-së. Besoj se njëjtë ka ndodhur edhe në rrethina dhe raste tjera. Procesi i tillë i filtrimit ka vazhduar të zbatohet deri në ditët e sotme, në të gjitha fazat e zhvillimit dhe në të githa institucionet e Kosovës.

Sitja dhe filtirimi i individëve, që kryhet nga SHMS-të në Kosovë, në shumicën e rasteve është kryer "me elegancë". Individi ka përfunduar jashtë të qenurit i kyçur në ndërtimin e institucioneve pa e hetuar fare se largimi ka qenë pjesë e programeve të SHMS-ve, është kryer me elegancë. Kryerja e menjanimeve me elegancë nuk ka qenë e mundur çdoherë. Ndonjëherë eleganca është dashur të përzihet edhe me vrazhdësi e brutalitet. Kur SHMS-të kanë konsideruar të nevojshme, janë kryer edhe menjanime fizike, por edhe eliminime fizike përmes heqjes së kokave, me vrasje.

INSTALIMI I "RANKOVIQIZMIT" NË PERIUDHËN E PASLUFTËS SË FUNDIT

Thënie: **"Historia që nuk mësohet, përsëritet"**

Thënia në formë të konstatimit të lartëshënuar, në dukje të parë mund të lë përshtypje provokative. Në të vërtetë ka edhe elemente provokative. Provokimi është drejtuar në të menduarit e qytetarit të zakonshëm, dhe gjithashtu në të menduarit e të gjithë zyrtarëve të institucioneve të Kosovës,

posaçërisht në të menduarit e drejtuesve të të gjitha institucioneve të Kosovës.
Një histori që nuk mësohet, sigurisht se përsëritet dhe përsëritja vazhdimisht ndodh përderisa nuk mësohet. Marrja e mësimit është posaçërisht e domosdoshme për zyrtarët e lartë, drejtues të institucioneve të Kosovës. Në mungesë të dëshmive se këta zyrtarë kanë marrë mësim nga e kaluara e afërt e "kohës së Rankoviqit", është e domosdoshme që vetë qytetari i zakonshëm të marrë mësimet nga e kaluara. Kuptohet se qytetari i zakonshëm, nuk mund të marrë mësim vetvetiu, mësimin e merr nga "bijtë dhe bijat e popullit".

Është me rëndësi që për lexuesin të shpjegohet se çka kuptojmë dhe çka shprehim me "Rankoviqizëm". "Rankoviqizmi" ka ndodhëur kur autori i këtij publikimi ishte i posalindur, nuk ka patur përvoja të veta të drejtëpërdrejta, njohuritë i ka të fituara vetëm përmes përshkrimit nga të tjerët. Kuptimi se çka ka qenë "Rankoviqizmi" shkurtimisht përmblidhet kësisoji: Populli përmes veprimeve të ndryshme të SHMS-ve, është frikësuar aq shumë sa që nuk ka guxuar as vetmevete të flasë keq për pushtetin dhe të pushtetshmit. Frika është futur nga spiunët dhe goditjet e marra në koordinim, nga të gjitha institucionet shtetërore dhe me fuqi shumë të madhe përmes "stupcit" (rrahjes me stupc), burgosjes, vrasjeve dhe persekutimeve, e të ngjajshme. "Rankoviqizmi" i tillë është instaluar në Kosovë edhe në periudhën e pasluftës së funidt, veç se kuptohet me përshtatje të rrethanave të reja.

"Rankoviqizmi" i pasluftës së fundit është i njëjtë. Populli nuk po guxon as vetmevete të flasë keq për pushtetin dhe të pushtetshmit. Nuk guxon individi të flasë keq për të pushtetshmit nga spiunët dhe goditjet e marra në koordinim nga të gjitha institucionet shtetërore të Kosovës dhe me fuqi shumë të madhe në interesat personale të individit. Interesat personale përfshijnë: vendi i punës, karriera profesionale, veprimtaria biznesore, pasuria dhe prona private dhe themelet familjare siç janë: ndershmëria e familjes, harmonia familjare, etj. Me shprehjen "të pushtetshmit", kuptojmë individët, siç janë përshkruar në pjesën "Krijimi i shtresës së të pushtetshmëve si shtresë e të paprekshmëve".

Dallimi në mes të "Rankoviqizmit" të paraluftës së fundit dhe "Rankoviqizmit" të pasluftës së fundit është se në vend të persekutimeve përmes stupcit, burgosjes e të ngjajshme, janë duke u përdorur persekutimet në interesa personale të paraqitura në paragrafët paraprakë . Themelet e rendit shoqëror të ekonomisë së tregut, janë interesat dhe mirëqenia personale e individit, ndryshe nga rendi shoqëror socialist që ishte si i

proklamuar, interesi dhe mirëqënja shoqërore, por që kurrë nuk u dëshmua në praktikë.

Meqë veprimet edhe në "Rankoviqizmin" e paraluftës së fundit edhe në "Rankoviqizmin" e pasluftës së fundit ishin dhe janë të organizuara, ishin të koordinuara, ishin të përsëritura dhe ishin të studjuara mirë, d.m.th. se këto veprime kanë qenë dhe vazhdojnë të janë sistemike, gjë që nënkupton se kemi të bëjmë me sistem të ndërtuar dhe funksional. Sisteme të tilla deri më tani në Kosovë kanë instaluar vetëm SHMS-të.

Zëvendësimi i persekutimeve përmes stupcit, burgosjes etj. me persekutimet përmes interesave personale, janë përshtatje e përkryer e veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, në bazë të rrethanave të krijuara me fillimin e ndërtimit të rendit shoqëror të ekonomisë së tregut. Për të siguruar arritjen e synimeve të politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovë, SHMS-të kanë drejtuar goditjet pikërisht në themelet e ndërtimit të rendit shoqëror të Kosovës.

NIVELI I BESIMIT DHE I BESNIKËRISË NDAJ SERBISË SI THEMEL PËR NIVEL TË HIERARKISË

Veprimtaria e msheftë e SHMS-ve në Kosovë, ka për themel dhe është e lidhur me sistemin e vlerave që kanë bartësit e kësaj veprimtarie. Asnjë sistem nuk funksionon pa patur si themel vlera të caktuara, që e mbajnë në funksion atë sistem. Të gjitha sistemet e qëndrueshme dhe efikase, në themel të funksionimit kanë sistemin e vlerave që e mundësojnë qëndrueshmërinë dhe efikasitetin, sistem të vlerave që ka edhe nivelet e veta hierarkike të vlerave.

Sistemet funksionale që SHMS-të kanë ndërtuar në Kosovë, në themel kanë vlerat që lidhen me besimin dhe besnikërinë e bartësve të veprimtarisë së SHMS-ve. Niveli i funksionalitetit dhe efikasitetit të sistemeve të ndërtuara në Kosovë nuk do të ishte kaq i lartë siç është tani, po që se vlerat mbi të cilat janë ndërtuar këto sisteme nuk kanë edhe nivelet hierarkike.

Besimi dhe besnikëria e bartësve të veprimtarisë së SHMS-ve ndaj Serbisë, si vlerë për SHMS-të, nuk është diçka që vetëm deklarohet, diçka që "një herë e dëshmon dhe u krye puna". Besimi dhe besnikëria ndaj Serbisë, matet dhe vlerësohet sipas parametrave të përcaktuara nga SHMS-të. Këto vlera për SHMS-të, nuk dëshmohen vetëm me një veprim, ose vetëm me disa veprime. Sa e sa individë kanë kryer vepra të ndryshme që mund të

konsiderohen si të mëdha, si p.sh. vrasja e një individi, votimi në Kuvendin e Prizrenit në vitin 1945 ,ose votimi për ndryshime kushtetuese në vitin 1989, e të ngjajshme, por nuk kanë mjaftuar. Besimi dhe besnikëria ndaj Serbisë është dashur dhe ende duhet të dëshmohet në vazhdimësi, duhet të jetë sistematik.

Sigurisht se besimi dhe besnikëria e një individi ndaj Serbisë ka nivelet e veta hierarkike. Vlerësimi fillimisht i besimit dhe besnikërisë ndaj Serbisë dhe pastaj edhe i nivelit hierarkik të besimit dhe besnikërisë, kryhet nga SHMS-të, duke marrë parasysh tërësinë e elementeve dhe veçorive që e përbëjnë besimin dhe besnikërinë. Sikur çdo vlerësim edhe vlerësimi i besimit dhe besnikërisë ndaj Serbisë dhe i nivelit të saj, kryhet në bazë të procedurave, rregullave dhe kritereve të paracaktuara. Sikur çdo vlerësim edhe ky vlerësim kryen matjen e besimit dhe besnikërisë, bazuar në rregullat dhe kriteret e paracaktuara dhe në këtë mënyrë bëhet edhe përcaktimi i niveleve të besimit dhe besnikërisë.

Ku është interesi i shtjellimeve të vlerësimit dhe të përcaktimit të niveleve të besimit dhe besnikërisë ndaj Serbisë?

Interesi qëndron në atë se varësisht nga besimi dhe besnikëria e individit në Serbi, janë dhënë dhe jepen edhe përfitimet për individin. Dëshmimi i besimit dhe besnikërisë ndaj Serbisë, demonstrohet me kryerjen e veprimit a veprimeve konkrete, ku këto veprime në fakt janë kontribute për SHMS-të në punën e saj.

Para luftës së fundit, përfitimet e individit, bartës i veprimeve të SHMS-ve kanë qenë kryesisht pozitat e larta publike, shoqërore, në fushën në të cilën individi ka patur shtrirje. Pasluftës së fundit, përfitimet nuk kanë qenë vetëm pozitat e larta publike shoqërore, por janë shtrirë edhe në rritjen e pasurisë dhe mirëqënies për individin dhe familjen e individit. Bile pozitat publike shoqërore u janë dhënë në shumë raste individëve, bashkëpunëtorë pa dijeni të SHMS-ve. Kur është e mundur nuk dalin në sipërfaqe spiunët me betim dhe bashkëpunëtorët me dijeni të SHMS-ve, mjafton që të kryhen detyrat siç donë SHMS-të. Kështu veprohet me qëllim që të kryhen veprimet e SHMS-ve, pa u dyshuar, për të shmangur dyshimin.

Veprimet dhe veprimtaria e msheftë është e msheftë dhe për këtë arsye është vështirë për t'u dokumentuar. Nëse veprimet dhe veprimtaria e një individi për SHMS-të nuk është e dokumentueshme, përfitimet e individit janë të dokumentueshme. Niveli i përfitimeve të një individi, në fakt është nivel i veprimtarisë së atij individi. Nivelet e larta të përfitimeve të individëve në

periudhën e kontrollit nga SHMS-të, të zhvillimeve në Kosovë, janë nivele të larta të dëshmimit të besimit dhe besnikërisë së këtyre individëve ndaj Serbisë. Niveli i lartë i dëshmimit të besimit dhe besnikërisë së individit, është arritur me kryerjen edhe të shumë veprimeve por edhe me kryerjen e veprimeve të çmueshme për SHMS-të.

Nëse qëndron pohimi se SHMS-të kanë nën kontroll zhvillimet shoqërore në Kosovë, atëherë qëndron edhe e vërteta se shumë individë që kanë përfituar pozita të larta publike, shoqërore, dhe pasuri për vete dhe familjen e tyre, në fakt kanë dëshmuar besim dhe besnikëri të lartë ndaj Serbisë. Çdoherë në të kaluarën, SHMS-të kanë vepruar kështu, nuk ka asnjë arsye të besohet ndryshe.

Shumë individë, pas Luftës së Dytë Botërore janë dërguar nga kryeqendra e Kosovës në Drenicë, për të dëshmuar besim dhe besnikëri ndaj Serbisë dhe se varësisht nga niveli i dëshmimit janë shpërblyer. Një nga kësilloj individësh, që më poshtë në libër paraqitet si komunist i devotshëm, tek popullsia e kësaj treve njihet si pa inteligjencë, kryetrashë, ose "tullë" siç thotë populli, por, pas dëshmimeve në punën me Drenicën, ka qenë i paprekshëm në LKJ-në e Kosovës, deri në vdekje. Po kuptohet se dëshmimi i besimit dhe besnikërisë në ato periudha është fshehur nën petkun e dëshmimit ndaj partisë dhe komunizmit. Njëjtë është vepruar edhe me aksionet politike pas demonstratave të vitit 1968, 1981, ndryshimeve kushtetuese në vitin 1989 si dhe aksionet tjera politike. Sigurisht se njëjtë veprohet nga SHMS-të edhe sot.

Individët që kanë demonstruar dëshmim të lartë të besimit dhe besnikërisë ndaj Serbisë, paraluftës së fundit, përveç se u janë dhënë pozita të larta publike, shoqërore, u është dhënë edhe besim nga SHMS-të, që të ndërmarrin veprime në dobi të Kosovës, si hapje të shkollave, ndërtim të ndërmarrjeve ekonomike, zhvillime të veprimtarive të atëhershme shkencore, akademike, kulturore. Këto lejime për zhvillim të kësilloj veprimtarie nga bartësit e veprimtarisë së SHMS-ve, janë bërë me qëllim të shpërblimit për këta individë, për punën e kryer në njërën anë dhe në anën tjetër i kanë maskuar si kontribues të zhvillimit të Kosovës. Të parë nga populli si kontribues të zhvillimit, këta individë më lehtë kanë trullosur popullin për të fshehur veprimet tjera të radhës, sipas kërkesave të SHMS-ve. Në fakt, këta individë kanë vazhduar demonstrimin e dëshmimit të lartë të besimit dhe besnikërisë ndaj Serbisë.

Veprimet dhe praktikat e kryera nga SHMS-të, paraluftës së fundit, siç u paraqitën në paragrafin sipër, janë të njohura sheshazi. Nuk ka ndonjë arsye

të besohet se edhe pas luftës së fundit SHMS-të të mos zbatojnë praktika të njëjta. Nëse qëndron pohimi se SHMS-të kanë kontroll mbi zhvillimet në Kosovën e pasluftës së fundit, qëndron edhe e vërteta se shumë nga kontribuesit e zhvillimeve shoqërore të pasluftës së fundit, janë në fakt po ata individë që kanë demonstruar dëshmim të lartë të besimit dhe besnikërisë ndaj Serbisë.

KRIJIMI I SHTRESËS SË "TË PUSHTETSHMËVE" SI SHTRESË E "TË PAPREKSHMËVE"

Siç është shtjelluar në pjesët paraprake, SHMS-të kanë dëshmuar traditën e ndërtimit komplet të shtresave shoqërore, si një mekanizëm që siguron arritjen e synimeve dhe të politikave të Serbisë për Kosovën. Shtresat janë ndërtuar, janë funksionalizuar dhe janë mirëmbajtur në përputhje me rrethanat dhe kërkesat e zhvillimeve shoqërore në Kosovë.

Në periudhën e pasluftës së fundit në Kosovë, rrethanat janë ndryshuar përmbajtësisht. Në këto rrethana të krijuara, për të siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e shumë sistemeve të vlerave shoqërore, njerëzore, të shtjelluara në paragrafët paraprakë , SHMS-të kanë ndërtuar shtresën e "të pushtetshmëve". Në këtë publikim, togëfjalëshi "të pushtetshmit" është përdorur për të shprehur një kuptim më të gjerë dhe më të gjithanshëm. Përndryshe, brendia e problemit që synohet të shkoçitet me këtë togfjalësh, ka të bëjë me kuptimin e shtresës së "të paprekshmëve", të paprekshmëve në kuptimin e përgjegjësive ligjore, morale, njerëzore, etj. për veprimet e kryera në shoqërinë e Kosovës.

Qytetari i zakonshëm në rrethinën ku jeton dhe punon njeh jo një, por disa individë që kryejnë veprime që shkelin ligjin, kryejnë veprime që shkelin moralin shoqëror, kryejnë veprime që janë jonjerëzore, mirëpo nuk mbahen përgjegjës nga askush. Këta individë, këto lloj veprimesh i kryejnë jo vetëm një herë, por në vazhdimësi për periudha të gjata dhe se në vazhdimësi nuk mbahen përgjegjës. Kjo gjendje sigurisht se nuk është e zakonshme, në të vërtetë është e pazakonshme për një shoqëri të organizuar mirë dhe të zhvilluar.

Këta individë që kryejnë këso veprimesh dhe që nuk mbahen përgjegjës, nuk janë të panjohur, ata kanë emër e mbiemër, iu dihet edhe "kotilla" siç thuhet në popull. Secili qytetar i zakonshëm i njeh disa individë të tillë në rrethinën

e vet. Qytetarët e zakonshëm, janë gjithandej Kosovës edhe këta individë të paprekshëm janë gjithandej Kosovës, janë një shtresë e plotë.

Po si u shpërndan këta individë në gjithë Kosovën, si arrijnë që të kenë vazhdimësi?

Jo rastësisht, sigurisht, në mënyrë të organizuar. Tanimë po është e kuptueshme se një ndërtim të tillë të organizuar, mund ta kryejnë vetëm SHMS-të.

Si çdo shtresë shoqërore edhe shtresa e "të pushtetshmëve" përbëhet nga përfaqësues të fushave të ndryshme profesionale dhe shoqërore. Shtresa e "të pushtetshmëve" përbëhet nga pjesëtarë (jo të gjithë) të partive politike, nga pjesëtarë të të gjitha partive politike më të mëdha në Kosovë, nga pjesëtarë (jo të gjithë) të udheheqësve të institucioneve shtetërore (niveli qendror dhe vendor), nga pjesëtarë (jo të gjithë) të institucioneve që do të duhej të ishin të pavarura dhe profesionale, nga pjesëtarë (jo të gjithë) të komunitetit të biznesit, nga pjesëtarë (jo të gjithë) të institucioneve akademike-arsimore, nga pjesëtarë (jo të gjithë) të mediave dhe publicistikës, e kështu me radhë. Pjesëtarët e kësaj shtrese rëndom mbajnë për një kohë, poste publike udhëheqëse dhe pastaj zëvendësohen me pjesëtarë të tjerë të kësaj shtrese.

Pjesëtarët e shtresës së "të pushtetshmëve" janë të paprekshëm edhe kur zyrtarisht mbajnë ndonjë post publik udhëheqës edhe kur zyrtarisht nuk mbajnë ndonjë post publik udhëheqës, prapë janë të pushtetshëm, kjo falë lidhjeve joformale të interesit me pjesëtarët tjerë të kësaj shtrese që mbajnë poste publike udhëheqëse. Pjesëtarët e kësaj shtrese edhe kur mbajnë poste publike udhëheqëse edhe kur nuk mbajnë poste publike udhëheqëse, mbrojnë dhe përkrahin njëri-tjetrin, e mbrojnë njëri- tjetrin edhe kur është i partisë politike, gjoja kundërshtare, sepse është i llojit të vet.

Pjesëtarët e shtresës së "të pushtetshmëve" janë bashkë kundrejt gjithë të tjerëve. Në rastet kur pjesëtarët e kësaj shtrese janë në poste publike udhëheqëse, shfrytëzojnë institucionet ku punojnë dhe pocizionet që kanë, për t'u dalë në mbrojtje institucionalisht pjesëtarëve tjerë të kësaj shtrese. Kur këta pjesëtarët e kësaj shtrese nuk mbajnë poste publike udhëheqëse, ndihmojnë pjesëtarët e kësaj shtrese që janë duke mbajtur poste publike udhëheqëse, me format dhe mundësitë që mund t'i përdorin për t'i mbajtur këta pozitat dhe postet publike udhëheqëse. Në këtë mënyrë kryhet "solidariteti" në mes të anëtarëve të shtresës së njëjtë, solidariteti në mes të pjesëtarëve në poste publike dhe pjesëtarëve që nuk janë në poste publike, në fakt kryhet mbrojtja në mes të anëtarëve të shtresës së njëjtë.

Secila shtresë shoqërore ka hierarkinë e shtresës, edhe kjo shtresë ka hierarkinë e vet, ku në krye të hierarkisë, janë pjesëtarët e partive politike. I gjithë strukturimi dhe funksionimi i kësaj shtrese është i lidhur dhe varet nga prijësi dhe oborrtarët e prijësit që dalin si parti politike fituese. Pjesëtarët tjerë të kësaj shtrese që dalin jofitimtarë, presin dhe punojnë me shpresë që radhën tjetër të zgjedhjeve politike të dalin fitimtarë. Pjesëtarët që nuk dalin fitimtarë, nuk kundërshtojnë veprimet e pjesëtarëve të shoqërisë që kanë dalë fitimtarë që thyejnë ligjin, veprimet që thyejnë moralin shoqëror, veprimet që thyejnë ndershmërinë, përkundrazi promovojnë kulturën e relativizimit dhe të normalitetit në bashkëjetim me këto thyerje.

Kultura e relativizimit dhe bashkëjetimit me thyerje të ligjit dhe vlerave të dobishme për shoqërinë, promovohet me shpjegimet: "kjo është Kosovë", "çka me ba, kështu shkon këtu, kjo nuk ndërron, është e kotë përpjekja për ndërrim, kështu ka me qenë gjithmonë, ka me qenë edhe në të ardhmen, etj". Këto shpjegime janë ninula për vënien në gjumë të qytetarit të zakonshëm. Në ndërkohë, pjesëtarët që dalin fitimtarë, vjelin të mirat e të qenurit fitimtarë për prijësin dhe oborrtarët, por nuk harrojnë ose nuk gabojnë të harrojnë edhe pjesëtarët që nuk dolën fitimtarë. Pjesëtarët fitimtarë, ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar mosmbajtjen përgjegjës për veprimet e kryera më herët nga pjesëtarët që nuk dolën fitimtarë kësaj radhe, por që ishin fitimtarë më përpara.

Secila shtresë ka vlerat dhe hierarkinë e vlerave mbi të cilat është ndërtuar, funksionon dhe mirëmbahet funksionimi i shtresës. Edhe shtresa e "të pushtetshmëve" ka vlerat, bile edhe hierarkinë e vlerave mbi të cilat është ndërtuar si shtresë, funksionon si shtresë dhe mirëmbahet funksionimi i saj si shtresë. Vlerat e kësaj shtrese janë: moszbatimi i ligjit, hajnia, rrena, mashtrimi, tradhtia, papërgjegjësia, improvizimi profesional dhe vlera tjera të këtij lloj grupi të vlerave. Veprimet e kryera në përputhje me këto vlera, përveç që thyejnë moralin shoqëror dhe thyejnë ndershmërinë, gjithashtu thyejnë edhe zbatimin e ligjeve të Kosovës. Meqë thyerja e zbatimit të ligjit në Kosovë është vepër kriminale, ky grup-vlera në përmbajtje është kriminale dhe kesisoj edhe kjo shtresë në themel është kriminale.

Shtrohet pyetja: pse SHMS-të ndërtojnë shtresën e "të pushtetshmëve" , siç u paraqit paraprakisht?

Me përfundimin e luftës dhe largimin e administratës dhe forcave të sigurisë së Serbisë, në Kosovë fillon etapë tjetër e zhvillimit, në të cilën edhe do të ndërtohen shtresa të reja shoqërore. Zhvillimi i papenguar i Kosovës,

mundëson edhe zhvillim organik ose natyror të shtresave shoqërore. Për të penguar zhvillimet organike dhe natyrore në Kosovë. Serbia njëjtë si më parë, kur ka mundësi për të ndërhyrë, ndërhyn dhe ndërton krijime artificiale. Me ndërtimet artificiale, ngulfat dhe pamundëson zhvillimet natyrore në shoqërinë e Kosovës. Ndërtimi dhe mirëmbajtja në fuqi e shtresës së "të pushtetshmëve" si shtresë e "të paprekshmëve" ,në mënyrë të drejtëpërdrejtë mundëson, por edhe siguron, funksionimin e sistemit të neokolonializmit, siç është paraqitur në pjesët tjera të librit.

Ndërtimi i shtresës së "të pushtetshmëve", siç është paraqitur në paragrafët paraprakë, ngulfat dhe pamundëson zhvillimin e disa shtresave që do të përbëjnë shoqërinë e Kosovës, në kohën kur nuk do të ketë ndërhyrje nga veprimet e SHMS-ve. Shtresat që do të zhvillohen në Kosovë në të ardhmen do të jenë vërtet të pushtetshme, do të kenë vlerat në bazë të të cilave do të ndërtohen, funksionojnë dhe mirëmbahen si shtresa. Këto zhvillime do të jenë të natyrshme dhe se këto shtresa do të jenë natyrore.

Në vijim janë paraqitur disa shtresa që sipas mendimit tonë do të zhvillohen dhe do të jenë të pushtetshme në të ardhmën në Kosovë:

- Shtresa e pronarëve të pasur

  Vetë rendi shoqëror i ekonomisë së tregut krijon këtë shtresë. Të gjithë lojtarët në lojën e futbollit kanë dëshirë të japin gol, mirëpo vetëm disa kanë këto shkathtësi dhe e arrijnë këtë. Njëjtë, të gjithë në ekonominë e tregut kanë dëshirë që të jenë pronarë të pasur, por vetëm disa do të kenë shkathtësitë dhe do të arrijnë këtë. SHMS-të me veprimet e veta ndërhyjnë, që individët me shkathtësi të tilla të mos mund të krijojnë pasuri pa veprime që thyejnë ligjin, pa veprime që thyejnë moralin shoqëror dhe pa veprime që thyejnë ndershmërinë. Tani për tani në Kosovë, për shkak të veprimtarisë dhe veprimeve të SHMS-ve, pasurimi mund të arrihet vetëm përmes thyerjes së ligjit, thyerjes së moralit shoqëror dhe thyerjes së ndërshmërisë.

- Shtresa e zyrtarëve shtetëror

  Shteti i pavarur i Kosovës do të ketë administratën shtetërore, do t'i ketë institucionet shtetërore dhe publike dhe do t'i ketë zyrtarët shtetërorë dhe publikë të këtyre institucioneve. SHMS-të me veprimet e veta ndërhyjnë që individët në postet zyrtare të mos kenë mundësi të krijojnë karrierën e vet pa veprime që thyejnë ligjin, pa veprime që thyejnë moralin shoqëror dhe pa veprime që thyejnë ndershmërinë. Për shkak të

veprimeve të SHMS-ve, tani për tani karriera e zyrtarëve mund të arrihet vetëm përmes thyerjes së ligjit, thyerjes së moralit shoqëror dhe thyerjes së ndërshmërisë.

- Shtresa e profesionistëve

Zhvillimi në rendin shoqëror të ekonomisë së tregut, bëhet përmes zhvillimit dhe fuqizimit të shkathtësive individuale profesionale, në të gjitha fushat dhe në të gjitha institucionet e shoqërisë. Niveli i zhvillimit dhe niveli i fuqisë së profesionit është i lidhur me nivelin e zbatimit të ndershmërisë nga profesionistët. SHMS-të me veprimet e veta ndërhyjnë që individët profesionistë të mos mund të krijojnë karrierën profesionale pa veprime që thyejnë ndershmërinë. Për shkak të veprimeve të SHMS-ve, tani për tani karriera e profesionistëve mund të arrihet vetëm përmes thyerjes së ndërshmërisë.

- Shtresa e të papunëve

Edhe në ekonomitë më të zhvilluara të rendit shoqëror të ekonomisë së tregut, ekziston shtresa e të papunëve. Në ekonominë e Kosovës do të ketë shtresë të të papunëve, relativisht të madhe, derisa të arrihet një nivel shumë më i madh i zhvillimit ekonomik. Në rendin shoqëror të ekonomisë së tregut, vetë të papunët janë të vetëdijshëm se nuk janë të punësuar për shkakun se shkathtësitë dhe vlerat e tyre profesionale në raport me konkurrentët e fushës që i përkasin janë më të ulta, nuk janë konkurrues në nivelin e duhur. Në rendin shoqëror të imponuar nga veprimet e SHMS-ve, të papunë janë pikërisht ata që kanë shkathtësitë dhe vlerat profesionale në raport me konkurrentët, janë të papunë për shkakun se nuk kanë vlerat e kërkuara nga SHMS-të, nuk pranojnë të thyejnë ligjin, nuk pranojnë të thyejnë moralin shoqëror, nuk pranojnë të thyejnë ndërshmërinë.

MAKINERIA E SHTYPJES DHE LARTËSIMIT TË VLERAVE SHOQËRORE NJERËZORE

Më sipër paraqitëm veprimet e kryera dhe sistemet e ndërtuara nga SHMS-të në Kosovë, me qëllim të arritjes së synimeve të politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën. Të gjitha këto veprime dhe sisteme përbëjnë një tërësi që në përmbajtje paraqet një makineri funksionale dhe efektive e cila shtyp dhe shkatërron vlerat që janë në shënjestër të SHMS-ve, në njërën anë dhe lartëson e fuqizon në anën tjetër vlera tjera të cilat janë pjesë e programeve të

Serbisë për Kosovën. Kjo makineri ka si pjesë përbërse të vetën sistemet funksionale dhe efektive, të cilat janë shtjelluar në pjesët paraprake të këtij publikimi, siç janë: sistemi i degradimit të vlerave, sistemi i moszbatimit të ligjit, sistemi i kontrollit të mbitokës nga nëntoka, etj.

Sistemet e ndërtuara nga SHMS-të në Kosovë janë ndërtuar, funksionojnë dhe mirëmbahen nga veprimet konkrete të spiunëve zyrtarë me betim. Funksionimi dhe mirëmbajtja e këtyre sistemeve kryhet nga shumica e pjesëmarrësve të cilët nuk janë spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve, nga shumica e bashkëpunëtorëve të SHMS-ve që nuk e dijnë se me veprimet e veta janë duke ndërtuar, se janë vënë në funksion ose se janë duke mirëmbajtur sistemet e këtilla. Le të përkujtojmë se veprimet dhe veprimtaria e SHMS-ve është shumë e msheftë dhe shumë profesionale. Le të përkujtojmë gjithashtu se në njërën anë strukturat e SHMS-ve janë shumë mirë të organizuara, kanë të ndërtuar traditë veprimi mbi 100 vjeçare dhe se mbështetet nga institutet dhe institucionet më profesionale dhe më shkencore të Serbisë dhe në anën tjetër, përballë kemi qyetarin e zakonshëm si strukturë plotësisht e paorganizuar dhe mungesë e plotë e veprimit të institucioneve të Kosovës.

Sistemet e ndërtuara nga SHMS-të në Kosovë, funksionojnë si tërësi e sistemeve që krijojnë makineri në vetvete. Kjo makineri si tërësi e sistemeve funksionon dhe mirëmbahet nga SHMS-të, ashtu që të sigurojë se tërësia e sistemeve shtyp dhe shkatërron vlerat shoqërore, njerëzore, të dobishme për Kosovën dhe lartëson dhe fuqizon vlerat shoqërore, njerëzore, të dëmshme për Kosovën.

Vlerat shoqërore, njerëzore, kanë bartësit e vlerave dhe në këtë mënyrë kjo makineri gllabëron dhe shkatërron individët që janë bartës të vlerave shoqërore, njerëzore, të dobishme shoqërore. Po ashtu, kjo makineri lartëson dhe fuqizon individët që janë bartës të vlerave shoqërore, njerëzore, të dëmshme për Kosovën. Kjo makineri, duke gllabëruar dhe shkatërruar individët e shënjuar nga SHMS-të, gllabëron dhe shkatërron shtresat që natyrshëm do të zhvilloheshin në Kosovë, meqë këta individë janë pjesëtarë potencialë të shtresave shoqërore që do të zhvillohen në Kosovë. Po ashtu, kjo makineri lartëson dhe fuqizon individët e përzgjedhur nga SHMS-të dhe në këtë mënyrë ndërton dhe fuqizon shtresën e "të pushtetshmëve".

Sistemet e ndërtuara në Kosovë nga SHMS-të, që janë pjesë e makinerisë si terësi, duke qenë të ndërtuara, funksionojnë ashtu që zvoglojnë nevojën për veprime të drejtpërdrejta të spiunëve zyrtarë me betim dhe të bashkëpunëtorëve me dijeni. Funksionimi dhe mirëmbajtja e funksionimit të

kësaj makinerie ushqehet me veprimet e individëve, që shprehur në përqindje supozohet se mund të përbëjnë deri mbi 90% të numrit të përgjithshëm të bartësve të vlerave shoqërorore, njerëzore, të dëmshme për Kosovën, pa e ditur se janë duke kryer veprime të tilla. Numri i individëve që janë spiunë zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorë me dijeni të SHMS-ve, si bartës të vlerave shoqërore, njerëzore, të dëmshme për Kosovën dhe që e dijnë se janë duke kryer veprime të tilla, supozohet se mund të jenë më pak se 10% nga numri i përgjithëshëm i bartësve të vlerave shoqërorore, njerëzore, të dëmshme për Kosovën.

Se si vepron makineria e shtypjes dhe lartësimit të vlerave shoqërore, njerëzore, të paraqitura në këtë publikim, mund të demonstrohet nëpërmes një shembulli të thjeshtësuar. Të marrim një ndërmarrje publike. Ndërmarrja publike organin më të lartë të udhëheqjes e ka Këshillin e Ndërmarrjes, pastaj ka Kryeshefin Ekzekutiv, dhe pozitat tjera më të ulëta. SHMS-të me vetëm një spiun zyrtar me betim, mund të vëjnë në lëvizje gjithë këtë ndërmarrje si mekanizëm për lartësimin dhe shkatërrimin e vlerave shoqërore, njerëzore. Ka mundësi që krejt kjo të kryhet edhe pa asnjë spiun zyrtar me betim të vetëm. Supozojmë se SHMS-të angazhojnë vetëm një spiun zyrtar me betim. Ky spiun duhet të jetë në pozitë të lartë të udhëheqjes, ose Kryetar i Këshillit Drejtues ose Kryetar i Komisionit të Auditimit të Brendshëm, ose duhet të jetë në pozitë të lartë të udhëheqjes, që mjafton të jetë Drejtor i Burimeve Njerëzore, Drejtor për Punë Ligjore etj.

Nëse SHMS-të kanë strukturë të veprimit që mundëson të mos angazhohet asnjë spiun në këtë ndërmarrje publike edhe mund të mos angazhohet asnjë spiun zyrtar me betim të SHMS-ve. Spiunët mund të kryejnë detyrat edhe nga jashtë ndërmarrjes pa problem, mjafton që në rrethin e vet të njerëzve, të ketë bashkëpunëtorë me dijeni të vendosur në njërën ose në disa nga pozitat e larta të udhëheqjes si: Kryetar i Këshillit Drejtues, ose Kryetar i Komisionit të Auditimit të Brendshëm, ose duhet jetë në pozitë të lartë të udhëheqjes që mjafton të jetë Drejtor Ekzekutiv, Drejtor i Burimeve Njerëzore, Drejtor për Punë Ligjore.

Shtrohet pyetja: si nga jashtë ndërmarrja?

Këshilli Udhëheqës i ndërmarrjes publike, emërohet nga partia politike që ka dalur fitimtare në zgjedhje. Mjafton që spiuni ose bashkëpunëtori me dijeni i SHMS-ve të jetë në post të lartë të partisë politike fitimtare, që i mjafton të mundësojë emërimin e individëve të përzgjedhur sipas kritereve dhe filtrave, ku lakmia është kryesorja. Këta individë pastaj të shtyrë nga lakmia, si motor i fuqishëm, zbatojnë me përpikëri të gjitha udhëzimet nga "shefi" që në fakt

është spiuni i SHMS-ve, që u jep detyra këtyre individëve. Ky spiuni, ose mund të jenë disa spiunë të SHMS-ve, për të fshehur veprimet, iu fshijnë trurin këtyre lakmitarëve përmes ideologjizimit, ku p.sh., nëse partia politike fitimtare është e luftës, të tjerët që pengojnë i ngjyrosë si kundërshtues të luftës, mospërkrahës i luftës e lloj-lloj epitetesh, dhe nëse partia politike fitimtare është e paqes, të tjerët që pengojnë i ngjyrosë si enverista, të majtë, etj.

Anëtarët e Këshillit Udhëheqës të ndërmarrjes publike të përzgjedhur në këtë mënyrë, pastaj përzgjedhin gjithë drejtuesit e ndërmarrjes, duke përdorur kritere të njëjta siç janë emëruar vetë, përfshi edhe punësimet, kuptohet të gjitha në bazë të porosive të "shefit" , ose "të shefave" jashtë ndërmarrjes, që zakonisht janë kafenetë dhe restorantet. Të gjitha emërimet, përzgjedhjet dhe punësimet në këtë mënyrë, janë në përputhje me politikat dhe programet e Serbisë për Kosovën.

Të gjitha veprimet konkrete të bartësve konkretë, filluar nga anëtarët e Këshillit Udhëheqës, në këtë mënyrë, janë kryer nga individë që nuk janë spiunë a bashkëpunëtorë me dijeni të SHMS-ve, por që janë shndërruar në bashkëpunëtorë, ku disa mund të kenë dijeni ose pak dijeni, kurse shumica absolute nuk kanë aspak dijeni se janë bashkëpunëtorë të SHMS-ve. Të gjithë këta individë, që janë bartës të vlerave shoqërore, të dëmshme për Kosovën, kanë zënë postet dhe vendet e punës të individëve që kanë qenë ose që do të duhej të ishin bartës të vlerave shoqërore, njerëzore, të dobishme për Kosovën. Në këtë mënyrë, kjo ndërmarrje publike u shndërrua në makineri të shtypjes dhe të lartësimit të vlerave shoqërore, njerëzore, siç është përshkruar më lart në këtë publikim.

Ndërtimi dhe funksionimi i makinerisë së shtypjes dhe lartësimit të vlerave shoqërore, njerëzore, zbërthehet dhe kuptohet më mirë gjithashtu përmes shembujve tjerë konkretë. Derisa ishte duke u shkruar ky libër, autori bisedonte me individë të ndryshëm në lidhje me veprimtarinë e SHMS-ve, pas luftës së fundit. Në një rast, njëri nga bashkëbiseduesit thotë: "Si është e mundur që vëllezërit e mi, kushërinjtë e mi të punojnë për SHMS-të, jam i sigurt se lidhje me SHMS-të asnjëri nga ata nuk ka. Pothuajse të gjithë ata, rrejnë, kur munden mashtrojnë, me një fjalë i bien telit të njëjtë, që i bien edhe spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve, njëjtë sikur t'i kishin marrë detyrat nga ta".

Shpjegimi që iu dha bashkëbiseduesit, ishte se SHMS-të, në vazhdimësi dhe për periudhë shumë të gjatë, kanë vendosur në pozita qendrore të larta shoqërore, individë me vlera negative për shoqërinë. Këta individë në

vazhdimësi kanë rrejtë, kanë mashtruar, kanë tradhtuar, etj. Po ashtu këta individë me poste të larta, në vazhdimësi kanë ngritur lart dhe kanë avancuar në pozita shoqërore individët tjerë siç janë vetë dhe kanë shkelur poshtë individët tjerë me vlera pozitive për shoqërinë. Vëllezërit dhe kushërinjtë e bashkëbiseduesit, duke parë për periudhë të gjatë se vetëm ata që rrejnë dhe mashtrojnë, mund të mbesin gjallë dhe të përballojnë jetën, sillen dhe veprojnë në këtë mënyrë, nuk mund të mendojnë se pa rrejtë, pa mashtruar etj. mund të ndërtohet ardhmëria. Në këtë mënyrë, vëllezërit dhe kushërinjtë e bashkëbiseduesit pa e ditur fare, japin ndihmesë të çmueshme dhe kontribuojnë në funksionimin e makinerisë së shtypjes dhe lartësimit të vlerave shoqërore, njerëzore në Kosovë sipas programit të SHMS-ve.

Ngjajshëm me bisedën e cekur më lart, autori ka patur edhe me vëllain e vet më të vogël. Ka qenë diku viti 2005 – 2006 kur vëllai i vogël shprehet:

"Prej se t'mbaj mend unë ty vëllau jem, ti gjithë ke folë kështu po kurrë nuk u bë qysh po thu ti".
Autori vazdimisht i thoshte vëllait të vogël: "Të gjithë ata që rrejnë, mashtrojnë e kryejnë punë të këqija ndëshkohen. Të gjithë ata që shkelin ligjin, japin përgjegjësi para institucioneve të zbatimit të ligjit".

Autori vazhdon të flasë edhe tani se të gjithë ata që rrejnë e mashtrojnë, ndëshkohen nga shoqëria dhe të gjithë ata që shkelin ligjin, japin përgjegjësi para institucioneve të drejtësisë. E vërteta është se edhe në të kaluarën, në vazhdimësi, dhe ende edhe tani, shoqëria nuk po arrinë të ndëshkojë ata që rrejnë e mashtrojnë, dhe institucionet e drejtësisë nuk po arrijnë që t'i bëjnë përgjegjës ata që shkelin ligjin. Kjo e vërtetë dhe ky realitet shpreh funksionalitetin dhe efikasitetin e makinerisë së shtypjes dhe lartësimit të vlerave shoqërore, njerëzore, në Kosovë, të ndërtuar dhe të mirëmbajtur në funksion nga SHMS-të.

VEPRIMTARIA E SHIKU-ut DHE SIA-së SI FILIALA TË SHMS-ve, NË KOSOVË

Veprimtaria e SHIK-ut është një nga temat më të diskutuara, sidomos në vitet e fundit. SIA ka qenë diskutuese para disa viteve dhe tani pothuajse është harruar. Edhe krijimi i SHIK-ut edhe krijimi i SIA-së, kanë patur rol dhe funksion të njëjtë, vetëm se detyrat kanë qenë të ndara. Në këtë pjesë të librit, shtjellimi do të bëhet kryesisht për SHIK-un, për faktin e nivelit të shtrirjes së veprimtarisë në krahasim me SIA-në.

Trajtimi i veprimtarisë së SHMS-ve kundrejt SHIK-ut si organizatë, në këtë libër, bëhet njëjtë sikur edhe trajtimi i veprimtarisë së SHMS-ve, kundrejt të gjitha institucioneve dhe organizatave tjera që veprojnë në Kosovën e pasluftës së fundit. Prania e SHMS-ve në SHIK, njëjtë sikur gjetiu, ka qenë e mjaftueshme për të patur nën kontroll këtë organizatë dhe veprimtarinë e saj, mirëpo jo të gjithë anëtarët e SHIK-ut, kanë qenë spiunë zyrtarë me betim. Në fakt, spiunë zyrtarë me betim kanë qenë shumë pak. shumica kanë vepruar pa dijeni, bile edhe kanë besuar se po kryejnë punën më të mirë të mundshme për atdheun. Edhe veprimet e SHIK-ut nuk kanë qenë krejtësisht veprime të SHMS-ve, ka patur veprime që kanë qenë të dobishme për Kosovën.

SHIK-u edhe nga vetë udhëheqësi i saj edhe nga të tjerët, është vlerësuar si një organizatë me veprimtari të shërbimeve të mshefta. SHIK-u është një strukturë e organizuar dhe funksionale e cila nga vetë prijësi i kësaj organizate në prag të miratimit të Kushtetutës së Kosovës u deklarua se pushoi veprimtarinë e vet. Shumçka dhe pothuajse gjithçka rreth veprimtarisë së SHIK-ut ka qenë dhe vazhdon të jetë e diskutueshme dhe me shumë dilema. Të gjitha këto dilema rrjedhin nga disa arsye, që po paraqesim në vijim:

- Krijimi i kësaj organizate

  Asnjëherë deri më tani nuk është ndriçuar plotësisht se si u krijua kjo organizatë. Pavarësisht kësaj, një gjë është dokumentuar dhe është e qartë se kjo organizatë nuk është krijuar nga institucionet e Kosovës.

- Kompetencat, përgjegjësia dhe llogaridhënia

  Asnjëherë deri më tani nuk është ndriçuar plotësisht se cilat kanë qenë kompetencat e kësaj organizate, cilat kanë qenë përgjegjësitë në punë të kësaj organizate dhe para kujt kanë ushtruar llogaridhënie pjesëtarët e kësaj organizate, si dhe vetë kreu i kësaj organizate. Pavarësisht të gjitha këtyre, janë të ditura se pjesëtarët e kësaj organizate kanë marrë kompetencat nga ata që kanë krijuar këtë organizatë, kanë qenë përgjegjës para atyre që kanë krijuar këtë organizatë, dhe se janë mbajtur llogaridhënës para atyre që kanë krijuar këtë organizatë.

- Frytet e punës

Asnjëherë deri më tani nuk është ndriçuar plotësisht se cilat kanë qenë frytet e punës së kësaj organizate dhe se kush i ka marrë në shfrytëzim këto fryte të punës. Pavarësisht kësaj, është e ditur se frytet e punës së kësaj organizate i kanë shfrytëzuar ata që e kanë krijuar këtë organizatë.

Në lidhje me SHIK-un, meqë kjo organizatë nuk është krijuar nga institucionet e Kosovës, mbetet të ndriçohet se nga kush është krijuar. Ajo që është ndriçuar deri më tani, është se kjo organizatë është krijuar nga krerët e SHIK-ut, të njohur për publikun. Krerët që kanë themeluar SHIK-un në atë kohë kanë qenë në funksion ekzekutiv (Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme) dhe jo në funksion të marrjes së vendimit për themelimin e SHIK-ut. Është Kuvendi i Kosovës institucioni për marrje të vendimeve të tilla dhe jo Kryeministria.

Bazuar në rrethanat e kohës, vendimi për themelimin e SHIK-ut është marrë nga SHMS-të dhe është zbatuar nga krerët e themelimit të SHIK-ut. Ndërtimi i një organizate aq të fuqishme sikur SHIK-u, kërkon resurse shumë të mëdha, kërkon njohuri dhe ekspërtiza të shumë fushave. Krerët që kanë themeluar SHIK-un, nga paraqitjet e tyre publike të deritanishme, nuk kanë ofruar asnjë dëshmi se kanë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për krijimin dhe fuqizimin e një organizate të tillë.

Meqë këta krerë krijues të SHIK-ut nuk i kanë zotësitë e nevojshme për krijimin e organizatës së SHIK-ut, shtrohet pyetja: kush me të vërtetë e krijoi SHIK-un?

Të gjitha shenjat që dalin në dritë, dëshmojnë se SHIK-u është krijuar nga SHMS-të. Këtë e fuqizon edhe fakti se në Kosovë krijime të tilla deri tani kanë qenë të kryera vetëm nga SHMS-të. Strukturat si SHIK-u, por edhe strukturat tjera te ngjajshme si SIA etj. janë forma më e përshtatshme për SHMS-të , të shtrijnë praninë e tyre në rrethanat e krijuara pas luftës së fundit në Kosovë. Dëshirohet që ndriçimet në të ardhmën të dëshmojnë se ky mendim është i gabuar.

Shtrohet pyetja: Pse SHMS-të kanë krijuar SHIK-un dhe SIA-në?

Dy janë qëllimet kryersore:

1) Në zhvillimet normale, kur një popull ndërton lëvizje çlirimtare siç kanë qenë lëvizjet e shqiptarëve të Kosovës dhe kur këto lëvizje arrijnë nivelin e një lufte e cila përfundon me çlirim, pas çlirimit forcat çlirimtare ndërtojnë institucionet shtetërore pëfshi institucionet e

asnjëra nga këto shërbime nuk kanë pushuar veprimtarinë. Të gjitha këto shërbime i janë përshtatur rrethanave të reja, kanë krijuar organizata joformale nga pjesëtarët e këtyre shërbimeve të cilat kanë eliminuar edhe fizikisht pjesëtarë tjerë të po këtyre shërbimeve dhe njerëz të tjerë që ju kanë paraqitur probleme. Këto organizata, veprimtarinë e tyre e kanë shtrirë në përvetësim të pasurive shtetërore dhe në ndërtim të kapitaleve duke filluar nga privatizimet deri te trafikimet dhe veprimtaritë tjera kriminale.

- SHMS-të çdoherë kanë ndërruar formën e veprimit, varësisht nga rrethanat e krijuara, por asnjëherë nuk e kanë shuar veprimtarinë e tyre në Kosovë dhe as që pritet të shuajnë ndonjëherë këtë veprimtari. Edhe veprimtaria e SHIK-ut si pjesë e veprimtarisë së SHMS-ve, nuk ka shuar veprimtarinë e vet, vetëm se u është përshtatur rrethanave për veprim dhe se nuk do të shuajnë lehtë veprimtarinë e vet.

Edhepse veprimtaria e SHIK-ut ka qenë e msheftë dhe se kurrë nuk u shpalos nga krerët e saj asnjë lloj pune a rezultati i punës, diçka nga puna e kësaj organizate ka mund të shihet nga qytetari i zakonshëm. Puna dhe rezultatet e punës së SHIK-ut mund të përmblidhet në dy fusha:

1) Krijimi dhe fuqizimi i konflikteve dhe ngatërresave

   Në pjesët e mëparme të librit është paraqitur krijimi dhe fuqizimi i konflikteve dhe ngatërresave si njëra nga veçoritë e veprimtarisë së SHMS-ve. Krijimi dhe fuqizimi i konflikteve dhe ngatërresave është kryer në vazhdimësi nga SHMS-të, mirëpo, pjesëtarët e SHIK-u kanë arritur fuqizimin më të lartë të njohur në Kosovë deri më tani. Autori nuk beson se në kohën e Rankoviqit mund të ketë qenë afërsisht njëjtë niveli i prishjes së marrëdhënieve ndërnjerëzore, e shprehur përmes shkallës së konflikteve dhe ngatërresave ndërnjerëzore, prishja e martesave, etj.,siç është tani pas veprimtarisë së pjesëtarëve të SHIK-ut.

2) Filtrimi dhe infiltrimi i individëve në ndërtimin e institucioneve dhe jetës institucionale

   SHMS-të, qysh nga përfundimi i luftës së fundit kanë kryer infiltrimin dhe filtrimin e individëve në ndërtimin e institucioneve dhe jetës institucionale. Infiltrimi dhe filtrimi është kryer edhe më parë pa SHIK-un. Mirëpo, infiltrimi dhe filtrimi masiv deri në absolutizëm, është arritur vetëm përmes pjesëtarëve të SHIK-ut, sidomos kur krerët e SHIK-ut morën pushtetin. Sot, rrallë mund të gjendet ndonjë institucion

që SHMS-të nuk e kanë plotësisht nën kontroll, falë infiltrimit dhe filtrimit të kryer nga SHMS-të, përmes SHIK-ut.

SHMS-të kanë vepruar në Kosovë edhe jashtë strukturave të SHIK-ut, mirëpo, arritja e caqeve të tyre është arritur kur krerë të SHIK-ut kanë marrë pushtetin. Sot, lehtë mund të shihet se në Kosovë janë duke funksionuar shkelqyeshëm të gjitha sistemet dhe nënsistemet e paraqitura në pjesët e mëparme të librit, si dhe tërësia e këtyre sistemeve, si makineri e shtypjes dhe lartësimit të vlerave shoqërore, njerëzore, siç janë paraqitur në pjesët e mëparme të librit. Me fjalë tjera, është instaluar plotësisht neo-kolonializmi, siç na është mësuar nga socializmi.

PSE INDIVIDËT BËHEN SPIUNË ZYRTARË ME BETIM A BASHKËPUNËTORË TË SHMS-VE

Sigurisht, armata e spiunëve dhe bashkëtpunëtorëve të SHMS-ve është krijuar në bazë të disa rregullave dhe kritereve të përpunuara mirë nga SHMS-të. Kriteri themeltar i zbatuar në krijimin e bashkëpunëtorëve është lakmia. Një individ, për t'u kualifikuar se mund të bëhet spiun zyrtar me betim ose bashkëpunëtor, duhet të jetë lakmitar, nëse është lakmitar kualifikohet dhe nëse nuk është lakmitar diskualifikohet.

Kriteri i lakmisë është shumë efikas për veprimtarinë e SHMS-ve, garanton kryerje të sigurtë të të gjitha detyrave. Një individ që është lakmitar, nëse fillohet t'i plotësohet lakmia, nuk ka të ndalur sepse sa më shumë që i plotësohet lakmia aq më shumë i shtohet oreksi. Në këtë mënyrë, lakmia shndërrohet në një motiv të fuqishëm. Në fakt, lakmia është një motor i fuqishëm, që jo vetëm se nuk ndalet kurrë, por që fuqizohet në vazhdimësi, se sa ma shumë që plotësohet lakmia ajo rritet dhe në këtë mënyrë fuqizohet motivi si motor i veprimit.

Është e nevojshme që të bëhet e kuptueshme se ka raste kur lakmia edhe pse përdoret në shumicën absolute të rasteve, nuk është kriteri i vetëm i kualifikimit nga SHMS-të për të kualifikuar dikë që të bëhet spiun zyrtar me betim a bashkëpunëtor.

Në raste të caktuara, SHMS-të kanë përdorur dhe përdorin shantazhin si kriter themeltar të kualifikimit. Në raste të caktuara, vetë kanë krijuar raste ose krijojnë raste të shantazhimit për të rekrutuar dikë në spiun zyrtar me betim a bashkëpunëtor të SHMS-ve. Individët që janë rekrutuar përmes shantazhit si bashkëpunëtor, në të kaluarën dhe deri tani, ose përfundojnë si

spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtor me dijeni të SHMS-ve ose dalin jashtë ushtrimit të veprimtarisë. Shumë prej individëve fillimisht të rekrutuar përmes shantazhit u shplohet lakmia dhe kalojnë në spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë me dijeni. Një thënie italiane shpreh diçka kësisoj: duke ngrënë të shtohet oreksi.

Fillimisht, individët motivohen për të punuar me SHMS-të, në shkëmbim të ndonjë dobie materiale a interesi personal. Kjo e mirë materiale ose interes personal, në fillim zakonisht nuk është diçka e madhe. Edhe detyra që individi kryen për SHMS-të, në fillim është e vogël. Individi mendon se çka merret vesh në interesa të Kosovës kjo detyrë që e kryej unë, është cikërrimë. Më vonë shtohet oreksi, "hajt more se nuk merret vesh, çka varet Kosova prej këtyre punëve që po i kryej unë", ose, "çka po ma ninë mue për Kosovën, kur unë i bëj punët e mija ma mirë, jetoj mirë, etj."

Në të vërtetë, detyrat që një individ i kryen për SHMS-të, në shumicën e rasteve në shikim të parë mund të duken se nuk çojnë shumë peshë në interesin e Kosovës. Kjo duket kësisoj, kur është vetëm një individ, por kur janë p.sh. 50.000 ushtarë që kryejnë detyra, kush më shumë e kush më pak, çka bëhet me interesat e Kosovës? Po në rastet kur individi është në krye të institucionit të lartë të Kosovës, siç janë një nga dy partitë më të mëdha politike dhe kryen një detyrë të SHMS-ve, çfarë bëhet me interesat e Kosovës? Po kur spiuni zyrtar me betim i SHMS-ve është në krye të njërës nga dy partitë më të mëdha politike dhe kryen, jo një, po shumë detyra të SHMS-ve, çfarë bëhet me interesat e Kosovës?

Në të gjitha rastet individuale, të cilitdo lloj të kryerjes së detyrave të SHMS-ve arrihet efekti sipas motos "gurë gurë bëhet mur" , në realizimin e politikave dhe programeve të Serbisë për Kosovën.

Lakmia si kriter kualifikues përdoret nga SHMS-të, jo vetëm për spiunët zyrtarë me betim, por edhe për bashkëpunëtorët, si për bashkëpunëtorët që janë në dijeni se janë bashkëpunëtorë të SHMS-ve, ashtu edhe për bashkëpunëtorët që nuk janë në dijeni se janë bashkëpunëtorë. Këta bashkëpunëtorë që nuk janë në dijeni, përbëjnë shumicën dërrmuse të bashkëpunëtorëve.

Fuqia motorike e lakmisë mund të bëhet më e ditur për lexuesin, nëse marrim si shembull të rekrutuarit bashkëpunëtorë a spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve, në fillim të luftës së fundit në Kosovë dhe atë, individët që iu ka përkitur të dy drejtimeve politike të njohura më vonë si blloqe politike (i luftës dhe i paqes). Në fillim, këta bashkëpunëtorë dhe spiunë, si lakmi

kishin si të arrinin të përvetësonin për nevoja personale 10.000 DM. pastaj si të përvetësonin 50.000 DM, më pastaj 100.000 DM. Ky nivel i lakmisë ishte gjatë kohës së luftës, kurse pas lufte këtyre u shtohet lakmia. veç për nga një zero. Fillimisht pas lufte lakmia ishte se si të përvetësohen 1.000.000 DM. pastaj 10.000.000 EUR, pastaj 100.000.000 EUR dhe tani kanë në synim ndërtimin e perandorive të biznesit dhe lakmojnë se si të arrijnë tek 1 miliard EUR. Këta lakmitarë, sa ma shumë që hanë, aq më shumë iu shtohet uria.

FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË SHMS-ve

Në lidhje me veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë, çështja e financimit është shumë me interes që të ndriçohet dhe të kuptohet nga qytetari i zakonshëm. Siç u bë e njohur, tani për tani janë 720 spiunë zyrtarë me betim të SHMS-ve në Kosovë, që bëjnë sa 70 batalione ushtarake. Këta 720 spiunë dhe batalionet e tyre tani për tani janë duke mbajtur në funksion dhe janë duke mirëmbajtur funksionimin e sistemeve të vlerave shoqërore, njerëzore, të cilat janë shtjelluar në paragrafët paraprakë. Logjika të shtyn në konkludim se ka edhe sisteme tjera të cilat janë duke u mirëmbajtur në funksion nga këta spiunë dhe bashkëpunëtorë dhe që nuk janë përmendur në këtë publikim. Sigurisht, e gjithë makineria e SHMS-ve si tërësi e sistemeve funksionale, lëviz dhe fuqizohet përmes interesit financiar që kanë spiunët zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorët me dijeni e pa dijeni.

Mendojmë se paga për punën e rregulltë në baza mujore mund të praktikohet për spiunët zyrtarë me betim dhe ndoshta ndonjë nga bashkëpunëtorët me dijeni, që ose ka qenë spiun me betim në të kaluarën, ose është në garë që potencialisht të fitojë statusin e spiunit me betim në të ardhmen. Numri prej 720 spiunëve me betim dhe numri i të tjerëve që ose kanë patur në të kaluarën, ose që potencialisht mund të marrin statusin e spiunit me betim në të ardhmen, nuk është aq i madh për të mbajtur në funksion dhe për të mirëmbajtur funksionimin e makinerisë së SHMS-ve si tërësi e sistemeve në Kosovë. Edhe paga për spiunët me betim në baza mujore nuk mund të jetë aq e madhe dhe po të bëhej publike kjo shumë do të ishte ndoshta qesharake për shumë nga qytetarët e zakonshëm.

Në përgjithësi, pagesa e drejtpërdrejtë në formë të pagës e institucioneve të Serbisë, në baza të rregullta mujore e të gjithë spiunëve me betim nuk është e mjaftueshme për mirëmbajtjen në funksion të sistemeve të SHMS-ve në Kosovë. Me siguri se vetëm nga kjo pagë nuk ka as gjasa minimale që të mirëmbahen në funksion sistemet që SHMS-të kanë ndërtuar në Kosovë.

Veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë nuk përbëhet vetëm nga spiunët me betim dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve në Kosovë. Spiunët me betim dhe bashkëpunëtorët, krejt punët që kryejnë, janë mbledhja dhe grumbullimi i informatave të kërkuara nga SHMS-të, dërgimi i këtyre informatave në qendrat e përpunimit në Beograd (në "laboratorët e Serbisë") dhe zbatimi i detyrave të marra nga qendrat e vendosjes.

Financimi i veprimtarisë së SHMS-ve nga Serbia është kryesisht i kufizuar në financimin e të punësuarëve në institucionet e pranimit, të analizimit dhe përpunimeve tjera të nevojshme dhe të vendimmarrësve. Të punësuarit në këto institucione shtetërore të Serbisë, pa dyshim se financohen drejpërdrejt nga buxheti i Serbisë. Financimet tjera të Serbisë janë minimale, janë tepër minimale, për faktin se nuk ka nevojë dhe në rastet kur ka nevojë, sigurisht që Serbia nuk kursen financimet. Kufizimi i vetëm në financim nga Serbia do të ishte analiza e "kushtueshmërisë-dobive" ("cost-benefit analysis").

Nëse pagesa e shpërblimeve në baza të rregullta mujore nuk është as përafërsisht e mjaftueshme për ndërtimin e sistemeve dhe për mirëmbajtjen në funksion të sistemeve dhe se e gjithë makineria si tërësi e sistemeve të SHMS-ve në Kosovë ushqehet dhe fuqizohet nga interesi financiar i spiunëve me betim dhe bashkëpunëtorëve, shtrohet pyetja, si nxirren interesat financiare të spiunëve me betim dhe të bashkëpunëtorëve të SHMS-ve?

Përgjigjja në këtë pyetje është se këta spiunë dhe bashkëpunëtorë, interesat financiare i nxjerrin në mënyra të ndryshme, por që mund të përmblidhen në tri kategori kryesore:

1) Paratë e buxhetit të Serbisë (siç u shtjellua në paragrafët paraprakë),

2) Paratë e buxhetit të Kosovës dhe paratë e donatorëve, dhe

3) Paratë nga krimi (trafiqet, pastrimi i parave, etj).

Financimet nga kategoria e parë e paraqitur më lart, u shtjellua deri në një masë. Financimi nga kategoria e tretë e paraqitur më lart, ndoshta nuk do të ishte shumë interesante të shtjellohet për qytetarin e zakonshëm për arsye se shumçka vetëkuptohet. Po ashtu edhe në mungesë të njohurive dhe përvojave të kësaj fushe, nuk do të shtjellohen proceset e financimit të veprimtarisë së SHMS-ve nga paratë e krimit. Mendojmë se kategoria më me interes për t'u

ndriçuar, për qytetarin e zakonshëm, është kategoria e financimit nga paratë e buxhetit të Kosovës.
Në përpjekje për të kontribuar në ndriçmin e financimit të veprimtarisë së SHMS-ve nga paratë e buxhetit të Kosovës, disa nga format e financimit janë paraqitur në vijim:

i) Nga tenderët e financuar nga paraja publike,

ii) Nga ngritjet dhe avancimet në poste publike, punësimet. e të ngjajshme,

iii) Nga manovrimet me transaksione biznesore përmes spiunëve me betim dhe bashkëpunëtorëve në të mirë të biznesmenëve spiunë me betim dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve,

iv) Nga privilegjet biznesore, eliminimet e konkurrencës e të ngjajshme përmes institucioneve shtetërore si: tatimet, doganat, agjensionet që duhet të jenë të pavarura, etj. për biznesmenët që janë spiunë me betim ose bashkëpunëtorë të SHMS-ve,

v) Nga ofrimi i mbrojtjes së interesave përmes institucioneve të hetuesisë, të prokurorisë, të gjyqësisë dhe institucioneve tjera të ngjajshme për spiunët me betim dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve.

vi) Avancimi, privilegjimi dhe fuqizimi i të ashtuquajturve profesionistë të të gjitha fushave, e që në fakt janë improvizues profesionalë, përmes rrjetit të spiunëve me betim dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, të pozicionuar nëpër intitucionet e Kosovës.

Financimi i veprimtarisë së SHMS-ve kryhet në pjesën më të madhe nga paratë e taksapaguesve të Kosovës. Shpenzimi i parasë së taksapaguesve të Serbisë, për financimin e veprimtarisë së SHMS-ve është tepër minimal, është i kufizuar vetëm në pagesat në baza të rregullta mujore për spiunët me betim dhe bashkëpunëtorët, që janë tepër simbolike. Para tjetër e taksapaguesve të Serbisë shpenzohet për financimin e instituteve dhe institucioneve që funksionojnë, si Qendra të SHMS-ve në Serbi.

Nuk ka nevojë për shpenzime tjera të parasë së taksapaguesve të Serbisë, meqë sistemet e ndërtuara nga SHMS-të në Kosovë funksionojnë dhe mirëmbahen me shumë efikasitet pa patur nevojë për shpenzime të financuara nga buxheti i Serbisë. Mënyrat e shpërblimit, të paraqitura në

paragrafët paraprakë, nga nr. i) deri në nr. vi) por edhe mënyra tjera që mund të mos jenë paraqitur në këtë publikim, janë mjaftueshëm tërheqëse për të patur edhe konkurrencë të forte, për të qenë pjesë e sistemeve të ndërtuara nga SHMS-të dhe atë sidomos për të qenë në majat e sistemeve.

Edhe mënyrat e financimit në paragrafët paraprakë nga nr. i) deri në nr. vi) dhe edhe mënyrat tjera që mund të mos jenë paraqitur në këtë publikim, kanë si burim në fund të fundit paranë e taksapaguesve të Kosovës. Të gjitha këto lloje të financimit gjithashu janë të bazuara në moszbatim të ligjit në Kosovë.

Nuk mund të ketë mënyrë të financimit të veprimtarisë së SHMS-ve, pa shkelur disi ligjin e Kosovës. Forcimi i zbatimit të ligjit në Kosovë, zvogëlon burimet e financimit të veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë. Me zvogëlimin e burimeve të financimit, zvogëlohet edhe veprimtaria e tyre në Kosovë. Është pikërisht moszbatimi i ligjit ajo çka përbën fuqinë më të madhe të veprimtarisë së tillë në Kosovë.

SI DUHET TRAJTUAR SPIUNËT ZYRTARË ME BETIM DHE BASHKËPUNËTORËT E SHMS-ve

Numri i spiunëve zyrtarë me betim dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve nuk është aspak i vogël, në raport me popullësinë dhe madhësinë territoriale të Kosovës, përkundrazi mendojmë se numri është tepër i madh për një vend të vogël siç është Kosova. Këta spiunë dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve, janë qytetarë të Kosovës, si dhe kanë familjet dhe farefisin e tyre në Kosovë. Prandaj, edhe trajtimi që duhet t'u bëhet këtyre individëve është shumë me rëndësi për Kosovën. Veprimtaria e këtyre individëve është shumëdimensionale, por edhe veprimet konkrete të tyre janë shumë të ndryshme. Meqë këta individë janë qytetarë të Kosovës, trajtimi që duhet t'u bëhet këtyre është trajtim që u bëhet qytetarëve të Kosovës.

Edhe pse veprimtaria e këtyre individëve është e msheftë, së paku disa nga veprimet e tyre mund të jenë të ditura dhe në këtë mënyrë të dokumentueshme. Gjithsesi, disa nga individët mund të jenë të identifikueshëm si të dyshimtë në bazë të veprimeve të tyre, mirëpo gjithashtu, gjithsesi shumë prej këtyre individëve nuk mund as të identifikohen si të dyshimtë në bazë të veprimeve të tyre. Edhe po të identifikohen disa individë si të dyshimtë, do të duhej kohë dhe punë shumë serioze e institucioneve tona shtetërore për të mbledhur dëshmi për t'i faktkuar këto lloje veprimesh dhe këshilloj veprimtarie. Marrë parasysh

brishtësinë e institucioneve tona, marrë parasysh jofunksionalitetin dhe joefikasitetin e institucioneve tona, dokumentimi dhe faktimi i veprimeve të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve në Kosovë është diçka që nuk mund të pritet, së paku edhe për disa vite të ardhshme.

Mënyra më e mirë dhe më e drejtë, por edhe më e lehtë për institucionet e Kosovës, e identifikimit të këtyre individëve, do të ishte sikur Serbia të bënte publike listën me emra të spiunëve zyrtarë me betim të SHMS-ve. Por, bërja publike nga ana e Serbisë e spiunëve të vet në kushte normale, nuk del të jetë e pritshme. Edhe pse mund të mos jetë e pritshme nuk është edhe e pamundur, sepse:

Kosova dhe Serbia janë në fazën e normalizimit të marrëdhënieve. Logjikisht, nuk mund të ketë marrëdhënie normale në mes të Kosovës dhe Serbisë, kur Serbia ka në Kosovë prani aq të madhe të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të shërbimeve të mshefta.

Nëse vërtet Brukseli kërkon që marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës të jenë normale, çështja e pranisë së veprimtarisë së SHMS-ve duhet të jetë çështje për të cilën duhet biseduar dhe duhet gjetur zgjidhje të pranueshme për të dy palët. Serbia ka patur në Kosovë edhe veprimtari tjera të paligjshme dhe të papranueshme për bashkësinë ndërkombëtare, mirëpo me kërkesën e bashkësisë ndërkombëtare, Serbia ka ndërprerë këto lloj veprimtarish.

Bashkësia ndërkombëtare për të normalizuar marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të kërkojë nga Serbia që të ketë marrëveshje për veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë dhe të ndërpresë veprimet e tyre në Kosovë. Shtrirja e pranisë së spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve në Kosovë është në përmasa shqetësuese. Pengimi i institucioneve të Kosovës për t'u bërë funksionale dhe efikase, ka frenuar zhvilllimin e Kosovës deri në bllokim të zhvillimit që sheshazi shihet në vitet e fundit.

Qytetarët e zakonshëm mund të kërkojnë që të marrin vetë fatin e tyre në duart e veta. Kjo do të sillte trazira shoqërore dhe gjendje shumë të keqe deri në përplasje civile. Një Kosovë me trazira shoqërore nuk i duhet askujt dhe as bashkësisë ndërkombëtare. I gjithë mundi dhe përpjekja për ndërtimin e shoqërisë Kosovare me rend shoqëror demokratik dhe të sundimit të ligjit, do të dëmtoheshin rëndë.

Deri më tani, të paktën jo publikisht, çështja e veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë nuk është përmendur nga askush, që të jetë njëra nga pikat e rendit të bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Si të përmendet kjo çështje si

temë për bisedime, kur çështja e veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë nuk ngritet nga askush si çështje as brenda shoqërisë Kosovare. Në këto kushte heshtjesh absolute dhe sidomos të heshtjes së institucioneve të Kosovës, krejt çka mund të bëhet është që qytetarit të zakonshëm t'i bëhen sa më shumë publike të gjitha njohuritë dhe përvojat personal që kanë të bëjnë me veprimet e SHMS-ve dhe me bartësit e këtyre veprimeve.

Do të ishte shumë me rëndësi që të identifikohen nga qytetarët e zakonshëm, indvidët bartës të veprimeve të SHMS-ve në Kosovë dhe të bëhet së paku ndëshkimi shoqëror ndaj tyre (siç thuhet tek anglezët "name and shame" – që në shqip i bie "emëroji dhe merrjua fytyrën"). Sigurisht se ndëshkimi institucional është ndëshkimi i duhur.

Po që se kjo çështje do të ngritej nga institucionet e Kosovës dhe të arrijnë që të fusin si pjesë e bisedimeve për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, kjo do të ishte zgjedhja më e mirë. Kuptohet se në interes të Kosovës dhe në interes të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është ndriçimi i listës me emrat e individëve që kanë qenë aktivë dhe janë aktivë pas vitit 1990 dhe pas luftës së fundit.

Po që se në mënyrë institucionale do trajtohej kjo çështje, po që se do të ndriçohej lista e plotë me emrat e spiunëve të SHMS-ve dhe po që se do të ndriçoheshin veprimet e këtyre individëve, do të mund të ishte e arsyeshme që një pjesë e veprave të dënoheshin dhe një pjesë e veprave të amnistoheshin. Në këtë mënyrë do të mund të normalizoheshin marrëdhëniet në mes Kosovës dhe Serbisë.

Në lidhje me individët që kanë punuar dhe që punojnë si spiunë të SHMS-ve, autori gjykon se trajtimi nga shoqëria e Kosovës, i veprimtarisë së tyre, duhet të ndahet në periudha kohore. Trajtimi nga shoqëria Kosovare duhet të kryhet njëjtë edhe për të gjithë individët, të cilët në cilëndo formë kanë punuar dhe kanë shërbyer për sistemin Jugosllav, si ata të fushës së administratës publike, gazetarisë, politikës, ekonomisë, mbrojtjes dhe sigurisë, shkencës; me një fjalë të gjithë.

Trajtimi i spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, sipas periudhave kohore konsiderohet të jetë i arsyeshëm, siç është paraqitur në vijim:

1) Periudha deri në fillim-vitet '90-ta

Thirrja gjithëpopullore në fillim të vieteve '90 për braktisjen e punës për institucionet e Serbisë, ka qenë stacioni i parë. Të gjithë ata që kanë

braktisur veprimtarinë për institucionet e Serbisë në këtë kohë, kanë barazuar vetën e tyre me të tjerët që kurrë nuk kanë punuar për institucionet e Serbisë. Këtu është fjala për ata të cilët vërtet kurrë mëpastaj nuk kanë "përzie" kurrgjë me institucionet e Serbisë.

2) Përfundimi i luftës së fundit

Përfundimi i luftës së fundit ka qenë stacioni i dytë për t'u larguar nga veprimtaria me institucionet e Serbisë. Individët që kanë vepruar për institucionet e Serbisë nga stacioni i parë deri në stacionin e dytë, janë përzierje e atyre që kanë patur frikë, atyre që nuk kanë patur besim në lirinë e Kosovës dhe atyre që me dëshirë kanë zgjedhur të punojnë për institucionet e Serbisë.

3) Periudha pas përfundimit të luftës së fundit

Kjo periudhë nuk ka më stacion për t'u larguar nga veprimtaria me institucionet e Serbisë. Këta individë duhet larguar me forcë nga veprimtaria me institucionet e Serbisë, nga fakti se është zgjedhja e tyre për t'u marrë me këtë veprimtari.

KAPITULLI I TRETË

RASTET DHE BARTËSIT KONKRETË TË VEPRIMEVE TË DYSHUARA TË SHMS-ve

Në pjesët paraprake të këtij publikimi janë paraqitur nevojat dhe arsyeshmëritë për ndriçimin e veprimeve dhe të veprimtarisë së SHMS-ve, si dhe janë paraqitur veçoritë dhe karakteristikat e veprimeve dhe veprimtarisë së tillë. Pas paraqitjes së asaj, se pse dhe për çfarë arsyesh duhet të ndriçohet veprimtaria e SHMS-ve, si dhe pas përshkrimit dhe shtjellimit se çka e përbën, cilat janë elementet etj. të veprimtarisë, për lexuesin është e nevojshme që të paraqiten edhe raste konkrete dhe veprime konkrete. Ka patur hamendësim rreth paraqitjes edhe të bartësve konkretë të veprimeve, mirëpo është gjykuar si më e arsyeshme që të mos përfshijë edhe bartësit e veprimeve me emra të përveçëm.

Paraqitja e rasteve konkrete me veprime konkrete edhe pa bartës me emra konkretë, bën lidhjen e koncepteve dhe njohurive mbi veprimtarinë e SHMS-ve me praktikën e zbatimit të veprimeve konkrete. Paraqitja e njohurive dhe të kuptuarit mbi veprimet dhe mbi veprimtarinë e SHMS-ve, po që se nuk plotësohet edhe me paraqitjen e praktikave konkrete të zbatuara nga SHMS-të, mbetet disi njohje e mangët, mbetet disi pak e besueshme dhe mund të bie në rrafshin e spekulimeve. Lidhja në mes të paraqitjes së koncepteve, kuptimeve dhe njohurive, me paraqitjen e rasteve konkrete, përveç se e rritë besueshmërinë tek lexuesi, bën edhe plotësimin dhe ngritjen e të kuptuarit mbi veprimtarinë e SHMS-ve në nivelin e duhur.

Kuptohet se paraqitja e rasteve dhe veprimeve konkrete duhet të bëhet aq sa mund të ofrohen edhe dëshmi, përndryshe nuk do të jenë të besueshme për lexuesin. Në këtë publikim, paraqiten vetëm rastet dhe veprimet konkrete me të cilat kemi pasur përvoja personale, kemi kontakte personale dhe njohuri personale dhe nuk kemi paraqitur raste dhe veprime të tjera të dyshuara si të SHMS-ve.

Rastet dhe veprimet konkrete të paraqitura, janë të kufizuara në ato për të cilat ekziston së paku një dëshmi. Rastet për të cilat ekziston së paku një dëshmi, është e mjaftueshme për të ndërtuar dyshim se është veprim i SHMS-ve dhe se bartësi i veprimit të jetë i dyshuar se është spiun ose bashkëpunëtor. Përndryshe, rastet dhe veprimet për të cilat mbahen dyshime, janë shumëfish më të mëdha, shprehur në numra, mirëpo këto raste nuk janë paraqitur në mungesë të mundësisë për të paraqitur së paku një dëshmi.

PARAQITJA E DËSHMIVE TË VEPRIMEVE KONKRETE DHE BARTËSVE KONKRETË SI BAZË PËR NGRITJEN E DYSHIMEVE TË BAZUARA

Një ndodhi e treguar:

Në një rast gjykimi të një dhunimi, në një gjykim të korruptuar, gjyqtari e pyet dëshmitarin: Na e përshkruaj rastin? Dëshmitari e përshkruan rastin. Gjyqtari e pyet dëshmitarin: Po fakti? Dëshmitari prapë e përshkruan rastin. Gjyqtari prapë pyet dëshmitarin: Po faktin, faktin a e ke pa? Dëshmitari përgjigjet: O shok gjykatës, faktin nuk e kam pa, se ka qenë brendpërbrenda, por e di se e ka dhunuar.

Bazuar në natyrën e msheftë të veprimtarisë së SHMS-ve, dëshmitë e mbledhura janë tepër të pakta. Pavarësisht kufizimit në dëshmi, që janë të pakta, këto dëshmi së paku janë të mjaftueshme që të ngritet dyshimi i bazuar se veprimet janë veprime të SHMS-ve dhe se bartësit e këtyre veprimeve janë bartës të veprimeve dhe të veprimtarisë së tyre në Kosovë. Gjithsesi dëshmitë e mbledhura nuk paraqesin të gjitha dëshmitë e mundshme për të gjitha veprimet.

Të gjitha rastet e paraqitura në këtë publikim, janë raste të dyshuara si të SHMS-ve, dhe të gjitha veprimet e paraqitura në këtë publikim janë veprime të dyshuara si veprime të SHMS-ve. Për asnjërin nga rastet dhe për asnjërin nga veprimet e paraqitura në këtë publikim, në këtë fazë, përderisa institucionet kompetente të Kosovës të japin vlerësimin e tyre, nuk paraqiten si raste të vërtetuara, dhe si veprime të vërtetuara. Janë institucionet e Kosovës që duhet të kryejnë vërtetimin. Autori ngre dyshime në bazë të dëshmive që ka dhe se janë institucionet e Kosovës që do të duhej të kryejnë vërtetimin.

Të gjitha rastet e paraqitura në këtë publikim dhe të gjitha veprimet e paraqitura në këtë publikim, paraqiten në nivel të dyshimit dhe jo si të vërtetuara dhe se kjo vlen, kuptohet edhe kur kjo është përshkruar në këtë publikim, në mënyrë të veçantë, dhe edhe kur kjo nuk është përshkruar në mënyrë të veçantë. Nuk konsiderohet si e arsyeshme që për secilin rast dhe për secilin veprim të përshkruhet në mënyrë të veçantë se janë në nivel të dyshimit dhe se nuk janë të vërtetuara. Autori shpreh, se paraqitjet në këtë paragraf vlejnë për gjithë tekstin dhe përmbajtjen në këtë publikim.

Bazuar në veprimtarinë mbi 100 vjeçare të SHMS-ve në Kosovë, ku kjo

veprimtari ka qenë aq e pranishme sa që qytetarët janë mësuar me të dhe e marrin gati si normale, dëshmitë e paraqitura jo vetëm se janë bazë e mjaftueshme për dyshim, por në të vërtetë paraqesin vetë veprimtarinë e SHMS-ve, kuptohet një pjesë të veprimtarisë. Jo çdoherë shihen faktet, por dihet se çka ka ndodhur. Veprimtaria e SHMS-ve është shumë, shumë më e gjerë dhe shumë, shumë më e pranishme sesa rastet e paraqitura në këtë publikim.

Këto raste të përshkruara këtu mund t'iu shërbejnë individëve të tjerë dhe t'iu ndihmojë atyre që të mendojnë rreth zbatimit nga SHMS-të edhe ndaj tyre, të praktikave të njëjta ose të ngjajshme dhe të kuptojnë se ka patur veprime dhe veprimtari të tillë edhe ndaj tyre. Po ashtu, rastet konkrete të paraqitura në këtë publikim, mund të shërbejnë edhe për institucionet e Kosovës që kanë përgjegjësi ligjore t'iu ofrojnë mbrojtje qytetarëve të Kosovës dhe vetë Kosovës nga veprimet dhe veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë, që të ndërmarrin procedurat të cilat u kërkohen me ligj, në mënyrë që të dëshmojnë funksionalitetin dhe efikasitetin e vet institucional.
Përveç përshkrimeve sipër, paraqitja dhe përshkrimi i rasteve konkrete, mund t'iu ndihmojë edhe studjuesve të fushave të ndryshme si material për studime, hulumtime dhe analiza të mëtejme.

Përshkrimi i rasteve konkrete të veprimeve të SHMS-ve, nuk është përcjellur edhe me paraqitjen e bartësit dhe bartësve konkretë, me emër e me mbiemër edhe pse janë të njohur. Përmendja haptas e emrave të përveçëm si bartës të veprimeve si dhe të veprimeve të tyre personale, tek lexuesi mund të përçojë shenja se autori ka diçka personale me individë të veçantë. Autori nuk ka asnjë lloj çështje personale dhe asnjë lloj problemi me këta individë. Të gjitha çështjet dhe të gjitha problemet, autori i ka me SHMS-të.

Nëse dikush mund të mendojë se ka diçka personale në mes të autorit dhe bartësve të veprimeve të SHMS-ve, shtrohet pyetja:

Çka ka personale?

Përgjigjja është se nuk ka asgjë, asnjë lloj konflikti, asnjë lloj problemi.

Si dhe pse mund të këtë autori diçka personale me të gjithë këta individë?

Asgjë, të gjitha çështjet dhe problemet kanë të bëjnë me SHMS-të.

Po këta individë që kryejnë këto veprime të SHMS-ve, a kanë diçka personale me autorin e këtij publikimi?

Përgjigjja është se nuk kanë asnjë lloj gjëje personale.

Si dhe çka mund të kenë diçka personale të gjithë këta individë me një person të vetëm, autorin e këtij publikimi?

Asgjë.

Po çka është puna atëherë?

Puna është se këta individë kanë pranuar detyra nga SHMS-të për t'i kryer dhe se këta individë kanë çështje dhe punë vetëm me SHMS-të. Këta individë kanë marrë detyra nga SHMS-të, i kryejnë detyrat, dhe kaq.

Sigurisht, këta individë me veprimet e kryera në përmbushjen e detyrave të SHMS-ve, kryejnë dëme, bile nganjëherë edhe dëme të mëdha ndaj autorit të këtij publikimi. Por, autori i këtij publikimi i shpallë të falur të gjithë këta individë, për të gjitha dëmet që kanë shkaktuar me veprimet e tyre ndaj autorit. Kjo falje është për dëmet personale ndaj autorit të këtij publikimi dhe jo për dëmet që këta individë mund të kenë shkaktuar tek populli i Kosovës, dëme për të cilat flet vetë populli, përmes institucioneve të veta.

Ndriçimi dhe bërja publike e veprimeve konkrete, sigurisht që do të bënte, që së paku, një lloj ndëshkimi shoqëror do të kryhej nga shoqëria dhe në këtë mënyrë do të pamundësohej zhvillimi i kësi lloji veprimtarie edhe më tutje në Kosovë. Më e mira do të ishte, po që se ndriçimet kryhen në mënyrë të kontrolluar dhe të udhëhequr mirë nga institucionet e Kosovës, me marrjen e listës së plotë të të gjithë spiunëve të SHMS-ve për Kosovë.

PSE AUTORI U BË CAK I GODITJEVE NGA SHMS-të?

Përgjigjja në pyetjen se pse autori është bërë cak i goditjes nga SHMS-të, nuk mund të jepet me siguri të plotë. Në mendim të parë, arsye që dikush të jetë cak për goditje, do të duhej të ishte veprimtaria e individit që bie ndesh me interesat e Serbisë në Kosovë. Interesat e Serbisë në Kosovë janë të trupëzuara në politikat dhe programet e Serbisë për Kosovën, ku SHMS-të marrin përsipër realizimin e synimeve të këtyre politikave dhe programeve. Nëse merret për bazë veprimtaria politike kundër interesave të Serbisë në Kosovë, autori e konsideron këtë veprimtari si të pakët, shumë të pakët, për të mos thënë modeste. Nëse krahasohet veprimtaria politike e autorit me

veprimtarinë e shumë të tjerëve, kundër interesave të Serbisë në Kosovë, është vërtet modeste.

Veprimtaria politike kundër interesave të Serbisë në Kosovë, deri në përfundim të luftës, shkurtimisht mund të përmblidhet me disa rreshta. Autori ka qenë aktiv në pjesëmarrje të grevave dhe demonstratave kundër ndryshimeve të Kushtetutës së Kosovës, në fundvitet '80-ta, ka qenë aktiv në pjesëmarrje të demonstratave për pluralizëm dhe ndryshime demokratike të fillimviteve '90, dhe ka qenë pjesëmarrës në protesta kundër vrasjeve dhe persekutimeve të individëve shqiptarë nga policia e Serbisë, në fillimvitet '90. Në të gjitha këto veprimtari, pjesëmarrja ka qenë individuale dhe me organizime në rreth shokësh, mirëpo nuk ka qenë pjesë e ndonjë grupi ilegal.

Nga aspekti i veprimit politik, autori ka qenë anëtar i Këshillit Nismëtar të Parlamentit Rinor të Kosovës, për Skenderaj dhe kryetar i Degës së LDK-së, në Prekaz të Poshtëm, kur është themeluar kjo degë. Në cilësinë e kryetarit të Degës së LDK-së, gjatë viteve 1990 – 1992, ka kryer organizime të cilat më 30 dhjetor 1992, rezultuan me ballafaqimin e parë luftarak ,ose luftën njëditore të popullsisë së kësaj ane me forcat serbe, në të cilën para plumbave të forcave serbe u gjend edhe autori i këtij publikimi.

Ky ballafaqim luftarak erdhi si rezultat i kundërvënies luftarake të Adem Jasharit dhe grupit të tij, përpjekjeve të policisë së Serbisë për arrestim, ngjarje kjo e ndodhur më 30 dhjetor 1991. Kundërvënia luftarake e Adem Jasharit dhe grupit të tij, u shoqërua me ballafaqim luftarak të mbrojtjes së fshatit me armë, mbrojtje kjo e organizuar dhe udhëhequr nga autori i këtij publikimi. Mirëpo, pas këtij ballafaqimi luftarak, emigron në Londër. Gjatë qëndrimit në Londër ka qenë pak aktiv, por jo shumë aktiv në lëvizjet për liri të Kosovës, të asaj kohe në Londër dhe nuk ka qenë pjesëmarrës i luftës në Kosovë.

Siç mund të shihet, veprimtaria politike kundër interesave të Serbisë në Kosovë, deri në përfundim të luftës së fundit, ka qenë modeste.

Atëherë, çka e bëri autorin të jetë cak i goditjeve të SHMS-ve?

Veprimtaria profesionale e pasluftës ka bërë që të bëhet cak i goditjeve. Veprimtaria profesionale e pasluftës, përmban tri veçori që mund të kenë ndikuar për të qenë cak i goditjes, të cilat paraqitën në vijim:

1) Bartës i vlerave shoqërore, njerëzore, të dobishme për Kosovën.

Që nga kthimi nga Londra në fund të shtatorit 2001, ka qenë dhe vazhdon të mbetet bartës i vlerave shoqërore, njerëzore, të cilat kanë qenë cak i goditjes nga SHMS-të në Kosovë. Disa nga vlerat për të cilat autori ka qenë dhe vazhdon të mbetet bartës, janë paraqitur në vijim:

- Zbatues i ligjit

  Me përjashtim të ndonjë delikti kundërvajtës, nuk ka kryer asnjë veprim të vetëm që shkel ligjet e Kosovës.

- Nuk ka qenë rrenc, mashtrues a tradhtar

  Në asnjë rast të vetëm nuk ka rrejtë, nuk ka mashtruar ose tradhtuar asnjë person të vetëm, as më herët dhe sidomos as nga kthimi në Kosovë në vitin 2001 e deri më tani.

- Nuk ka vjedhur

  Me asnjë veprim të vetëm nuk ka vjedhur ose përvetësuar paranë ose pasurinë publike të Kosovës, as më përpara dhe sidomos as pas kthimit nga Londra në Kosovë.

2) Profesionist siç është e kërkueshme

Që nga kthimi nga Londra, ka ushtruar dhe vazhdon të ushtrojë profesionin e vet, në përputhje me standardet profesionale dhe me kodin e etikës profesionale, ashtu siç kërkohet me ligjet e Kosovës. Disa nga vlerat profesionale për të cilat ka qenë dhe vazhdon të mbetet bartës, paraqiten në vijim:

- Nuk ka kryer improvizime profesionale

  Në asnjë angazhim të vetëm profesional dhe me asnjë veprim të vetëm, nuk ka kryer asnjë improvizim të vetëm profesional.

- Nuk ka qenë i korruptuar dhe as nuk ka korruptuar

  Në asnjë angazhim të vetëm në punën profesionale, nuk ka qenë i korruptuar në asnjë mënyrë të vetme. Po ashtu, për të gjitha punët e angazhuara, nuk ka korruptuar asnjë person të vetëm në asnjë mënyrë të vetme, nuk ka dhënë asnjë cent të vetëm, nuk ka ofruar asnjë kundërshpërblim të vetëm të asnjë forme. Është e arsyeshme që

lexuesit t'i bëhet e ditur se sipas kodit etik profesional, jo që nuk lejohet asnjë formë e kundërshpërblimit për punën e marrë si angazhim profesional, por nuk lejohet as joshja (marrja me të mirë) e askujt në asnjë formë.

- I pavarur, i vërtetë dhe i paanshëm

  Gjatë gjithë angazhimit profesional, ka mbajtur pavarësinë e plotë dhe të gjithanshme në të gjitha rastet dhe me të gjithë personat fizikë dhe juridikë, dhe gjithashtu ka qenë i vërtetë dhe i paanshëm plotësisht, pa asnjë zbehje të vetme.

3) Trashëgimia familjare

Autori është i lindur dhe i rritur në një rreth familjarësh dhe farefisi, që me dekada dhe pothuaj me shekuj, kanë dëshmuar papranueshmëri të robërisë dhe nënshtrimit. Siç është paraqitur edhe në paragrafët paraprakë, personalisht nuk ka dëshmuar ndonjë veprimtari politike, të bujshme, kundër interesave të Serbisë në Kosovë dhe se kjo veprimtari nuk është aq domethënëse për të qenë cak i goditjeve nga SHMS-të. Sigurisht SHMS-të kanë vënë në zbatim thënien: "as nuk mund të bëhesh patriot i madh, as nuk mund të bëhesh spiun i madh pa e patur edhe kodin gjenetik".

Përgjigjja në pyetjen se çka e bëri autorin cak të goditjeve, sigurisht se është veprimtaria profesionale e pasluftës, ajo që nxiti SHMS-të të futin edhe autorin e këtij publikimi në listën për goditje. Jo vetëm autori i këtij publikimi, por të gjithë individët që kanë qenë bartës të vlerave të paraqitura në paragrafët nga 1 – 3, më lart, si dhe bartës të vlerave tjera të ngjajshme, kanë qenë cak i sulmeve dhe janë goditur e goditen sistematikisht nga SHMS-të në Kosovë.

Numri i individëve që janë bartës të vlerave të paraqitura në paragrafët nga 1 – 3, më lart dhe që janë duke marrë goditje nga SHMS-të, janë dhjetëra mijëra ose së paku mijëra. Dallimi në mes të këtyre individëve dhe autorit është se këta individë nuk janë në dijeni, nuk mendojnë në lidhje me veprimtarinë e SHMS-ve. Goditjet që këta i marrin i kuptojnë si të rastësishme, ose i lidhin me baza personale: "ma ka inati", "nga xhelozia e kanë", "nuk më dojnë se jam i drejtë", e të ngjajshme. Këta individë sikur janë duke fjetur. Duhet treguar këtyre individëve se kur ushtria serbe ka rrethuar Azem Bejtë Galicën, rojet e Azemit kanë fjetur dhe janë zënë rob në

"novilka" të sanës[3]. Përveç se këta janë zënë rob të gjallë, këto roje me fjetjen e tyre edhe kanë mundësuar që ushtria serbe të kryej rrethimin deri të avlia[4] e kullës së Azemit.

Bartësit e vlerave që janë cak i sulmeve të SHMS-ve, meqë bartin në vete vlerat që janë cak i sulmeve, njëkohësisht edhe vetë si individ, janë cak i sulmeve të SHMS-ve. Forma dhe përmbajtja e goditjeve, kush çka dhe si të goditet, përcaktohen nga qendrat e vendimmarrjes së SHMS-ve, kurse ekzekutimi i këtyre vendimeve kryhet nga spiunët dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Bartësit e vlerave që janë cak i sulmeve të SHMS-ve, nuk goditen vetëm në Kosovë, këta bartës goditen kudo nepër botë, ku SHMS-të kanë shtrirje të veprimtarisë dhe kudo që kanë spiunë dhe bashkëpunëtorë.

VEPRIMET E SHMS-VE KUNDËR MEHAJVE

Autori ka patur fatin që t'i takojë familjes së Mehajve nga Prekazi. Ngjarjet e ndodhura rreth Mehajve, të drejtuara dhe të diktuara nga veprimet e SHMS-ve, janë të shumëta, por që fatkeqësisht nuk janë të dokumentuara. Në fakt këto ngjarje dhe veprime janë të dokumentuara tek institucionet e SHMS-ve, në Beograd, por sigurisht se këto dokumente janë pronë e shtetit serb të cilat shteti serb nuk i bën publike. Fatkeqësisht ka patur mundësi që të dokumentohet shumçka nga historitë e krijuara nga Mehajt dhe rreth Mehajve, mirëpo kjo deri më sot nuk është bërë, gjë që është dobësi personale e autorit, por edhe dëm i madh.

Në përputhje me përmbajtjen e këtij publikimi, do të përmblidhen vetëm disa nga veprimet e SHMS-ve kundër Mehajve, të cilat autori i ka të regjistruara në kujtesën e vet. Këto veprime, megjithë kufizimet në dokumentimin e tyre, në vetvete paraqesin disa dëshmi që krijojnë bazë të mjaftueshme për dyshime të bazuara se këto veprime kanë qenë veprime të SHMS-ve. Sigurisht se veprimet e paraqitura në këtë publikim janë shumë të pakta, janë tepër të pakta nga tërësia e të gjitha veprimeve që SHMS-të kanë kryer kundër Mehajve.

Në Luftën e Dytë Botërore, shumë nga meshkujt e Mehajve, të aftë për pushkë, kanë qenë pjesëmarrës të luftës së Shaban Polluzhës, në Brigadën e

[3] Kështu u thuhet në Drenicë tubave të barit të kositur dhe të tharë në livadhe
[4] Kështu i thuhet në Drenicë rrethojes së oborrit të shtëpive të punuara nga drunjët

Isë Zymerit. Në luftimet e kësaj brigade, të njohur si grupi i Mehajve, kanë marrë pjesë: Bajram Zenë Mehaj, Milazim Qerim Mehaj, Brahim Halil Mehaj, Nebih Emin Mehaj, Sejdi Zeq Mehaj dhe Ahmet Dil Mehaj. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, dy individë: Istref Zen Mehaj dhe Sheqir Lim Mehaj, që në fillim të luftës, kanë qenë duke kryer shërbimin ushtarak, janë detyruar t'u bashkangjitën brigadave partizane.

Kjo traditë e përballjes luftarake, pas Luftës së Dytë Botërore, u demonstrua edhe me veprimet përmes grupeve të mshefta politike. Grupi politik i msheftë më i veçantë, është grupi Nacional Demokrat, në cilin marrin pjesë Shaban Fazli Mehaj, Ajeti, vëllai i Shabanit, Ahmet Dil Mehaj dhe Mehmet Emin Mehaj. Nga ky grup, Shaban Fazli Mehaj dënohet me 25 vjet burg. Po ashtu, Beqir Nebih Mehaj merr pjesë në grupin ilegal të Prekazit "Vuajtjet" dhe dënohet me 2 vjet burg. Tradita e përballjes me okupatorët serbë u vazhdua me luftën e Tahir e Nebih Mehaj dhe me pjesëmarrjen e Mehajve në lëvizjet kombëtare çliruese nga periudha e fundviteve '80 deri në pjesëmarrjen aktive në luftën e fundit.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, burrat e Mehajve, meqë kanë qenë trima të rrebtë, kanë qenë edhe cak i sulmeve të veprimtarisë së SHMS-ve, njëjtë sikur edhe të gjithë individët e tillë në gjithë Kosovën. Si pasojë e veprimeve kurdisëse të SHMS-ve (të njohura në popull si "të shtine") dhe rrebtësisë për nga natyra, të burrave të Mehajve, në mesin e gjithsej 13 familjeve të Mehajve, pas Luftës së Dytë Botërore, krijohen 18 gjaqe të formave të ndryshme, si vrasje, plagosje, rrahje, etj.

Gjendja e krijuar u kuptua drejt nga Selman Rrahim Mehaj, i pari nga Mehajt me diplomë fakulteti. Selman Rrahim Mehaj ishte i fejuar dhe se para se të organizonte dasëm, në shtator të vitit 1970, merr iniciativën që të shtrihet dora e pajtimit dhe të falen të gjitha gjaqet. Motoja: "të gjithë jemi të një barku, ndash fale ndash vraje, këtu mbetet, në mesin e vëllëzërve të një barku". Pleqtë e Mehajve përkrahën iniciativën e Selman Rrahim Mehajt, u shtrinë duart e pajtimit, dhe dasma u mbajt me gëzim e hare pa asnjë brengë shpirtërore në mesin e të gjitha familjeve të Mehajve. Dasma e Selman Mehajt u shndërrua në pajtesë.

Falja e gjaqeve tek Mehajt u krye në shtator të vitit 1970, dhe për këtë u shkrua në gazetën Rilindja. SHMS-të morën goditjen e duhur, mirëpo sigurisht veprimtaria e tyre vazhdoi. Edhe në këtë shkrim pati veprim të SHMS-ve. Shkrimi ishte përgatitur me titull: "Dasma u shëndrrua në pajtesë" dhe përfshinte afirmimin e Selman Rrahim Mehaj si një njeri i shkolluar dhe përparimtar. Mirëpo, pas veprimeve të SHMS-ve, titulli u ndërrua dhe

gjithashtu afirmimi i kontributeve të Selman Rrahim Mehaj dhe afirmimi i personalitetit të tij u eliminuan.

Është me rëndësi të theksohet se nga koha e faljes së gjaqeve deri më tani, ka ndodhur vetëm një vrasje dhe asnjë tjetër ngatërresë në mesin e familjeve të Mehajve. Mehajt qysh në vitin 1970, kanë patur pesë djelmosha që kanë ushtruar profesionin e mësuesit dhe tre studentë duke u shkolluar. Pas faljes së gjaqeve, Mehajt hapen rrugë të re jetësore, u shkolluan masivisht. Në fillim të viteve '80, pothuasje të gjitha familjet e Mehajve, kishin së paku nga një person të shkolluar e disa familje edhe më shumë se një person me diplomë fakulteti, shkollë të lartë ose shkollë normale që punonin si mësues.

Në shkollimin e të rinjve, meritë të veçantë ka Selman Rrahim Mehaj, i cili nuk ka rreshtur së biseduari me kryefamiljarët e secilës shtëpi, derisa "ka nxjerrë" gjithsesi së paku një anëtar familje për të vazhduar shkollimin. Autori nuk ka kryer ndonjë hulumtim konkret në nivel vendi, mirëpo po të kryhej hulumtimi, do të rezultonte se, trungu familjar i Mehajve, në fillim të viteve '80 kanë qenë në mesin atyre trungjeve familjare në Kosovë që kanë patur numrin më të lartë të familjeve me persona të shkolluar.

LAJMI I FUNDIT

AMERIKANËT PO I DERGOJNË ARMË JORDANIT

Aman, 12 tetor (Tanjug)

Agjensia e lajmeve Asoshited pres lajmëron se sot një aeroplan amerikan transportoi armë dhe municion për armatën Jordaneze në një aeroport 60 kilometra në veriperëndim të Amanit.

18 GJAQE TË FALURA

(fq. 8)

DISA GJERA DUHET TË PRECIZOHEN NË KUSHTETUTË

(fq. 6)

E MARTË
13 TETOR
1970

RILINDJA

Çmimi 50 paro

ORGAN I LIDHJES SOCIALISTE TË POPULLIT PUNUES TË KOSOVËS

KRYETARI TITO DEKOROI REVISTEN „TEHNIKA"

Beograd, 12 tetor (Tanjug)

Kryetari i republikës, Josip Broz Tito, dekoroi me Urdhërin e meritave për popull me shkëndi të argjendtë revistën „Teknika", organ i Lidhjes së inxhinierëve e teknikëve të Jugosllavisë. Kjo dekoratë u dha me rastin e 25-vjetorit të botimit të kësaj publikacioni për merita të veçanta në zhvillimin e idesë teknike e shkencore dhe kontributin e rëndësishëm në zhvillimin shoqëror të vendit.



EMITI: „Ndryshoi koha e po ndryshojnë edhe na." Sot ma trima janë ata që felin se ata që dojnë me ba beste"

MILAZIMI: „Erdh dita ma e lum ma e lum për ne! Prej mendjemadhësisë ke shkrirë të çfarohemi i madh e i vogël"

SHAQIRI: „Prej bakërrjes kurr kush nuk fitonte. Prëdha ju kodtë u' ne vlamive çë u 'pajtuam!"



BEQIRI: „Ma mirë se me pasë rasësi ne shpt tane mësk kish, ore sho. çë. . ."

JETULLAHU: „Shumë prej nesh jemi shkollusar vona dhe ndër ethe prej frikës ne bakërrjes"

SHABANI: „Jemi bashkëpunë pa kësë burreti pajtuni"

TETËMBEDHJETE GJAQE TË FALURA

E rëndë është plaga e hakmarrjes, të rëndë janë [illegible] e mëkatit që derdh për të vetmin djalë të vrarë, shumë më të rëndë janë vuajtjet që trashëgojnë fëmijët e dorasve në kulla të ngujimit... E ditët rridhnin gjithnjë e më të zeza për një lagje, për një fshat, banorët e lë cilit ishin të gjithë vëllezër të një gjaku... Në një kreshtë të Drenicës, në Prekaz të Ulet, pikërisht në lagjen e Mehajve — epshet e hakmarrjes vëllavrasëse zënë fill para më se një shekulli. Bilanci i krimeve është tragjik: tetëmbëdhjetë të vrarë, ca të plagosur, shumë të zhelur nëpër burgje si të dënuar dhe ato që i dënonin figjet e pashkruara të këtyre maleve... Epshet hakmarrëse u harlen gjer në ditët tona. Sot prej këtyre 13 shtëpive të kesaj lagje një djalosh kreu fakultetin, 5 djelmosha ushtrojnë detyrën e [illegible], 3 vajzënë studimet si dhe 15 [illegible] te mesme. Te rinjtë e [illegible] pleq dhe te gjithë [illegible] shumë e gjatëmet dhe vëllezërit [illegible]



Ketu, prapa këtyre mureve shekullore, mëshibej urrejtja vëllazërore që tani njëherë e përgjithmë u hoq perdja e zezë e hakmarrjes

„Jo, jo [illegible] kujtojmë ma ato [illegible] po na sollen bo[illegible] i zbutëm zemrat. Na [illegible] për bajr vllamin e [illegible] na tha xha Emini i shtyer me [illegible] moshë të pleqërisë dhe vajtoi: „Trima rrok janë ata që ja [illegible] urrehin kamben pushkës, po ata qe e shtrejnë dorën dhe falin gjakun. Unë gjithmonë [illegible] jam kërë për me shëqërë te [illegible] kote...“

Xha Emini rrëshqiti krimet, ngatërresat për vëgjëkaf shë, tregon për ditët e zezë që perendonin...

Xha Mehaimi ndërhyri: [illegible] kë, kush kujna po ja mshojë [illegible] dënim me theqra! Te rijve që [illegible] dhe pleqve që ka [illegible] pirdhu ju [illegible] [illegible] se dy lë [illegible] një kohë ush [illegible] e zvetarit te ko [illegible]

[illegible] burrat e pranë [illegible] njeri tjetrin

Burrat e Mehajve, përveç që kanë qenë trima dhe luftëtarë të rrebtë, kanë demonstruar edhe mençuri dhe zotësi të filozofisë së të jetuarit. Mishërimi i trimërisë me cilësitë tjera të gjendjes mendore, si mençuria në të njëjtën rrënjë familjare, ka nxitur SHMS-të, që veprimet për shkatërrim, të jenë më të mëdhat dhe më të fuqishmet. Nga njohuritë e përgjithshme, janë dalluar dy elemente kryesore të demonstrimit të mençurisë së burrave të Mehajve:

1) Organizimi

Mehajt kanë qenë të organizuar sipas vijes së gjakut në "familje" ose "shtëpi", ku secila "shtëpi" ka patur të zotin e shtëpisë si kryefamiljar. Kuptohet se secila "shtëpi" ka qenë e lirë të organizohet dhe të veprojë e lirë, ashtu siç ka menduar të jetë më së miri. Përve çështjeve dhe problematikave që kanë qenë në nivel të "shtëpisë", kanë ekzistuar edhe çështje dhe problematika që është dashur të marrin zgjidhje në nivel të trungut familjar Mehaj, ose edhe më gjerë. Po ashtu Mehajt kanë patur edhe të Parin ose Prijësin e Mehajve, i cili gjithashtu ka përfaqësuar Mehajt tek të tjerët.

Për çështjet dhe problemet që kanë patur shtrirje përtej nivelit të "shtëpisë", si dhe po ashtu për çështjet e brendshme që kanë patur të bëjnë brenda Mehajve, ose me ndonjë "shtëpi", kanë qenë kryesisht katër burra kryefamiljarë, që kanë pleqnuar çështjen dhe kanë nxjerrë përfundimin. Çështja që është pleqnuar nga këta burra, nuk ka qenë detyrim për zbatim, mirëpo çdoherë është zbatuar për arsye se ka qenë zgjidhja më e mirë. Përzgjedhja e këtyre katër burrave ose burrave për pleqni, nuk është bërë me ndonjë votim, ose me ndonjë pozitë të trashëguar. Përzgjedhja është kryer në bazë të cilësive që kryefamiljari ka demonstruar, në përballje me jetën në të gjitha segmentet e saj.

Prijësi i Mehajve, po ashtu nuk është përzgjedhur me ndonjë votim ose me trashëgimi. Prijësi ka marrë rolin e të parit në bazë të demonstrimit të zotësisë në përballjen me jetën, në të gjitha dimensionet e saj. Individi është bërë Prijës nëse ka arritur të marrë besimin e të tjerëve se ka cilësitë e duhura për të qenë Prijës. Besimi nga të tjerët, është fituar në bazë të demonstrimit të mendjeprehtësisë, në bazë të demonstrimit të inteligjencës, në bazë të demonstrimit të gjykimit të drejtë, të paanëshëm dhe të qëndrueshëm, në bazë të zotërimit të Odës së Burrave dhe zotësisë për t'u përballur me sukses me burrat tjerë në Odë të Burrave e të ngjajshme.

Në lidhje me Prijësin e Mehajve, është me rëndësi për lexuesin që të

bëhet e njohur se pas Luftës së Dytë Botërore, për një kohë bukur të gjatë, ka qenë prijës Bajram Zenë Mehaj. Tregohet se dikur Bajramin e mori pleqëria dhe ky këtë e sheh gjatë rrugëtimit për një të pame, kur gjatë ecjes në një përpjetëze, mbushet frymë. Kur arrijnë në maje të përpjetzës, Bajrami, në prani edhe të burrave tjerë të Mehajve i thotë Milazim Qerim Mehajt: "Pej sotit ti duhet me kanë Prijës. Mue ka nis me m'zan pleqnia, edhe n'Oda po e kam zor për shkak t'pleqnis".

Gjatë kohës sa kanë qenë të gjallë edhe Bajrami edhe Milazimi, autori ka dëgjuar vetë Milazimin tek thoshte: "Për dy sene m'vjen ran, kur n'Odë t'Mehajve ulna para Bajram Zenës dhe kur n'Odë t'katunit ulna para Shaban Murat Jasharit, edhe pse edhe Bajrami edhe Shabani janë ma t'ri se unë. Bajrami u ka burrë shumë i zoti, po edhe Shabani ashtë burrë i zoti, edhe ashtë i shkolluem edhe ashtë i meçëm."

Mënyra e organizimit dhe mënyra e funksionimit të këtij organizimi të Mehajve ka mundësuar që Mehajt, përkundër goditjeve të të gjitha llojeve nga SHMS-të, pa nderprerë, në vazhdimësi, të jenë trungu familjar ndër më me zë në Drenicë. Edhe sot po të pyetet cilido nga të vjetrit në Drenicë, për burrat e Mehajve, do të konfirmojë këtë pohim.

2) "Shkollat" e Mehajve

Mençuria dhe filozofia e të jetuarit tek Mehajt, deri vonë, nuk është ndërtuar nëpërmes shkollimit, por është ndërtuar nëpërmes ballafaqimit me jetën. Ballafaqimi me jetën tek burrat e Mehajve ka ndihmuar që ata të zhvillojnë koncepte filozofike të nxjerra nga jeta, të cilat, po që se zbatohen drejt në jetë, i mundësojnë individit që të ndërtojë një jetë më të mirë. Dobia e zbatimit në jetë të këtyre koncepteve filozofike ka bërë që këto koncepte filozofike, në popull të njihen si "shkollë", për faktin se kanë mësuar popullin në ndërtimin e jetës, njëjtë sikur shkolla më e mirë.

Në bazë të njohurive të përgjithshme, autori ka të njohura disa koncepte filozofike ose "shkolla" të burrave të Mehajve, të cilat janë të paraqitura në vijim.

Sigurisht se jeta e burrave të Mehajve është e ndërtuar edhe nga shumë "shkolla" tjera.

1920-1997

i) "Shkolla" e Shaban Fazli Mehaj

Qysh nga vrasja e Skender Kosovës, – Komisar i Batalionit të 4 të Ushtrisë Nacional Çlirimtare Shqiptare, Shabani mori misionin që Kosova të mos mbetet nën Serbi. Formimi i Brigadave të Shaban Polluzhës e gjen Shaban Fazlinë në burg në Shqipëri, për shkak të një aksioni të kryer së bashku me shokët tek vendi "Aroqet", kundër pushtuesve, nga i cili aksion një nga tre shokët vritet, kurse dy të tjerët burgosen.

Shabani kyçet në veprimtarinë e msheftë politike të Partisë Nacional Demokratike Shqiptare dhe në vitin 1948, dënohet me 25 vjet burg. Pas vuajtjes së burgut, arratiset në Shqipëri, ku jeton deri në vdekje. Edhe pse me gjithë qenien e vet, gjatë gjithë jetës së vet, iu përkushtua lirisë së Kosovës, përkundër vullnetit të zjarrtë që ta shohë Kosovën e lirë, jeta nuk i premtoi që të shijojë lirinë e Kosovës.Vdiq mu në pragun e daljes në skenë, të UÇK-së.

Nga burrat tjerë të Mehajve, është kuptuar se nga goja e tij kurrë nuk ka pushuar porosia: "Gjithmonë dhe me krejt fuqinë, të ruhet dhe të mbahet në mendje dhe në shpirt ajo që i ndihmon Kosovës deri në bashkim kombtar". Po ashtu, Shabani mbahet në mend që edhe pse ishte detyrim për qytetarët të përdorin emërtimin Sërbicë, i ndërruar me zor, në vend të emrit Skenderaj, kurrë nga goja e tij nuk ka dalë emri Sërbicë, por vetëm Skenderaj.

1905-1979

ii) "Shkolla" e Bajram Zenë Mehaj

Bajram Zenë Mehaj ka qenë bashkëluftëtar i Bajram Currit, bashkëluftëtar i Azem Bejtë Galicës, si dhe bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës. Në një mënyrë ka qenë luftëtar profesionist i përjetshëm. Pavarësisht kësaj, Bajrami ka qenë i njohur në Oda si burrë i urtë e i qetë. Ai thoshte: "Me u ngatërru me dikë është kallaj, po nuk duhet. E sheh kit njeri që po kalon, nëse t'përshendet munesh me i thanë pse po m'përshendet, a nuk munesh me shku udhës tane a, e ai sigurisht t'thotë çka t'bana, e ti munt'ngatërrohesh; nëse nuk t'përshendet, i thue pse ti kalon si kah vorret e nuk përshendet, prap munesh me u ngatërrue".

iii) "Shkolla" e Emin Lat Mehaj

1892-1974

Emin Lat Mehaj ka qenë bashkëluftëtar i Azem Bejtë Galicës. Pavarësisht kësaj dhe pavarësisht veprimeve të SHMS-ve, ai njihet si njeriu që kurrë nuk është ngatërruar me asnjërin nga Mehajt. Ai thoshte: "Me tanin (të afërmin) nuk kallxohesh i fortë".

iv) "Shkolla" e Sejdi Zeqë Mehaj

1897-1960

Sejdiu ka qenë bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës, ku ka qenë komandant i njërës prej Skuadriljeve të Luftës. Çmohej shumë nga të tjerët si burrë i meçëm dhe i drejtë. Sejdiu ka qenë shumë arsimdashës. Nga shtatë djemtë e tij, njëri është mësues, veteran dhe katër të tjerë kanë të kryer fakultete. Në filozofinë e tij jetësore mbahen mend dy thënie: 1) Dhjetë herë mate njëherë punoje, dhe 2) Largoju të keqit dhe prej të keqes se e keqja nuk të sjell të mira.



1903-1991

v) "Shkolla" e Milazim Qerim Mehaj

Milazim Qerim Mehaj ka qenë bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës, ku pas luftës vetëm falë fatit dhe gjeturisë së tij i ka shpëtuar pushkatimit nga komunistët. Edhe pse shpëton nga pushkatimi, SHMS-të veprojnë ashpër kundër tij, për të mos e lënë të bëhet ndonjë burrë me zë. Pavarësisht këtyre, Milazimi arrinë që të bëhet burrë në zë në Drenicë dhe atë përmes ndërtimit të marrëdhënieve të shëndosha me popullin. Edhe sot po të pyetet dikush nga të moçmit në Drenicë, sigurisht se do të mbajnë në mend Milazimin dhe do të konfirmojë burrëninë e Milazimit.

Milazimi arrinë që në vitet e vona të jetës, të jetë shumë i respektuar në Odat e burrave. Respekti i të tjerëve ndaj tij është shprehur edhe në rastet kur për shembull ka qenë duke udhëtuar këmbë, dikush që rastësisht e ka takuar dhe ka qenë duke udhëtuar me kuaj ose traktor, e ka ndërruar drejtimin e vet, për ta dërguar Milazimin deri në pikë-arritjen e tij. Milazimi ka arritur të ndërtojë respektin në popull përmes demonstrimit të trimërisë, mendjeprehtësisë, vendosmërisë, si dhe përmes gjykimit të drejtë, të pandikuar dhe të paanshëm. Këto vlera, Milazimi i ka demonstruar në të gjitha ballafaqimet me jetën, përfshi mbi 100 pleqni, pajtesa e maresa të familjeve të ndryshme nëpër Drenicë, në të cilat ka marrë pjesë. Në mënyrë të veçantë, Milazimi ka ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me burra tjerë të Drenicës, të cilët i quante "shokë". Ai thoshte: "Kraht e njerit janë shokt".

Milazimi thoshte "harami gjithkuj i del po dikuj ja merr kryt", " ma s'zori është me njoft vetveten, kur e njef veten te njef bota", pastaj kërkesa ndaj djalit të tij kur punësohet si arsimtar: "Ti e kryve shkollën për msues. Nëse qata thmi nuk i mson si duhet, nuk i don si thmin tu, hiç mos shko me punu msues", si dhe shumë thënie të tjera.

1910-1981

vi) "Shkolla" e Nebih Emin Mehaj

Pas konfliktit të Tahir Nebih Mehaj me policinë në Skenderaj, të ndodhur në vitin 1980 e deri në luftën e tij, në maj të vitit 1981. Tahiri jetonte i fshehur. Gjatë kësaj periudhe, Nebihi (babai i Tahirit) në Oda të burrave thoshte: "Ni kullë. Kulla e Kuqe, ka hi n'histori edhe kjo Kullë (Kulla e vet) sikur Kulla e Kuqe, ka me hi n'histori. I fikti t'fik. Krejt t'gjallt n'gryk t'pushkës e kam". Për t'u kuptuar më lehtë, domethëniet e thënieve të tij, janë si në vijim:

- ".....edhe kjo Kullë (Kulla e vet) sikur Kulla e Kuqe ka me hi n'histori" - Kur njeriu është i vendosur, edhe historinë e bën siç do vetë.

- "I fikti t'fik" – Mos u ngatërro me atë që nuk ka çka humb, se humb ti.

- "Krejt t'gjallt n'gryk t'pushkës e kam" - Pasuria e njeriut është në forma të ndryshme, për të bërë historinë siç do njeriu vetë, mundet që të mjaftojë pasuria e një pushke.



1918-1996

vii) "Shkolla" e Shaqir Lim Mehaj

Në vijim të këtij publikimi është paraqitur një ndodhi e veçantë e Sheqir Lim Mehaj, që i ka shkaktuar Shaqirit të shfaqte një mllef të brendshëm. Mllefi shprehej sidomos në rastet kur njerëzit silleshin keq, shfaqnin mosdije dhe ishin mospërfillës. Ai thoshte: "O k'ta njerëz nuk din gja, veç tuten e interesin e njohin".

Akti i pajtesës dhe zotërimi i mençurisë nga Mehajt, i dha rezultatet e veta, mirëpo edhe SHMS-të, vazhduan veprimet e tyre kundër Mehajve, kuptohet me përshtatje ndaj rrethanave ekzistuese të krijuara. Edhe pse shumë individë të shkolluar, asnjëri nga Mehajt nuk mund të ngritej në poste publike të udhëheqjes. Përgjithësisht, Mehajt ishin të përjashtuar nga mundësia e pjesëmarrjes në ndërtimin e institucioneve të atëhershme të Kosovës. Por, edhe pse Mehajt u ndaluan nga SHMS-të, që të kenë poste publike udhëheqëse dhe të marrin pjesë në ndërtimin e institucioneve të Kosovës, të gjithë të shkolluarit e Mehajve ndërtuan nder dhe respekt në mesin ku punuan, ofruan kulturë të mirësjelljes. Pavarësisht veprimeve të SHMS-ve, Mehajt kurrë nuk pushuan zhvillimin dhe afirmimin e vlerave të dobishme për zhvillimin e shoqërisë.

NDODHIA E SHAQIR LIM MEHAJT ME KOMUNISTIN E DEVOTSHËM

Shaqir Lim Mehaj ka qenë partizan, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Si partizan, ka qenë shok me disa malazezë, me të cilët ka kaluar mirë dhe ka ndërtuar marrëdhënie të mira. Shumë nga malazezët kanë gjak shqiptari dhe shumë nga ta ndryshojnë nga serbët. Me ndihmën e shokëve malazezë, Shaqir Lim Mehaj, pas lufte, arrinë që të marrë poste publike të udhëheqjes dhe arrinë të bëhet kryetar i komunës së Skenderajt dhe pastaj edhe sekretar i komunës.

Kur Shaqir Lim Mehaj bëhet kryetar i komunës, në odë të tij vjen një nga komunistët shumë në zë në Kosovë. Ky komunist, rrin dy ditë e dy net me Shaqirin në odën e tij, me qëllim që ta bind Shaqirin që të punojë për UDB-në dhe për të dërguar në Shqipëri për kryerje të detyrave të Jugosllavisë kundër shtetit shqiptar. Pas dy ditëve të qëndrimit kokë-më-kokë, Shaqiri e përcjell këtë komunist dhe në sokak, gjyshi i autorit – Milazim Qerim Mehaj, e dëgjon nga brenda duvarit[5] thënien e Shaqirit, drejtuar komunistit: "kam edhe 6 vëllezër, kam kaq hektarë tokë, kam kaq bollica e kaq dele, atë punë nuk e baj".

Ajo çka u pa pas kësaj ndodhie, ishte se Shaqir Lim Mehaj largohet nga posti i kryetarit të komunës. Ky komunisti i devotshëm përgaditë mbledhjen e partisë, për të shkarkuar Shaqir Lim Mehajn nga partia dhe për ta larguar nga posti i kryetarit të komunës. Në këtë mbledhje, Shaqiri i thotë komunistit të

[5] Kështu i thuhet në Drenicë rrethojes së oborrit të shtëpive të punuara nga gurët dhe tullat

devotshëm: "Ngo more "komunisti i devotshëm". kurrë as babë e as babëgjysh nuk e kanë bajtë strajcën e kërkuj e nuk ta baj as unë ty. Ta pshu.... partinë, ta pshu... postin, e të pshu... ty". Pas kësaj. Shaqiri largohet nga të gjitha punët e pushtetit dhe institucionet e shtetit. Shaqir Lim Mehaj kthehet në një fshatar të zakonshëm, në familje me vëllezër dhe punë fshati sikur çdo fshatar tjetër, deri në vdekjen e tij.

Është me rëndësi për lexuesit e këtij publikimi të theksohet se ky komunist i devotshëm, me detyrat e SHMS-ve që ka kryer në Drenicë, është fuqizuar si komunist i besuar dhe se si rezultat i këtij besimi, ky komunist i devotshëm i ka patur të hapura të gjitha dyert në Beograd, kurse këtu në Prishtinë nuk ka guxuar kush t'ia prish tymin e duhanit. Si shpërblim për detyrat e kryera në Drenicë, ky komunist, fillimisht zgjedhet kryetar i partisë për rrethinën e Drenicës, e pastaj kryetar i partisë për Kosovë.

Në Drenicë, ky komunist ka punuar ekskluzivisht me njerëzit më të poshtër, me njerëzit më të pamoralshëm, me njerëzit më faqezi, me një fjalë, me njerëzit më të këqinj të kësaj ane. Në popull njihet me nofkë të veçantë, sepse ky komunist i devotshëm në Drenicë ka pas krijuar dhe udhëhequr një grup njerëzish që në popull janë njohur si "depsuzska brigada" ("brigada e të pafytyrëve"). Këta njerëz të "depsuzska brigada" ("brigada e të pafytyrëve") kanë patur për detyrë që të thyejnë dhe shkatërrojnë individët dhe familjet e forta kombëtare, individët dhe familjet që kanë qenë bartës të vlerave shoqërore, njerëzore, të dobishme për shoqërinë e Kosovës. Milazim Qerim Mehaj, disa herë kishte theksuar se është në gjendje t'i përmend se paku njëzet e pesë individë, që kanë qenë anëtarë të kësaj brigade dhe se me fajin e autorit, kurrë nuk është pyetur për këta emra, në mënyrë që të dokumentohen dhe të ruhen.

MOSPUNËSIMI DHE PËRJASHTIMI NGA LKJ I SHABAN MILAZIM MEHAJT

Shaban Milazim Mehaj ka qenë axha më i ri autorit, i cili ka patur të kryer shkollën e lartë të muzikës, qysh në fillim të viteve '70, dhe ka punuar arsimtar në shkollën fillore "Azem Bejta", në Prekaz. Nga fundi i viteve '70, komuna e Skenderajt e dërgon në stërvitje për Telegrafi & Daktilografi Ushtarake, në kurs 6 mujor, në Beograd. Në përfundim të stërvitjeve, mbahen gara në këto lëmi në nivel të Jugosllavisë, ku Shabani zë vendin e parë.

Pas përfundimit të stërvitjeve, kthehet në Skenderaj dhe pret që të punësohet në Mbrojtjen Territoriale të atëhershme, edhe pse ishte duke punuar si arsimtar i muzikës. Punësimi ishte arsye pse ishte organizuar stërvitja dhe dërgimi në stërvitje. Pavarësisht kësaj, me veprimin e SHMS-ve, Shabanit i ndalohet që të punësohet në Mbrojtjen Territoriale të Komunës.

Gjatë viteve '80, Shabani sëmuret nga një lloj tumori, që përparonte ngadalë, por që e dërgonte drejt vdekjes së sigurt. Si djalë ballisti që ishte, ashtu cilësohej nga pushteti i atëhershëm, meqë babai i tij, Milazimi, kishte qenë luftëtar i luftës së brigadave të Shaban Polluzhës, nuk ishte anëtar i LKJ-së. Kolegët e tij arsimtarë, duke parë përparimin e sëmundjes dhe duke kuptuar se Shabani po shkon drejt vdekjes, e ftojnë dhe e pranojnë si anëtar të LKJ-së, me qëllim që kur të vdesë të ketë disa të mira më të mëdha për fëmijët që do t'i lë pas.

Me të marrë vesh SHMS-të, për pranimin e Shaban Milazim Mehaj si anëtar i LKJ-së, Komiteti Komunal i LKJ-së, kërkon nga LKJ e shkollës që ta përjashtojnë Shabanin. LKJ e shkollës, meqë vetë e kishin ftuar për anëtarësim, reziston përjashtimin nga LKJ për një kohë. Meqë përjashtimi nuk kryhej, Komiteti Komunal dërgon zyrtarin komunal të LKJ-së, një komunist nga fshati i njëjtë, në mbledhje të LKJ-së së shkollës për të kërkuar përjashtimin drejtpërdrejtë në mbledhje të LKJ-së. LKJ e shkollës prapë reziston deri sa ky komunist flet hapur: "Shabani është djalë i ballistit dhe se është urdhër që të përjashtohet"! Në këtë mënyrë para vdekjes në ardhje, të Shabanit, zbatohet detyra e SHMS-ve.

HISTORIA E REGJISTRIMIT NË FAKULTETIN EKONOMIK

Autori bën kërkesë për regjistrim në Fakultetin Ekonomik, në vitin 1982 dhe shkon së bashku me nxënësit tjerë në Prishtinë, ditën kur publikoheshin listat me kandidatët e pranuar. Në listat e publikuara, ishin emrat e 17 të pranuarve nga Skenderaj, por në listë nuk ishte emri i autorit. Në atë kohë, nuk ka patur provim pranues, pranimi kryhej në bazë të poenave të cilat secili nxënës i dinte për vete dhe për të tjerët, meqë poenat krijoheshin në bazë të notës mesatare, suksesit të përgjithshëm e të ngjajshme.

Autori rrinte duke lexuar 17 emrat e pranuar nga komuna e Skenderajt, për dhjetëra minuta, dilte poshtë në qendër të Prishtinës e shëtitej pak dhe prapë kthehej dhe lexonte 17 emra për dhjetëra minuta, katër herë radhazi, meqë nuk mund të shkonte tek autobusi për t'u kthyer në shtëpi. Kur kthehet për herë të katërt, duke lexuar emrat e pranuar, si shigjetë në sy, nga anash i vjen

emri, Xhevat Meha. Shikon se ku është ky emër dhe sheh se është në komunën e Vitisë, dhe gjithashtu numri i dokumenteve të dorëzuara ishte po ai që kishte autori. Rrin edhe disa dhjetëra minuta, herë duke lexuar emrin e tij në listën e të pranuarve nga komuna e Vitisë e herë duke lexuar emrat e të pranuarve nga komuna e Skenderajt dhe vetëm pastaj shkon tek stacioni i autobusave.

Të nesërmen shkon tek referentët, në Fakultetin Ekonomik, për t'u sqaruar, ku i thuhet se duhet të bisedohet me një referent të veçantë. Ky referenti i veçantë, ashtu siç i kishte marrë detyrat nga SHMS-të edhe i kryente. Përgjigjet ishin të llojllojshme si: je regjistru, s'je regjistru, po hajde nesër, është bërë gabim, po hajde nesër, e të ngjajshme. Kështu vazhdohej për çdo ditë, deri në ditën kur nuk mund të shtyhej më, kur ky referenti i veçantë thotë se "mundesh me i dorëzue dokumentet e nevojshme për regjistrim dhe mundesh me shkue në shërbim ushtarak të APJ-së", siç ishte atëherë.

Autori shkon ushtar dhe kryen pushimin e rregullt në pranverën e hershme të vitit 1983. Posa kthehet nga pushimi, pranon një letër të shkruar nga babai, ku njoftohet se i gjithë dokumentacioni është kthyer nga Fakulteti Ekonomik. Autori shkruan dhe i kërkon babait që dokumentet t'i përcillen Sefedin Demakut – tezakut të autorit, meqë ai ishte absolvent në Fakultetin Ekonomik në atë kohë. Tezaku, pas shumë perepecive, arrin që t'i dorëzojë përsëri dokumentet tek ky referenti i veçantë, ku i thuhet se çdo gjë është rregulluar dhe se Xhevat Meha vërtet është pranuar në fakultet.

Pas përfundimit të shërbimit ushtarak, sikur edhe të gjithë të pranuarit tjerë, duhej të kryheshin formalitetet e nevojshme për të marrë indeksin e studentit. Për të marrë indeksin, duhej të shkonte për çdo ditë, ekskluzivisht, tek ky referenti i veçantë, i cili vazhdonte t'i kryente detyrat ashtu siç edhe i kishte marrë, i cili jepte lloj-lloj përgjigje, por që të gjitha përgjigjet përfundonin me: "Hajde nesër". Kjo zgjati deri pothuajse në përfundim të javës së dytë pas fillimit të vitit akademik kur u mor indeksi i studentit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës.

Historia e regjistrimit në Fakultetin Ekonomik, u vazhdua me historinë e marrjes së kredisë studentore. Në atë kohë, secilit që regjistrohej si student i rregullt, i takonte edhe një shumë të hollash në baza mujore, që ishte kredi për studentë edhe pse kurrë askush nuk e ka kthyer marrjen e asaj kredie. Kredia studentore jepej nga BVI-ja Komunale e Arsimit. Kryhen procedurat e nevojshme, sikur edhe të gjithë studentët tjerë për të marrë këtë kredi studentore, mirëpo emri nuk ishte dalë në listën e studentëve. Pothuajse së paku një herë në javë për disa javë rresht, autori duhej të shkonte tek BVI-ja,

të pyeste në lidhje me këtë dhe të merrte përgjigje pothuajse të njëjtë: "Nuk është sqaruar ende, po eja pas kaq ditësh".
Dy muaj pasi që të gjithë studentët tjerë kishin filluar të merrnin kredinë studentore, shkohet në zyrën e drejtorit të BVI-së dhe i kujtohet pritja dhe paraqitja e drejtorit të BVI-së sikur të ishte dje, kujtohet ajo fytyrë, ajo pamje e mimikës së fytyrës dhe të folmes së tij. Posa hapet dera e zyrës që ishte e gjatë dhe drejt me derë, në ballë ishte tavolina dhe vetë drejtori i vetëm në zyrë, i cili drejtohet: "Hajde hajde Xhevat", me një buzëqeshje të vrazhdtë. Kur bëhet ofrimi dhe kryhet përshëndetja, drejtori pyet: "I cilit djalë të Milazimit je ti". "I Sherifit", ishte përgjigjja. "A është Sherifi i madhi a cili është", pason pyetja tjetër. "Është i dyti", pason përgjigjja. "He-he-he, edhe ti do të marrësh kredinë studentore", vazhdon drejtori me një të qeshur të vrazhdtë.

Lidhur me peripecitë e paraqitura në këtë publikim, ka edhe shumçka të thuhet, por maksimalisht është shmangur paraqitja, për hir të modestisë, si dhe të mundësohet që publikimi sa më tepër të lirohet nga personalizimi i çështjeve të shtruara.

MARRJA E VIZËS PËR VIZITË NË GREQI

Autori fillon të ushtrojë profesionin e revizorit të pavarur, në vitin 2002 dhe se në atë kohë ishte i vetmi revizor në Kosovë, me kualifikime dhe përvoja perëndimore. Duke parë këto cilësi, firma ndërkombëtare e revizionit Ernst & Young e fton që të bëjnë propozim të përbashkët për revizionin e KEK-ut, Ngrohtoreve të Qytetit të Prishtinës dhe Gjakovës si dhe Ndërmarrjet Publike të Ujësjellësve dhe Mbeturinave në gjithë Kosovën. Këto angazhime u fituan dhe u kryen bashkërisht ku Ernst & Young, mbante pozitën e Drejtorit të Revizionit dhe firma "Luani SHA", në pronësi të autorit, mbante pozitën e Menaxherit të Revizionit, për secilin revizion.

Pas këtij bashkëpunimi dhe kryerjes me sukses të këtyre revizioneve, Ernst & Young, dërgon ftesë për udhëtim në Athinë, për të diskutuar dhe për të arritur një marrëveshje për bashkëpunim afatgjatë. Kryhen formalitetet e nevojshme, kompletohet dokumentacioni i nevojshëm dhe bëhet kërkesa për vizë në ambasadën e Greqisë, në Shkup. Në atë kohë , kushdo që plotësonte të gjitha kërkesat për dokumentacionin e kërkuar, merrte vizën greke pa përjashtim dhe pa ndonjë vonesë. Kjo nuk ndodhi edhe me autorin e këtij publikimi.

Procedura ishte që personi që kërkon vizë, të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm dhe të kryej një pagesë prej disa dollarëve amerikanë dhe javën tjetër e merrte vizën. Kur autori dorëzon dokumentacionin, i thonë të shkojë javën tjetër. Kur shkon javën tjetër i thonë shko kryeje pagesën, edhe pse të gjithë të tjerët e kryenin pagesën, ditën që dorëzonin dokumentacionin. Kur kryhet pagesa, i thonë hajde javën tjetër.

Javën tjetër, priste në rend për të marrë vizën dhe kur arrihet tek sporteli, i thonë se nuk ka vizë për ty. I habitur, qëndron në oborr të ambasadës, ku njëri nga personat përgjegjës për sigurimin e ambasadës i ofrohet dhe e pyet greqisht diçka. Autori i kthen në anglisht se ka ardhë të marrë vizën, mirëpo i thanë se nuk ka vizë edhe pse të gjithë të tjerët po i marrin vizat. Pa e përfunduar mirë këtë përgjigje, personi i sigurimit i rrëmben nga dora pasaportën, njëjtë sikur një qen që rrëmben copën e mishit, i flet greqisht dhe bën me shenjë që të presë.

Pritet deri vonë pasdite dhe kur kishte vetëm 3-4 njerëz në rend, ende për të marrë vizën ofrohet tek sporteli, pyet se si qëndron puna me vizën, mirëpo merr përgjigjen që të presë. Autori detyrohet që të presë i vetëm deri në orën 5:00, kur zyrtarët e ambasadës fillojnë që t'i mbyllin dollapët për të përfunduar punën dhe vetëm atëherë i hedhin në sportel pasaportën me vizë. Të gjitha këto, sollën konstatimin se veprimtaria e SHMS-ve ishte shtrirë edhe tek ambasada e Greqisë në Shkup.

ELIMINIMI NGA MARRJA E PUNËVE DHE NGA JETA INSTITUCIONALE

Angazhimi i autorit në punët profesionale të revizionit dhe të konsulencës, është një kapitull interesant për t'u shtjelluar. Praktikë e njëjtë është zbatuar edhe në angazhimin e organizimit dhe ndërtimit institucional të zhvillimit të profesionit. Mendohet se kjo fushë, është pjesa më mjeshtërore e "gjuajtjes së gurit dhe fshehjes së dorës" së veprimtarisë së SHMS-ve. Këtu vërtet është dëshmuar arti i shkathtësisë, arti i mjeshtërisë dhe fuqia e veprimtarisë së SHMS-ve. Aq mirë janë fshehur veprimet, sa që është e fortë bindja se shumë veprime kanë qenë drejtpërdrejt të kryera nga spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve, mirëpo janë të vështira për t'u emërtuar.

Që nga kthimi nga Londra, autori ka qenë dhe vazhdon të mbetet revizori i vetëm në Kosovë, me përjashtim të firmave ndërkombtare, që ka kualifikime, përvoja dhe licencë ndërkombtare për revizion financiar dhe që

mban licencë për revizion nga ACCA (The Association of Chartered Certified Accountants) – institucion profesional i Mbretërisë së Bashkuar. Edhe firma në pronësi të tij Meha & Co është e miratuar nga USAID Washington, për revizion të programeve të financuara nga USAID. Në vitet e para të ushtrimit të profesionit të revizorit financiar dhe të konsulentit, autori kishte numër të angazhimeve që ishin të kënaqshme. Gradualisht angazhimet zvogëloheshin, derisa në vitin 2011, kur nuk mund të mbahej më tutje si zyrë e ofrimit të angazhimeve profesionale dhe mbyllet.

Në kushte normale, një kandidat me kualifikimet, përvojat dhe liçencat ndërkombtare do të duhej që të kishte një ekip prej dhjetëra profesionistëve, nën drejtim të tij, për kryerje të angazhimeve profesionale në revizion dhe në konsulencë. Po ashtu, si individ me kualifikime dhe përvoja të tilla, do të duhej të ishte në ballë të çdo zhvillimi profesional të kësaj fushe dhe jo të jetë 100% jashtë çdo zhvillimi institucional të profesionit të kontabilitetit dhe revizionit. Një ndodhi të këtij niveli vetëm SHMS-të kanë fuqinë që të ndërtojnë në Kosovë.

Puna profesionale veçohet me sjellje dhe veprime profesionale të cilat kanë qenë tepër të veçuara nga sjellja e të gjithë individëve tjerë që ushtronin të njëjtin profesion. Ky veçim shkon deri në ekstrem për rrethanat e Kosovës. Në kryerjen e punës profesionale, autori i këtij publikimi ruan pavarësinë me shkallë 100%, asnjëherë as edhe një kafe nuk ka ofruar për të marrë një punë, as edhe një herë të vetme nuk ka vënë në dyshim nivelin më të lartë profesional, çdoherë ka përfshirë në raport të revizorit ato që duhej të ishin pjesë e raportit, dhe asnjëherë nuk ka përfshirë si pjesë të raportit ato që nuk duhej të ishte pjesë e raportit, për të mundësuar që raporti të shpreh vetëm dhe vetëm atë që duhet të shpreh. Sigurisht se veprimet e tilla janë përjashtuese për mjedisin profesional të Kosovës, nën kushtet e sundimit të SHMS-ve.

Pavarësisht këtij niveli profesional përjashtues, ndjehet se në eliminimin nga marrja e punëve, ka patur dorë edhe veprim të drejtpërdrejtë të spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, sidomos në propozimet për punë të konsulencës.

Edhe pse, siç u theksua në paragrafët paraprakë, veprimet e SHMS-ve kanë qenë të fshehura në mënyrën më elegante të mundshme, janë disa raste në kujtesë, të cilat do të bëhen të ditura për lexuesin, si në vijim:

1) Në pranverë të vitit 2001, derisa autori ishte ende në Londër, një Kate Thompson, meqë i kishte ra në dorë CV-ja, e kishte pyetur autorin se a

është i interesuar të kthehej për të punuar në Kosovë në postin e Drejorit të Revizionit të Brendshëm të Administratës së UNMIK-ut. Kjo ftesë u bë, meqë ishte i kualifikuar me gradën ACCA, dhe kishte 5 vite përvojë pune në KPMG, Zyra e Londrës si revizor financiar. Kate Thompson ishte Shefe e Barents Group që ishte angazhuar nga USAID për ndihmë profesionale, në ndërtimin e institucioneve të Kosovës pas lufte. Me të marrë pëlqimin (edhe ashtu autori kishte në plan që të kthehej në Kosovë), Kate Thompson kryen edhe intervistimin përmes telefonit.

Mirëpo, diku pas dy javësh, Kate Thompson, shkruan se kolegët e saj europianë po kërkojnë që për këtë post duhet të jetë dikush me "EU citizenship" (shtetësia e BE-së), dhe se për këtë arsye nuk mund të angazhohesh në këtë punë. Në fakt, në këtë post ishte angazhuar një rumun, ku Rumania ende nuk ishte pjesë e Bashkësisë Evropiane, i cili nuk kishte qenë ende i kualifikuar si ACCA, dhe se, nuk kishte as afërsisht përvojat e punës që autori i këtij publikimi i kishte. Shumë e kuptueshme, veprimi i SHMS-ve kishte dorë edhe në këto nivele.

2) Puna e parë që ishte angazhuar autori pas kthimit nga Londra, në fund të shtatorit 2001, ishte në rolin e konsulentit, në një projekt të Bankës Botërore për krijimin e shoqatës profesionale për kontabilist dhe revizor të Kosovës. Puna ishte e përshtatshme dhe i përgjigjej kualifikimeve dhe përvojave.

   Projekti kishte për qëllim që të vënte themelet e zhvillimit institucional të profesionit të kontabilitetit dhe revizionit në përputhje me standardet dhe praktikat perëndimore. Angazhimi në këtë projekt ishte i pari, por edhe angazhimi i fundit në ndonjë institucion për zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe revizionit në Kosovë, edhe pse, edhe pas 13 viteve që nga kthimi në Kosovë, është individi me kualifikimet dhe përvojat më të larta perëndimre, në profesionin e kontabilitetit dhe revizionit në Kosovë.

3) Në vitin e parë kur ishte krijuar qeveria e parë e Kosovës, Ministria për Ekonomi dhe Financa shpall kërkesë për revizionin e parë financiar për të gjitha komunat e Kosovës. Autori konkurron në partneritet me një firmë nga Mbretëria e Bashkuar, dhe konkurrent tjetër ishte vetëm një firmë ndërkombtare me zyrë në Kosovë.

   Ekipi vlerësues bën poentimin e vlerësimit teknik ku partneriteti i "Luani SHA", kishte 100 poena kurse konkurrenti tjetër, 89 poena. Në hapje të ofertave financiare, dallimi në çmim ishte maksimumi 2 poena,

dhe në këtë mënyrë dihej edhe fituesi. Në hapjen e ofertave financiare, pjesëmarrës ishte edhe përfaqësuesi i firmës konkurrente. Pasi bëhet e ditur se kush duhej të ishte fituesi, përfaqësuesi i firmës konkurrente me ndihmen e drejtorit të Njësisë së Revizionit të Brendshëm të Ministrisë, alarmon dhe mobilizon gjithë ministrinë, kundër shpalljes së fituesit. Për çudi, i gjithë mobilizimi kundër shpalljes së fituesit nga këta dy individë është kryer me moton: "Ku-ku, drenicaku do me fitu tenderin". Sigurisht që tenderi u anulua.

4) Njoftimet mbi mosdhënien e punëve ose të eliminimit nga konkurrimi, kanë përfshirë përshkrime të ndryshme për raste të ndryshme të konkurrimit. Në vitet e para të kthimit në Kosovë, autori i këtij publikimi ishte me kualifikime dhe përvoja shumë të veçanta nga të tjerët, në tregun e Kosovës. Kjo shkaktoi, që shumë firma konsulente të Evropës të ftojnë për bashkëpjesëmarrje në konkurrim për projekte të BE-së në Kosovë.

Është veçori, se në shumicën e rasteve rregullisht, njoftimi për eliminimin ose refuzimin për angazhime, jepej në ditët e fundit, para shpalljes së fituesit. Raste të tilla të njoftimeve janë bashkangjitur në vijim (shih gjithashtu të përkthyer në vijim). Është me rëndësi të theksohet me këtë rast se në njoftimin dhe shpjegimet, të datës 15 maj 2006, kërkohet të zëvendësohet me ndonjë tjetër që nuk është nga Ballkani.

Pikërisht për këtë angazhim, personi përgjegjës nga operatori ekonomik që kishte përcaktuar kushtet e këtij angazhimi, kishte kërkuar që gjithsesi së paku një konsulent duhet të jetë nga ish-Jugosllavia, për arsye të njohjes së specifikave të sistemit ish-jugosllav, që ishin ndryshe vendet tjera socialiste. Qartazi këto ndërhyrje janë veprime të SHMS-ve , në qendër të donatorit që financonte këtë angazhim.

From: [redacted]
To: xhevat@luani.net
Date: 16 May 2006, [illegible]:00:24 PM
Subject: Re: PROJECT

Dear Xhevat,

I am sorry to inform you that ECO finally decided to outsou
expert in their offer and they finally did not put your CV.
I was informed today of this change. I am sorry we cannot compl
this project. We will be in touch for future opportunities.

Best regards,

[redacted]

From: [redacted]
To: "xhevat@luani.net" <xhevat@luani.net>
Date: 15 May 2006, 06:07:54 PM
Subject: Fwd: 2006 - 002

HTML content follows

Dear Xhevat,
I don't know what the problem is - but please see the message below - we cannot have a 'Balkan' on the team.
I'm sorry but it seems that we will have to remove your CV.
Once again, my apologies.

[redacted]

-------- Original Message --------
Subject:2006 - 002
Date: Mon, 15 May 2006 17:32:35 +0200
From: Ian Tait <Ian.Tait@kumik.org>
To:[redacted]

Mr [redacted]

Without Prejudice

OAG / ASU [illegible] - 002

CVs

Thank you for your e-mail of earlier today,
information on the subject of the proposed [illegible]
After discussion of your offer, the Office [illegible]
requests that you remove the CV of Xhevat Mo[illegible]
replacing this person with a colleague fro[illegible]
leaving John Hunter or Chafik Hakiami [illegible] given
auditor. Following your agreement to this [illegible]
to your offer.
This request is not made in the light of [illegible] concerns
specifically regarding Xhevat Moha.

The OAG participates in these [illegible] contract, and a
firm decision regarding the award [illegible] made.
Your early response, as ever, [illegible]
Regards
Ian Tait
on behalf of the OAG, Kosovo

Përkthim:

Nga: xxxx
Për: xhevat@luani.net
Datë: 30 maj 2006

Më vjen keq të ju informoj se ECO në fund ka vendosur të paraqes në ekspert tjetër në ofertën e tyre dhe në fund nuk kanë paraqitur CV-në tënde. Unë jam informuar sot për këtë ndryshim. Më vjen keq që nuk mund të bashkëpunojmë në këtë projekt. Do të jemi në kontakt për mundësit në të ardhmen.

Nga: xxxx
Për: xhevat@luani.net
Datë: 15 maj 2005

I nderuari Xhevat,

Nuk po kuptoj se çka është problemi –por shih porosinë më poshtë – "ne nuk mund të kemi ballkanas në ekip". Më vjen keq por shihet se duhet të largojmë CV-në tënde. Edhe njëherë, keqëardhje.

Datë: 15 maj 2005
Nga: Ian.Tait@eumik.org
To: xxxxx

Faleminderit për emailin e mëhershëm sot, në të cilën ofruan informata të mëtejme në lidhje me ndarjen e propozuar të punëve. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës Kërkon që të largoni CV-në e Xhevat Meha nga propozimi juaj, ose të zëvendësoni këtë njeri me kolegë nga regjioni jashtë Ballkanit; ose të leni John Hunter dhe Chafib Haklani të marrin punën pa auditorin e tretë. Pas pajtimit tuaj me këtë, vlerësim i mëtutjeshëm të jepet në ofertën tuaj.

Kjo kërkesë nuk është bërë sipas ndonjë informate ose shqetësimi të veçantë në lidhje me Xhevat Meha.

5) Përshkrimet që u paraqitën në pikën 4 më lart, kanë të bëjnë vetëm me një donator, i cili ishte dhe donatori më i madh për Kosovë. Përvoja të njëjta ka patur me pothuaj të gjithë donatorët dhe OJQ-të që financohen nga donatorë të ndryshëm në Kosovë, veç se dokumentimi i kësilloj

veprimesh ka qenë i vështirë. Është bindëse se, tek të gjithë donatorët që veprojnë në Kosovë, veprimtaria e SHMS-ve ka patur shtrirjen më të gjërë dhe më të fuqishme. Futja e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve në pjesën e donatorëve për SHMS-të, ka qenë terreni më atraktiv, për arsye se pa përdorur fonde të veta dhe me fonde të donatorëve, ka arritur të përmbush synimet dhe qëllimet e politikave të përcaktuara nga qendrat e vendosjes për SHMS-të.

KONTRATA ME AGJENSIONIN KOSOVAR TË MIRËBESIMIT

Autori, me datë 04.06.2008, nënshkruan kontratë me Agjensionin Kosovar të Mirëbesimit (AKM), për revizionin e investimeve të disa ndërmarrjeve të privatizuara me spin-off special, në vlerë gjithsej €13.000. AKM, përfundoi mandatin në fund të qershorit të vitit 2008 dhe u zëvendësua me Agjensionin Kosovar të Privatizimit (AKP), që në bazë të ligjit i mori përsipër të gjitha pasuritë dhe detyrimet që AKM kishte patur, dhe në këtë mënyrë edhe vazhdimin e zbatimit të kontratës me nr. të Prokurimit: 312-08-011-221. Derisa AKM ishte aktive, fillohet zbatimi i kontratës dhe përfundohet puna në revizionin e njërës ndërmarrje të privatizuar, mirëpo nuk kishte arritur që të kryhej pranim-dorëzimi i raportit, meqë zyrtarët ishin në përfundim të misionit dhe se kishin shumë angazhime tjera.

Në bazë të ligjit, AKP duhej që të pranonte raportin për revizionin e kryer dhe të organizonte kryerjen e revizioneve tjera. Mirëpo, në vend të kësaj, zyrtari i AKP-së në postin e Zv. Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së (Drejtor Ekzekutiv të AKP-së nuk ka patur për disa vite rresht) në fakt kryen veprime tjera. Në cilësinë e spiunit ose të bashkëpunëtorit të SHMS-ve, ky zyrtar nuk zbaton kontratën, bile kryen edhe detyrë tjetër duke dhënë urdhër që Departamenti i Prokurimit të mos pranojë aplikimet nga dy firmat në pronësi të autorit, në punët e shpallura nga AKP.

Kuptohet, të gjitha veprimet e paraqitura më lart, janë kryer në kundërshtim me ligjet në fuqi. Është me rëndësi të theksohet se deri në këtë ndërhyrje, firmat në pronësi të autorit, kishin shkallë të daljes fitimtar me 80%, në punët e shpallura nga AKM , në të cilat kryhej aplikimi, bile ka edhe letër reference pozitive nga AKM.

Në këtë vazhdë, përgatitet padi e cila dorëzohet me datë 28.04.2009, mirëpo Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkon që të rifillohen

procedurat juridike. Në përputhje me këtë, përgatitet dhe dorëzohet padi tjetër me datë 27.04.2010. Në lidhje me këtë padi, përmes avokatit të angazhuar në shkurt të vitit 2013, pranohet një Akvendim, i cili hedh poshtë kërkesëpadinë, si të pabazuar. Ky aktvendim nuk kishte kurrëfarë baze ligjore. Përveçse aktvendimi nuk kishte bazë ligjore, vetë dokumenti përmbante elemente të dyshimit të bazuar se ishte i falsifikuar, mirëpo edhe procesi i njoftimit të autorit ishte përcjellë me veprime tipike të veprimeve të SHMS-ve.

Dyshimi se aktvendimi është i falsifikuar, është i bazuar në dy fakte: nënshkrimi nga kryetari i Panelit në këtë aktvendim nuk përputhet me asgjë, me nënshkrimin e po të njëjtit në një dokument tjetër, si dhe se ky nënshkrim është vënë në kopjen në shqip, kurse autori i nënshkrimit është gjerman.

Njoftimi për pranimin e aktvendimit të gjykatës ishte përcjell me veprime të avokatit të angazhuar në këtë lëndë, që janë tipike të porositura nga SHMS-të. Filllimisht, avokati kishte njoftuar me një vonesë prej 11 ditësh, kurse afati për parashtrimin e ankesës ishte 21 ditë. Nga 10 ditët e mbetura, vetëm 6 ditë ishin ditë pune, kurse 4 ditë ishin fundjavë. Për vetëm 6 ditë pune, duhej që të gjendej avokat tjetër i duhur dhe duhej të përgatitej e dorëzohej ankesa, po kuptohet me një nguti që përveçse vështirë arrihet në kohë, së paku dëmton cilësinë e ankesës. Pëveç vonesës, avokati kishte kryer shumë veprime tjera që janë shkelje e detyrimeve ligjore që avokati ka ndaj klientit.

Këto shkelje janë të përmbledhura në shkresën që është përgatitur dhe dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit të Kosovës. Në lidhje me këto shkelje nga ana e avokatit, dorëzohen tri shkresa në Odën e Avokatëve të Kosovës, mirëpo që të tri përgjigjet e këtij institucioni paraqesin se nuk janë gjetur shkelje ligjore. Pas marrjes së këtyre përgjigjeve, me datë 24.02.2014, dorëzohet kallëzim në Prokurorinë e Shtetit të Kosovës dhe autori është në pritje të ftesës nga Prokuroria e Shtetit.

ANGAZHIMI NË PUNË NË PTK

Veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë dhe veprimet e drejtpërdrejta të SHMS-ve kundër autorit, sigurisht se kanë prodhuar rezultatet e veta. Për shkak të mjedisit për ushtrim të profesionit të revizorit të pavarur, të krijuar nga veprimtaria e SHMS-ve në Kosovë dhe për shkak të goditjeve të drejtpërdrejta, sigurisht se të hyrat e gjeneruara nga ushtrimi i profesionit të revizorit dhe konsulentit, u zvogëluan në përmasa shumë të mëdha. Të hyrat e gjeneruara nga ushtrimi i profesionit zbritën në nivelin, ku më e

lëverdishme ishte që të angazhohej me pagë të rregulltë, sesa të ushtrohej profesioni si zyrë e pavarur.

Nën kushtet e rënies së theksuar të të hyrave nga ushtrimi i profesionit, si i pavarur, shpallet një konkurs për postin e Menaxherit të Auditimit të Brendshëm në PTK. Autori konkurron dhe përzgjidhet në këtë post brenda Departamentit të Auditimit të Brendshëm të PTK-së. Në fillim të punës, për pothuaj se gati një vit, punët e angazhuara nga Drejtori i Departamentit ishin shumë të pakëta dhe ishin të përzgjedhura me kujdes që të kryhej kontroll dhe rishikim, në pjesët ku nuk kishte mundësi për hajni të parasë dhe pasurisë së PTK-së. Angazhimi i parë, ku kishte mundësi për të patur hajni, ishte rishikimi i një kontrate në mes të PTK-së dhe një kompanie tjetër.

Në rishikimin e kontratës, në mes të PTK-së dhe një kompanie tjetër, autori ishte vetëm njëri nga 3 zyrtarët e Auditimit të Brendshëm, të angazhuar në këtë rishikim. Të gjeturat e këtij rishikimi ishin se kishte patur shkelje ligjore dhe se në lidhje me këtë jepen edhe rekomandime konkrete. Në përpilimin e raportit, edhe pse ishte punuar së bashku në ekip, autori u dallua me këmbëngulësinë, që gjithë ajo që duhej të ishte pjesë e raportit, të përfshihet në raport dhe se gjithë ajo çka nuk duhej të ishte pjesë e raportit, të mos ishte pjesë e raportit.

Raporti në lidhje me kontratën e cekur më lart, ishte lëshuar me datë 8 tetor 2010 dhe pas një muaji aktivizohet mekanizmi i SHMS-ve, brendpërbrenda PTK-së. Ky mekanizëm kishte marrë trajtën ligjore, si Departamenti për Hetim i PTK-së. Roli dhe përgjegjësia e këtij departamenti ishte i njëjtë me rolin që kishte "SUP"-i" deri në përfundim të luftës së fundit, rol që ishte maltretimi fizik dhe psikologjik i individëve të përzgjedhur nga spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve. Meqë ky departament ka rol të njëjtë, më tutje në këtë trajtesë, fjala SUP do të përdoret në vend të fjalëve për këtë departament. SUP-i fillon me dërgimin e një kërkese për të gjithë të punësuarit në Departamentin e Auditimit të Brendshëm, të nxjerrin "Çërtifikatën e të Kaluarës Kriminale" nga Policia e Kosovës. Dallimi rreth përmbajtjes së raportit të revizionit në qëndrime nga anëtarët tjerë të ekipit, bëri që SUP-i të merr veprime shtesë, e fton për "bisedë informative".

Është e nevojshme, që për lexuesin të bëhet e kuptueshme se në bazë të ligjit për ndërmarrjet publike, Departamenti i Auditimit të Brendshëm dhe zyrtarët e këtij departamenti, janë përgjegjës para Komisionit (diku Komitetit) të Auditimit të Brendshëm dhe se ky komision/komitet/ ka të drejta dhe përgjegjësi ekskluzive për dhe ndaj zyrtarëve të auditimit të brendshëm. Po ashtu, në bazë të ligjit, roli dhe përgjegjësia e auditimit të brendshëm është

që të kryej kontrollin ndaj gjithë kompanisë, duke filluar nga Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes e më poshtë.

Në përgjigje të kërkesës së SUP-it, për të punësuarit e Departamentit të Auditmit të Brendshëm, përgatitet kërkesa për sqarim nga këta të fundit. Kjo kërkesë nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e departamentit, por jo edhe nga drejtori i Departamentit. Kërkesa i drejtohet Komisionit të Auditimit, mirëpo kurrë nuk merret ndonjë përgjigje, edhepse ishte kërkuar që përgjigjja të jepej në afatin më të shkurtë, të mundshëm. Jo vetëm se ky Komision nuk është përgjigjur, por as edhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ndaj kryerjes së paautorizar të hetimeve dhe shkeljeve tjera ligjore nga SUP-i.

Pas ngjarjeve të ndodhura, siç u përshkruan në paragrafët paraprakë, ishte një periudhë qetësie për një kohë, për t'u pasuar me kërkesë nga Komisioni i Auditimit për verifkim plotësues, lidhur me ekzistimin ose jo të një aneksi të kontratës së rishikuar. Ekipi i njëjtë nga Departamenti i Auditimit, kryen verifikimin dhe nxjerr konkluzion.

Në përpilimin e këtij raporti të këtij verifikimi, shtohen presionet. Vetëm falë këmbëngulësisë së autorit të këtij publikimi, dorëzohet raporti me konkluzionin e duhur. Ky qëndrim bëri që me automatizëm të aktivizohet SUP-i. Zyrtarë të SUP-it hyjnë në zyrën e Departamentit të Auditimit të Brendshëm, me pretekst të kontrollës. Autori i këtij publikimi i pyet se kush ishin dhe se a kishin ndonjë takim të caktuar me dikë nga departamenti. Meqë nuk kishin ndonjë takim, u kërkohet këtyre zyrtarëve që të dalin jashtë dhe të mos pengojnë punën në departament. Këta zyrtarë, pas kësaj, kishin përgatitur raport për paraqitje në Komision Disiplinor

Pas gjithë ndodhive të paraqitura në paragrafët paraprakë , vjen periudha e një qetësie para stuhisë. Në qershor të vitit 2011, autori i këtij publikimi njoftohet se është caktuar si i vetëm për të rishikuar një kontratë në mes të PTK-së dhe një kompanie tjetër private. Rishikimi i kontratës kryhet dhe raporti i lëshuar përfshin mendimin dhe rekomandimet ashtu siç duhej të ishin të paraqitura.

Pas këtij raporti, me nxitim aktivizohet SUP-i. Raporti për paraqitje në Komision Disiplinor ishte i gatshëm për t'u aktivizuar si mekanizëm për goditje. Me datë 27 korrik 2011, pranohet një email, ku kërkohet që të paraqitet në Komision Disiplinor. Në bazë të ligjit, vetëm Komisioni i Auditimit do të mund të thirrte në përgjegjësi për veprim a mosveprim, zyrtarin e auditimit të brendshëm, vetëm ky Komision ka të drejta dhe përgjegjësi ekskluzive.

Derisa ishte në pritje të përgjigjes nga eprorët e vet (eprorët sipas ligjeve të Kosovës dhe jo sipas ligjeve të SHMS-ve), kryhen formalitetet e nevojshme që të realizohet detyra e SHMS-ve. Komisioni Disiplinor nxjerr vendimin e duhur dhe "i propozon" Komisionit të Auditimit, që të kryej pjesën tjetër të detyrave.

Duhet të theksohet se në bazë të ligjeve të Kosovës, Komisioni i Auditimit nuk mund të marrë dhe nuk mund të zbatojë "propozime", që në fakt janë urdhëra nga struktura të ndërmarrjes, të cilat janë objekt i kontrollit nga ky Komision. Me vendim të Komisionit Disiplinor dhe sipas urdhërit për zbatim të këtij vendimi, autori i këtij publikimi, largohet nga Departamenti i Auditimit dhe degradohet në nivel më të ulët në punë dhe në pagesë.

Komisioni Disiplinor propozon, që Komisioni i Auditimit me pëshkëpunim me Departamentin e Burimeve Njerëzore, të ndërmarr veprimet dhe hapat e duhura dhe të domosdoshme, me qëllim të zbatimit të dispozitivit, respektivisht masat e propozuara disiplinore ndaj punetorit sipas nikes 2, 3 dhe 4, i cili eshte gjetur pergjegjës, për veprimet respektivisht, mosveprimet e tyja.

Në lidhje me shkeljet ligjore të paraqitura në paragrafët sipër është ngritur padi e cila në kohën e bërjes publike të këtij libri është duke u shqyrtuar nga institucionet gjyqësore.

ANGAZHIMI NË PUNË NË POSTËN E KOSOVËS

PTK brendpërbrenda saj përbëhej nga tri njësi biznesore: Telefonia Fikse, Telefonia Mobile dhe Shërbimet Postare. Me qëllim të përgatitjes për privatizim, Qeveria merr vendim për ndarje të shërbimeve postare nga PTK, si një ndërmarrje e vetme biznesore, me emrin Posta e Kosovës, e cila filloi veprimtarinë më 1 gusht 2012. Meqë pas degradimit të vitit 2011, autori i këtij publikimi ishte caktuar të punojë në Njësinë e Shërbimeve Postare, me rastin e ndarjes, konsiderohej si punëtor i Postës së Kosovës.

Emërimi i i një zyrtari të ri në postin e Drejtorit Ekzekutiv të PTK-së, bëri që të përshpejtohen proceset për privatizimin e PTK-së. Ndarja e shërbimeve postare nga pjesa tjetër e PTK-së, ishte kushti që duhej plotësuar për nisjen e privatizimit. Për këtë arsye, Drejtori Ekzekutiv i PTK-së, emëron autorin ,në prill të vitit 2012 si Menaxher përgjegjës për kryerjen e kësaj ndarjeje. Puna e filluar në muajin maj për ndarjen e shërbimeve postare nga PTK , u

përfundua në fund të korrikut, ku Posta e Kosovës (PK) filloi veprimtarinë e vet si e pavarur më 1 gusht 2012.

Angazhimi në procesin e ndarjes dha mundësia që zotësitë profesionale të dalin në sipërfaqe dhe të jenë të njohura për të tjerët. Këto zotësi u vërejten nga të gjithë të emëruarit anëtarë të Këshllit Drejtues të PK-së. Dy, nga tre anëtarët e Komisionit të Auditimit të Brendshëm të PK-së, propozojnë që autori i këtij publikimi të emërohet nga Këshilli Drejtues, si njëri nga 4 zyrtarët kryesorë të PK-së, në rolin e Ushtruesit të Detyrës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm. Njëri, nga tre anëtarët e Komisionit të Auditimit, jo vetëm që kishte kundërshtuar propozimin për emërim, por gjithashtu e kishte futur në izolim të plotë profesional. Izolimi ishte realizuar duke bllokuar që asnjë punë, ose angazhim konkret professional, të mos kryhet nga autori, në postin në të cilin ishte emëruar.

Izolimi profesional kishte zgjatur deri në përzgjedhjen e një individi tjetër, si Zyrtar i Auditimit të Brendshëm. Përzgjedhja ishte kryer përmes shpalljes së konkursit, edhe pse kushtet e parapara në konkurs për përzgjedhje nuk ishin respektuar. Ky individ nuk i plotësonte kushtet e parapara me konkurs, veçse kishte një cilësi/vlerë që i jepte përparësi në krahasim me autorin e këtij publikimi, kishte punuar në Prishtinë si inspektor financiar gjatë sundimit të Sllobodan Millosheviqit. Përvoja e punës si inspektor financiar, në kohen e Millosheviqit, jep dëshmi të pakontestueshme dhe besim të plotë dhe të pacenuar, se ky kandidat i kryen detyrat në mënyrën më të mirë të mundshme. Nuk mbetet tjetër pëveçse të ngritet padi kundër kësaj përzgjedhjeje, gjë që është bërë dhe është në pritje të thirrjes së seancës së parë.

VEPRIMET E SHMS-ve EDHE NGA VETË SERBIA

Autori, duke patur çdoherë në mendje veprimet dhe veprimtarinë e SHMS-ve në Kosovë, vazhdimisht ka mbajtur qëndrime dhe është sjellur ashtu që maksimalisht të minimizojë mundësitë e goditjeve nga SHMS-të, është kujdesur vazhdimisht që të mos u jep rast dhe mundësi për goditje. Me gjasë, kjo i ka shtyrë SHMS-të që të aktivizojnë mekanizma nga vetë Serbia, për të bërë goditje më të fuqishme.

Derisa ishte me punë në PTK, në postin e Menaxherit të Auditimit të Brendshëm, në tri javët e fundit para se të sillej për nënshkrim vendimi për degradim dhe largim nga Departamenti i Auditimit, kontaktohet përmes emailit nga dy firma nga Serbia duke i ofruar punë në poste të larta

menaxheriale. Përderisa firma e parë ofron postin e menaxherit dhe refuzohet, aktivizohet firma tjetër që ofron post edhe më të lartë, atë të Drejtorit Financiar dhe Këshilltarit Personal tek Drejtori Gjeneral për Kosovë, në Prishtinë. Bile kjo firma e dytë kryen edhe intervistimin përmes telefonit, duke kërkuar nga autori që "veç për kureshtje", të provojë të folmen në gjuhën serbe, edhe pse gjuhë pune, ishte deklaruar gjuha angleze.

Për më pak se një orë, nga përfundimi i bisedës telefonike, siç u paraqit më lart, në zyrë vjen për t'u nënshkruar pranimi i vendimit për degradim dhe largim nga departamenti. Gjatë gjithë jetës së vet profesionale, janë të vetmet këto dy raste kur autori i këtij publikimi kontaktohet nga ndonjë firmë nga Serbia, për t'i ofruar punë dhe poste konkrete.

Sigurisht, filiali i SHMS-ve për Kosovë, ka menduar se me dorëzimin e vendimit për degradim dhe largim nga departamenti, do të pranohet posti më i lartë dhe privilegjet e ofruara nga firma serbe. Ky kalkulim ishte bërë nga SHMS-të, meqë kjo firmë ishte private, ku pas disa muajve do të hedhte në rrugë, dhe pastaj spiunët e bashkëpunëtorët e tyre këtu në Kosovë, do të kontaktonin autorin e këtij publikimi, për t'i thënë se a më të mirë jemi ne a serbët nga Serbia, ne vetëm të degraduam, kurse këta të hodhën në rrugë. Pjesë nga komunikimet në lidhje me ofrimin e posteve nga këto firma, janë në vijim të këtij publikimi (shih gjithashtu të përkthyer në vijim).



Përkthim:

Nga: Ivana Rako
Për: Xhevat Meha
Datë: 11 gusht 2011

Faleminderit për interesimin tuaj. I kam bashkangjitur disa përshkrime të punës poshtë për ju që të shkoni. Dëshiroj të përmendi disa gjëra:

1. Klienti jonë është Coca-Cola
2. Pozita është Prishtinë, Kosovë
3. Ne mundemi os të ose intervistë në skype me kamerë për javën tjetër

,.....



Përkthim:

Nga: Xhevat Meha
Për: Ivana Rako
Datë 16 gusht 2011

Dëshiroj të ju faleminderoj për kontaktimin në këtë rast. Me që pozita është për Drejtor Financiar, nuk jam i interesuar të përcjell këtë mundësi më tutje. Edhe njëherë faleminderit për kontaktimin dhe e vlersoj atë tepër shumë.

emID=I218441087_208&trk=COMM_NI

edIn

Messages Invitations

Reply Forward Archive Delete Report Spam

RE: Cell phone number

Luka Kadić Recruiter at NIS Gazprom Neft
To: Xhevat Meha
Date: August 19, 2011

You replied to this message:

Dear Mr Meha,

thank you for this mail. Is it ok that I call you at 3:00 PM today at your line phone number?

On 08/19/11 5:06 AM, Xhevat Meha wrote:

Dear Luka,

My cell phone number is +37744195089. For health reason, I prefer to use land line rather than cell phone. Could you please try on +38138220904. I will at this number until 4:00 this afternoon.

Regards,
Xhevat

On 08/19/11 4:58 AM, Luka Kadić wrote:

Dear Mr Meha,

can you send me your cell phone because i would like to call you as soon as possible

Përkthim:

Nga: Luka Kadic, Rekrutues në NIS Gazprom Neft
Për: Xhevat Meha
Datë: 19 gusht 2011

Faleminderit për emailin tuaj. A është në rregull të ju thërras sot në ora 3:00 në ldihjen e numrit tuaj.

Me datë 19/08/11, Xhevat Meha shkruan:

Numri im i telefonit është +37744195089. Për shkaqe shëndetsore, preferoj të përdori lidhjen tokësore ne vend të mobilit. A mund të provoni në +38138220904. Do të jam në këtë numër deri në 4:00 pasdite.

Me datë 19/08/11, Luka Kadic shkruan:

A mund të më dërgoni numrin tuaj të mobilit sepse dëshiroj të ju thërras sa më shpejt që është e mundur.



Latest Headlines Customize Links Windows Marketplace

uestion... FT World business, finance, and political n...

Archive Spam Delete Move to ▾ Labels ▾ More ▾

your expectations from our company considering pay.

I would appreciate if you could answer me as soon as you can.

Best regards,
Luka Kadić

Reply Forward Invite Luka Kadic to chat

Xhevat Meha to Luka 21 Aug Reply

Dear Mr Kadic,

I would like to thank you for contacting regarding the potential employment. I am also very thankful for the phone conversation. Regretably have to say that at present I am satisfied with the position I have at the moment and am not interested to pursue further on this occassion. I wish you manage to find a suitable candidate to fulfil the position.

Regards,
Xhevat Meha

- Show quoted text -

Reply Forward

Luka Kadic to me 22 Aug Reply

Dear Mr Xhevat,
thank you for opportunity to discuss with you our job offer.
I'm very sorry to hear that you are not interested, but i'm also glad
to hear that you are satisfied with your current job.
Maybe there will be a chance for cooperation in future.
Until than
best regards,
Luka Kadić

Përkthim:

Nga: Xhevat Meha
Për: Luka Kadic
Datë 21 gusht 2011

Dëshiroj të ju falenderoj për kontaktimin në lidhje me mundësinë e punësimit. Unë jam gjithashtu falenderues për bisedën telefonike. Me keqardhje duhet të ju them se tani për tani jam i kënaqur me pozitën që e

kam dhe nuk jam i interesuar të vazhdoj më tutje në këtë rast. Dëshiroj që ju të arrini të gjeni kandidat të përshtatshëm për përmbushjen e pozitës.

Nga: Luka Kadic
Për: Xhevat Meha
Datë: 22 gusht 2011

Faleminderit për mundësin që të diskutoj me ju për ofertën tonë për punë. Më vjen shumë keq të ndëgjoj se ju nuk jeni të interesuar, por unë gjithashtu i kënaqur të ndëgjoj se ju jeni të kënaqur me punën tuaj të tanishme. Ndoshta do të ketë rast që të bashkëpunojm në të ardhmen.

POSTET NË BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS

Autori, deri më tani ka pothuaj gjithë përvojën e vet të punës dhe gjithë kualifikimet e veta të deritanishme në fushën e financave. Është një nga themeluesit e bankave të para në Kosovë, ka mbi 15 vjet përvojë pune si revizor financiar dhe mbi të gjitha ka 5 vite përvojë pune të drejtpërdrejtë, në sistemin financiar të Mbretërisë së Bashkuar. Të gjitha këto kualifikime dhe përvoja të punës, ishin nxitje për të konkurruar për udhëheqje me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) si institucion i Kosovës për qeverisjen me sistemin financiar të Kosovës.

Duke u nisur nga këto, në shkurt të vitit 2011, konkurrohet, për postin e Guvernatorit të BQK-së. Sikur edhe në të gjitha proceset tjera, edhe në procesin e përzgjedhjes së Guvernatorit, SHMS-të kryen veprimet e nevojshme, që të përzgjedhet kandidati i tyre. Vetëm falë të drejtave ekzekutive të ICO-së, nuk arrihet që SHMS-të, të emërojnë kandidatin e tyre. Mirëpo, SHMS-të arritën që të eliminojnë kandidatët të cilët nuk dëshironin që as të hyjnë në listën e ngushtë. Dobësitë dhe shkeljet ligjore gjatë procesit të emërimit të Guvernatorit, u përmblodhën shkurtimisht, dhe ju dërguan me një shkresë qarkore të gjitha institucioneve kryesore të Kosovës dhe atyre ndërkombtare, si dhe të gjitha mjeteve të informimit.

Më vonë, BQK, në qershor të vitit 2013, shpall kokurs për postin e Zëvendës Guvernatorit ku poashtu merret pjesë në konkurrim. BQK injoron gjithë kualifikimet dhe përvojat e punës së autorit dhe vendos për një kandidat tjetër.

Po ashtu, në nëntor të vitit 2013, BQK shpall konkurs për Shef të Auditimit të Brendshëm, për të cilin post poashtu konkurrohet. BQK injoron gjithë kualifikimet dhe përvojat e punës dhe vendos për një kandidat tjetër.

PËRBALLJA NË VAZHDIMËSI NGA VITI 2001 E DERI TANI NË BANKËN PËR BIZNES

Banka për Biznis (BpB) është banka e dytë vendore, e themeluar në Kosovë, në prill të vitit 2001. Në atë kohë autori i këtij publikimi ishte duke punuar si revizor financiar në Londër, me banka dhe institucione tjera financiare, anëtare të Berzës Financiare të Londrës. Përmes kontaktit që kishte me profesorin Nexhmi Rexha, ftohet që të angazhohet në sektorin financiar të Kosovës, si njëri nga themeluesit e BpB-së, ftesë e cila u pranua, ku edhe tani vazhdon të jetë njëri nga themeluesit e BpB-së. Të qenët aksionar themelues i kësaj banke më vete, në fakt ka bartur dhe vazhdon të bartë ballafaqim në vijimësi me spiunët dhe bashkëpunëtorë të SHMS-ve dhe jo diçka tjetër.

Kur autori kishte marrë ftesën për t'u bashkuar me grupin që ishte duke punuar për themelimin e bankës, me të drejtë, ishin marrë parasysh kualifikimet, përvojat, dhe punët të fituara në Londër, shfrytëzimi i të cilave do të ishin të dobishme për vetë bankën dhe për Kosovën. Gatishmëria ekzistonte, dhe ashtu do të ndodhte sikur të mos ekzistone veprimtaria e fuqishme e SHMS-ve në Kosovë.

Asnjëherë deri më tani, autori nuk ka marrë miratimin nga Banka, për ushtrimin e ndonjë funksioni në Bankë, edhe pse ka qenë dhe vazhdon të mbetet personi me përvojat dhe kualifikimet më të larta në Kosovë, për punë në sektorin financiar. Qysh nga fillimi i veprimtrisë së bankës, ka filluar edhe konfrontimi me spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve, konnfrontimi në mes të koncepteve, logjikës dhe veprimeve praktike të autorit të këtij publikimi në njërën anë; dhe koncepteve, logjikës dhe veprimeve konkrete të spinëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, në anën tjetër.

Ndryshe nga konfrontimet tjera, konfrontimi në BpB, ishte një lloj bashkëjetimi me konfrontim, për faktin se spiunët dhe bashkëpunëtorët e SHMS-ve nuk kishin mundësi të eliminimit ose të izolimit.

Izolimi, të paktën jo izolimi i plotë, nuk ka ndodhur për faktin se autori nuk pranonte të shiste aksionet e veta dhe duke qenë aksionar, i jepej edhe rasti për mundësi të konfrontimit.

Në këtë konfrontim, secila palë luftonte dhe vazhdon të luftojë me armët që ka. Pala e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, luftonte me armët e veta që kishte: me moszbatime të ligjit, me mashtrime dhe manipulime të të tjerëve (viktimave), me vjedhje të pasurisë së Bankës, me marrje të mbështetjes dhe ndihmës nga institucionet e Kosovës (siç janë Banka Qendrore e Kosovës, Prokuroria e Shtetit të Kosovës, Gjyqësia e Kosovës etj), me bashkëpunimin dhe ndihmën e spiunëve dhe bashkëpunëtorëve tjerë të SHMS-ve, jashtë bankës, e të ngjajshme. Në anën tjetër, autori luftonte dhe vazhdon të luftojë, me armët që kishte dhe që i ka: me zbatime të plota të ligjit, me përgatitje përkatëse profesionale, me sjellje dhe qëndrime parimore, të pastra e korrekte ndaj të tjerëve.

Në vitet e para të punës së BpB-së, Banka udhëhiqej nga një ish- zyrtar i lartë, me pedigre komuniste dhe grupi i tij, të cilët si rëndom në Kosovë, shfrytëzonin bankën për përvetësime personale. Kjo bëri që aksionarët tjerë të organizohen kundër këtij grupi. Edhe pse ky grup kishte ndihmë dhe mbështetje të fuqishme nga SHMS-të, arrihet që ky ish- zyrtar i lartë, komunist, dhe grupi i tij të largohen nga Banka, dhe të ngritet padi ndaj tyre. Kjo është arritur sigurisht për faktin se institucionet e Kosovës mbikëqyrëshin nga UNMIK-u, me gjithë dobësitë që UNMIK-u kishte. Kjo padi është ngritur në vitin 2005 dhe ende nuk është mbajtur ndonjë seancë përmajtësore, edhe pse keqpërdorimet në Bankë ishin me disa miliona.

Pas largimit nga Banka, në vitin 2006, të këtij grupi, nuk vonoi shumë dhe SHMS-të krijuan grup të ri të aksionarëve në Bankë. Ky grupi i ri u formua në vitin 2008. Edhe ky grup vazhdoi me praktika të grupit paraprak, me kryerjen e veprimeve në përputhje me detyrat që SHMS-të kanë në Kosovë, dhe, njëjtë si më parë të kenë mbështetjen institucioneve të Kosovës siç janë Banka Qendrore e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjyqësia e Kosovës, etj.

Ky grup ishte më mirë i organizuar dhe kishte mbështetje edhe më të fuqishme nga SHMS-të, sesa grupi paraprak. Ky grup ende ka fuqinë më të madhe në Bankë, edhe pse tani në vitin 2014, është arritur që nga Banka të largohet "koka" i cili ka patur rol qendror në këtë grup. Autori i këtij publikimi, me kohë ka reaguar me shkrim tek institucionet e Kosovës siç janë Banka Qendrore e Kosovës, Ministria e Financave, Qeveria e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, etj. Vetëm muajve të fundit banka ka filluar të mos jetë nën kontroll të SHMS-ve.

VONIMI I TRAJTIMIT TË PADIVE NGA GJYKATA SI MOHIM I DREJTËSISË

Autori deri më tani ka dorëzuar në gjykata gjithsej 7 padi për raste të ndryshme. Deri në kohën e përgatitjes së këtij publikimi, gjykatat nuk kanë përmbyllur asnjë nga paditë e ngritura në gjykata.
Numri i padive të paraqitura mund të duket se është i madh, por realisht është shumë i vogël, në të vërtetë, është tepër i vogël në krahasim me numrin e padive që do të duhej ngritur, në kushte normale të një shteti funksional dhe efektiv ligjor.

Paditë e dorëzuara në gjykata, datojnë nga viti 2009 dhe u takojnë rasteve të ndryshme. Është me rëndësi të theksohet se lëndet që kanë të bëjnë me punësimin, janë të deklaruara nga gjykata si lëndë që duhet të trajtohen me prioritet, kurse autori ka dorëzuar padi në vitin 2011 dhe ende nuk është zgjidhur kontesti. Po ashtu, paditë e dorëzuara në vitin 2009 , nga gjykata është paraparë që të fillojnë të trajtohen në vitin 2013, mirëpo për padinë e dorëzuar nga autori në vitin 2009 , ende nuk është thirrur seanca.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Tani, 15 vite pas largimit të forcave të sigurisë dhe të administratës së Serbisë, në kushte normale, do të duhej të kishim shtetin e Kosovës funksional, do të duhej të kishim institucione shtetërore funksionale, do të duhej të kishim ekonomi, arsim, shëndetësi, dhe përgjithësisht kulturë, shumë më të zhvilluar sesa realisht kemi. Populli ka qenë në pritje dhe vazhdon të presë, që nivelet e kënaqshme të zhvillimit të arrihen sa më parë. Populli lëviz ngadalë, mirëpo kur lëviz nuk gabon.

Botërisht është e ditur se, tanipërtani institucionet e Kosovës nuk kanë funksionalitetin dhe nuk kanë efikasitetin e pritur. Është momenti i duhur që bijtë dhe bijat e popullit të ndërmarrin veprime të cilat do të mundësonin ngritjen e funksionalitetit dhe të efikasitetit të institucioneve të Kosovës, kjo para se populli të lëviz. Populli në njëfarë mënyre është lodhur nga të lëvizurit, pra është koha e punës institucionale tani.

Veprimtaria e msheftë kundër lirisë së Kosovës, si e tillë që është, kryhet nga individë pjesëtarë të shoqërisë Kosovare. Niveli i pranisë së veprimtarisë së SHMS-ve, është nivel i mohimit të lirisë së Kosovës. Individët e angazhuar si spiunë a bashkëpunëtorë të SHMS-ve, janë të angazhuar kundër lirisë së Kosovës. Shoqëria Kosovare duhet që të veprojë kundër të gjithë atyre që mohojnë lirinë e pjesëtarëve të saj. Kur niveli i shtrirjës së mohimit të lirisë së Kosovës, ka përmasat e 720 spiunëve zyrtarë me betim, që bëjnë sa 70 batalione ushtarake, me 50.000 ushtarë, është e vështirë për t'u trajtuar. Kur niveli i shtrirjes së mohimit të lirisë së Kosovës arrinë përfishirje të krerëve të institucioneve të Kosovës, përfshirë partitë politike, trajtimi bëhet edhe më i vështirë. Kur diçka është e domosdoshme, nuk duhet të merren parasysh vështirësitë.

Domosdoshmëria se duhet të kryhet trajtimi i veprimtarisë së SHMS-ve, në Kosovë, bëhet më e fuqishme po që se vërtet dëshirojmë që të mos na përsëritet historia. Lufta për lirinë e Kosovës nga Serbia nuk ka pushuar asnjëherë. Kjo luftë është filluar nga Ahmet Delia me sopatë, është vazhduar nga grupet kryengritëse kaçake me Kryekomandantin, Azem Bejtë Galica dhe grupet tjera kaçake, është vazhduar pas Luftë së Dytë Botërore, me brigadat kryengritëse me Kryekomandantin Shaban Polluzha, është vazhduar me veprimtarinë e grupeve të mshefta, të djathta, është vazhduar me veprimtarinë e grupeve të mshefta të majta, është vazhduar me luftën e strukturave të organizuara ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftë e cila kulmoi me lirinë e Kosovës. Përpjekjet e qindar mijëra grave dhe burrave, luftëtarë të lirisë së Kosovës, nga sëpata e Ahmet Delisë e deri të

mitralozi e bombat e Adem Jasharit, që kulmuan me lirinë e Kosovës, nuk duhet lejuar që të mohohen tani kur Kosova ka shtetin e vet, tani kur Kosova ka institucionet e veta!

Duhet, që gjithsesi prania e veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë të zvogëlohet, dhe atë deri në eliminim të plotë. Duhet, që gjithsesi individët e kyçur në veprimtarinë e SHMS-ve, të trajtohen nga shoqëria e Kosovës. Trajtimi më i mirë i veprimtarisë së SHMS-ve në Kosovë, dhe githashtu i spiunëve dhe bashkëpunëtorëve të SHMS-ve, bëhet përmes institucioneve përkatëse e relevante të Kosovës.

Po tani kemi institucione të Kosovës që nuk janë funksionale dhe nuk janë efikase, çka të bëhet?

Duhet që institucionet e Kosovës gjithsesi të arrijnë nivelin e pritur të funksionalitetit dhe efikasitetit.

Duhet që shoqëria Kosovare të ballafaqohet me të këqijat që ka brenda shoqërisë së vet. Individët pjesëtarë të shoqërisë së Kosovës, të kyçur në veprimtarinë e SHMS-ve, në fakt janë bartës të vlerave shoqërore, njerëzore, të dëmshme për shoqërinë e Kosovës. Rrena, mashtrimi, tradhtia, moszbatimi i ligjit dhe tipare tjera të këtij lloji janë sinonim i të keqes, por janë edhe themeli mbi të cilin ndërtohet dhe zhvillohet veprimtaria e SHMS-ve. Kryerja e këtyre të këqijave, ka arritur nivele shumë shqetësuese në këto vitet e fundit. Janë kryer dhe janë duke u kryer aq shumë të këqija sa që po të ndriçohen plotësisht, qytetari i zakonshëm, përveç se do të shtangët nga mosbesimi, do të iritohet tejmase. Ky iritim, sigurisht se pastaj e ndërlikon trajtimin e veprimtarisë së SHMS-ve.

Është e nevojshme të bëhet e njohur se, autori gjatë të jetuarit në Londër, ka nxjerrë shumë të kuptuara, në mesin e të cilave është edhe kjo: shoqëria angleze ka shumë faza të zhvillimit me të cilat krenohet, mirëpo, në po këto të njëjta faza, ka edhe veprime të këqija e budallaqe nga individë pjesëtarë të po kësaj shoqërie, me të cilat ata vetë kënaqen së qeshuri. Trajtimi i duhur institucional i veprimarisë së SHMS-ve, së paku, sigurisht se pas një kohe do të bëjë të mundur që të kënaqemi së qeshuri me veprimet e këqija si veprime budallaqe.

Partitë politike duhet, që si formë e organizimit institucional për ndryshime shoqërore, të kenë nivelin e pritur të funksionalitetit dhe efikasitetit dhe atë secila parti politike që angazhohet për zhvillimin e Kosovës. Zhvillimi i Kosovës mund të bëhet vetëm kur Kosova është e lirë dhe e papenguar.

Niveli i mohimit të lirisë është edhe nivel i mohimit të mundësisë për zhvillim. Duhet që secila dhe çdonjëra nga partitë politike në Kosovë të sigurohet se në radhët e veta nuk ka spiunë zyrtarë me betim a bashkëpunëtorë të SHMS-ve, dhe atë për fillim, së paku të sigurohet që kryesia e partisë dhe kryetari i partisë të jenë plotësisht të përjashtuar nga veprimtaria e SHMS-ve.

Duhet që, ... Shumë punë duhet!

SHKURTESAT DHE SQARIMET

SHMS – Shërbimet e Mshefta Serbe
USB – Universal Serial Bus (Bartësi Serik Univerzal)
d.m.th. – do me thënë
UDB – Uprava Drzavne Bezbednosti (Drejtoria Shtetërore e Sigurisë)
SDB – Sluzba Drzave Bezbednosti (Shërbimi i Sigurimit Shtetëror)
RDB – Resor Drzave Bezbednosti (Resori i Sigurimit Shtetëror)
SUP – Sekretariat Unutrasni Poslove (Sekretariati për Punë të Brendshme)
KPMG – Kompani ndërkombëtare për revizion financiar dhe konsulencë
PTK – Post Telekomi i Kosovës
PK – Posta e Kosovës
UÇK – Ushtrua Çlirimtare e Kosovës
SHIK – Shërbimi Informativ i Kosovës
SIA – Sigurimi i Atdheut
LPK – Lëvizja Popullore e Kosovës
UNMIK – United Nations Mission i Kosova (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
DM – Deutche Mark (Marka Gjermane)
EUR – Monedha e Bashkimit Evropian
LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës
PNDSH – Partia Nacional Demokratike Shqiptare
LKJ – Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë
APJ – Armata Popullore e Jugosllavisë
BVI – Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit
Ernst & Young - Kompani ndërkombëtare për revizion financiar dhe konsulencë
KEK – Korporata Energjetike e Kosovës
SHA – Shoqëri Aksionare
ACCA - The Association of Chartered Certified Accountants (institucion profesional për kontabilitet dhe revizion financiar i Mbretërisë së Bashkuar)
USAID – Organizatë për Ndihmë dhe Zhvillim e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
CV- Curriculum Vita
Barents Group – Kompani amerikane për konsulencë
BE – Bashkësia Evropiane
EU – European Union (Bashkësia Evropiane)
Windows – Lloj i sistemit operativ kompjutoristik
Apple - Lloj i sistemit operativ kompjutoristik
Oracle - Lloj i sistemit operativ kompjutoristik
OJQ – Organizatë Jo-Qeveritare
AKM – Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit

AKP – Agjensioni Kosovar i Privatizimit
BQK – Banka Qendrore e Kosovës
Auditim – Fjalë e përdorur për hetimin, kontrollimin dhe vërtetimin e transaksioneve financiare dhe zbatimit të ligjit në organizatat biznisore, ndërmarrjet publike dhe organizatat tjera.
ICO – Internatinal Civil Office (Zyra Civile Ndërkombëtare)
BpB – Banka për Biznis

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327.84

Meha, Xhevat
Syni dhe mendja e qytetarit : përballë shërbimeve të mshefta serbe / Xhevat Meha. - Prishtinë : Fishta, 2015. – 202 f. ; 24 cm.

Parathënie : f. 17-20.

ISBN 978-9951-576-21-5

Xhevat Meha u lind në vitin 1964, në Prekaz të Poshtëm, Komuna Skenderaj. Në vitin 1989 u diplomua në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Kosovës. Pas diplomimit, punoi si profesor në Shkollën e Mesme Ekonomike në Skenderaj, deri në shkurt të vitit 1992, kur emigroi në Londër.

Në Londër, në vitin 1996, u regjistrua për të studiuar kontabilitetin dhe revizionin financiar në ACCA (The Association of Chartered Certified Accountants – një nga institucionet më të fuqishme ndërkombtare për kontabilitet dhe revizion financiar). Në po këtë vit fillo të punojë në KPMG (një nga katër firmat më të fuqishme botërore për revizion financiar dhe konsulencë me klientë, anëtarë të Bursës Financiare Londineze. Këtu punoi deri në kthimin e tij në Kosovë në vitin 2001. Në vitin 2000, përfundoi studimet në ACCA dhe bëhet anëtar i këtij institucioni (ekuivalent me shkallën Magjistër i Shkencave) ku vazhdon të jetë deri sot.

Në fund të shtatorit të vitit 2001, kthehet në Kosovvë, dhe në verë të vitit 2002 ,themelon Zyrën për ofrim të shërbimeve profesionale të revizionit dhe konsulencës, ku punoi deri në vitin 2010. Gjatë kësaj kohe përmes kësaj zyre, ka kryer mbi 100 revizione financiare me klientë, si KEK, Trusti Pensional, Ndërmarrjet Publike të Ujit, Mbeturinave dhe Kanalizimeve, ndërmarrje shoqërore dhe private, Organizata Jo Qeveritare, vendore dhe ndërkombtare, etj. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka punuar në projekte të shum, ta të ofrimit të konsulencës për institucionet shtetërore, institucionet publike dhe ndërmarrjet private.

Në vitin 2009 punësohet në PTK, ndërsa nga viti 2012 punon në Postën e Kosovës.

Libri "Syni dhe Mendja e Qytetarit përballë Shërbimeve të Mshefta Serbe", është libri i parë i autorit. Xhevat Meha, ka një numër të madh të prononcimeve për mediet në Kosovë dhe ka disa shkrime për gazeta dhe punime tjera, ku njëra nga këto punime ka marrë shpërblim nga Shoqata e Bankave të Kosovës. Të gjitha këto prononcime dhe punime mund të gjenden në faqen e internetit www.luani.co.

ISBN 978-9951-576-21-5

9 789951 576215

€ 5